



# INTERKULTURA

Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane  
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки  
Journal of the Faculty of Human Sciences

4





# **INTERKULTURA**

**Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane**  
**Научно списание на Факултетот за хуманистички науки**  
**Journal of the Faculty of Human Sciences**

## **4**

**Përmbledhje punimesh nga Konferenca IV Shkencore Ndërkombëtare për Interkulturën me temë: "Gjuha, letërsia dhe komunikimi ndërkulturor" mbajtur më datën 22.11.2023 në UNT, Shkup.**

**Збирка на трудови од IV Меѓународна научна konferenciја за интеркултурата со тема: „Јазикот, литературата и интеркултурната комуникација,, одржана на ден 22.11.2023 година во УМТ, Скопје**

**Conference proceedings from the IV International Scientific Conference on Interculture on the topic: "Language, Literature And Intercultural Communication" held on 11/22/2023 at MTU, Skopje.**

**Shkup, 2024**

## INTERKULTURA

# 4

Botues / Editor  
**Fakulteti i Shkencave Humane,  
Universiteti “Nënë Tereza” Shkup**

**Redaktori përgjegjës / Editor-in-chief  
Prof. dr. Mustafa IBRAHIMI**

**Këshilli botues / Editorial board:**

Mustafa IBRAHIMI  
Izer MAKSUTI  
Arta TIKA – BEKTESHI  
Rilind MAHMUDI  
Edona VINCA  
Qatip ARIFI

**Redaksia ndërkombëtare / International editorial office**

Niko QAFOKU (SHBA)  
Mateo MANDALA (Itali)  
Robert MAGARI (SHBA)  
Laszlo MARÁCZ (Hollandë)  
Vilson DE MARKU (Austri)  
Emil LAFE (Shqipëri)  
Kristaq JORGO (Shqipëri)  
Begzad BALIU (Kosovë)  
Shpresa HOXHA (Kosovë)  
Goran BASHIQ (Serbia)  
Zeqirja NEZIRI (Maqedonia e Veriut)  
Vebi BEXHETI (Maqedonia e Veriut)  
Rubin ZEMON (Maqedonia e Veriut)  
Izaim MURTEZANI (Maqedonia e Veriut)

# INTERKULTURA

Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane  
Научно списание на Факултетот за хуманистички науки  
Journal of the Faculty of Human Sciences

4/2024

**Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga:**

Република Северна Македонија  
Министерство за образование и наука



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Shtypur në shtypshkronjën "GRAFODEN" – Shkup, 2024  
Tirazhi: 300 kopje



## PËRMBAJTJA

HYRJE – ВОВЕД - INTRODUCTION .....	7
POSTERAT E KONFERENCAVE / ПОСТЕРИТЕ ПО КОНФЕРЕНЦИИ/ CONFERENCE POSTERS.....	8
ZEQIRJA NEZIRI	
<b>FATI I TË FOLMES SË ARBNESHËVE TË ZARËS .....</b>	<b>9</b>
MUSTAFA IBRAHIMI	
<b>EKOLINGUISTIKA PËRBALLË INTERKULTURALITETIT NË NJË SHOQËRI SHUMËGJUHËSHE .....</b>	<b>15</b>
VEBI BEXHETI	
<b>TOKA ME SHIJE, ULLIRI PAK TË HIDHUR PAK TË ËMBËL .....</b>	<b>23</b>
AZIS K. POLLOZHANI	
<b>INTERKULTURALIZMI NJË PARADIGMË E RE E SHOQËRIVE MULTIETNIKE .....</b>	<b>35</b>
BEGZAD BALIU	
<b>PIKËPAMJET E LINGUISTIKE TË PROFESOR SHEFKI SEJDIUT: PREJ RRAFSHIT ILIRO-ARBRORO-SHQIPTARË DERI TE UNIVERSI GLOBALIST .....</b>	<b>39</b>
ISMET OSMANI	
<b>PËRKTHIMI SI AKT NDËRKULTUROR .....</b>	<b>51</b>
IZAIM MURTEZANI	
<b>LIGJËRIME IMAGOLOGJIKE APO KONSTRUKTI DISKURZIV I TJETRIT DHE TJETËRSISË (SIPAS DISA SHEMBUJVE TË EPOISIT HEROIK SHQIPTAR DHE TË SLLAVËVE TË JUGUT).....</b>	<b>57</b>
TEUTA ARIFI	
<b>INTERKULTURA, NJË KONCEPT PROGRESIV I RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE. 73</b>	

RUBIN ZEMON

**NDËRKULTURALIZËM PA KULTURË DHE KONTAKTE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 89**

QATIP ARIFI

**ANGLISHTJA SI LINGUA FRANCA (ALF) DHE APLIKIMI I SAJ NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES SË KËSAJ GJUHE ..... 97**

AJTEN HAJDARI-QAMILI

**LEKSIKU NDËRKULTUROR DHE NDËRGJUHËSOR NË TË FOLMEN URBANE TË STRUGËS ..... 107**

SEJDI M. GASHI

**ROLI I MEDIEVE NË (MOS) NGRITJEN E PRESTIGJIT TË SHQIPES (GJUHA SI IDENTITET PERSONAL E NACIONAL) ..... 115**

AGRON VRANGALLA

**ANALIZË KRITIKE E DISKURISIT: GJUHA E ALBIN KURTIT NË INTERVISTËN E DHËNË PËR CNN (31 MAJ)..... 121**

KOSOVARE KRASNIQI

**IMAGOLOGJIA DHE PËRKTHIMI LIBRAT E PËRKTHYERA NGA GJUHA SHQIPE NË ATË BULLGARE ..... 139**

ARTA TIKA BEKTESHI

**CHOOSING THE CORRECT N-WORD OR NPI - A CASE STUDY WITH ALBANIAN STUDENTS ..... 149**

VIKTORIA ELENOVA

**ПРОЦЕСИТЕ КОН ВОСПРИЕМАЊЕ И ПРЕДАВАЊЕ СТРАНСКИ ЈАЗИК ..... 159**

JORDANA ШЕМКО-ГЕОРГИЕВСКА - ЕЛЕНА ПРЕНЦОВА

**ПРЕВОД НА БИЛИНГВАЛНИТЕ И ДВОДОМНИТЕ КУЛТУРОЛОШКИ ЕЛЕМЕНТИ ВО ПРИМЕРИ ОД ЧИКАНА ПОЕЗИЈАТА ..... 169**

JETLIRA BEQIRI

**INTERKULTURALITETI NË EMËRTIMET E LIDHJEVE FAREFISNORE NË DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE ..... 183**

## Нурје – Вовед - Introduction

Më datën 22 nëntor 2023 u mbajt Konferenca IV Shkencore Ndërkombëtare, në organizim të Fakultetit të Shkencave Humane, i cili u themelua këtë vit, në kuadër të cilit veprojnë 4 programe studimore: Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Gjuhë dhe letërsi Gjermane, Përkthim AL-MK-EN dhe Përkthim AL-MK-GER, me gjithsej 40 studentë. Konferenca me temën boshte “Gjuha, kultura dhe komunikimi ndërkulturor” është vazhdimësi e tre konferencave të mëparshme për komunikimin interkulturore. Konferenca I (2018) Dialogu dhe diversiteti ndërkulturor; K-II (2019) Trashëgimia kulturore dhe ndërkultura dhe K-III (2020) Arsimi ndërkulturor (2020). Punimet janë botuar në revistën “Interkultura”. Punimet do të zhvillohen në dy seanca, do të prezantohen 26 kumtesa, për gjuhën, letërsinë komunikimin ndërkulturor, alfabetin, që përkon edhe me 115 vjetorin e Kongresit të Alfabetit të gjuhës shqipe.

На ден 22 ноември 2023 се одржа IV Меѓународна научна конференција, организирана од Факултетот за хуманистички науки, еден од трите најнови факултети при УНТ. Во склоп на овој факултет постојат 4 студиски програми: Англиски јазик и книжевност, Германски јазик и книжевност, , Преведување АЛ-МК-ЕН и Преведување АЛ-МК-ГЕР со вкупно 40 студенти.

Денешнава конференција „Јазикот, културата и интеркултурна комуникација“ е продолжение на претходните 3 конференции поврзани со интеркултурата, и тоа: К-1 се одржа во (2018) со тема Дијалогот и интеркултурната различност; К-2 (2019) Културното наследство и интеркултурата и К-3 (2020) Интеркултурното образование. Излагањата ќе се одвиваат во две секции каде ќе се претсавата 26 излагачи со научни излагања од разни области, поврзани со јазикот, литературата и меѓукултурната комуникација. Овој датум конреспондира и со 115-годишнината од Албанската азбука што се одржа во Битола.

**On November 22, 2023, the IV International Scientific Conference was held**, organized by the Faculty of Humanities, which was founded this year, within which 4 study programs operate: English Language and Literature, German Language and Literature, Translation AL-MK-EN and Translation AL-MK-GER, with a total of 40 students. The conference with the central theme "Language, culture and intercultural communication" is the continuation of three previous conferences on intercultural communication. Conference I (2018) Intercultural dialogue and diversity; K-II (2019) Cultural Heritage and Interculture and K-III (2020) Intercultural Education (2020). The papers were published in the journal "Interkultura". The presentations will be held in two sessions, 26 papers will be presented, on language, literature, intercultural communication and the alphabet, which also coincides with the 115th anniversary of the Alphabet Congress of the Albanian language.

Prof.dr.Mustafa Ibrahim / Dekan i FSHH Декан на ФХН / Dean of the FHS

Posterat e konferencave / Постерите по конференции/ Conference posters

Universiteti "Nënë Tereza" / Универзитет „Мајка Тереза, / University "Mother Teresa"

KONFERENCA E 1-RE NËRKOMBËTARE PËR GJUHËT DHE KOMUNIKIMIN NËRKULTUROR  
1-та МЕЃУНАРОДНА КОНФЕРЕНЦИЈА ЗА ЈАЗИЦИТЕ И ИНТЕРКУЛТУРНАТА КОМУНИКАЦИЈА  
1-st INTERNATIONAL CONFERENCE ON LANGUAGES AND INTERCULTURAL COMMUNICATION

Organizuar nga Fakulteti i Shkencave Humane  
Organized by Faculty of Human Sciences

3-4  
2018  
Universiteti "Nënë Tereza"  
Шкопје, Македонија e Veriut  
www.unt.edu.mk

**ICONLIC 2018**

**DIALOGU DHE DIVERSITETI NËRKULTUROR  
ДИЯЛОГОТ И МЕЃУКУЛТУРНАТА РАЗЛИЧНОСТ  
DIALOGUE AND INTERCULTURAL DIVERSITY**

Universiteti "Nënë Tereza" / Универзитет „Мајка Тереза, / University "Mother Teresa"

KONFERENCA E 2-RE NËRKOMBËTARE PËR GJUHËT DHE KOMUNIKIMIN NËRKULTUROR  
2-та МЕЃУНАРОДНА КОНФЕРЕНЦИЈА ЗА ЈАЗИЦИТЕ И ИНТЕРКУЛТУРНАТА КОМУНИКАЦИЈА  
2-nd INTERNATIONAL CONFERENCE ON LANGUAGES AND INTERCULTURAL COMMUNICATION

Organizuar nga Fakulteti i Shkencave Humane  
Organized by Faculty of Human Sciences

8  
2019  
Universiteti "Nënë Tereza"  
Шкопје, Македонија e Veriut  
www.unt.edu.mk

**ICONLIC 2019**

**TRASHËGIMIA KULTURORE DHE INTERKULTURA  
КУЛТУРНОТО НАСЛЕДСТВО И ИНТЕРКУЛТУРАТА  
CULTURAL HERITAGE AND INTERCULTURE**

Universiteti "Nënë Tereza" / Универзитет „Мајка Тереза, / University "Mother Teresa"

Konferenca e 3-të Nërkombëtare për Gjuhët dhe Komunikimin Nërkulturor  
3-та Меѓународна конференција за јазиките и интеркултурната комуникација  
3-rd International Conference on Languages and Intercultural Communication

Organizuar nga Fakulteti i Shkencave Humane  
Organized by Faculty of Human Sciences

26  
2020  
Universiteti "Nënë Tereza"  
Шкопје, Македонија e Veriut  
www.unt.edu.mk

**ICONLIC 2020**

**ARSIMI NËRKULTUROR  
ИНТЕРКУЛТУРНО ОБРАЗОВАНИЕ  
INTERCULTURAL EDUCATION**

Universiteti "Nënë Tereza" / Универзитет „Мајка Тереза, / University "Mother Teresa"

Konferenca e 4-të Nërkombëtare për Gjuhët dhe Komunikimin Nërkulturor  
4-та Меѓународна конференција за јазиките и интеркултурната комуникација  
4-th International Conference on Languages and Intercultural Communication

Organizuar nga Fakulteti i Shkencave Humane  
Organized by Faculty of Human Sciences

22  
2023  
Universiteti "Nënë Tereza"  
Шкопје, Македонија e Veriut  
www.unt.edu.mk

**ICONLIC 2023**

**GJUHA, LETËRSIA DHE KOMUNIKIMI NËRKULTUROR  
ЈАЗИКОТ, ЛИТЕРАТУРАТА И ИНТЕРКУЛТУРНАТА КОМУНИКАЦИЈА  
LANGUAGE, LITERATURE AND INTERCULTURAL COMMUNICATION**

UDC 811.18'282(497.581.1)  
Punim studimor**Zeqirja NEZIRI**Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup  
[zeqirjaneziri@gmail.com](mailto:zeqirjaneziri@gmail.com)**FATI I TË FOLMES SË ARBNESHËVE TË ZARËS****The fate of the Arbanac speech in Zadar  
Судбината на арбанашкиот говор во задар**

## 1. Shpërngulje dhe vendosje e organizuar

Në fillim të shekullit XVIII (në vitet 1726: 23 mars 1726 dhe 10 – 31 maj; si dhe me 11 mars 1733), në afërsi të Zarës u vendosën, në mënyrë të organizuar mbi 84 familje (me rreth 450 anëtarë) të ardhura nga katundet Brisk, Ljare (kr. Livari) dhe Shestan të Malësisë së Krajës, midis Ulqinit dhe Shkodrës (Erber 1997: 39; Stipçević 2011: 1). Shestani<sup>1</sup> sot është Bashkësi Lokale e komunës së Tivarit. Në juridiksionin e vet këto fshatra: Ljarje, Brisk (i Sipërm dhe i Poshtëm), Muriq (i Sipërm dhe i Poshtëm), Besë, Pinç, Gjuraç, Nënmal, Pecaj, Bujgër, Dedaj, Lukaj, dhe Gurëz.

Mbi itinerarin e shkëlqes dhe të vendosjes së këtyre banorëve në afërsi të Zarës u kujdes kryepeshkvi i Tivarit Vicko Zmajević (Perast, 23. XII. 1670 – Zarë, 1745), i cili ishte nga këto anë të Dalmacisë. Ai në bashkëpunim me organet venedikase të pushtetit të atëhershëm të Zarës u kujdes që këtyre të ardhurve t'i sigurojë mirëqenie: shtëpi dhe tokë pune, sepse këta shqiptarë, në vendin e tyre kishin pasur "një shkallë të caktuar të mirëqenies sociale" dhe nuk kishin ardhur që Republikës së Venedikut "t'i kërkojnë lëmoshë, por tokë që të punonin dhe të jetonin ndershmërisht" (Erber 1997: 16). Vendin ku u vendosën, këta të ardhur do ta quanin *Arbënesh* (kr. *Arbanasi*, it. *Borgo Erizzo*). Kjo pjesë toke në afërsi të Zarës ishte djerrinë dhe e pabanuar. Arbnesët menjëherë pas vendosjes, shumë shpejtë e kthyen në tokë pjellore dhe prej saj siguronin mjetet e jetesës. Ata, po ashtu menjëherë përfshihen në jetën kulturore e sociale të mjedisit. Brenda një shekulli dyfishohet numri i banorëve. Në vitin 1853, Arbneshi kishte mbi 900 banorë, ndërkaq në vitin 1880 ky numër arrin në 2000 banorë (Erber 1997: 39).

Në lagjen Arbneshe (kr. *Arbanasi*) të Zarës jetojnë midis 200 dhe 300 banorë, që në komunikim të përditshëm shërbehen me të folmen arbneshe.

<sup>1</sup> (<https://sq.wikipedia.org/wiki/Shestani>).

Kjo e folme është një variant arkaik i gegërishtes veriperëndimore. Këtij grupi i bashkohen edhe rreth 1000 banorë të tjerë që dijnë diçka nga kjo e folme dhe, kohë pas kohe shërbehen me të. Numri i banorëve që për nga ndjenja e përkatësisë kombëtare e konsiderojnë veten arbneshtë, është shumë më i madh. Mirëpo, këta të fundit në komunikim të përditshëm nuk e përdorin këtë të folme, por gjuhën kroate. Sipas përkatësisë kombëtare këta arbneshtë, përgjithësisht janë deklaruar kroatë dhe, si të tillë i kanë dhënë ndihmesë të konsiderueshme shkencës, artit dhe kulturës; estradës dhe sportit kroat. Një pjesë jo fort e vogël e arbneshtëve të Zarës janë ndërë italianë. Rreth 1500 prej tyre, pas Luftës së Dytë Botërore janë deportuar në Itali. Shumë arbneshtë edhe sot flasin tri gjuhë: arbnisht, kroatisht dhe italisht.

## 2. Kujdesi për kultivimin dhe ruajtjen e arbnishtes nga zhdukja

Në vitin 2014 mediat e shkruara kroate, si: “Dnevnik”, “Novi list” dhe “Slobodna Dalmacija” japin alarmin e rrezikimit të zhdukjes së të folmes së arbneshtëve. Shkak i këtij alarmi është shkrimi i gazetës britanike “*Telegraph*”. Kjo gazetë kishte botuar konstatimin e portalit britanik GoEuro, të përgatitur nga Christopher Moseley, autor i Atlasit të gjuhëve të rrezikuara botërore të UNESCO-s. Aty shkruhej se midis 24 gjuhëve më të rrezikuara evropiane janë edhe tri gjuhë të Kroacisë, njëra prej të cilave është edhe e folmja e arbneshtëve të Zarës.

Informacioni i gazetës britanike “*Telegraph*” tërhoqi vëmendjen e intelektualëve kroatë dhe zgjoi interes shumë të madh midis studiuesve të fushave të ndryshme. Për këta tre shekuj prej vendosjes së shqiptarëve në Arbneshtë të Zarës, asnjëherë më parë si në këtë dhjetëvjeçar të dytë të shekullit XXI nuk është folur dhe nuk është shkruar qaq shumë për gjuhën, mënyrën e jetesës, traditat dhe identitetin e tyre etnik; si dhe mbi ambientimin e tyre në mjedisin kroat dhe ndihmesën e tyre të konsiderueshme dhënë dijes e jetës shkencore, kulturore, jetës artistike e sportive kroate. Por dhe mbi fatin e ardhshëm si të identitetit, ashtu edhe të gjuhës së tyre.

Në të gjitha gazetatat parafrazohet deklarata e sekretarit të Shkencave të Filologjisë të Akademisë së Arteve dhe të Shkencave Kroate (HAZU) August Kovačec. Ai shpjegon se e folmja e arbneshtëve të Zarës është formë arkaike e gegërishtes veriperëndimore, të zonës prej nga vinin këta arbneshtë.

Krahas intervistave me studiues arbneshtë e kroatë (Bernard Kotlar, Maximiliana Barančić<sup>2</sup>) botohen edhe një numër artikujsh studimorë (siç është artikulli antropologjik e sociologjik i autorëve: A. Artić & D. Cakić, M. Novosel & Ante Petrović & Adi Tufek<sup>3</sup>; D. Babić, Š. Selimović<sup>4</sup>), si dhe libra,

---

<sup>2</sup> <https://hrcak.srce.hr/32730>.

<sup>3</sup> Anamarija ARTIĆ, Dorotea CAKIĆ, Martina NOVOSEL & Ante PETROVIĆ & Adi TUFEK, Studija slučaja ugroženoga jezika: arbanaški u suvremenom kontekstu: *Antropološki almanah*, nr. 3/2019: 9-20:

siç është studimi monografik sociolinguistik: *Arbnishtja në udhëkryq: vitaliteti dhe ruajtja e një gjuhe minoritare*<sup>5</sup> i autoreve L. Šimičić, K. Bilić Meštrić botuar në Zagreb më 2018.

Për arbneshtë deri tani janë bërë studime historiografike (T. Erber 1883) dhe etnografike (A. Stipčević 2011) ose gjuhësore e kulturore historike (N. Jokl, C. Taliavini, I. Ajeti) e leksikografike (Krstić 1987, Barančić 2013). Kohëve të fundit me studimin e arbnishtes dhe të identitetit të arbneshtëve të Zarës me sukses po merret arbneshtja dr. sc. Maximilijana Barančić (Karuc, lindur më 1947), e cila përveç veprimtarisë kulturore ka botuar edhe dy libra: (1) „*Udžbenik arbanaškoga govora s arbanaško-hrvatskim i hrvatsko-arbanaškim glosarom / Libri i të folmes arbneshe me glosarin arbnisht – kroatisht dhe kroatisht arbnisht*“ (2017)<sup>6</sup> dhe „*Hrvatsko-arbanaški rječnik s gramatikom / Fjalori kroato-arbnisht me gramatikë*“<sup>7</sup>, (2020) i cili përmbledh rreth 6.500 fjalë.

Në studimet e fundit e folmja arbneshe dhe lidhshmëria e saj me identitetin arbnesht janë studiuar edhe nga kornizat teorike të sociolinguistikës. Lucija Šimičić dhe Nikola Vuletić (2016), në hulumtimin e përfatjesimit shoqëror të arbneshtëve konstatojnë se identiteti arbnesht mbijeton përkundër vdekjes të së folmes dhe se bëhet i veçantë për banorët e vendbanimit Arbnesht me prejardhje joarbneshe. Krahas çështjeve të identitetit arbnesht në librin „*Arbanaški na raskrižju: vitalitet i održivost jednog manjinskog jezika / Arbnishtja në udhëkryq: vitaliteti dhe ruajtja e një gjuhe minoritare*“ (2017) të autoreve Klara Bilić Meštrić dhe Lucija Šimičić preken edhe çështje të sasisë së pranisë aktive të arbnishtes në bashkësi (d.m.th. *vitaliteti i saj*) dhe përgjithësisht a është e mundshme që arbnishtja t'i shpëtojë vdekjes (d.m.th. ruajtja dhe kultivimi e saj).

[https://www.academia.edu/44744843/Igra\\_%C5%BEivota\\_prilozi\\_antropologiji\\_smrti\\_i\\_%C5%BEalovanja](https://www.academia.edu/44744843/Igra_%C5%BEivota_prilozi_antropologiji_smrti_i_%C5%BEalovanja)

<sup>4</sup> Zadarski Arbanasi: integracija, asimilacija, identitet – od doseljenja do početka 21.stoljeća: *Tratise and documents journal of ethnic studies / Razprave in gradivo revija za narodnostna vrpašanja*: 82 / 2019, p. 111–130: <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=748296> dhe <https://rigtd.si/en/clanki/zadarski-arbanasi-integracija-asimilacija-identitet-od-doseljenja-do-pocetka-21-stoljeca/> (Marrë me: 26.08.2020).

<sup>5</sup> ŠIMIČIĆ, Lucija; BILIĆ MEŠTRIĆ, Klara, *Arbanaški na raskrižju: vitalitet i održivost jednog manjinskog jezika / Arbanasi at the crossroads: Vitality and sustainability of a minority language*: <https://www.bib.irb.hr/919676>

<sup>6</sup> Slavica Šarović, *Arbanaški govor ovjekovječen u udžbeniku*: <https://nacionalnemanjine.hr/arbanaški-govor-ovjekovjecen-udžbeniku/>; 20. travnja 2018.

<sup>7</sup> M. Gugić, Prvi i jedini hrvatsko-arbanaški rječnik s gramatikom kojeg je napisala dr. Maximilijana Barančić predstavlja spas ovog posebnog jezika, 27. listopada 2020.

<https://zadarski.slobodnadalmacija.hr/zadar/djirada/prvi-i-jedini-hrvatsko-arbanaški-rječnik-s-gramatikom-kojeg-je-napisala-dr-maximilijana-barancic-predstavlja-spas-ovog-posebnog-jezika-1053665>

Studimi i arbnesëve të Zarës nga perspektiva antropologjike në artikullin “*Studija slučaja ugroženoga jezika: arbanaški u suvremenom kontekstu*”<sup>8</sup> / “*Studimi i rastit të gjuhës së rrezikuar: arbnishtja në kontekst bashkëkohor*” analizon pikëpamjet ndaj të folmes arbneshe nga vetë arbnesët dhe nga banorët e tjerë, joarbnesë të Zarës.

Në këtë studim autorët kanë konstatuar se konstruimi i identitetit arbnesh ndërtohet në mbështetje të tri pikëpamjeve themelore: (a) narrativi i trashëguar kolektiv i shpërnguljes në shekullin XVIII në rrethinën e Zarës i shërben përforcimit të identitetit të përbashkët arbnesh; (b) ruajtja e formave të mbiemrave; dhe (c) koncentrimi i bashkësisë në një hapësirë relativisht të ngushtë.

### Përfundim

Arbnesët e Zarës deri në prag të 300-vjetorit të vendosjes në rrethinë të Zarës në Dalmaci arritën ta ruajnë të gjallë kujtesën për atdheun e të parëve, si dhe identitetin kombëtar e gjuhësor, edhe pse nuk dinin shkrim e lexim dhe, për 200 vjet pa pasur kontakt me atdheun e të parëve.

Në fillim shënuam thënien e Tulio Erberit në parathënien e librit “*Kolonia shqiptare e Arbëneshit pranë Zarës*”. Ai aty u uron jetëgjatësi arbnesëve dhe gjuhës së tyre. Në pjesën e parë të punimit ky urim i Erberit kontestohet, ndërkaq në pjesën e dytë bëhet fjalë mbi përpjekjet e arbnesëve për t’i qëndruar asimilimit dhe sidomos zhdukjes të së folmes së tyre. Shtrohet pyetja: a do të arrijnë ta sfidojnë kohën e zhvillimit teknologjik dhe digjital?

Studiuesja arbneshe Maximiljana Karuc Barançiq në një artikull të vitit 2006 shkruante: “Një pjesë e popullsisë në Zemunik është asimiluar në popullsinë e atjeshme vendëse duke harruar edhe gjuhën. Këta janë, p. sh. Prendët, Shestanët, Qurkoviçët, Palekët etj. Pjesa tjetër e popullsisë përgjatë këtyre 280 vjetëve është përpjekur ta ruajë identitetin e saj etnik e gjuhësor. Me 10 maj 2006 u shënua 280-vjetori i vendosjes së tyre në periferi të qytetit të Zarës. Nuk ka qenë e lehtë, sidomos në fillim, sepse nuk kanë pasur kishën, shkollën e tyre dhe mënyra e vetme e ruajtjes së identitetit dhe gjuhës së tyre ka qenë rruga gojore”<sup>9</sup>.

Në fund imponohet pyetja: vallë do të mjaftojnë *Libri i mësim* dhe *Fjalori* të Maksimiliana Barançiqit, si dhe edhe për sa kohë arbnesët e Zarës do të flasin me krenari mbi ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar etnik e gjuhësor!?

---

<sup>8</sup> Anamarija ARTIĆ, Dorotea CAKIĆ, Martina NOVOSEL & Ante PETROVIĆ & Adi TUFEEK, Studija slučaja ugroženoga jezika: arbanaški u suvremenom kontekstu: Antropološki almanah, nr. 3/2019: 9-20: [https://www.academia.edu/44744843/Igra\\_%C5%BEivota\\_prilozi\\_antropologiji\\_smrti\\_i\\_%C5%BEalovanja](https://www.academia.edu/44744843/Igra_%C5%BEivota_prilozi_antropologiji_smrti_i_%C5%BEalovanja)

<sup>9</sup> Maximiljana Barančič, Arbanasi i etnojezični identitet: *Croatica et Slavica Iadertina*, Zadar, IV (2008): 1; <https://hrcak.srce.hr/32730> (01.03.2021).

## Personalitete arbneshe:

- prof. Arturo Cronia – sllavist italian, profesor universiteti  
 Pavle Dešpalj – dirigjent dhe kompozitor, anëtar i rregullt i HAZU  
 Valter Dešpalj – profesor i violonçelit në Akademinë e Muzikës në Zagreb  
 Maja Dešpalj Bjegović – violiniste dhe pedagoge e muzikës, që nga viti 1987  
 profesoreshë në Akademinë e Muzikës në Zagreb  
 Msgr. Simeone Duca (Šime Duka) – dikur sekretar i Arkivave të Vatikanit  
 dhe kontribues i Zarës dhe Arbanasit.  
 Giuseppe-Pino Gjergja – basketbollist – trajner  
 Josip Gjergja – politikan dhe diplomat kroat, ndihmësministër i punëve të  
 jashtme të ish-RSFJ-së  
 Dr. Albino Jović – kardiolog  
 Dr. Ratimir Kalmeta – kroat i njohur. gjeograf dhe pishtar i Shkencës së  
 gjeografisë kroate, gjuhëtar, pedagog dhe publicist  
 Božidar Kalmeta – politikan – kryetar shumëvjeçar i Zarës, ministër në  
 Qeverinë e Republikës së Kroacisë  
 Bernard Kotlar – autor i CD-së multimediale “Zadarski Arbanasi”, fitues i  
 “Stemës së qytetit të Zarës” (2002).  
 Đani Maršan – këngëtar, kompozitor, diplomat kroat  
 Ivica Matešić Jeremija - oficer ushtarak është i përfshirë në veprimtari  
 ushtarake diplomatike në Romë, Prishtinë, Shkup,  
 Prof. Dr.Sc. Hrvoje Mazija, profesor emeritus i Fakultetit të Mjekësisë  
 Veterinare, mbajtës i Urdhrit Kroat të Danicës dhe çmimit Oton Kučera.  
 Msgr. Ivan Prenda – Kryepeshkopi i 68-të i Kryedioqezës së Zarës  
 Dushko Modrinić – aktor kroat  
 Dr. Kruno Krstić - sociolog dhe filolog, redaktor i Enciklopedisë Kroate,  
 autor i një fjalori që dallon gjuhën serbe dhe kroate.  
 prof. Ph.D. Aleksandar Stipčević - profesor emeritus i Fakultetit Filozofik në  
 Zagreb, albanolog.  
 prof. Ph.D. Ennio Stipčević - muzikolog, akademik i HAZU  
 prof. Dr. Nikša Stipčević - romancier, akademik, nënkryetar i SANU-së  
 Dr. Ivo Perović - Prefekt i Rajonit të Splitit, Ndihmësministër i Punëve të  
 Brendshme, Ban i Sava Banovinës, Regjent i Mbretërisë së Jugosllavisë  
 për të miturin Pjetri II. (1934 - 1941)  
 Tomislav Ivčić – këngëtar

kroat <https://hr.wikipedia.org/wiki/Arbanasi/13/11/2023>

### Abstrakt

Në lagjen Arnesh (kr. *Arbanasi*) të Zarës jetojnë midis 200 dhe 300 banorëve të cilët në komunikim të përditshëm shërbehen me të folmen arbneshë. Kjo e folme është një variant arkaik i gegërishtes veriperëndimore. Këtij grupi i bashkohen edhe rreth 1000 banorë të tjerë që dinë diçka nga kjo e folme dhe kohë pas kohe shërbehen me të. Numri i banorëve që për nga ndjenja e përkatësisë kombëtare e konsiderojnë veten arbneshë, është shumë më i madh. Mirëpo, këta të fundit në komunikim të përditshëm nuk e përdorin këtë të folme, por gjuhën kroate. Sipas përkatësisë kombëtare këta arbneshë, përgjithësisht janë deklaruar kroatë dhe, si të tillë i kanë dhënë ndihmesë të konsiderueshme shkencës, artit dhe kulturës; estradës dhe sportit kroat. Një pjesë jo fort e vogël e arbneshëve të Zarës janë ndierë italianë. Rreth 1500 prej tyre, pas Luftës së Dytë Botërore janë deportuar në Itali. Shumë arbneshë edhe sot flasin tri gjuhë: arbnisht, kroatisht dhe italisht. Në vitin 2014 mediat e shkruara kroate, si: "Dnevnik", "Novi list" dhe "Slobodna Dalmacija" japin alarmin e rrezikimit të zhdukjes së të folmes së arbneshëve. Shkak i këtij alarmi është shkrimi i gazetës britanike "Telegraph". Kjo gazetë kishte botuar konstatimin e portalit britanik GoEuro, të përgatitur nga Christopher Moseley, autor i Atlasit të gjuhëve të rrezikuara botërore të UNESCO-s. Aty jepej e dhëna se midis 24 gjuhëve më të rrezikuara evropiane janë edhe tri gjuhë të Kroacisë, njëra prej të cilave është edhe e folmja e arbneshëve të Zarës.

### Abstract

Between 200 and 300 residents live in the Arnesh neighborhood (Arbanasi district) of Zara, who use the Albanese language in their daily communication. This speech is an archaic variant of north-west Geg. This group is joined by about 1000 other residents who know something of this language and use it from time to time. The number of residents who, in terms of their sense of national belonging, consider themselves Albanians, is much larger. However, the latter do not use this dialect in daily communication, but the Croatian language. According to their national affiliation, these Albanians have generally declared themselves Croatian and, as such, have given considerable help to science, art and culture; Croatian entertainment and sports. A not very small part of the inhabitants of Zara have felt Italian. About 1,500 of them were deported to Italy after the Second World War. Many Albanian even today speak three languages: Albanian, Croatian and Italian. In 2014, the Croatian print media, such as: "Dnevnik", "Novi list" and "Slobodna Dalmacija" gave the alarm of the danger of extinction of the Albanian language. The cause of this alarm is the article of the British newspaper "Telegraph". This newspaper had published the findings of the British portal GoEuro, prepared by Christopher Moseley, author of the UNESCO Atlas of World Languages in Danger. It was given information that among the 24 most endangered European languages there are also three languages of Croatia, one of which is the language of the Albanians of Zara.

ISSN 2671-3004

UDC 81'27  
811.18'27(450)

Punim studimor

**Mustafa IBRAHIMI**  
Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup  
mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk

## **EKOLINGUISTIKA PËRBALLË INTERKULTURALITETIT NË NJË SHOQËRI SHUMËGJUHËSHE**

### **Ecolinguistic versus interculturality in a multilingual society**

Еколингвистиката наспроти интеркултуралитетот во едно  
многујазично општество

Zhdukja e gjuhëve të vogla, ka marrë aq hov të madh sa që OKB-ja, UNESCO-ja, Këshilli i Evropës dhe disa organizata shkencore, kanë filluar të shprehin brengosje për fatin e gjuhëve të rrezikuara. Studiuesit më pesimistë parashikojnë se gjatë këtij shekulli do të zhduket 90 për qind e rreth shtatë mijë gjuhëve që fliten aktualisht. Në analizat e gjuhëtarëve, kjo temë është relativisht e re.

Raportet midis gjuhëve si një lloj raporti midis popujve, shoqërive dhe shteteve sot shtrohet si një nga pyetjet më aktuale të sociolinguistikës, që në aspektin teorik, shpesh shqyrtohen nga disiplina e re – Ekologjia gjuhësore ose ekolinguistika. Kjo disiplinë gjuhësore në qendër të studimeve të veta ka vënë raportin midis gjuhëve të mëdha dhe të vogla, dhe me shumë mund paraqitet si një disiplinë e re gjuhësore për mbrojtjen e gjuhëve më të vogla, duke kundërshtuar trendet aktuale që të krijohet një botë me një gjuhë, një shkrim, një komb, një ideologji, pra si një botë me një “supergjuhë”, “superkomb” apo “superideologji” që me të madhe do t'i zhdukte gjuhët e vogla. Këto gjuhë në fund mund të shndërrohen si gjuhë për përdorim privat, më pas ato janë kandidat për muzeologji gjuhësore (Leman 1996:185-191), deri sa të ndodhe kjo, ato gjuhë mbijetojnë dhe shpesh ushqehen nga dialektet e tyre.

Kjo disiplinë nuk ka ndonjë traditë të gjatë shkencore, nuk ka edhe definicion të pranuar dhe të stabilizuar. Ekologjia gjuhësore, e cila për herë të parë e përdori studiuesi E. Hekel që në vitin 1866, si lëndë të përbashkët

ka raportin midis gjuhës dhe mjedisit në të cilin gjuha ekziston dhe funksionon. Ekologjia gjuhësore, filloi të krijohet me të njëjtin emër me librin e gjuhëtarit norvegjez E.Haugen *Ekologjia gjuhësore* (Haugen 1972), por që në vitet e njëzeta kur me një shpejtësi të madhe filluan të zhduken gjuhët, sidomos parë nga aspekti sociolinguistik u kuptua gjendja alarmuese e gjuhëve të vogla dhe filloi interesimi për ekologjinë gjuhësore, por jo aq sa duhet.

Objekt i ekologjisë gjuhësore është pikërisht ky raport midis këtyre gjuhëve, duke përfshirë para së gjithësh problemet gjeografike, etnike, institucionale, gjuhësore si dhe probleme tjera si: ndryshimi i një gjuhe, braktisja, vdekja e gjuhës, pixhinizimi, kreolizimi, huazimet, diglosia, dialektologjia urbane e tj. (Asher 1994:v.3:391). Kur flitet dhe shkruhet për rrezikimin e gjuhëve të vogla nga ana e gjuhëve të mëdha, sot në qendër të vëmendjes është anglishtja si gjuha më e përhapur jashtë vendit, si një gjuhë me të cilin zhvillohet 75 % e korrespondencës në botë, kurse mbi 80 % të informatave kompjuterike shkëmbehen poashtu në gjuhën angleze (Edwards 1994:41). Nga ana tjetër E. Haugen vuri në dukje se lënda e ekolinguistikës është arsimiti, gjegjësisht ndërveprimi midis gjuhëve të njerëzve të vobektë dhe njerëzve të pasur. Ne vlerësojmë se detyra kryesore e ekolinguistikës së vendit tonë është të gjurmojë, dokumentojë dhe zbulojë gjuhët që janë nën kërcënim, ose kërcënohen nga pabarazia klasore).

Në vitin 2000, për shkak të frikës së fundshekullit, u publikuan shumë studime mbi të ardhmen linguistike të planetit. Disa prej këtyre studimeve kishin tituj alarmues dhe terme të tmerrshme, si për shembull: *vdekja e gjuhëve* (e autorit David Crystal), *glotofagjia, linguocidi, lufta midis gjuhëve*, *“Vdekja dhe rilindja e gjuhëve”*, *“Ndryshimet e gjuhës si trashëgimia e njerëzimit”*.etj. Këtu mund të shtohen edhe terme metaforike si *dhunë ndaj gjuhëve*, *keqpërdorime ndaj gjuhëve*, *vrasje të gjuhëve*, *Zërat e heshtjes*” dhe *“Në gjurmët e gjuhëve që po zhduken”* etj. (Crystal 2003), që mund të ngrihet edhe si çështje e së drejtës ndërkombëtare. Për fat të keq nuk ekziston Shoqatë për mbrojtjen e gjuhëve të vogla, ose shoqatë për mbrojtjen e dhunës që ushtrojnë popujt e mëdha ndaj popujve të vegjël. Nga ana tjetër, nën patronazhin e OKB-së ekzistojnë shoqata për mbrojtjen e peshkaqenëve, tigrave ose llojeve të ndryshme të kafshëve ose bimëve. Një nga shkaqet e ekzistimit të këtij paradoksi është fakti se shoqëritë e pasura për aktivitetet e tyre humane dhe për ta tërhequr vëmendjen e opinionit publik më lirë u vjen të investojnë dhe të merren me mbrojtjen e ndonjë specie biologjike sesa shpëtimin nga zhdukja e ndonjë gjuhe të vogël ose ndonjë popull të vogël e të padëgjueshëm.

Megjithatë, një nga problemet kryesorë të ekologjisë gjuhësore është raporti i gjuhëve të mëdha ndaj atyre të vogla, për të cilën ende nuk është gjetur një model universal sociolinguistik si të zgjidhet ky raport, që sipas studiuesve ende nuk janë pjekur kushtet që ai model të artikulohet bindshëm (Kuznjecova 1997:4). Edhe pse sot gjuhët e vogla janë më të shumtë

se sa gjuhët e mëdha, kjo nuk garanton që ata do të mbijetojnë. Për shebull sipas Institutit të Vrojtimit Botëror, disa nga të dhënat për gjuhët e kërcënuara përmbledhen më poshtë: Amerika e Veriut ë Rreth 80% e 260 gjuhëve vendore që akoma fliten në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada nuk janë duke u mësuar prej fëmijëve. Për shebull, gjuha Ejak në bregun e Alaskës ka mbetur vetëm me një folës. Në Amerikën e Jugut me qindra gjuhë u shuan si përfundim i pushtimit Spanjoll. Rreth 80% e 640 gjuhëve të ngelura në këtë kontinent fliten nga më pak se 10.000 njerëz; nga këto 27 gjuhë përballen me zhdukjen. Në Afrika pothuaj 1/3 e gjuhëve të botës, 54 gjuhë besohet se janë zhdukur dhe 116 të tjera po përballen me zhdukjen. Më shumë se gjysma e gjuhëve vendore të Azisë kanë më pak se 10000 folës secila. Rreth 90% e 250 gjuhëve të Australisë vendore përballen me zhdukjen. Në Evropë afërsisht 90% e rusëve flasin rusisht. Domethënë, shumica e 100 gjuhëve të tjera vendore të Federatës Ruse, pothuajse të gjitha gjuhë siberiane, janë afër zhdukjes. I njëjtë është rasti edhe me pakicat gjuhësore në Itali, të cilët janë të shumtë por aq të vogël sa që janë para zhdukjes për shkak të fuqisë së vogël ekonomike, politike dhe fuqisë së vogël organizative.

### 1. Realiteti gjuhësor në Evropë

Gjatë historisë më të re evropiane, raportet midis gjuhëve të Evropës kanë kaluar kryesisht nëpër 3 modele. I pari model mund të quhet *modelues*, duke u mbështetur në parimet romantike-nacionaliste të “treshit të shenjtë” gjuha, kombi, shteti që ishte tipike për Evropën e fundit të shek.18. (Bugarski 2009:12). Kah mesi i shek.XX, këtë gradualisht e zëvendëson *ekspansioni*, i cili favorizon shtrirjen e gjuhëve të fuqishme, në dëm të gjuhëve të vogla. Ky model më i pranishëm ka qenë në pjesët e ndryshme të botës, por aktiv ka qenë edhe në Evropë (Bugarski 2009:12). Padyshim ky model rrënjët i ka që nga polemikat që kanë ekzistuar në Evropë në shek. XVI, pothuaj nuk ka mospajtime se gjuha hebraike është gjuhë parababilonase, pra gjuha që ka ekzistuar para se të paraqitet dënimi, porse evropianët me çdo kusht janë orvatur të dëftojnë se gjuha e tyre (anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja etj.) është një nga gjuhët e kohëve më të lumtura, para se zoti ta paraqes dënimin, e me këtë duke lindur edhe çfarëdo lloj gjuhësh. Andaj një nga mënyrat e para për të vepruar me shoqëritë shumëgjuhësore është që dallimet të drejtohen në pabarazinë e gjuhëve, e me këtë edhe të popujve. Me anë të këtyre koncepcioneve romantike, ata e kanë matur fuqinë e tyre, pikërisht duke e lartësuar gjuhën e tyre, dhe duke zvogëluar dhe nënçmuar gjuhën e popujve tjerë.

Dhe më në fund gjatë ndërrimit të shekujve dhe në fillim të shek. XXI, afirmohet një model tjetër ai *interaktiv*, që nënkupton komunikimin e folësve të gjuhëve të ndryshëm në bazë të parimeve të barabarta, që do të mundësonte anëtarësim në familjen evropiane në një kulm të përbashkët (Bugarski 2009:12-13). Shumë popuj, që janë pakicë në shtetet shumë-

gjuhësore, nëpërmjet gjuhës ata shohin ardhmërinë, dhe gjuhën e shohin si armë kundër robërisë së huaj. Nëse në një shtet shumëgjuhësor orvatemi të krijojmë gjuhë të përbashkët, do të vijmë në situata të palakmueshme. Pse? Para së gjithash, ai shtet do të orvatet të garantoj sigurimin e mjeteve për komunikim të gjerë të nacionaliteteve të ndryshme dhe do të mundësoj të gjithë të integrohen në jetën shoqërore. Por, për ata që kjo gjuhë është e huaj do të jenë të detyruar ta mësojnë me qëllim që mos t'i keqësojnë kushtet e jetës së tyre qytetare. Duke iu falënderuar përktihimeve nga njëra palë, sidomos këtë e bëjnë pakicat edhe pala tjetër do të ketë njohuri për ndonjë kulturë të caktuar. Por kjo formë e demokratizimit e bën më pak të mundur përdorimin e gjuhës së përbashkët, sepse çdokush e favorizon gjuhën e tij. Si kompromis për këtë duhet të përdoren të dyja gjuhët, dhe të kategorizohen edhe si gjuhë nacionale dhe si gjuhë zyrtare.

## 2. Realiteti gjuhësor në R. e Maqedonisë së Veriut

Është fakt se nga ana e shtetit është arritur përparim të madh në promovimin e të drejtës për edukim të komuniteteve të ndryshme etnike, sidomos nëpërmjet të sigurimit të arsimit në gjuhën amtare dhe me promovimin e decentralizimit, me çka komunitetet etnike, nëpërmjet të pushtetit lokal, fituan kontrollë më të madhe ndaj shkollave. Po ashtu nëpër shkolla është futur promovimi i multikulturalizmit dhe interkulturalizimit, si koncepte kryesore në arsimin fillor dhe të mesëm që drejtpërdrejt ka të bëjë me promovimin e multikulturalizmit në arsim. Mirëpo, ne ende ballafaqohemi me mospërfshirjen e mësimit fillor në gjuhën amtare, pra shqipe në qytetin e Manastirit me rrethinë, rrethin e Velesit, Prilepit dhe Krushevës, në disa fshatra të Shkupit etj. Me kësi problemesh hasen edhe disa gjuha tjera, si ajo rome, vllehe e ndonjë gjuhë tjetër. P.sh. romët e Prilepit që jetojnë në lagjen Trizlla, ballafaqohen me një problem tjetër, të themi segregues. Në Shkollën Fillore "Dobre Jovanovski" të Prilepit, fëmijët e tyre jo vetëm që mësojnë maqedonisht dhe nuk e njohin gjuhën e tyre amtare rome, por nxënësit romë mësojnë në paralele të ndara nga nxënësit maqedonas.

## 3. Realiteti gjuhësor i arbëreshëve në Itali

Për studimin e dukurive sociolinguistike e të tjerë të raportit midis gjuhëve të mëdha dhe atyre të vogla, interes paraqet edhe varianti arbëresh i gjuhës shqipe në Itali, ku përfshihet si pakicë gjuhësore dhe ai arvanitas në Greqi që s'ka as status pakice. Këto gjuhë arbëreshe, por edhe ato rome dhe vllahe në RMV janë të rrezikuara. Këto gjuhë mund të zhduken sepse shqyrtohen në kuadër të gjuhëve shumicë, si ajo italiane, greke ose maqedonase.

Një nga format më të dukshme të zhdukjes së tyre është reduktimi i numrit të njerëzve që flasin një nga gjuhët e vogla arbëreshe dhe e dyta

është ndikimi në rritje i gjuhës italiane në strukturën dhe përdorimin e tyre. Në mënyrë drastike zvogëlohet edhe territori por edhe numri i folësve të arbërishtes. Shumë i ulët është edhe intensiteti i komunikimit të arbëreshëve midis veti. Edhe ai komunikim që bëhet, zhvillohet vetëm nëpër katunde dhe më ngushtë në familje. Kanë shkolla por arbërishtja është zgjedhore. Kanë një veprimtari botuese, në gjuhën arbëreshe botohen gazeta, revista, libra si dhe radioemisione në këtë gjuhë, por shkruhet dhe botohet në të folmet e fshatrave arbëreshe. Ndihma institucionale për të mbajtur gjallë këtë gjuhë është e vogël. Po ashtu ekzistojnë stereotipat se gjuha amtare është joprestigjioze dhe e panevojshme për fëmijët dhe kjo është shumë rëndë të fitohet, andaj fusha e përdorimit të arbërishtes vazhdimisht ngushtohet. Në katundet ortodokse arbërishtja shumë mirë përdoret për shkak fesë së kundërt, por në katundet katolike, arbërishtja pothuaj është asimiluar.

### Përfundime

Lirisht mund të themi se dominimi kulturor nga ana e gjuhës dhe kulturës më të zhvilluar, sjell deri te asimilimi. Njerëzit për shkaqe ekonomike pranojnë të mësojnë gjuhën e tjetrit, për shkak të privilegjeve të ndryshme, dhe në këtë mënyrë gjuha e tij amtare zhduket. P.sh. disa popuj edhe pse jetojnë aty ku me shekuj kanë jetuar, përsëri janë të rrezikuar, mund të dobësohet, zhduket por edhe ta zëvendësojë ndonjë gjuhë tjetër. Zhdukje mund të bëhet edhe nga ndryshimet demografike (P.sh. indianët në SHBA, Australi, Kanada etj.), ose një kulturë mund të ndikojë mbi tjetrën nëpërmjet luftës ose epërsisë ekonomike.

Zhdukja e gjuhëve të vogla, ka marrë aq hov të madh sa që OKB-ja, UNESCO-ja, Këshilli i Evropës dhe disa organizata shkencore, kanë filluar të shprehin brengosje për fatin e gjuhëve të rrezikuara. Studiuesit më pesimistë parashikojnë se gjatë këtij shekulli do të zhduket 90 për qind e shtatë mijë gjuhëve që fliten aktualisht. Në analizat e gjuhëtarëve, kjo temë është relativisht e re.

Habit fakti se në shumë media botërore nuk parashtrojnë problemin e ekzistencës së gjuhëve të vogla si pyetje civilizuese dhe etike, e në aspektin më të gjerë edhe si pyetje ekologjike, por me konstatimet e shumta sikur e bindin publikun për ngjarjet e tilla të domosdoshme. Në këtë mënyrë me anë të parashikimeve të zhdukjes së gjuhëve më të vogla, ose thjesht parashikimeve për të ardhmen e tyre sikur bën përgatitjen e organizuar të terrenit dhe zhdukja e tyre të heshtur ose margjinalizimin e tyre në favor të gjuhëve të mëdha (shpesh kjo bëhet me favorizimin paralel së pari si gjuhë publike e pastaj si gjuhë zyrtare të një mjedisi).

Për fat të keq nuk ekziston Shoqatë për mbrojtjen e gjuhëve të vogla, ose shoqatë për mbrojtjen e dhunës të popujve të mëdha ndaj popujve të vegjël, edhe pse nën patronazhin e OKB-së ekzistojnë shoqata për mbrojtjen e peshkaqenëve, tigrave ose llojeve të ndryshme të kafshëve ose

bimëve. Një nga shkaqet e ekzistimit të këtij paradoksi është fakti se shoqëritë e pasura për aktivitetet e tyre humane dhe për ta tërhequr vëmendjen e opinionit publik më lirë u vjen të investojnë dhe të merren me mbrojtjen e ndonjë specie biologjike sesa shpëtimin nga zhdukja e ndonjë gjuhe të vogël ose ndonjë popull të vogël të padëgjueshëm.

Një shpresë sado e vogël jep insistimi i *BE-së në të drejtën e të gjithë qytetarëve në përdorimin e të gjitha të drejtave kombëtare dhe të pakicës, por në të njëjtën kohë edhe në mësimin e gjuhëve fqinje dhe të huaja*. Qëllimi është që secili të flet nga tri gjuhë (duke përfshirë edhe gjuhën amtare). Realizimi i programeve të tilla, nënkupton vrotim thelbësor të politikave kombëtare gjuhësore, si dhe reforma të rëndësishme në arsimin gjuhësor, sidomos në çështjen e mësimin të gjuhëve të vogla.

### Abstrakti

Ekologjia gjuhësore në qendër të studimeve të veta ka vënë raportin midis gjuhëve të mëdha dhe të vogla dhe me shumë mund paraqitet si një disiplinë e re gjuhësore për mbrojtjen e gjuhëve të vogla. Ekologjia gjuhësore lufton kundër ideologjisë që të krijohet një botë me një “supergjuhë”, “superkomb” apo “superideologji” që me të madhe do t'i zhdukë gjuhët e vogla. Objekt i studimit tonë do të jetë pikërisht ky raport midis këtyre gjuhëve, duke përfshirë para së gjithësh problemet gjeografike, etnike, institucionale, gjuhësore si dhe probleme tjera si: ndryshimi i një gjuhe, braktisja, vdekja e gjuhës, pixhinizimi, kreolizimi, huazimet, diglosia, dialektologjia urbane e tj. (Asher 1994:v.3:391). Për këtë rast edhe janë krijuar edhe termet si: *vdekja e gjuhëve, glotofagjia, linguacid, luftë midis gjuhëve etj.* Këtu mund të shtohen edhe terme metaforike si *dhunë ndaj gjuhëve, keqpërdorime ndaj gjuhëve, vrasje të gjuhëve* që mund të jetë edhe lëndë e të drejtës ndërkombëtare. Për studimin e dukurive sociolinguistike e të tjerë të raportit midis gjuhëve të mëdha dhe atyre të vogla, interes paraqet edhe varianti arbëresh i gjuhës shqipe në Itali, ku përfshihet si pakicë gjuhësore dhe ai arvanitas në Greqi që s'ka as status pakice. Këto gjuhë sa vjen e zvogëlohen. Do të shqyrtohet në kuadër të gjuhës shqipe, por edhe në kuadër të gjuhës italiane, nga e cila është më e rrezikuar. Këto gjuhë do të studiohen sipas statusit, sipas numrit të folësve, sipas zgjerimit të përdorimit të kësaj gjuhe, sipas fuqisë ekonomike dhe politike të gjuhës me të cilën jeton etj.

Fjalët kyçe: Ekologjia gjuhësore, gjuhët e vogla, gjuhët e mëdha, arbërishtja, sociolinguistika

---

## Abstract

Linguistic ecology at the center of its studies has put the relationship between the big and the small languages and it is mostly regarded as a new language discipline for the protection of small languages. Language ecology fights against ideology to create a world with a "super-language", "super-nation" or "super-ideology" that will largely erase small languages. The object of our study will be precisely this relationship between these languages, including in particular geographical, ethnic, institutional, linguistic problems and other problems such as language change, abandonment, language death, pidginization, creolization, borrowing, diglossia, urban dialectology and so on. (Asher 1994: v.3: 391). In this case, the following terms have also been created: death of languages, glogofagia, linguacid, language struggle, etc. Metaphorical terms such as violence against languages, language abuses, and language assassinations can also be added here, which may also be the subject of international law. For the study of the sociolinguistic and other aspects of the relationship between the big and the small languages, interest is also the variant of the Arbëresh of the Albanian language in Italy, which includes both the language minority and the Arvanitas in Greece, which has no minority status. These languages are decreasing. It will be examined within the Albanian language, but also within the Italian language, from which it is most endangered. These languages will be studied by status, according to the number of speakers, according to the extension of the use of this language, according to the economic and political power of the language they live in.

Key words: Linguistic ecology, small languages, big languages, archeology, sociolinguistics.

## Referencat:

- ALTIMARI, Françesko. (2002). *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*. Shpresa & Faik Konica. Prishtinë.
- ASHER, d. R. E. (1994). *The Encyclopedia of Language and Linguistics*. Pergamon Press: Oxford– New York –Seoul – Tokyo.
- BUGARSKI, Ranko. (2009). *Evropa u jeziku*. Beograd: Bibliotek XX vek.
- CRYSTAL, D. (2003). *English as a Global Language*. Second edition. Cambridge: CUP.
- EDWARDS, J. (1994). *Multilingualism*. London; New York.
- HAUGEN, E. (1972). *The Ecology of Language*. – Stanford University Press, Stanford, CA.
- IBRAHIMI, Mustafa (2021). *Në Kalabri me Arbëreshët*. Shkup.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2018). *Sociolinguistika*. UNT: Shkup.
- KALVE, Luj - Žan(1995). *Rat među jezicima*. Beograd.
- SHKURTAJ, Gjovalin. *Shpirti i arbërti rron – shënime dhe të dhëna për arbëreshët e Italisë*-. “8 Nëntori”. Tiranë.
- ZLLATKU, Rexhep (1996). *Me arbëreshët*. Shkup.
- КУЗЬНЕЦОВА А. И., Раевская, О. В., Скорвид, С. С. и др. (1997). *Малые языки Эвразии: Социолингвистический аспект*. Сборник статей. Москва.
- ЛЕМАН. К. (1996). Документация языков, находящихся под угрозой вымирания (Первоочередная задача лингвистики). – *Вопросы языкознания*, 2, 180-191.

ISSN 2671-3004

UDC 821.18(450)-1.09

Punim studimor

**Vebi BEXHETI**

Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë

E-mail: v.bexheti@seeu.edu.mk

**TOKA ME SHIJE, ULLIRI PAK TË HIDHUR PAK TË ËMBËL**

**Земјата со вкус, маслинката малку горка малку слатка**  
**The earth has a good taste, the olives are slightly bitter and**  
**slightly sweet**

Ulliri si figurë poetike është metafora më e qëlluar për tokën, ku u vendosën arbëreshët, madje edhe si simbol i tokës së arbërit, prej nga u nisën ata në kërkim të një vendi të ri. Ashtu si në shumë poezi të poetit të Zef Skiro Di Maxhos, edhe në këto të përmbledhjes *Kopshti im me dritare* (1995), kjo pemë, që konsiderohej si e bekuar, e që është shumë e lidhur me jetën e shqiptarit, madje me historinë më të lashtë të saj, mbase si pemë mijëvjeçare që është, e me rrënjë të thella, simbolizonte edhe rrënjët shqiptare, ndërsa me trungun jo të zakonshëm, me gunga, gropa e formë të çregullt, gjithsesi i ngjante jetës plot vuajtje të shqiptarit dhe njëherësh qëndresës karshi stuhive historike, që e përcollën në vazhdimësi. Për këtë pemë magjike shkruajtën edhe shumë shkrimtarë dhe poetë tjerë të letësisë sonë, por lidhja e poetëve arbëreshë, siç është edhe Zef Di Maxho, e frymëzuar nga tokat bregdetare të atdheut të lashtë, të Moresë dhe krahinave të ndryshme arbëreshe në jugun e Italisë, është më e fortë, meqë ulliri ishte pjesë e jetës së tyre, që nga parashpërngulja e deri në ditët e saotme. Ishte malli, që i lidhëte me atdheun e të gjitha periudhave kohore, e sidomos me ate të Skënderbeut, kur ai matresën e djemve të rinj e kushtëzonte me një numër të caktuar të ullinjve të mbjellë, traditë kjo që vazhdoi edhe ngulmimet e reja në Kalabri e Sicili:

*Ty të nguli në tokën e re  
para pesëqind vjetësh  
dora e emocionuar e dhëndrit  
që të vinte kurorë arbëreshe  
u detyrua sipas Kanunit  
të mbillte dymbëdhjetë ullinj  
-paja e tij.  
(Ullirit tim në lindje-juglindje)*

Te ullahtë e këtij poeti është i pranishëm dekori antik dhe malli More. Njeriu dhe hyu janë bashkë në këtë udhëtim biblik të lirikës me ullahtë të Zef Skiro Di Maxhos. Ullahtë e kësaj lirike do vazhdojnë të jenë përjetësisht të ngarkuar me kokra sa të ëmbla sa të hidhura, sa të lëna në degë e të trishtuara.<sup>1028</sup> Ullahtë dhe kopshti në Horën e tij, pas përshkrimit poetik të udhëtimit nëpër detë tani më bëhen frymëzim i pashtershëm për poetin. Ai jeton me to, me degët, me ngjyrën e argjendtë të gjetheve, flet me to, në mungesë të miqve të largët: *...Pranoj si shpërblim/ zëra nga degët/ e dhurata të stinës./ Me domethënie* (Kopshti). Frymëzimi poetik nga ullahtë e Gjetsemanit të tij, i hap rrugë të re për ndërtimin e vargut plot figura stilistike, ku sërish metafora e ka fjalën, mbase Zef Di Maxho përmasat shprehëse të gjuhës për artikulumin e mendimit poetik i gjen në çdo moment e në çdo vend, prandaj personifikimi i ullahtë, është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të: *E secili dru/ di ankimet e mia/ e të secilit dru/ di përgjigjen e devotshme* (Gjetsemani). Mendimi poetik i tij shpeshherë merr përmasë tjetërfare, edhe atëherë kur flet për shartimet me filiza të rinj, për dhembjen e njerëzve dhe të hyut, për ndarjen e dhembshme dhe ndërprerjen e dashurisë, të paraqitur figurativisht përmes këtij shartimi të degës së ullahtë të vjetër: *Lidhja jote dashurie/ dëshmi shartimesh edhe ajo/ me ullahtë që u bë nënkresë* (Ullahtë tim më të moçëm).

Edhe në poezitë tjera të ciklit mbi poezinë e ullahtë, ky poet ka prirje që përmes kësaj peme të jashtëzakonshme të depërtojë mëthellë në qenien e jetën e njeriut, në raportet e tij me natyrën dhe universin. Tërë këto raporte, që strumbullar e kanë ullahtën i lidh edhe me shpezë e insekte të ndryshme, siç janë: korbata, trishtilët, harabelët, zhapihtë, grerëzat, vemjet, krimbat, e parazitë të ndryshëm, që githsesi në ndonjëfarë mënyre e kërcënojnë pemën e ullahtë dhe frutat e tij, e që në aspektim metaforik, mendojme se poeti në këtë rast e zgjeron mendimin poetik, për të ardhur te fenomeni i luftës mes së keqes dhe së mirës, të mirëqenies dhe shkatërruesit: *Roli i luftës së korbave/ që kundron. Roli i ullahtë/ qëmbarset. I zhapiut/ që dëshiron të bëhet degë jote* (Ullahtë tim në veri-perëndim). Ullahtë si figurë poetike dhe poezitë, kushtuar kësaj peme, të Zef Skiro Di Maxhos, janë me burim lashtësie, që zënë fillë në letërsinë e vjetër greke, te veprat e Homerit.<sup>1129</sup>

Vargjet e nxjerra nga vepra "Odisea", që poeti i shënoi në krye të poezisë "Në Odisea", e dëshmojnë këtë lidhje me të kaluarën e largët, si burim frymëzimi, e që në poezinë e Zef Di Maxhos praktikohet shpesh, sidomos në poezitë me frymëzim nga ullahtë dhe Morea, kjo dhembje e përherëshme për arbëreshët. Përmes Odseut, Penelopës, që e priste dhe shtratit me dru ullahtë, poeti e shtrin intuitën krijuese deri në antikën e

<sup>10</sup> Po aty, f.23.

<sup>11</sup> Lënë vejan nga degëzat ullahtën,/ bukur pjesë nga rrënja trungun preva/ të përpiktë, e përsipër pra me zdrukthat... /Kështu mbështetjen bëra të krevatit... (Homeri: Odisea, Kënga XXIII-Përkthimi i Zef Skiro Di Maxhos).

largët, pa u shkëputuras nga tradita shqiptare e mjelljes së ullinjve, para se djemtë të maroheshin: *E ai ndërtoi/ një shtrat ulliri në truall të ngulur,/ e ndizej duke menduar/ befasinë e nuses. Gazet pra/ për net e ditë* (Në Odiseu)! Në disa poezi, përveç frytit të ullirit, përmendet edhe druri i kësaj peme dhe rëndësia e tij, si material ndërtimor për anijet dhe jo vetëm. Në poezinë "Ullirit tim detar", përmendet "bashi" i lëmuar nga dallga e erës, i anijes nga lënda e drurit të ullirit, kësaj peme të bekuar dhe dëshira e poetit të udhëtojë në kërkim të bashkëkombasve të tij: *Ankorim është të gjej/ miqtë e vjetër shqiptarë/ që shpëtuan nga tufane të vërteta.*

Traditën e vjetër të mbjelljes së ullinjve, si kusht për martesë, arbëreshët e praktikonin edhe në tokën e re. Dy kohërat, atë të vjetrën e atdheut të rrënjëve dhe këtë të renë, të tokës së huaj, poeti i lidhë përmes dhëndrit, simbolit të martesës, nëse i riu i ka plotësuar kushtet për martesë, apo jo: *Por ti je këtu dëshmi/ e dashurisë së vjetër/ dhe sot e dashurisë së re/ të një dhëndri tjetër* (Ullirit tim në lindje-jug-lindje). Pema e ullirit me trungun me gërrella dhe plasa të thara, në shumë poezi të këtij cikli është simbol i arbëreshit, me tërë vrazhdësinë e jetës së tij: *Modulon në erën e veriut harpën/ e trungut tënd të vjetër/ plot cijatje dhe rrënkime./ Ashtu edhe imja* (Ullirit tim në rrafshinë). Edhe në poezinë "Në Nausikaja"<sup>12</sup>, poeti i këndon Odiseut, në këtë rast bashkë me Nausikajën e bukur e cila e takon ate, pa tesha në trup, vetëm me një degë ulliri në pjesën e përparme, pasi atij i ishte shkatërruar anija. Fragmente të shkurtëra të ngjarjeve gjatë kthimit të Odiseut në Itakën e tij, sikurse është edhe takimi i tij me Nausikën, dhe dashuria e saj për te, janë dëshmi e dëshirës së poetit tonë për ta shtrirë fatin e arbëreshëve deri në antikitet, prandaj jorastësisht, Odiseja, Itaka dhe shumë ngjarje nga kjo e kaluar e largët, bëhen pjesë e krijimtarisë së tij poetike, e lirikës së tij, që në këtë rast buron nga epet e mëdha klasike. Edhe në këtë poezi, para vargjeve, nën titullin e saj, poeti i kishte shënuar disa vargje të poemës "Odiseu."<sup>13</sup>

Dega e ullirit, si metaforë shumëkuptimëshe, që reflekton gjithanshëm në jetën e njeriut, dhe "Nausikaja e dashuruar e pyjeve dhe e gazeve, që humbi në detet dashurie, e kursesi e zhgënjyer, që çnjosri vegimin e burrit, veshur me degë ujlliri", janë zëri, që sfidon kohën e hapësirën, është vatër frymëzimit krijues, që fatmirësisht ka sjellë në dritë perla arbëreshe, në këtë rast përmes lirikave të poetit, Zef Skiro Di Maxho. Me vargjet e kësaj poezie dhe të shumë të tjerave të këtij poeti bashkëkohor arbëresh, ndjehet një prirje drejt hapjes, drejt pushtimit të hapësirave tematike e ndjeshmërive universale, mbase edhe drejt universalizmit krijues të Itakës arbëreshe.<sup>14</sup>

<sup>12</sup> Nausikaja ishte vajza e bukur dhe fisnike e mbretit Alkinoja, që në breg të detit e takoi Odiseun e raskapitur, pas shkatërrimit të anijes.

<sup>13</sup> Doli aherë hyjnor Odiseu gërmusash dhe preu/ dora e tij e fuqishme nga pylli i dendur një degë/ veshur me gjethtë, ta kish si mbulesë për trupin e zhveshur. (Homeri: Odisea, Kënga VI-përktheu: Spiro Çomora).

<sup>14</sup> Shih te Ali Aliu, po aty, f. 22.

Edhe foleja në bajame e zogjve, bashkë me cicërimën e tyre, përballë dardhës dhe çerdhja boshe, poetikisht lidhen edhe me fatin e arbëreshit, dhe jetën e vështirë, meqë të gjitha këto gjenden brenda kopshtit të tij me dritare, që është edhe titulli i kësaj përmbledhjedje poetike: *Çfarë drame për këto/ frymorë të mjerë/ s'dinë t'i shpjegojnë vetes/ rolin në natyrë/ të blokuar nga fati* (Fole).

Ky poet, ashtu si në shumë përmbledhje tjera poetike, edhe në këtë, thurte vargje për shumë qytetete, e vendbanime shqiptare, por edhe për qytete tjera, ku e gjente inspirimin poetik, apo ndonjë fije vegëze, që kishte lidhje, apo ngjashmëri me historinë shqiptare. Në këtë libër, ai shkruajti për Elorën (Sirakuzën), që gjendet në juglindje të Sicilisë, Patrasin, që gjendet në veri të Gadishullit të Moresë, për Jerusalemin, dhe Tiranën. Vlorën, Sirakuzën e dikurshme e përshkruan në një kokë kodre, buzë detit, ku dikur flitej greqisht, ndërsa: *sot në amforën e varrosur,/ që nga bari i verdhë, nxjerr turirin/ një nëpërkë nga breza,/ nëpërkash mbetur gjallë* (Në Eloro). Qytetin e Moresë, Patrasin, në poezinë "Nisje nga Patrasi," poeti e kujton me mallë e trishtim nga koha e shkëputjes së arbëreshëve nga këta rajone. Në vargjet e kësaj poezie, poeti si duket flet për dy kohërat, për atë më të hershmen dhe më të renë, gjatë një vizite që i bëri këtij qyteti. Edhe në poezinë "Tri brigje", poeti sërish i këndon *Eloros*, brigjeve të Shqipërisë, Greqisë dhe atyre të viseve arbëreshe, banorët e të cilave janë aq të lidhur mes veti:

*Përballë Eloros ujëra kobalti  
që lëmojnë andej  
toka Greqi e Shqipëri  
lundrova pa anije  
frymët tona gjatore deri atje e të ndihesh e të kuptosh cilat  
lidhje tërheqin tri brigjet. (Tri brigje)*

Edhe kur flet për qytetet që nuk kanë të bëjnë me arbëreshët, siç është edhe Jerusalemi, i cili vetëm për nga kuptimi e ka domethënien e paqes, poeti e lidh atë me degët e prera të ullinjve, të kopshtit të tij, që do i ngrejë si flamuj në këtë qytet qiellor: *Do të marr degët e prera/ nga krasitja/ e do t'i ngre si flamuj*. Në poezinë "Tirana, tetor 1995", autori me gjuhën e zakonshme të tij, e përshkruan këtë qytet, pas dhjetë vitesh nga vizita e parë, gjithsesi me ndryshime marramendëse të një zhvillimi të hovshëm, por jogjithmonë pozitiv, sidomos në ndërtimtari, infrastrukturë e ekologji. Megjithë këto çrregullime zhvillimore gjatë një dhjetëvjeçari, ai Tiranën e sheh si qytet të rinisë, me plot bare, me shumë hotele të ngjyrosura, me vajzat e bukura me "minigonat ekstrasistolike", me shumë kisha e minare, e me zërin e çdo tingulli të këmbanave. Ajo që më tepër i pëlqeu në këtë qytet, ishte ndryshimi i aspektit ideologjik, që e dëshmon edhe mungesa e portretit të Stalinit, simbolit të miqësisë së dy shteteve komuniste, të cilin përveç pikëpamjeve ideologjike, nuk e lidhte asgjë me shqiptarët. Rënia e

regjimt, dhe zhvillimet demokratike, pas dhjetë vitesh për poetin ishin të prekshme:

*... më pëlqen të shoh se ai i tmerrshmi  
me mustaqet e trash e me kapotin  
e errët iku nga piedestali e nga portretet  
i cili më shumë se gjithçka tjetër  
më bezdiste ngase s'kish asnjë thërrime  
ruaze të ngjashme me këtë trevë...*  
(Tirana, tetor 1995)

Portretin e Tiranës, poeti nuk mbaroi me kaq. Në poezinë "Lutja Allahut", pas përshkrimit të mëngjesit të hershën të botës tiranase, që poeti bën, derisa gjendej në një hotel të kryeqytetit, në momentin kur ende heshtnin minareja dhe kumbonarja, e kishave ortodokse e katolike, dëgjoi lutjen në këngë të një fqinji arab. Është koha kur pas rënies së komunizmit Tirana dhe e gjithë Shqipëria ishte hapur për turistët e huaj, ndër të cilët edhe shumë vizitorë nga bota arabe. Dhe sërish anijet në mendjen e tij, me velat, që i fryn era e lehtë e mëngjesit tiranas, që në këtë rast na vjen si metaforë e valëzimit të zërit të lutjes së "modeluar në këngë. Nga shumë përshtypje të Tiranës që kishte ndryshuar e pondryshonte çdo ditë, poetit Skiro Di Maxhbo do këthehet bashkë me imazhet e këtij qyteti kulturash të shumta, dhe mbi të gjitha respektin e ndërsjellë ndërfitar të besimtarëve. E tërë kjo pamje e Tiranës dhe e shpirtit të saj, përshkruhet me tone të larta poetike, që i bën këtij pejsazhi, në kohën kur dielli skuqet dhe fillon t'i hap ngjyrat: *...ari i thelbit/ të kuq të diellit sapo hap ngjyrat./ Ashtu me këngën udhëtova/ andej këndeje botëve të mundshme/ Sa bollëk Zoti/ Sot në Shqipëri!*

Në mesin e tri poezive të shkruara në Tiranë, gjatë tetorit të vitit 1995, që ai i quan "Tri agime të tetorit 1995", është edhe ajo me titull "Convivium", kushtuar poetëve: Xhevahir Spahiut dhe Ali Podrimjes. Jorastësisht në këtë rast poeti i zgjedh dy nga poetët më të mëdhenj të lëtërsisë shqiptare, që bashkë me te, e përbëjnë treshen përfaqësuese të tri hapësirave shqiptare: Shqipërisë, Kosovës dhe Arbërisë m'atanë detit. Dëshira e poetit arbëresh, që të tre së bashku, të ndodhen në një anije për të lundruar në çdo erë, njëherësh duhet nënkuptuar se zëri i poezisë së mirëfilltë i përballon edhe sfidat më të mëdha shoqërore, i tejkalon pengesat me furtuna që i nxjerr para "motit me detë"<sup>1533</sup>, e veçmas, kur atë poezi e ndërtojnë tri penat e tri hapësirave të shpërndara shqiptare, pa dëshirën e tyre:

*Xhevahir, doja që ti, Aliu dhe unë  
për magji tok të ndodheshim një herë*

<sup>15</sup> Me kuptimin e motit të lig me erë e stuhi.

*mbi nj'anije e t'lundronim me çdo erë  
pas qejfit tuaj e timit pa përdhunë,  
kështu që moti keq o çdo furtunë  
nuk mund të na pengonte 'dhe asnjëherë,  
bile, duke jetuar me nj' mendje e një vlere,  
t'na rritej, se ishim njësh, dëshirë e punë.  
(Convivium)*

Ky takim i tre poetëve dhe trajtimi i barabartë i krijuesve të Zonjës Shqipëri, të Zonjës Kosovë dhe Arbërisë, të cilën poeti nuk e quan Zonjë për arsyt, që dihen, kur e kemi parasyshtë searbëreshët në Itali njihen vetëm si pakicë gjuhësore e jo edhe etnike. Letërsia shqipe, përfshirë edhe ate të arbëreshëve, duhet konsideruar një dhe të pandarë, përndryshe, do të bënim njëvetpërrjashtim të një pjese të vlerave tona të përbashkëta letrare. Këtë realitet e ka të qartë edhe poeti Skiro Di Maxho, prandaj poezinë e tij duhet kuptuar edhe si mezazh se nuk duhet ndarë vlerat tona letrare, ashtu siç jemi të ndarë gjeografikisht, pa fajin tonë:

*E zonjën Shqipëri, zonjën Kosovë,  
me 'të, që tok e treta është, Arbërinë,  
bashkë me ne t'i vinte magjistari:  
e aty për poezi të jepnim provë  
e t'kish secila Zonjë lumturinë  
që ju besoj të kishit, e unë i pari.  
(Po aty)*

Ulliri, kjo pemë e veçantë, që bashkë më Morenë, Itakën shqiptare, janë dhembja e përhershme, që poetin e kthejnë në historinë e largët, është i pranishëm në shumë poezi të poetit. Kjo pemë e bekuar, edhe pse qindvjeçare, madje edhe mijëvjeçare, një ditë do e ketë edhe mbarimin e vet. "Rënien" e këtij ulliri të moçëm, poeti e karahason më ate të njeriut, prandaj shuarjen e tij e quan vdekje, ndërsa ceremonialin e mortjes të ngjashëm me ate të njeriut: *Te mortja mori/ figurë njerëzore. i këndova/ një seri të sinqertë lëvdatash*. Ashtu si për njeriun, që nuk është ndër të gjallët, edhe për ullirin, i zoti ia kujton të shkuarën e ditëve diellore, mbushjen me borë të zgavrave të trungut dhe atë që e kishte mbjellë plot me shpresa, për të mirat që do i sjellë, e që sot nuk është i pranishëm ta shoh, ashtu të shtrirë. Pasi e shtriu për prehje, e pastaj ta bënte skulpturë ullinjëzore, ai u zhduk:

*...Pyeta muratorin/ që më ndërtonte një mur mbajtës/ e m'u përgjegj  
ç'farë ta bëje? mua/ për dru zjarri më bënte nevojë. (Druri vdekur). Edhe në poezinë "Lexim", autori flet për ullirin, këtë pemë me koherencë, siç shprehet ai, dhe metaforë paqeje, ku e përmend Shqipërinë, Athinën, Morenë e largët dhe vajzën e bukur siciliane, që e dëshmon lidhjen e*

vazhdueshme të këtyre hapësirave, me “Itakën arbëreshe”: *Athena shpikëse në tokën e Moresë/ ullinjsh nga shenja e paqes...*

Tema e ullirit vazhdon të jetë e pranishme edhe në vargjetjera të kësaj përmbledhjeje dhe të shumë veprave tjera poetike. Pëshkrimi i luginave e kodrave të tokës së Sicilisë, dashurisë së etërve tanë për atdheun e humbur, i rrënjëve të thella të ullinjve dhe e trungjeve me fytyra njerëzish, e formojnë imazhin e plotë të arbëreshit, bashkë me historinë e tyre me plot vuajtje, që e dëshmojnë kushedi për të satën herë rrudhat e fytyrës, të ngjashme me të çarat e trungut të ullirit të vjetër: *Lot të derdhur pezull/ në pritje frytet./ Rrudhat.Kur të piqet koha/ do të kenë edhe të miat* (Rrudha). Në lirikën me ullinj të këtij poeti, krahas paraqitjes figurative të kësaj peme me rrënjë të thella në tokë, e me tungun e vrazhdë, gjurmë të kohës, që shpeshherë i krahason me fytyrën e njeriut të përvuajtur, përmes vargjeve poetike e paraqet edhe pejsazhin e bukur të natyrës arbereshe. Me rrënjët e thella në tokë “dhe trupin me trajtë të gremtë”, bashkë me degët si krah, poeti e përshkruan këtë pemë fisnike që qëndron në kopshtin e bukur të tij, mes dritës, territ e agut mëngjesor: *Frymëmarrja e lodhët valëzuese e drurit./ Hëna as e di. Më gjen agu/ kur ende nga toka tërheq/ me zor këmbët e rrënjosura/ që të mos më shokojnë dita e fqinji.* (Kur bie nata). Ulliri dhe pronari i tij, që me padurim priste të vjelat, ishin aq fortë të lidhura, sa që të lenin përshtypjen se jetojnë me një frymëmarrje. Çdo erë e furishme, qoftë edhe ajo e shkaktuar nga treni, që përshkonte luginat pranë “ndërtesave të bukura të degëve të ngarkuara”, nganëna plakë përjetohej si tragjedi e vërtetë. Ky breshër ullinjsh, që binin në tokë si të plagosur, përjetohej keq nga kjo nënë, që kishte dhënë aq mund e djersë: *...Vajtim valëzues/ me gjeste nona plakëi shton/ erës që ullinj të shkul/ sikur t’ia shkulë nga gjiri i saj...* (Kohë me erë).

Kopshti me ullinj të, prej ku edhe u frymëzua poeti për t’i shkruar këta vargje, ishin burim i vazhdueshëm dhe njësherësh edhe identiteti artistik, që e karakterizojnë ciklin e poezive me motiv ullirin. Ashtu si zakonisht, Zef Skiro Di Maxho, edhe me këto poezi njihet me stilin e tij të veçantë estetik, me plot figura poetike, ku nuk mungojnë edhe emocionet. Në poezinë “Vizitë në kopsht”, që poeti ua kushton Luizës dhe Skalambrinos, ulliri me rrënjët e tij të thella, kopshti dhe pronari i tij, paraqiten si një trupi vetëm që edhe komunikojnë mes veti, e njëherit, siç thotë poeti, janë vet burimi i vargjeve të tij: *Erdhët këtu të shihnit/ kopshtin tim e burimin e këtyre vargjeve të mundshme. Patë ullinj të/ të krasitur bukur dhe mua që flisja me ta/ sikur t’ishim njerëz...* Rrënjët e thella e të shpërndara në tokë, në këtë rast simbolizojnë qëndresën e ullirit në tokën ku është mbjellë, “se është vështirë të udhëtojnë nëpër tokë o detë o nëpër ajër.” Kjo mënyrë e paraqitjes poetike të ambientit të kësaj parajse, që poeti e quan “kopsht me dritare”, është e veçanta e kësaj poezie dhe e tërë kësaj vepre poetike. Gjetjet poetike rreth ullirit, ngjyrës së tij jo shumë të definuar dhe shijes pak të hidhur e pak të ëmbël, i përgjigjen plotësisht, vargut “Shije ulliri ka kjo tokë, pak e hidhur, pak e ëmbël”, që jorastësisht është edhe titulli i këtij

studimi, kushtuar përmbledhjes poetike *Kopshti im me dritare* të Zef Skiro Di Maxhos. Poeti dhe ulliri janë vet zëri i dashuisë, ndërsa gjethet e tij, ku mund të zhdukej ai, parajsja e këtij kopshti me dritare: *...Disa herë doja/ të zhdukështa midis gjetheve. Por për ju/ dje isha bilbil i dashurisë/ në dritaren e këtij kopshti.*

Te poezia "Krasitje", ku gjithashtu tema sillet rreth ullirit, procesi i krasitjes së degëve të kësaj peme, përveç veprimit fizik të procesit të krasitjes, fjalja në këtë rast e zgjeron kuptimin, duke marrë tjetër kahe, që figurativisht, si duket, mendohet për trupin e njeriut të gjymtuar: *mbetet trupi kështu/ dy krah të shkurtër/ dy duar të zhytura/ në të kufizuarën.* Edhe në pezinë "Trashëgim", që poeti ia kushton krijuesit e studiuesit të madh të letërsisë shqipe, Nasho Jorgaqit<sup>16,34</sup> poeti e përmend trungun e ullirit me kuptim, krejt të figurshëm, duke e krahasuar atë me vjershat e veta, me të cilat është i lidhur, ashtu si me trungun e kësaj peme, për ta përballuar furtunën e jetës: *Furtunës që është jeta/ çdonjëri i bën ballë në mënyrën e vet./ Të mos zhduke pa lënë presje/ nën këta qiej tanë/ lidhem fortë me këta vjersha/ si në trung të ullirit/ kur bëj sikur i trmbem erës.*

Veprën poetike, *Kopshti im me dritare*, poeti Zef Skiro Di Maxho e mbyll me dy poezitë e fundit, ku nuk përmendet ulliri, madje as përmes kuptimit figurativ. Poeti në poezinë me titull "Kudo që të jesh", e shpreh nostalgjinë për vendin e rrënjëve dhe dilemën, nëse gjenerata e re do e kuptojë apo jo se i përkasin shpirttrave fisnikë të një kombi me histori të lashtë. Këtë dilemë kuptojmë përmes këshillave të tij, babait të një të riu, kur i thotë: *kërko t'i vizitosh tët biri/ profilin e tokës sate,* duke menduar se brezit të ri, i janë shuar ndjenjat për rrënjët e tyre, madje se ata e vuanin kompleksin e të qenit arbëreshë në mjedise italiane: *Njeriu i gjithanshëm më i mirë/ është ai që nuk turpërohet për qenien e tij të veçantë.*

Me poezinë "Anijembyturve shqiptarë", Zef Di Maxho, na përkujton dy kohët shumë larg njëra tjetrës, atë të brakisjes së tokës së të parëve, kur arbëreshët morën rrugën e detit, drejt Italisë së jugut dhe këtë të kohës më të re, në prag të rënies së komunizmit, madje edhe pasi ata e kishin humbur pushtetin nga forcat politike demokratike. Me gjithë modernizimin e anijeve të kësaj kohe, strategjitë e refugjatëve ishin të pashmangshme, meqë numri i madh i pakontrolluar i këtyre udhëtarëve, që e braktisnin atdheun nga motive dhe në rrethana krejtësisht tjera nga koha e "Anijeve me vela dhe me motor", nuk kishte asnjëfarë kontrolli. Poeti përmes vargjeve të kësaj poezie, përveç përshkrimit të këtyre ngjarjeve tragjike, mëton të depërtojë deri te shkaqet e këtij ekzodi të paparë gjatë kohë. Kurorat e luleve në detë dhe thikat e ngulura në shpirtin tonë, që janë metaforë e një tragjedie dhe plagosjeje shpirtërore, janë njëherit edhe

<sup>16</sup> Ullirit i ngjaj unë tani. Një ulliri me trung/ të vjetër, të plasitur e të murrëtyer nga erërat.../ Ullirit i ngjaj unë tani. Një ulliri të lashtë,/ me degë të gjelbra, që në pranverë çel lule... (Nasho Jorgaqi, Manastiri idashurisë).

brengë e këtij poeti për një "shprishje", që nuk i ngjan asaj të kohës së zhvendosjes së arbëreshëve. Vet titulli i kësaj poezie flet për njerëzit që nga firika e morën botën në sy, e që kurrë nuk arrijtën në një botë "më pak të keqe" se në atdheun e tyre, tani më të çliruar nga regjimi i diktaturës komuniste:

*Kujt i dha mësim nga shpërndarja në histori  
frika  
por edhe mundësia të gjejë shpëtim  
nuk i mbetet  
veç se të vdesë me ta një çikë  
për atë herë  
e për ato herë kur i shpëtuar  
kaloi ditët në kërkim  
të një bote më pak të keqe.  
(Anijembyturve shqiptarëë)*

Përmbledhja poetike "Kopshtim im me dritare" e Zef Skiro Di Maxhos, është ndër librat poetik të tij, që gjithashtu shkëlqen në mesin e shumë veprave tjera të botuara më herët apo më vonë. Ajo që vlen të theksohet për këto lirika, është edhe përqëndrimi i poetit në figurën e ullirit, kopshtit dhe dashurisë së tij për këtë mjedis përrallor, që në këtë rast është më tepër se një kopsht, është vet jeta e arbëreshit me gjithë hallet e krenarinë për mbijetësen e tyre, prandaj vargu: "Shije ulliri ka kjo tokë, pak e hidhur pak e ëmbël", është motoja e jetës së arbëreshit, që i kaloi shekujt m këtë shije dhe me shpirtin e ndarë në dy pjesë.

## Abstrakt

Kumtesa ime me titull: "Metafora e ullirit në përmbledhjen poetike, Kopshti im me dritare, të Zef Skiro Di Maxhos", përqëndrohet në poezitë, në të cilat ulliri si metaforë është në qendër të frymëzimit poetik. Përmes vargjeve të kësaj përmbledhjeje, poeti arbëresh, vazhdon ta trajtojë temën e preferuar të etnitetit që i takon. Ulliri, kjo pemë magjike me jetëgjatësi qindraveçare, me trungun karakteristik, jo të zakonshëm, me shijen dhe ngjyrën e padefinuar të frutit, simbolizon historinë, lashtësinë dhe mbijetesën e popullit shqiptarë. Në kumtesë bëhet fjalë edhe për simbolikën e mbjelljes së një numri të caktuar të ullinjve nga beqarët, si kusht për martesë, traditë kjo me histori që nga koha e Skënderbeut dhe e bartur edhe ndër arbëreshë. Këto vargje poetike shtrihen edhe në përmasë më të gjërë në kohë e hapësire, madje që nga Morea, Itaka shqiptare, siç e quan poeti, e deri te "Odisea" e Homerit.

Fjalë kyçe: Zef di Maxho, metafora, historia ulliri, arbëreshët, mbijetesa, Sicilia, etj.

## Abstract

My paper entitled: "Metaphor of the olive in the poetic collection, My Garden with a Window, by Zef Skiro Di Maxho", focuses on the poems, in which the olive as a metaphor is at the center of the poetic inspiration. Through the verses of this collection, the poet from Arbëresh continues to address the favorite topic of his ethnicity. The olive tree, this magical tree with a lifespan of hundreds of years, with its characteristic, unusual trunk, with the undefined taste and color of the fruit, symbolizes the history, antiquity and survival of the Albanian people. The statement also talks about the symbolism of planting a certain number of olive trees by bachelors, as a condition for marriage, a tradition with a history since the time of Skënderbeu and also carried among Arbëreshes. These poetic verses extend to a larger extent in time and space, even from Morea, Albanian Ithaca, as the poet calls it, to Homer's "Odyssey".

Keywords: Zef di Maxho, metaphor, olive history, arboretums, survival, Sicily, etc.

## LITERATURA

- Zef Skiro Di Maxho*, Poema Arbëreshe- Poemi Arberischi Poema arbëreshe, Tiranë, 2018.
- Zef Skiro Di Maxho*, Sunata – Sonata-Settino torinese, Torino,1976.
- Zef Skiro Di Maxho*, Kopica e Ndryshku-La tignola e la ruggine, Palermo, 1981.
- Zef Skiro Di Maxho*, Përtej maleve prapa kodrës, zgjedhur dhepërgatitur nga Nasho Jorgaqi, “Naim Frashëri” Tiranë 1985.
- Zef Skiro Di Maxho*, Mas Rushi, Palermo, 1981.
- Zef Skiro Di Maxho*, Vjeç të tua 500 - Anni tuoi-Mas Rushi Arbëresh-Mastro Gio italo, Palermo, 1988.
- Zef Skiro Di Maxho*, Kopshti im me dritare-L’oreto e le finestre-Ed Mondo Albanese, 1995.
- Zef Skiro Di Maxho*, Kosova lule (vjrsha) - Fiore Kosovo-(poesie)Ed. Mondo Albanese, 1991.
- Zef Skiro Di Maxho*, Anije me vela e me motor-Navi a vela amotore- Mondo Albanese, 1992.
- Zef Skiro Di Maxho*, Canzoniere arbëresh (Sonete dygjuhësh), Hora e Arbëreshëve, 1999.
- Zef Skiro Di Maxho*, Gjeometri dhe ikje-Sonete dygjuhësh, Hora e Arbëreshëve-Piana degli Albanesi, 1998.
- Zef Skiro Di Maxho*, Metaforë-Metafora-ristampa arbërisht-versi bilingui.Perifazione di Matteo Mandala-Salvatore Sciascia Editore, Caltanisseta, 2005.
- Zef Skiro Di Maxho*, Trimdita (Poezi dygjuhësh) Giorneroe(poesia bilingue), Palermo, 2009.
- Zef Skiro Di Maxho*, Laerti, i jati (poezi)- il padre-Ed. (poezi)- Mondo albaneze, 1989.
- Zef Skiro Di Maxho*, Poezi gushtore e tjera, ASS.CULT MondoAlbaneze, Piana degli Albanesi, Palermo, 1994.
- Zef Skiro Di Maxho*, Poezi Dashurie në Kohë Vdekjeje (Kosova Dëshmore Tremujori i dytë –Poessie d’Amore in Tempo di Morte (Kosova Martire Sekondo Trimestre ’99-Testi bilingui - Prefazione di Matteo Mandala Salvatore Sciascia Ed Calttanisseta, 2000.
- Zef Skiro Di Maxho*, Përtej maleve, prapa Kodrës, Vjersha,Tiranë, 1985.
- Zef Skiro Di Maxho*, Atje kam (vjersha dygjuhësh) –La mia Morea (versi bilingui)-Prefazione di Matteo Mndala, (përrkthyer në shqip nga Zef Skiro Di Maxho) Tipgrafia Lusografica di Caltanisseta Hora e Arbëreshëve, 2004.
- Françeshko Alimari*, Vëzhgime gjuhësore dhe letrare, Prishtinë,2002.
- Gjuha dhe letërsia e arbëreshëve* (Simpoziumi Ndërkombëtar për Arbëreshët), Tetovë, 2011.

- Anton Nikë Berisha*, Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë, Kozencë, 2008.
- Contium*-Revistë e studimeve arbëreshe, Tiranë, 2021.
- Nasho Jorgaqi*, Antologji e poezisë bashkëkohore arbëreshe, Tiranë, 2001.
- Rexhep Ismajli*, Gjuha e bukës, përmbledhje me poezi të zgjedhura të zef Skiro Di Maxhos, Parathënia, Pishtinë, 1981.
- Sadik Bjko*, Përtej një apokalipsi. Mbi poezinë e sotme arbereshe 1946-1984, Tiranë, 1999.
- Mustafa Ibrahim*, Në Kalabri me arbëreshët, Shkup, 2021.
- Emin Kabashi*, Hapësira evropiane e letërsisë shqipe të arbëreshëve të Italisë, botuar në librin "Gjuha dhe letësia e arbëreshëve". Tetovë, 2011.
- Ali Aliu*, Don Kishoti shqiptar, Tiranë, 2007.
- Ali Aliu*, Ontologji e poezisë shqipe (Gjysëmshkulli i artë), Tetovë, 2000.
- Luan Tqçiu*, Udhëtimi në universin poetik, parathënia e librit "Poema arbëreshe", të Zef Skiro Di Maxhos, Tiranë, 2018.
- Gianfranco Romagnoli*, parathënia e librit "Poema arbëreshe", të Zef Skiro Di Maxhos, Tiranë, 2018.
- Giuseppe Schiro Di Maggio*, Poezi Dashurie në Kohë Vdekjeje (Kosova Dëshmore Tremujori i Dytë)- Poesie d'Amore in Tempo di Morte (Kosova Martire Secondi Trimestre), Caltanissetta-Romë, 2000.
- Andrëa Varfi*, Duke folur për krijimtarinë poetike të Xhuzepë di Maxhos, fjala e tij në përrurimin e librit "Përtej maleve prapa kodrës, Tiranë, 1985.
- Andrea Varfi*, Tradita dhe poezia e sotme arbëreshe, revista "Nëntori" 3, 1983.
- Visar Zhiti*, Një poet i ri 500 vjeçar, parathënia e librit "Poema arbëreshe" e Zef Skiro Di Maxhos, Tiranë, 2018.
- Ahmet Selmani*, Poezia e shprishur, Shkup, 2011. *Vebi Bexheti*, Studime arbëreshe, Tetovë, 2020.

ISSN 2671-3004

UDC 316.7(4)

Punim studimor

**Azis K. POLLOZHANI**  
Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup  
E-mail: a.pollozhani@unt.edu.mk

## INTERKULTURALIZMI NJË PARADIGMË E RE E SHOQËRIVE MULTIETNIKE

Hyrje

Semantika, rrjedhat dhe debati mbi multikulturalizmin

Në këtë vështrim të shkurtër do të shpalojmë një këndvështrim mbi debatin për rrjedhat, kuptimin dhe aspektet aplikative të termeve multikulturë dhe interkulturë. Punimi nuk ka për qëllim të bëhet pjesë e debatit mbi semantikën dhe aq më pak të merret me bazën epistemologjike të termave. Megjithatë, duke marrë parasysh se këto dy terme janë të kohës më të re në përdorim, në fillim do të përpiqemi të japim një spjegim semjotik duke mos u larguar nga dimensionin aplikativ i tyre në rrethanat aktuale edhe në debatin me interes të veçantë public edhe në Maqedoninë e Veriut.

Termi multikulturalizëm ka një sërë kuptimesh brenda konteksteve të sociologjisë, filozofisë politike dhe përdorimit i përgjithshëm.

-Në sociologji dhe në përdorimin e përditshëm, ai është një sinonim për "pluralizmin etnik", si një pluralizëm kulturor në të cilin grupe të ndryshme etnike bashkëpunojnë dhe hyjnë në një dialog me njëri-tjetrin pa pasur nevojë të sakrifikojnë identitetet e veta të veçanta.

-Shkencat politike, multikulturalizmin e përkufizojnë edhe si kapaciteti i një shteti për t'u marrë në mënyrë efektive dhe efikase me pluralitetin kulturor brenda kufijve të tij sovran.

-Teoriticientët (Wodak) nënvizojnë faktin se ideja e multikulturalizmit përfshin pajtimin, tolerancën, respektin, ndërvarësinë dhe universalizmin që pritej të sillte një "komunitet interkulturor".

Multikulturalizmi vs interkulturalizmit

Ramja e perdes së hekurt dhe dështimi i ideologjisë komuniste dhe rrjedhimisht teoritë respective mbi shtetin dhe kombin që i proklamote kjo

ideologji si dhe me hapjen e kufijve dhe mobilitetin e krahut të punës dhe migrimeve tjera për shkaqe të ndryshme , shoqëritë gjithnjë e më tepër po shfaqnin koloritin e vet etnik dhe kulturor që buronte nga egzistenca autoktone , por deri atëherë e pa dukshme në vendet ku ato jetonin ose nga shtimi i komuniteteve migrative në vendet e zhvilluara për shkak të nevojave të tyre ekonomike zhillimore.Diskursi i debatit mbi këtë fenomen deri në vitet e para të këtij shekulli, kryesisht ishte pozitiv.

Me kalimin e kohës, ajo u perceptua si një mënyrë për të institucionarizuar dallimet përmes diskurseve kulturore autonome.

Por përgjigja populiste ndaj kompleksitetit të një shoqërie gjithnjë e më pluraliste nuk është multikulturalizmi “si një një pluralizëm kulturor në të cilin grupe të ndryshme etnike bashkëpunojnë dhe hyjnë në një dialog me njëri-tjetrin pa pasur nevojë të sakrifikojnë identitetet e veta të veçanta”. Populizmi i djathtë e sheh multikulturalizmin si një recetë për të shkombëtarizuar kombin, për të dekonstruktuar popullin e dikujt.” Prandaj edhe dusa politikanë të shteteve më të fuqishme perëndimore e shpallën “*multikulturalizmin të vdekur*”

Ky ndryshim i shpejtë i diskursit , rihapi debatin për „ multikulturalizmin “ dhe mbrojtësit dhe teoriticinetët e diskursit pozitiv filluan të përdorin termin “ interkulturalizëm “ si një term që do të reflektonte esencën legjitime e të drejtave etnike , sociale dhe kulturore të njeriut të shkruajtura në Konventat ndërkombëtare por edhe që reflektonin cilësisht e re të përbërjes etnike dhe kulturore në Evropë dhe më gjërë.

Ashtu si komunikimi multikulturor, komunikimi interkulturor pranon bashkëjetesën e kulturave të shumta në një hapësirë të vetme.

Megjithatë, ajo shkon një hap më tej duke u fokusuar në takimet produktive që po ndodhin vazhdimisht midis kulturave. Edukimi multikulturor dhe ndërkulturor janë terma të ngjashëm që ndajnë shumë karakteristika, por ato dallohen për nga rezultati i këtij ndërveprimi.

*Multikulturalizmi promovon të kuptuarit e kulturave të ndryshme kurse interkulturalizmi promovon komunikimin pozitiv midis kulturave të ndryshme që konsiston në respektimin e opinioneve, vlerësimi i diversitetit, ndërveprimi kuptimplotë, dialogu ndërmjet të barabartëve, të mësuarit për njëri-tjetrin, të mësuarit nga njëri-tjetri dhe transformimi social duke fuqizuar kësisoj edhe kapitalin social të shoqërisë.*

Vendosja e këryre dy termeve, me aq ngjajshmëri ,në kontekstin e rrjedhave aktuale politike dhe gjithsesi parë nga aspekti praktik politik do të ndihmonte në qartësimin dhe eliminimin e vokabularit politik i cili mer kuptimin e caktuar varësisht se nga goja se kush flet.

Përderisa disa kur e përdorin fjalën”multikulturalizëm” “ shoqëri multikulturore “ pse jo edhe “shoqëri multietnike” e mendojnë si „aftësi e shtetit për të menaxhuar dallimet kulturore por pa mos e ndërruar konceptin themelor të shtetit, që nënkupton karakterin dominant etnocentrik të tij.

Kurse për të tjerët , repsektivisht për pjestarët e komuniteteve joshumicë multikulturalizetin e nënkuptojnë si “ ndryshim thelbësor të qenjes së

tij respektivisht të ndarjes të përgjegjësive mbi bazën e një koncepti të ri shtetformues”

Për të kuptuar më lehtë kuptimin politik të termit “multikulturalizëm “ dhe “ interkulturalizë” në literature i gjeta si më kuptimplot kuptimin e termave :

*multikulturalizëm nënkupton një përfshirje* që nuk lejon ndikim që do të thotë se termi përfshirje nuk do të thotë integrim i plotë, por një marrëdhënie vartëse mes sistemit në fuqi dhe atyre që duan t'i bashkohen.

*interkulturalizmi nënkupton integrim*, termi ky që përkundrazi, kuptimi thelbësor i të cilit ka të bëjë me ndarjen e arsyeve dhe metodave " e të qenit pjesë" ( që merr pjesë si protagonist dhe jo të përfshihet sipas rregullave që i cakton njëra anë.(Traccani)

Ky kuptim i termave spjegon dallimin esencial në mes tyre duke duke qartësuar dallimin mes tyre që duhet patur parasysh dhe do të duhej të jetë udhërrëfyes në diskursin politik dhe në debatin që po zhvillohet dhe do të zhvillohet për adaptimin e zgjidhjeve më efikase për stabilizimin e shoqërive multietnike.

#### Abstakt

Termi multikulturalizëm ka një sërë kuptimesh brenda konteksteve të sociologjisë, filozofisë politike dhe përdorimit i përgjithshëm. Diskursi i debatit mbi këtë fenomen deri në vitet e para të këtij shekulli, kryesisht ishte pozitiv.Me kalimin e kohës, ajo u perceptua si një mënyrë për të institucionalizuar dallimet përmes diskurseve kulturore autonome. Por përgjigja populiste ndaj kompleksitetit të një shoqërie gjithnjë e më pluraliste nuk është multikulturalizmi “si një një pluralizëm kulturor në të cilin grupe të ndryshme etnike bashkëpunojnë dhe hyjnë në një dialog me njëri-tjetrin pa pasur nevojë të sakrifikojnë identitetet e veta të veçanta”

Ky ndryshim i shpejtë i diskursit , rihapi debatin për „ multikulturalizmin “ dhe mbrojtësit dhe teoriticinetët e diskursit pozitiv filluan të përdorin termin “ interkulturalizëm “ si një term që do të reflektonte esencën legjitime e të drejtave etnike , sociale dhe kulturore të njeriut të shkruajtura në Konventat ndërkombëtare por edhe që reflektonin cilësishtë e re të përbërjes etnike dhe kulturore në Evropë dhe më gjërë. Vendosja e këryre dy termeve, me aq ngajshmëri ,në kontekstin e rrjedhave aktuale politike dhe gjithsesi parë nga aspekti praktik politik do të ndihmonte në qartësimin dhe eliminimin e vokabularit politik i cili mer kuptimin e caktuar varësisht se nga ai që fletl.

Interkulturalizmit si qasje në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme multietnike krijon kushte që të gjith përbërësit e akëcilës kulturë dhe të akëcilit komunitete etnik, të ndihen të respektuar, të mund të kultivojnë lirshëm traditën dhe të përparojnë vlerat e veta dhe bashkë me të tjerët të krijojnë kushte për një jetë më të mire dhe mirëqënje për të gjith qytetarët me të cilët jetojnë .

*Fjalët kyç: Shoqëri multietnike.paradigmë, interkulturalizmi.*

### Abstract

The term multiculturalism has a variety of meanings within the contexts of sociology, political philosophy, and general usage. The discourse of the debate on this phenomenon until the first years of this century was mostly positive. Over time, it was perceived as a way to institutionalize differences through autonomous cultural discourses. But the populist response to the complexities of an increasingly pluralistic society is not multiculturalism "as a cultural pluralism in which different ethnic groups cooperate and enter into a dialogue with each other without having to sacrifice their separate identities."

This rapid change of discourse reopened the debate on "multiculturalism" and defenders and theoreticians of positive discourse began to use the term "interculturalism" as a term that would reflect the legitimate essence of ethnic, social and cultural human rights written in International conventions, but also those that reflected the new quality of the ethnic and cultural composition in Europe and beyond.

Placing these two terms, with such similarities, in the context of the current political trends and in any case seen from the political practical aspect, would help clarify and eliminate the political vocabulary, which takes on a certain meaning depending on who speaks.

Interculturalism as an approach to building a sustainable multi-ethnic society creates conditions for all members of that culture and that ethnic community to feel respected, to be able to freely cultivate tradition and advance their own values and together with others to create conditions for a better life and well-being for all citizens with whom they live.

Key words: Multiethnic society. paradigm, interculturalism.

### Referencat:

Kymlicka W. (2003), "Multicultural states and intercultural citizens", Theory and Research in Education, 1(2), 147-169.

**Ricard Zapata-Barrero**, Interculturalism in the post-multicultural debate: a defence

### **R.Zapata: Interculturalism, main hypothesis, theories and strands**

Barrett, Martyn (ed.) (2013), Interculturalism and Multiculturalism: Similarities

and Differences, Strasbourg, France: Council of Europe Publishing.

Frances Riemer : Ruth Wodak, Rudolf De Cillia, Martin Reisigl, Karin Liebhart: The Discursive Construction of National Identity.

ISSN 2671-3004

UDC 811.18-112  
929Sejdiu, Sh.**Punim studimor****Begzad BALIU**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë  
Fakulteti i Edukimit  
e-mail: begzad.baliu@uni-pr.edu**PIKËPAMJET E LINGUISTIKE TË PROFESOR SHEFKI SEJDIUT: PREJ  
RRAFSHIT ILIRO-ARBRORO-SHQIPTARË DERI TE UNIVERSI  
GLOBALIST****Linguistic views of professor Shefki Sejdiu: from the Illyro-  
Arbroro-Albanian plane to the globalist universe****Јазичните погледи на професор Шефки Сејдиу: од илирско-  
арбрешко-албанско рамниште до глобалистичкиот универс**

HYRJE

Rreth një dy dekada më parë, pasi i kishim dhënë lexuesit dy vëllime me studime të Profesor Shefki Sejdiut<sup>17</sup>, po i jepnim edhe një tjetër me titull *(Illyro-arbroro) shqiptarët dhe gjuha e tyre në Universin globalist*. Si në dy botimet e para ashtu edhe në këtë vëllim, sfida e parë për mua ishte fjala hyrëse, e cila për autorin e veprave, nuk ishte e domosdoshme. Për mua ndërkaq, një *Parathënie* e zakonshme, sado modeste të ishte, duhej të vendosej në hyrje edhe të atij libri.

Gjatë këtyre viteve, kur edhe janë shkruar studimet e këtij vëllimi, kam qenë dëshmitar i një pune shumë sistematike dhe këmbëngulëse të Profesor Sejdiut për të sjellë në studimet shqiptare pamje dhe prirje të reja të kërkimeve shkencore. Studiuesit, kolegët dhe studentët e brezit tim, dhe madje, tash, edhe studentët e mi të masterit, do t'i kujtojnë gjatë diskutimet e Profesor Shefki Sejdiut në amfiteatrot e fakultetit dhe në institucionet e tjera arsimore e shkencore dhe insistimet e tij prej shkencëtari të formuar

---

<sup>17</sup> Shih vëllimet e fundit të Profesor Shefki Sejdiut: *Sisteme, struktura, raporte (etnolinguistikë)* (2002) dhe *Sprova etimologjike* (2002).

në vendet elitare akademike europiane, që gjuhësinë shqiptare dhe albanologjinë përgjithësisht t'i 'edukojë' me nocionet dhe termat më bashkëkohore të gjuhësisë europiane. Pra, besoj se lexuesit dhe studiuesit e brezave të ardhshëm do ta kuptojnë se kemi të bëjmë me profesorin, i cili në jetën akademike ka sjellë njëmendësinë europiane të dijes dhe të komunikimit në gjuhësinë shqiptare.

Libri (*Iliro-arbroro*) shqiptarët dhe gjuha e tyre në Universin globalist është edhe një vëllim i përzgjedhur i studimeve të Profesor Shefki Sejdiut. Në të vërtetë libri përmban një përzgjedhje trajtesash të kumtuara në disa konferenca shkencore të mbajtura në Prishtinë dhe në Tiranë, të cilat në ndonjë rast nuk janë botuar të plota, ndërsa në raste të tjera janë botuar me gabime të natyrës teknike (skemat) dhe përmbajtjesore (formulimet).

Në këtë vëllim me studime, të cilit do t'i pasvjen edhe një vëllim tjetër më heterogjen, ato janë të paraqitura, sikur do të shprehej autori i tyre, sipas një rendi lëndor, tematik e zhvillimor, logjiko-kognitiv epistemologjik, duke pasur parasysh edhe aspektet rrethanore, tipologjike, kulturo-historike, gjuhësore relacio-zhvillimore të entiteteve *objekt, subjekt, specie njeriu, racë, popull* etj. Qëllimi i kësaj vepreje, e cila më parë se një vëllim kumtesash, mund të quhet edhe korpus studimesh të ndërlydhura e të sistemuara në aspektin tematik dhe metodologjik, është përqendruar në vëmendjen tek *pre-* dhe *proto-ilirët, iliro-arbrorët-shqiptarët dhe gjuha e tyre*, që gjatë mileniumeve kanë marrë forma transpozicionale e zhvillimore, evolutive e fiziko-shpirtërore, kulturore dhe gjuhësore.

## PARADIGMA E TEMAVE

Vëllimit i paraprindë paradigma, e cila i përcakton ligjësisë e të gjitha temave dhe proceseve të trajtuara, qoftë në kontekstin historik - pra në diakroni, qoftë në kontekst të periudhave të caktuara - pra në sinkroni; për të vazhduar me transpozicionin (*Rreth transpozicionit semantiko-referencial dhe kategorialo-formativ të strukturave leksikore (leksik, terminologji, nomenklaturë)*), pa të cilin nuk ka nuancim të gjuhës. Pra, nëse studimi i parë e shihte procesin si zhvillim të jashtëm, transpozicioni merret në mënyrë thellësisht logjike me zhvillimin e brendshëm të saj. Studimi i tretë *Gjurmë lashtësie antropologjike*, trajton ndërrimin dhe zhvillimin kronologjik nga dolikocafalia në mezocefali dhe bracicofali. Edhe këtu nga aspekti metodologjik i qasjes shkencore, funksionon paradigma dhe transponimi mijëvjeçar dhe si rrallë kund tjetër funksionojnë përballë njëra tjetrës paradigmat dhe transpozicionet përballë njëra tjetrës, apo paradigmat me transpozicionet dhe anasjelltas. Studimi i katër *Gjurmë interferimesh emërtimi helen(ik)o-greke, ilir(ik)o-albane dhe ital(ik)o-romane*, identifikon gjerësisht gjurmët, ndikimin, paralelet, strukturat etj, përmes transpozicionit, shenjave, shtresave, referencave etj. Në këtë mënyrë konceptet metodologjike ndaj proceseve historiko-gjuhësore në studimet e Profesor Sejdiut, përveç me paradigmat dhe transpozicionin, plotësohet edhe me

interrogativët brenda gjuhës. Studimi i pestë *Fjalëformime mbi bazë interrogativësh (aspekti logjiko- semantik dhe strukturor)*, interrogativët, një dëshmi se njeriu kur ishte homoanimalis ka filluar të zhvillohet dhe përmes instiktit a nevojës ta pyesë veten apo t'i shtrojë pyetje vetvetes dhe tjetrit: *Kush? Çka? Ku? Kur? Pse? Sa? Si? etj.* Përmes ridefinimit kompleks të tyre, autori vjen në përfundim se përmes interrogativëve logjika zhvillohet në të menduarit e njeriut dhe bashkë me to edhe njeriu e shoqëria. Studimi *Parafjala NË dhe disa relatorë lokativë*<sup>18</sup> të shqipes, çështjen e kërkimit e thëllon për një shkallë më të lartë: nga një përpjekje për të nxjerrë zërin, jo si pashtrmë po si mendim, drejt një parafjale, prej nga krijohet sistemi i parapërgatitjes për ndikimet në universin globalist, qoftë si dhënëse qoftë si marrëse, pra qoftë si gjuhë e ndikuar qoftë si gjuhë ndikuese. Vëllimi përmbillet me një studim kulmor (*Proto-*)shqipja në universin globalist, që mund të quhet edhe përmbyllje e të gjitha studimeve të mëparshme, për faktin se temat e trajtuara nga njëri studim në tjetrin, sikur i rimerr dhe i trajton duke i parë bashkërisht në vertikalen e tyre.

Kësaj paraqitjeje i paraprinë trajtesa *Paradigma formë sistemore (argumentimi apo edhe përgënjeshtrimi) në trajtime shkencore*. Fjala është për kumtesën e lexuar në një nga tryezat shkencore të Prishtinës, menjëherë pas daljes nga shtypi të *Enciklopedisë maqedonase*, me të cilën autori iu përgjigjej argumentueshëm, si kurrë më parë në studimet albanologjike, synimeve largvajtëse të studiuësve të politizuar skajshëm maqedonas, për shqiptarët dhe trashëgiminë materiale e shpirtërore të tyre në Maqedoninë e sotme Perëndimore dhe Qendrore<sup>19</sup>. Në këtë studim të karakterit monografik Profesor Sejdiu ka trajtuar një nga problemet më me ndikim në gjithë historinë e studimeve albanologjike të studiuësve serbë e maqedonas në dy shekujt e fundit. Fjala është për sintagmën *zbritje nga malet*, përmes së cilës, sikur është thënë shumë herë Akademia maqedonase përpiqet ta mohojë autoktoninë e (proto)shqiptarëve në ultësira dhe në lokalitete urbane të Maqedonisë së sotme shtetërore. Pra, vlerëson Profesor Sejdiu "*autoktonia* e banorëve shqiptarë të kësaj hapësire përmes kësaj *sintagme* është vënë në sprovë, duke harruar se (*jo*)*autoktonia* e banorëve të hapësirave të ndryshme të mbarë globit tokësor (janë) është dukuri universale, probleme komplekse e edhe koncepte relative, ku nënkuptohet edhe *kronologjia* që përmban edhe konceptin *rend në kohë* dhe të tjerë faktorë e rrethana që janë në raporte kauzaliteti". (24)

Çështjes në fjalë autori fillimisht i është qasur nga aspekti semantik dhe në mënyrë interdisiplinare, ndërsa më tej, sidomos në pjesën e dytë, çështja është kundruar nga aspekti antropologjik e tipologjik. Pjesët vijuese

<sup>18</sup> Për aspektin teorik shih Keith Brown, *Encyclopedia of Language and Linguistic*, Amstardam, 1994, f. 198.

<sup>19</sup> Shih vëllimin me kumtesa: *Enciklopedia e ndarjes* (Marrëdhëniet shqiptare-maqedonase - konteksti i Enciklopedisë së Maqedonisë). *Kumtesa të Tribunës shkencore të organizuar nga Instituti Albshkenca, mbajtur në Prishtinë, më 7. 10. 2009*. Botoi Instituti Alb-shkenca, Prishtinë, 2010, f. 124.

të këtij studimi i janë kushtuar konkordancave, por edhe dallimeve kundërvënese në fushë të onomastikës me përqendrim të veçantë tek gjinia e *gjenerikut* të emrave të lumenjve, cilësi kjo dalluese e gjuhës shqipe, si dhe kundërvënese në raport me gjuhët sllave. Vëmendje të veçantë u është kushtuar disa çështjeve të domenit të fonologjisë diakronike, përkatësisht evoluimit të fërkimores (frikativit) /s/ në /sh/ në protoshqipe. Këto fërkimore u kanë shërbyer shumë gjuhëtarëve, që nga Skoku, Bariqi e Çabeji, t'i trajtojnë etimologjitë e disa toponimeve (ojkonime e oronime), si tek seria *Naissus, Scupi, Astibos, Lychnidus, Scardus*, të cilat në saje të ligjeve fonetike të shqipes kanë evoluar në të sotmet (forma): Nish, Shkup, Shtip, Ohër dhe Sharr.

Ky fenomen evolutiv ka bërë që protoshqipja të dallojë nga greqishtja, latinishtja, sllavishtja dhe të ndihmojë në diskutimin rreth autoktonisë së elementit etnik shqiptar në këto hapësira dhe lokalitete urbane. Kalimi i fërkimores alveolare /s/ në /sh/ u ka shërbyer shumë gjuhëtarëve të huaj e të vendit ta shikojnë në sistem-zinxhirin ojkonomik *Nish – Shkup – Shtip – Sharr*, që rrjedhin nga trajtat *Naissus – Scupi – Astibos – Scardus*, ku fërkimorja alveolare /s/, sipas mendimit të Skokut, Bariqit e Çabejt ka evoluar në fërkimore alveolare qiellzore /sh/ vetëm mbi bazë të ligjeve fonetike të shqipes.

Studimi i Profesor Sejdiut është nga ato pak sinteza shkencore të shkruara në gjysmën e dytë të shekullit XX e këtij, që i ka dhënë përgjigjen e duhur jo vetëm akademikëve maqedonas, po edhe akademikëve serbë e albanofilë përgjithësisht, prandaj mund të thuhet se përmasa e përgjigjes së tillë është pritur gjatë.

## TRANSPOZICIONI SEMANTIKO-REFERENCIAL

Studimi i dytë i këtij vëllimi trajton një problem të karakterit leksikor, por me një qasje shumëdimensionale, e që ka të bëjë me *transpozicionin semantiko - referencial dhe kategorialo-formativ të strukturave leksikore (leksik, terminologji, nomenklaturë)*<sup>20</sup>.

Nëse në studimin e parë Profesor Sejdiu nisej mbi një frakturë historike (hapësirë, kohë, gjuhë, origjinë), në studimin e dytë niset prej shkollave (*kognitivizmi dhe koneksionizmi*) dhe koncepteve teorike (*teoria e prototipave*) që mundësojnë hyrjen në diskutimin e shumanshëm të *transpozicionit semantiko-referencial dhe kategorialo-formativ të strukturave leksikore (leksik, terminologji, nomenklaturë)*. Problemi me të cilin merret Profesor Sejdiu, megjithëse i natyrës gjuhësore, trajtohet si formë e sistem i

<sup>20</sup> Për konceptin bazë *transpozicion*, shih gjerësisht, *Cambridge International Dictionary of English*, Originally published: 1995, Editor: Paul Procter, f. 1552 dhe *Encyclopedia of Language and Linguistics*, 2nd edition, bay Keith Brown, Amstardam, 1994, ndërsa mungon te *The Cambridge encyclopedia*, edited by David Krystal, Cambridge University press.

gjerë dhe kompleks entitetesh formale, konceptuale e semantiko - kognitive, duke sjellë në plan të parë edhe referentë të tjerë etno-linguistik, që gjuhësisht realizohen përmes formave, llojeve dhe kategorive ligjëri-more e, në veçanti, siç do të shprehej autori “përmes formave leksikore që shënojnë koncepte dhe krijojnë shenja gjuhësore” (51). Në këtë mënyrë, duke u mbështetur në universin semantiko - kognitiv, autori arrin deri te disiplina gjuhësore, siç është leksikologjia, tek e cila si bazë qëndron *emri* (nomen) dhe *termi*(nologjia) - disiplinë gjuhësore që studion sistemet e *termave*.

Në rrjedhë të këtyre kërkimeve: sisteme e nënsisteme, terma e nocione, autori arrin deri te përfundimi se dukuria e transpozicionit kategorialo-formativ, semantiko-kognitiv dhe referencial, haset dendur jo vetëm në fushë të terminologjisë, por edhe në fusha të tjera të leksikut, sidomos në taksonominë popullore të bimëve e të shtazëve, por edhe në sisteme e nënsisteme të emërtesës strukturore si ky i farefnisnë tek shqiptarët, duke përfshirë këtu edhe krijimin e realiteteve të reja formale, semantike e referenciale.

Te trajtesa *Gjurmë lashtësie antropologjike dhe gjuhësore tek shqiptarët*, hetohen çështje të origjinës *pre-* dhe *proto-ilire* të njërit prej fiseve indoeurpiane, që së bashku më *pre-* dhe *proto-gjermanikët* dhe *pre-, proto-keltët*, lëvizën në drejtim të hapësirave të Europës Qendrore dhe të Mesdheut, apo sikur e identifikon autori: Mediterrani. Pasi diskuton çështje të natyrës teorike dhe metodologjike të problemit, një pjesë të gjerë të studimit të tij Profesor Shefki Sejdiu ia kushton njëres prej teorive më me ndikim në studimet antropologjike të origjinës së popujve, përbërësve antro-po-fizikë të gjurmëve të popujve të lashtë, krahasuar me pasardhësit e kohës së re. Në këtë rrjedhë diskutohen rrethanat dhe hapësira gjeo-klimatike, që do të ndikojnë edhe në karakterin antropologjik dhe tipologjik të etnive, si te rasti i dukurisë së dedolicocefalizmit, mezosefalizmit dhe brakiocefalizimit, sidomos i atyre që u vendosën në hapësirat e Mesdheut (ilirëve, italikëve dhe keltëve).

Duke e parë problemin në diskutim si një kompleks çështjesh interdisiplinare (të origjinës, të historisë dhe të arkeologjisë, të kulturës, të civilizimit, të gjuhës, të antropologjisë fizike, sociale dhe kulturore, por edhe gjuhësisë dhe disiplinave të tjera diakronike), autori sjell një varg përbërësish të lashtë etnokulturorë (siç janë *kuvada*, *kulti i diellit*, *kulti i gjarprit*, *ritet mortore*, të ngjashme me ato të italikëve të periudhës romake, pastaj *gjakmarrja*, e ngjashme me *vindetta*-n korzikane); në fushë të kostumologjisë (*qeleshja (plisi)*, *fustanella*); në fushë të etnolinguistikës (*përdorimi virtual dhe simbolik i numrave 3, 7, 9, 12*), gjurmët e sistemit *vigezimal* (si: *dyzet*, *trezet* dhe *katërzet*) etj. Duke i hapur dimensionet e kërkimeve të tij në lashtësinë e përbërësve antropolinguistikë dhe kulturore, autori arrin të dëshmojë lashtësinë e kontakteve të protoshqiptarëve dhe të gjuhës së tyre me popuj, gjuhë dhe kultura paraindoeuropiane të Mesdheut, p. sh. : emri *motër* <i. e., mater, struktura *mëmëdhe* etj. Në këtë

rrjedhë të studimit të tij shumëdimensional, ai arrin të rikonstrukttojë edhe strukturat antropolinguistike në disa rrafshe të sistemit të farefisnisë tek protoshqiptarët, sikur janë: gjurmët e sistemeve të emrave të ditëve të javës në gjuhën shqipe (ilire, latine, të latinishtes së periudhës pagane romake dhe të epokës së kristianizmit).

Në studimet e tij në fushë të onomasiologjisë, ka një gjysmë shekulli që Profesor Sejdiu sjell rezultate të reja, mbështetur në fitoniminë e shqipes. Në këtë studim ai fitoniminë e shqipes e bën objekt krahasimi dhe referimi, duke gjetur te ajo gjurmë origjine paraindoeuropiane dhe mediterane (*shegë, fik, ilqe* etj). Po të kësaj natyre i sheh edhe hidronimet *Buenë* apo *Bunë* (*Barbanna*) dhe *Ibër*, të cilët autori, duke iu referuar edhe Skokut, konsideron se korrespondojnë nga aspekti formal dhe ai i origjinës (paraindoeuropiane) me lumin *Barbanne* (Francë) dhe *Ebro* (Spanjë). Të substratit mediteran e konsideron edhe apelativin oronimik të shqipes *mal* “*montagne*”, *malh* “*shkëmb*”, kodër shkëmbore në vargmalet e Pirinejeve spanjolle, *malkar* “vend shkëmbor” në baskishte, *mala* “mal” në frëngjishte, *Mala*, plazh shkëmbor afër Monakos, *Maluentum* dhe *Malventum* në Italinë qendrore, *Di-mallum*, në Iliri, etj. Në këtë trajtesë, si në pak studime të kësaj natyre, në fushë të albanologjisë autori ndërton struktura të pasura, të gjera e të lashta antropologjike, etnokulturore dhe gjuhësore që ndeshen jo vetëm tek shqiptarët po edhe tek popujt dhe rajonet e tjera fqinje, dëshmi kjo e një jete simbioze që në kohërat më të lashta me popujt paraindoeuropianë dhe indoevropianë, si dhe me kulturat dhe gjuhët e tyre në hapësirën e Mesdheut.

## INTERFERENCAT DHE INTERFERIMET

Objekti i studimit mbi interferencat dhe interferimet në fushë të emërtimit me titull *Gjurmë interferimesh emërtimi helen(ik)o-greke, ilir(ik)o-albane dhe ital(ik)o-romane*, vendoset në hapësirën e gjerë të Gadishullit, duke e parë atë si një *udhë* dhe *urë*, njëkohësisht të kalimit dhe të lëvizjeve jo vetëm të kryqëzatave po edhe të popujve, kulturave e gjuhëve, përgjatë mileniumeve. Duke qenë kështu një çështje thellësisht dhe gjerësisht komplekse, Profesor Sejdiu temës i qaset duke e parë atë në mënyrë konvergjente, pra në kontekst të gjeografisë, historisë, arkeologjisë, etnologjisë, antropologjisë, etnopsikologjisë, linguistikës, semantikës, si dhe teorisë së emërtimit (onomasiologjisë). Pra, sikur shprehet: “vëmendja hetuese e hulumtuese është përqendruar tek motivimet, konceptualizimet dhe bazat emërtuese, si dhe tek origjina e etnonimeve *ilir, gegë, alban (arbën, arbër), grek dhe italik*” (83), prej nga arrin të ndërtojë tri etnofaza: I. ILIRE – shek. VI para erës së re – shek. VII mbas erës së re; II. ALBANO-ARBËRORE – shek. VII-XVII; dhe III. ALBANO-SHQIPTARE – shek. XVII-XXI. Në këtë rrjedhë ai krijon edhe sistemin e raporteve të brendshme, por edhe të jashtme, me fqinjët: grekët dhe italikët, duke i parë mes tyre anët jo vetëm gjuhësore e gjeografike, po edhe etnopsikologjike e semantike të

komunikimit me botën dhe bashkëkohësinë. Megjithëse, autori shquan mjaft përbashkësi të tyre kohore (disa mija vjet), rajonale (Gadishullin Ballkanik) dhe gjuhësore (indouropiane) arrin në përfundimin se megjithatë të këta popuj vërehen dallimet në të menduar dhe vepruar, pasi: “tek *heleno-grekët* ka mbisunduar mitologjia dhe egocentrizmi, tek *iliro-albano-shqiptarët* ka mbizotëruar spontaniteti dhe individualizmi, tek *italo-romanët* ka predominuar racionalja, institucionalja dhe rendi” (103).

Në studimet albanologjike, gjatë gjithë shekullit XX janë zhvilluar shumë diskutime mbi raportet ndërndikuese dhe gjuhësore të gjuhëve e kulturave të fqinjëve në dy dialektet e gjuhës shqipe, duke i parë ato jo si zhvillime të brendshme po të ndikuara nga jashtë<sup>21</sup>. Do të ishte me shumë interes sikur në rrjedhë të kërkimeve albanologjike, qasja e Profesor Sejdiut të gjente zbatimin e saj edhe në këtë temë, sado shumë herë të përjashtuar nga diskutimi, apo të rivlerësuar vetëm brenda fushës së dialektologjisë.

Trajtesa mjaft komplekse, para se gjithash në kontekstin historik, etnopsikologjik dhe gjeografik e krahasues, *Gjurmë interferimesh emërtimi helen(ik)o-greke, ilir(ik)o-albane dhe ital(ik)o-romane*, pasurohet ndjeshëm në kontekstin etnolinguistik me trajtesën tjetër *Fjalëformime mbi bazë interrogativësh (aspekti logjiko- semantik dhe strukturor)*. Në këtë studim autori vazhdon kërkimet e tij për *interrogativët*, forma këto ligjërimore ndër më të hershmet e *species homo*, me të cilat qenia njerëzore ka filluar të shprehë të menduarit, të interesuarit e të kureshtjes për ta njohur botën materiale dhe shpirtërore. Studimi synon hulumtimin e disa strukturave të ndërtuara mbi bazë të interrogativëve, transpozicionimin, ndërtimin dhe transformimin e tyre formal dhe kuptimor, kategorial e funksional, primar e sekondar, si edhe risemantizimin dhe rikategorizimin e tyre.

Duke e parë natyrën komplekse të interrogativëve dhe raportet e tyre të ngushta, sidomos me *indefinitët* dhe *relativët*, dhe duke i parë veçantitë e shqipes për ndërtime aq të shumta mbi këtë bazë dhe me një sistem kaq koheziv dhe harmonik, të cilat nuk i shpreh asnjëra nga gjuhët e Ballkanit dhe as të Europës, arrin tek një pikëpamje se mbase “aftësitë e shqipes për ndërtime të tilla, rrjedhin ngase protoshqiptarët ishin lashtësisht dhe shumë kohë në kontakt me popuj dhe gjuhë paraindoeuropiane të hapësirës së Mesdheut” (122). Në këtë rrjedhë, mund të supozohet që ky zhvillim mendor dhe interesimi për ta njohur botën që e ka rrethuar, tek shqiptarët, përkatësisht paraardhësit e tyre, është arritur edhe përmes formave *logjiko-interrogative, kognitvo-epistemologjike*, sikundër që janë format dhe substancat e përmbajtjes që artikuloohen përmes interrogativëve *çka, kush, ku, kur, si* etj.

---

<sup>21</sup> Shih, gjerësisht diskutimet e Jorgji Gjinarit në studimin *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1968/4, f. 127-144.

## METODA HEURISTIKE

Në mënyrë po kaq të natyrshme, radhës së këtyre trajtesave iu vjen studimi *Parafjala NË dhe disa relatorë lokativë*<sup>22</sup> të shqipes. Fjala është për njërën prej trajtesave më komplekse, që më parë se sa një studim i rrjedhës është një trajtesë e karakterit teorik dhe monografik, për të cilën autori, bashkëkohësit dhe brezat e studiuesve që vinë, nga radhët e gjuhësisë së përgjithshme dhe të gramatologjisë së shqipes e të albanologjisë, do të kenë çka të diskutojnë. Për më tej, qasje të tilla dhe shumëfish më komplekse në fushë të gramatikës së shqipes, presin studiuesit e tjerë nga radhët e gramatikanëve, leksikografëve, albanologëve e linguistëve shqiptarë përgjithësisht, me kusht që të tejkalojnë fazën e sotme tradicionale të perceptimit dhe të studimit mbi të, si dhe me kusht që këtë lëndë hulumtimi e trajtimi ta kalojnë në fazën e këndvështrimit nga ai tradicional në kognitivo-semantik e strukturor.

Dhe pse të mos e bëjnë!

Hulumtime të tilla (investiguese) raportesh, konstaton autori në fillim të këtij studimi, mundësohen falë metodave heuristike, ku kognitivistika dhe teoria e toposeve me qasjet dhe metodat, dendur po aplikohen në gjuhësi, për të vazhduar me shembullin e arritjeve të sotme të shkollave, teorive, nocioneve e përfaqësuesve kryesorë të tyre në Europë dhe në Amerikë.

Parafjala *në*, si me origjinë dhe lashtësinë ashtu edhe format parafjalësore, ashtu edhe me origjinën e saj, me lashtësinë e saj, me format parafjalësore që janë ndërtuar mbi bazë të saj, ashtu edhe me veçantinë strukturore të sistemit në krahasim me gjuhët e tjera simotra indoeuropiane, paraqet lëndë me interes trajtimi në frymën e të arriturave të gjuhësisë bashkëkohore. Në të vërtetë, mbështetur në rrymat, metodat dhe konceptet e përvojës euro-amerikane autori arrin disa rezultate, të cilat janë të pranishme në fushë të gramatikës, në shembullin e parafjalës *në*, por që mund të bëhen edhe model kërkimi, sistemi e strukturimi në diakroni e sinkroni edhe për kategori të tjera gramatikore. Prej këtij studimi, ndërkaq, autori arrin te konstatimi se edhe parafjalë(sorë)t-lokativë, të cilët shprehin vendosje në kohë dhe hapësirë u zhvilluan herët, si forma kategoriale për të shprehur e shënjuar raporte topikale midis *ensit* subjekt dhe objekt (real apo virtual), e që epistemologjia kognitive dhe teoria e toposeve i konsideron si shumë relevante për zhvillimin e ligjëritimit dhe të komunikimit njerëzor. Në të vërtetë edhe autori e përmbyll trajtesën e tij mbi *parafjalët lokative* të shqipes me konstatimin se gjuhësia e *toposit* dhe ajo *kognitive*, u kanë hapur rrugë njohjeve të proceseve, në sistem, sikundër që janë perceptimet vizuale, spekulative, logjiko-kognitive, reale e virtuale, formale dhe semantike, etj.

---

<sup>22</sup> Për aspektin teorik shih Keith Brown, *Encyclopedia of Language and Linguistics*, Amstardam, 1994, f. 198.

Në kushtet e sotme shembulli më konkret mund të merret ndikimi globalist mbi gjuhët. Kaq imponues e dinamik është atakimi mbi gjuhët në të gjitha rrafshet, kategoritë dhe nivelet, madje si në aspekt të formës ashtu dhe të substancës, si në rrafshin shprehës ashtu edhe në nivel të përmbajtjes së shenjës gjuhësore, përkatësisht, në fonetikë e fonologji, në morfo-sintaksë dhe leksiko-semantikë etj. Në të gjitha situatat paradigmatiche dhe të përmbajtjes ndikimet globaliste janë evidente, e ato mund të vërehen edhe tek tekstet “e sajua” e të diskutuara në trajtesën përmbyllëse të kësaj monografie.

Trajtesa përmbyllëse e këtij vëllimi, që mund të quhet edhe një monografi më vete, mbështetur në sistemin metodologjik, që bartet nga njëri studim në tjetrin, merr në shqyrtim *(proto)shqipen në universin globalist*.

Duke qenë një koncept jo shumë i ri<sup>23</sup>, që më parë shënjohej me termin *mondializëm*<sup>24</sup>, viteve të fundit ka marrë përmasa përshtirëse në shumë fusha të dijes, të ekonomisë e të tregut, të kulturës, prandaj edhe të filozofisë së sjelljes dhe të të menduarit. Përmasa posaçërisht të veçanta (dhe madje shqetësuese, e ndonjëherë edhe refuzuese) globalizimi si term ka marrë në fushë të gjuhësisë, për të cilin ka shumë diskutime dhe referime. Ky koncept, në gjuhësi fillimisht perceptohej si tendencë ndikimi, huazimi e më gjerë, mbivendosje e gjuhëve të mëdha në ato të vogla, që fillojnë me forma leksikore dhe artikulimi. Profesor Shefki Sejdiu, vë re se mbishtresa a mbivënie të kësaj natyre i kanë zhdukur gjuhët e nënshtruara, siç ishin hetitishtja, pellazgishtja, fenikishtja dhe etrusishtja, për t’u ndalur në mënyrë të veçantë në ndikimin globalist mbi (proto)ilirët dhe arbëroro-shqiptarët e gjuhën e tyre, dhe duke u mbështetur në një skemë bosht në përcaktimin hapësinor e kontaktues të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera.

Në të vërtetë skema e “Universit Globalist” shpreh gjithë universin e kontakteve të (proto)ilirëve dhe arbëro-shqiptarëve dhe gjuhës së tyre gjatë mileniumeve sa ishin në truallin e hershëm indoeuropian të hapësirave midis Kaspikut, Pontusit (Detit të Zi), Kaukazit dhe Karpateve, si dhe lëvizjes drejt Europës dhe Mediteranit (Mesdheut) ku ranë në kontakt

<sup>23</sup> *Globalizimi*, si koncept njihet nga shekulli XV, ndërsa si term në gjuhën angleze në vitet 30 të shekullit XX. ( **shih, Hopkins, A. G. (ed. ). (2004). *Globalization in World History*. London: Norton, pp. 4–8; Jump, Bakari, Mohamed El-Kamel. "Globalization and Sustainable Development: False Twins?". *New Global Studies*. 7 (3): 23–56.** Megjithëse për çështje të natyrës ekonomike dhe arsimore shfaqet dendur që në fund të Luftës së Dytë Botërore, trajtën përfundimtare e merr nga mesi i vitetve '80. Në gjuhën frënge, të cilës i referohet Profesor Sejdiu, shfaqet në fillim të shekullit XX, pra në vitin 1903 (Shih, Pierre de Coubertin, “Le Figaro”, 13 dhjetor 1904).

<sup>24</sup> Shih gjerësisht, Mavoungou PA (2001). “*La mondialisation et la lexicographie trilingue ou plurilingue au Gabon*”. In Emejulu J duT(ed. ) *Elements de lexicographie Gabonai*, e. Tome 1. New York: Jimacs-Hillman Publishers. 160–183, së cilës i referohet edhe Keith Brown, *Encyclopedia of Language and Linguistics*, Amstardam, 1994.

edhe më banorët, kulturën dhe gjuhën e këtij nënqielli. Kjo skemë është paraqitur fillimisht nga dy rrafshë o. P. ie – para indoeuropiane, mediterane dhe O. 1. al. – (iliro-arbroro-) shqiptare e përshkallëzuar më tej edhe në njëmbëdhjetë nënsisteme: 1. ie. indo-europiane; 2. heleno-bizantino-greke; 3. latino-romane; 4. italiane; 5. gjermanike; 6. sllave; 7. turko-orientale; 8. frënge; 9. anglo-amerikane; 10. internacionalizma dhe terminologji tekniko-shkencore; 11. globalizma (144).

Megjithëse, sikur është shprehur autori, globalizimi sot kërkon qasje interdisiplinare, në këtë studim ai merr në diskutim e vlerësim aspektin leksiko-tekstor, fono-artikullativ dhe sistemo-strukturo-kategorial. Brenda të gjithë parametrave të saj, në këtë trajtesë, nuk mungojnë as shqyrtime teorike, historiko-gjuhësore dhe analitike, e në mënyrë të veçantë shembujt konkretizues e diskutues.

#### PËRFUNDIME: BALLKANOLOGU SUI GENERIS

Profesor Shefki Sejdiu është specialist i romanistikës dhe ballkanolog sui generis në studimet gjuhësore shqiptare. Ai është formuar në institucionet më të rëndësishme arsimore (Prishtinë, Shkup, Zagreb, Paris) në fushë të filologjisë në përgjithësi dhe romanistikës në veçanti. Këtë nxënie dhe përvojë bashkëkohore në fushë të gjuhësisë, ai e ka sjellë për pesë dekada me radhë në veprën e tij shkencore, qoftë si metodë: nga strukturalizmi te semiologjia e kognitivistika, qoftë si përmbajtje: nga korpusi i fitonimisë shqipe te struktura e fitonimisë ballkanike e mesdhetare. Në këtë mënyrë, me veprën e tij shkencore në fushë të romanistikës, ballkanistikës dhe gjuhësisë së përgjithshme, Profesor Shefki Sejdiu e ka europeizuar edhe albanologjinë si dije nacionale.

#### Rezyme:

Profesor Shefki Sejdiu është specialist i romanistikës dhe ballkanolog sui generis në studimet gjuhësore shqiptare. Ai është formuar në institucionet më të rëndësishme arsimore (Prishtinë, Shkup, Zagreb, Paris) në fushë të filologjisë në përgjithësi dhe romanistikës në veçanti. Këtë nxënie dhe përvojë bashkëkohore në fushë të gjuhësisë, ai e ka sjellë për pesë dekada me radhë në veprën e tij shkencore, qoftë si metodë: nga strukturalizmi te semiologjia e kognitivistika, qoftë si përmbajtje: nga korpusi i fitonimisë shqipe te struktura e fitonimisë ballkanike e mesdhetare. Në këtë mënyrë, me veprën e tij shkencore në fushë të romanistikës, ballkanistikës dhe gjuhësisë së përgjithshme, Profesor Shefki Sejdiu e ka europeizuar edhe albanologjinë si dije nacionale.

Veprës së tij i paraprinë paradigma, e cila i përcakton ligjësisë e të gjitha temave dhe proceseve të trajtuara, qoftë në kontekstin historik - pra në diakroni, qoftë në kontekst të periudhave të caktuara - pra në sinkroni; për të vazhduar me transpozicionin (*Rreth transpozicionit semantiko-refereencial dhe kategorialo-formativ të strukturave leksikore (leksik, terminologji,*

*nomenklaturë*), pa të cilin nuk ka nuancim të gjuhës. Pra, nëse në rrafshin e parë Profesori ynë shihte procesin si zhvillim të jashtëm, transpozicionin e merr në mënyrë thellësisht logjike me zhvillimin e brendshëm të saj. Në plan të tretë autori ynë trajton ndërrimin dhe zhvillimin kronologjik nga dolikocafalia në mezocefali dhe bracicofali. Edhe këtu nga aspekti metodologjik i qasjes shkencore, funksionon paradigma dhe transponimi mijëvjeçar dhe si rrallë kund tjetër funksionojnë përballë njëra-tjetrës paradigmat dhe transpozicionet përballë njëra-tjetrës, apo paradigmat me transpozicionet dhe anasjelltas. Po kaq me interes është edhe një kërkim mbi *interferimet emërtimtuese helen(ik)o-greke, ilir(ik)o-albane dhe ital(ik)o-romane*, ku identifikon gjerësisht gjurmët, ndikimin, paralelet, strukturat etj, përmes transpozicionit, shenjave, shtresave, referencave etj. Në këtë mënyrë konceptet metodologjike ndaj proceseve historiko-gjuhësore në studimet e Profesor Sejdiut, përveç me paradigmat dhe transpozicionin, plotësohet edhe me interogativët brenda gjuhës. Megjithëse, sikur është shprehur autori, globalizimi sot kërkon qasje interdisiplinare, në këtë studim ai merr në diskutim e vlerësim aspektin leksiko-tekstor, fono-artikullativ dhe sistemo-strukturo-kategorial. Brenda të gjithë parametrave të saj, në këtë trajtesë, nuk mungojnë as shqyrtimet teorike, historiko-gjuhësore dhe analitike, e në mënyrë të veçantë shembujt konkretizues e diskutues.

Fjalët nyje: *Profesor Shefki Sejdiu, linguistika, globalizmi, paradigma, transpozicioni*

### Rezime

Professor Shefki Sejdiu is a specialist in Romanistics and a sui generis Balkanologist in Albanian language studies. He was trained in the most important educational institutions (Pristina, Skopje, Zagreb, Paris) in the field of philology in general and romance in particular. This learning and contemporary experience in the field of linguistics, he has brought for five decades in a row in his scientific work, either as a method: from structuralism to semiology and cognitivism, or as content: from the corpus of Albanian phytonymy to the structure of Balkan phytonymy Mediterranean. In this way, with his scientific work in the field of Romanistics, Balkanistics and general linguistics, Professor Shefki Sejdiu has also Europeanized Albanianology as a national knowledge.

*Prishtinë, më 5 tetor 2023*



**Punim studimor****Ismet OSMANI**

Fakulteti i Filologjisë "Bllazhe Koneski", UKM, Shkup  
Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare  
[ismet.osmani@yahoo.com](mailto:ismet.osmani@yahoo.com)

**PËRKTHIMI SI AKT NDËRKULTUROR**

Преведувањето како интеркултурен акт  
Translation as an intercultural act

Hyrje

Përkthimi si akt komunikimi ndërkulturor krijon lidhje, përkatësisht krijon një hapësirë të përbashkët komunikimi, ndërveprimin dhe shkëmbimin kulturor, letrar e gjuhësor. Akti ndërkulturor i përkthimit mund të shihet edhe në faktin se përkthyesi dhe përkthimet plotësojnë kriteret që i bëjnë autorë të caktuar dhe veprat e tyre të pranueshme në mjedise shumëkulture. Përkthyesi si një ndërmjetësues komunikimi në dukjen vetëdijen e shprehur ndërkulture të autorit, sistemin dialogues midis gjuhëve të ndryshme dhe praninë e marrësit ndërkulturor.

Përkthimi është një proces kompleks i transferimit të përmbajtjes së shprehur nga një kod në një kod tjetër dhe përfshin dimensionin socio-kulturor dhe gjuhësor ku 'gjuha takon gjuhën' ose 'kultura takon kulturën'. Si ndërmjetës i komunikimit ndërkulturor, përkthyesi merr një rol të rëndësishëm në nivelin e komunikimit shoqëror, ekonomik, politik, kulturor, artistik, fetar, shkencor dhe sportiv. Përmes përkthimit, përveç krijimit të një lidhjeje dialogimi, krijojmë një kryqëzim këndvështrimesh, duke respektuar dallimet kulturo-historike, të krijuara nga ndikimi i zhvillimeve të ndryshme socio-historike, traditave të ndryshme kulturore (feja, arti, letërsia etj.), madje edhe përvojat natyrore (klima, peizazhi), ndërgjegjësimi i identitetit të kulturor" (Krushce, 1988: 70-78; Kovač, 2001: 112). Njohja e një kulture, apo bote të huaj bëhet nëpërmjet përkthimit.

Përkthimi si proces i domosdoshëm komunikimi në një shoqëri shumëkulture e shumëgjubnësore ngërthen në vete një sistem simbolesh e shenjash, nëpërmjet të cilave njerëzit, apo popujt e ndryshëm, arrijnë të vënë kontakte duke e kuptuar njëri-tjetrin. Pavarësisht nga rrafshet e

ndryshme semantike gjuhësore, ekzistojnë disa gjëra universale thelbësore që gjenden në të gjitha gjuhët e botës. P.sh., konceptet kozmologjike, ku njerëzit jetojnë në një planet dhe kanë një perceptim të njëjtë për botën e jashtme, konceptet psikologjike, ku dhembja dhe gëzimi njihet nga të gjitha bashkësitë, ku njeriu lind, jeton dhe vdes.

#### Mbi përkthimit si akt ndërkulturor

Përkthimin si domosdoshmëri e kohës së globalizimit krijon lidhje komunikimi ndërkulturor. Përkthimi bëhet midis dy kulturave dhe krijon lidhshmëri komunikimi, dialogu midis këtyre dy kulturave. Përkthyesit, luan rol të rëndësishëm në afrimin dhe miqësimin e kulturave të ndryshme në shoqëri shumëkulturore dhe shumëgjuhësore. Ai duhet të dijë se çfarë të marrë nga letërsia burimore dhe t'i japë letërsisë që duhet përkthyer. Në vetë aktin e përkthimit, përkthyesi udhëton vazhdimisht midis origjinalit dhe përkthimit.

Përkthimi, veçanërisht përkthimi letrar, pavarësisht nëse është përkthim në kuptimin praktik apo teorik, ngre domosdoshmërisht çështjen e interkulturës. Përkthimi bëhet midis dy kulturave dhe përfaqëson komunikimin (ose një përpyetje për të komunikuar), një dialog midis dy kulturave. Nëse një përkthim duhet të jetë i suksesshëm, duhet të mbart elemente të të dyja kulturave, të të dyja letërsive, gjuhëve, pra kulturën, letërsinë, gjuhën e origjinalit dhe të marrësit. Pra, përkthyesi vepron si ndërmjetës ose mediator, që përpiqet të pajtojë dallimet midis dy entiteteve ndonjëherë pothuajse të papajtueshme dhe të zhvillojë komunikimin midis tyre. Shikuar nga ky këndvështrim, roli i përkthimit është shumë i rëndësishëm, ndonëse shpeshherë shikohet me skepticizëm, ose i jepet statusi i një veprimtarie të rendit të dytë, një përpyetje për të kapërcyer hendekun midis dy kulturave të ndryshme, traditave të ndryshme letrare, shprehje gjuhësore shpesh të papërputhshme. Megjithatë, përkthyesi është i vetëdijshëm për pozicionin e tij ndërkulturor si ndaj kulturës marrëse, ashtu edhe ndaj kulturës origjinale. Ai domosdoshmërisht bëhet pjesëtar i letërsisë origjinale dhe asaj marrëse dhe me vetëdije u përket të dyja hapësirave kulturore, në fakt bëhet pjesëtarë i të dyjave. Ai thjesht merr nga njëra, i jep tjetrës dhe në këtë mënyrë që t'i japë përsëri ose t'ia kthejë të parit.

Marrëdhënia midis njerëzve me identitet të ndryshëm nuk përfshin vetëm përkthimin gjuhësor, por edhe atë kulturor. Prandaj, është me rëndësi që autorët e përkthimeve të veprave të ndryshme t'i plotësojnë kriteret ndërkulturore: të vënë në dukjen vetëdijen ndërkulturore të autorit, sistemin gjuhësor dialogues dhe marrësin ndërkulturor (lexuesin, kritikën, botuesit etj.). Koncepti mbi komunikimin ndërkulturor krijon pozicion komunikimi midis dy popujve me gjuhë, kulturë e tradita të ndryshme. Çdo gjuhë e përshkruan botën e saj në mënyrën e vet. “Kultura konsiderohet si koncept themelor në komunikimin ndërkulturor” (Martin, J; Nakayama, 2010 : 48).

Komponenti kulturor paraqet thelbin e procesit të përkthimit dhe e bën përkthimin jo vetëm faktik, por edhe të besueshëm në masën më të madhe të mundshme, sepse përkthimi shpesh nuk mund të jetë absolut besnik në të gjitha parametrat (B. Hlebec, 2009: 90). Në mënyrë që ky komponent të integrohet me sukses në përkthim, përkthyesi duhet të ketë njohuri të thelluara dhe me një përkthim adekuat t'i mundësojë lexuesit të kuptojë më plotësisht tekstin dhe të njohë elementet e kulturave të tjera, si të kaluara ashtu edhe të sotme.

### Gjuha dhe kultura

Gjuha si një mjet i rëndësishëm i komunikimit ndërkulturor dhe kulturor është e lidhur ngushtë me organizimin politik, ekonomik, historik e shoqëror të një shteti. "Kultura e një vendi përbëhet nga njohuritë, besimet, arti, morali, të drejtat, zakonet dhe gjithë sjelljet njerëzore" (Varfi, 1987 : 172). Gjuha dhe kultura janë dy elemente të rëndësishme të njerëzimit që lindën në të njëjtën mënyrë - duke u zhvilluar gradualisht, njëra nga përvojat e përbashkëta jetësore të bashkësisë dhe tjetra nga nevoja për t'i komunikuar këto përvoja me njëri-tjetrin. Kur mësojmë një gjuhë të re, pothuajse gjithmonë mësojmë elemente të kulturës së popullit të cilit i përket ajo gjuhë dhe etimologjia e pothuajse çdo fjale ka një histori në mënyrën e jetesës së bashkësisë dhe origjinës së saj.

Si kategori të përgjithshme, "...kultura dhe gjuha nënkuptohen në mënyrë të ndërsjellë, sepse nuk ka kulturë pa shprehje gjuhësore, as nuk ka gjuhë pa përmbajtje kulturore" (Bugarski, 2005: 16). Një kulturë mund të realizohet në disa gjuhë dhe anasjelltas, një gjuhë mund të jetë bartëse e disa kulturave. Njeriu është një qenie shoqërore dhe ndjen nevojën për të shprehur mendimet, ndjenjat dhe njohuritë e tij. Ai ndjen nevojën për të komunikuar diçka me gojë ose me shkrim, për të marrë mesazhe të caktuara dhe për t'ua dërguar të tjerëve. Çdo komb e zhvilloi gjuhën e vet gjatë historisë dhe në këtë proces evoluimi ajo u bë gjithnjë e më komplekse dhe e pasur.

Kultura është në thelb një sistem për organizimin dhe orientimin e përvojës njerëzore. Kështu, çdo kulturë formon një kornizë specifike brenda së cilës interpretohen shenjat e jashtme të përzgjedhura të realitetit. Mekanizëm bazë për këtë interpretim është gjuha. Nëpërmjet gjuhës, njeriu gjithmonë e ka interpretuar natyrën dhe e ka formësuar kulturën si botën e tij njerëzore, ku ekziston një ndërveprim i vazhdueshëm midis gjuhës dhe kulturës në nivele të ndryshme. E gjithë kultura u krijua falë gjuhës dhe përmes gjuhës, dhe në një masë të madhe në gjuhë; dhe dera e çdo kulture hapet me çelësin e gjuhës së saj. Kjo do të thotë se gjuha nuk është vetëm një kornizë statike referimi e kulturës, një sistem për interpretimin e saj, por edhe parimi i saj konstituiv dinamik. Në këtë mënyrë, përvoja e botës kushtëzohet nga kultura, ndërsa vetë kultura është e profilizuar kryesisht nga gjuha. Nga ana e saj, si parakusht dhe krijues i

kulturës, gjuha formësohet pikërisht sipas nevojave dhe mundësive të saj. Kështu, kultura dhe gjuha në bashkëpunim të vazhdueshëm formojnë dhe ndryshojnë botën në të cilën jetojnë bashkësitë njerëzore, duke ndërtuar veten në këtë proces.

Kur krahasojmë lidhjet midis kulturës dhe gjuhës, është e rëndësishme të bëhet dallimi midis gjuhës dhe kulturës në një kuptim të përgjithshëm apo në një kuptim të veçantë” (Risager, 2006: 3). Gjuha dhe kultura janë dukuri të përgjithshme të njerëzimit dhe e kulturës në përgjithësi. Kuptimi i përgjithshëm nënkupton dy nivele: psikologjikonjohës dhe shoqëror. Nga njëra anë, gjuha dhe kultura mund të shihen si dukuri psikologjiko-kognitive që kanë predispozita të caktuara neuropsikologjike. Ato mund të shihen edhe si dukuri që janë zhvilluar si pjesë e jetës shoqërore të llojit njerëzor. Kultura njerëzore gjithmonë nënkupton gjuhën dhe gjuha nuk mund të kuptohet kurrë pa kulturë. Praktika gjuhësore është gjithmonë e rrënjësuar në këtë apo atë kontekst kulturor.

Në kontekst të komunikimit, gjuha është e lidhur me kulturën në mënyra të ndryshme. Së pari, fjalët që thonë njerëzit u referohen një përvojë të përgjithshme. Ato shprehin fakte, ide ose ngjarje që mund të komunikohen, sepse lidhen me njohuritë e përbashkëta të botës që ndajnë të gjithë njerëzit. Fjalët përcjellin pikëpamjet, besimet dhe opinionet e autorit që dallohen nga të tjerët. Në përgjithësi, gjuha përcjell realitetin kulturor. Megjithatë, pjesëtarët e një bashkësie ose grupi shoqëror nuk e përdorin gjuhën vetëm për të përcjellë një përvojë, por për të krijuar përvojë me të. Ajo merr kuptim përmes mjeteve që pjesëtarët e bashkësisë përdorin për të komunikuar me njëri-tjetrin.

Gjuhëtarja Claire Kramersch, në librin e saj *Language and Culture* (1998), në detaje trajton lidhshmërinë midis gjuhës dhe kulturës dhe vë në dukje tri elemente të rëndësishme: E para, gjuha shpreh realitetin kulturor - njerëzit përdorin gjuhën për të shprehur përvojat e përbashkëta, d.m.th. fakte, ide, ngjarje, si dhe pikëpamjet dhe besimet e tyre, të cilat mund të komunikohen sepse i ndajnë ato me njerëz të tjerë. PE dyta, gjuha mishëron realitetin kulturor - përveç faktit që njerëzit përdorin gjuhën për të shprehur përvojat e tyre, ata i krijojnë ato edhe përmes gjuhës. E treta, gjuha simbolizon realitetin kulturor. Kramersch, gjithashtu vë në dukje se mënyra se si njerëzit përdorin mediumin me të cilin komunikojnë, krijon fjalë që janë të kuptueshme për grupin e njerëzve që i përdorin.

Nga e gjithë kjo rezulton se gjuha dhe kultura janë të lidhura dhe të ndërthurura ngushtë. Vërehet se gjuha është më e përpunuar, më e ndërtuar dhe më e strukturuar nga të gjitha sistemet kulturore. Karakteristikat e saj formale si një strukturë hierarkike e njësive dhe rregullave për kombinimin e tyre në nivele të ndryshme e bënë atë "...mediumin më të përshtatshëm për shumë sisteme të tjera, si dhe kulturën në tërësi" (Bugarski, 2005: 18). Kjo është arsyeja pse gjuha mund të jetë një pjesë integrale, por shumë specifike e kulturës.

## Abstrakt

Përkthimi është një proces që zhvillohet jo vetëm ndërmjet gjuhëve, por edhe ndërmjet kulturave. Përkthimi si një transferim ndërkulturor nxjerr në pah aspekte të rëndësishme të rolit të përkthyesit si pjesë e komunikimit ndërkulturor dhe rëndësinë e përkthimit si veprimtari kulturore. Veprimtaria e përkthimit nuk mund të vëzhgohet vetëm nga këndvështrimi gjuhësor, por edhe nga kontakti ndërkulturor. Nga kjo rezulton se gjuha dhe kultura janë të lidhura ngushtë apo të ndërthurura. Asnjë gjuhë nuk mund të studiohet jashtë kontekstit kulturor, domethënë, çdo tekst i përkthyer kërkon njohjen kulturore pragmatike të kulturës së cilës i përket. Përkthimi si transferim ndërkulturor vë në dukje mënyrën se si autori dhe përkthyesi e perceptojnë kulturën (si një fenomen homogjen ose heterogjen), ku bëhet fjalë për orientimin e lexuesit në dialogun ndërkulturor.

*Fjalët kyçe: përkthim, kulturë, përkthim ndërkulturor, akti i përkthimit, procesi i përkthimit.*

## Abstract

Translation is a process that takes place not only between languages, but also between cultures. Translation as an intercultural transfer highlights important aspects of the translator's role as part of intercultural communication and the importance of translation as a cultural activity. The activity of translation can be observed not only from the linguistic point of view, but also from the intercultural contact. From this it follows that language and culture are closely related or intertwined. No language can be studied outside of its cultural context, that is, every translated text requires the pragmatic cultural knowledge of the culture to which it belongs. Translation as intercultural transfer points out the way the author and the translator perceive culture (as a homogeneous or heterogeneous phenomenon), where it is about the orientation of the reader in the intercultural dialogue.

**Key words:** translation, culture, intercultural translation, translation act, translation process.

Literatura:

- Dominik Joseph R. (2010). *Dinamika e komunikimit masiv*. Tiranë: UET-Press.
- Eko, U. (2006). *Të thuash gati të njëjtën gjë. Përvoja përkthimi*. Tiranë: Dituria.
- Kokona, V. (2003). *Mbi përkthimin me përkthyesin*. Tiranë: Botimet Kokona.
- Kovač, Zvonko. 2001. *Poredbena i/ili interkulturalna povijest književnosti*. Zagreb: Hrvatsko filološko društvo.
- Landers, Clifford E. 2001. *Literary Translation: A Practical Guide*. Clevedon: Multilingual Matters.
- Lucas, S. *Arti i të folurit publik*. Tiranë: UET-Press.
- Munday, Jeremy. 2001. *Introducing Translation Studies: Theories and Applications*. London i New York: Routledge.
- Marashi A. (1996). *Përkthime para gjyqit*. Shkodër: ShB "At Gjegj Fishta".
- Shkurtaç, Gj. (2003). *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*. Tiranë: Kristalina – Kh.
- Tupja, E. 2000. *Këshilla një përkthyesi të ri*. Tiranë: Onufri.
- Venuti, Lawrence. 1995. *The Translator's Invisibility: A History of Translation*, New York i London: Routledge.

ISSN 2671-3004

UDC 82.091  
398.87(=18)(049.3)  
398.87(=163)(049.3)

**Punim studimor**

**Izaim MURTEZANI**  
Instituti i Folklorit Shkup  
izaim\_murtezani@yahoo.com

**LIGJËRIME IMAGOLOGJIKE APO KONSTRUKTI DISKURZIV I TJETRIT  
DHE TJETËRSISË**

**(Sipas disa shembujve të eposit heroik shqiptar dhe të sllavëve të  
jugut)**

**Имаголошки дискурси или дискурсивната конструкција на  
другото и другоста**  
**Imagological discourses or the discursive construction of the other  
and the otherness**

Imagologjia si disiplinë e studimit të Tjetrit dhe Tjetërsisë

Lëvizjet themelore imagologjike evropiane të cilat u angazhuan në drejtim të krijimit të një instrumenti specifik metodologjik, si dhe njëkohësisht edhe formësimit të programeve të qëndrueshme apo stabile univeritare, të cilat mund t'i përcaktojmë edhe si shkolla të mirëfillta studimore, janë kryesisht dy në numër: njëra zhvillohet mes viteve 60 dhe 70 të shekullit XX dhe është e përqëndruar apo e ndërlidhur kryesisht me studiuesin e njohur, Hugo Disernik (një komparativist apo krahasimtar me prejardhje belge i cili ligjëronte shumë vite në Gjermani). Ndryshe njihet edhe si “shkolla e Ahenit” pasi në universitetin e këtij qyteti ligjëronte profesori në fjalë i cili edhe i vendosi dhe i përforcoi bazat apo themelet e kësaj shkolle.

Ndërkaq, shkolla e dytë u paraqit diku kah vitet e 70-ta me nismën e krahasimtarit të njohur francez, Daniel Anri Pazho. Vlen të theksohet e dhëna se për të dyja shkollat në fjalë me rëndësi është fakti se ato u larguan dukshëm nga premiset apo qasjet e imagologjisë pozitiviste tradicionale, proces ky i cili u bë i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm, veçmas pas diskreditimit apo njollosjes së kësaj dege krahasimtare nga ana e Rene

Velekut - teoricien i njohur i letërsisë. Ky i fundit diku kah vitet e 60-ta i drejtoi kritika të ashpra veçanërisht “shkollës franceze” të letërsisë krahasimtare duke theksuar se ajo nuk ishte në rrugën e saj të drejtë sa i përket objektit dhe mënyrës së trajtimit të problemeve letrare.

Në të vërtetë, imagologjia tradicionale bazohej mbi premiset e pozitivizmit apo më konkretisht interpretimit të letërsisë nga ana e Hipolit Tenit, përkatësisht treshit të tij të famshëm se letërsia ishte produkt i racës, mjedisit dhe momentit apo ndryshe produkt i kolektivit, mjedisit dhe kohës. Teni me fjalën *racë* nuk nënkuptonte domethënien e saj në kohën e sotme, por mendonte në karakterin kulturor kolektiv të një bashkësie të caktuar kombëtare. Ai vinte në dukje se letërsia, në masë të madhe, ishte produkt i mjedisit të autorit dhe analiza e këtij mjedisi mund të ndikonte në kuptimin e letërsisë artistike. Në këtë drejtim, Teni ishte pozitivist sociologjik. Sipas një logjike të tillë, çdo popull ka veçoritë e veta, karakterin e vet specifik që në shumicën e rasteve interpretohet si ndikim i klimës, historisë dhe racës. Herderi theksonte se dallimet kulturore venerohen si kategori antropologjike të kulturës së përgjithshme njerëzore. Dallimet kulturore interpretohen si përgjigje të popujve apo kombeve kundruall përvojave kolektive dhe kushteve specifike jetësore që i formësojnë dhe u japin atyre identitetet të veçantë apo specifik. Në këtë kontekst, gjuha konsiderohet si elementi më specifik apo shpirti i një kombi. Ndërkaq, letërsia e shkruar në këtë gjuhë konsiderohet si pasqyrë e shpirtit kolektiv apo karakterit kolektiv, andaj gjuha dhe letërsia edhe sot e kësaj dite karakterizojnë katedrat apo emërtimet e tyre gjithandej nëpër botë.

Pra, kultura është nacionale apo kombëtare apo e ndryshme nga të tjerat, pasi veçohet me unitetin nacional si veçori themelore e një bashkësie të caktuar kombëtare. Si rrjedhojë e gjithë kësaj, në letërsi kërkohej imazhi kolektiv i një bashkësie etnike me tema si francezët në veprën e një autori të caktuar apo gjermanët në veprën e një autori tjetër e kështu me radhë. Në studimet e kësaj natyre pretendohet apo kërkohej që vepra letrare ta pasqyronte realisht një gjë të tillë, përkatësisht shpirtin e një kombi apo race të caktuar. Kjo mënyrë e interpretimit të letërsisë e kishte nxitur teoricienin letrar Rene Velek që ta kundërshtonte në mënyrë kategorike një gjë të tillë duke theksuar se qasja e jashtme kundruall veprave letrare e shndërronte letërsinë në etnopsikologji, sociologji, etj. Në të vërtetë, në veprën me titull *Teoria e letërsisë* e përkthyer edhe në gjuhën shqipe, Rene Veleku me bashkautorin tjetër të saj O. Voren në qasjen e jashtme të letërsisë ka përfshirë temat si vijon: letërsia dhe biografia, letërsia dhe psikologjia, letërsia dhe shoqëria, letërsia dhe idetë, letërsia dhe artet tjera e kështu me radhë.

Megjithatë, dy autorët në fjalë preferojnë qasjen e brendshme të letërsisë duke theksuar si vijon: “Pikënisje e natyrshme dhe e arsyeshme për punë në fushën e shkencës mbi letërsinë është interpretimi dhe analiza e vetë veprave letrare. Më në fund, i gjithë interesimi ynë për jetën e shkrimtarit, për rrethin e tij shoqëror dhe gjithë procesin letrar, arsyetohet

vetëm nga veprat. Mirëpo, për çudi, historia e letërsisë është marrë kaq shumë me kuadrin e veprës letrare sa që përpjekjet për shqyrtimin e vetë veprës, në krahasim me përpjekjet e studimit të rrethit, kanë qenë fare të parëndësishme dhe të pakta” (Velek - Voren, 1082: 205). Pra, duke parapëlqyer apo preferuar qasjen e brendshme të letërsisë e jo qasjen e jashtme të saj, autorët në fjalë kishin vënë në shënjestër edhe imagologjinë tradicionale duke theksuar se ajo e kishte huqur objektin e saj të mirëfilltë, përkatësisht qasjen e brendshme apo atë gjuhësore, fenomenologjike, estetike, etj. Në të vërtetë, sipas tyre, vepra artistike duhet shqyrtuar si një sistem shenjash ose si strukturë shenjash që i shërben qëllimit të jashtëzakonshëm estetik.

Një kritikë e tillë kundruall imagologjisë tradicionale kishte ndikuar pozitivisht, pasi më vonë ishin kërkuar rrugë dhe metoda tjera alternative të cilat do ta përcaktonin objektin e saj në mënyrë më precize dhe më të profilizuar. Si rrjedhojë, paraqitja e imagologjisë bashkëkohore ishte e mundshme vetëm atëherë kur u tejkalua koncepti i “realitetit” të karakterit nacional si model ilustrativ, kurse kjo është arritur pas Luftës së Dytë Botërore. Përvoja nacionaliste dhe raciste gjermane, nxiti qasjen antiesencialiste, konstruktiviste të imazhit të të huajit. Identiteti nacional tani studiohet si “autoimazh i brendshëm kolektiv”. Nuk ka karakter nacional, por vetëm karakter diskurziv. Karakteret nacionale krijohen nëpërmjet ligjërimit apo diskursit, andaj ky diskurs është i rrejtshëm dhe përplot elemente me natyrë të stereotipeve, miteve, paragjykimeve etj.

Një e arritur imagologjike paraqet padyshim dikotomia mes *imazhit* dhe *mirazhit* - koncept ky i Disernikut nga shkolla e Ahenit (Gjermani). Imazhi sipas imagologjisë paraqet një realitet diskurziv e jo ontologjik. Në këtë kontekst, meqenëse imazhet janë të ngarkuara me klishe, paragjykime dhe stereotipe, imagologu i mirënjohur francez, Zh. M. Kare (Carré), ia atribuon “konceptit *imazh* edhe një koncept tjetër, përkatësisht konceptin *mirazh* me kuptimin *mashttrim, fatomorganë* ose *imazh i rrejshëm*. Kjo do të thotë se nuk ka paragjykime për të njëjtin apo për vetveten, por vetëm për Tjetrin, apo për të huajin i cili varësisht nga situatat e jashtëzakonshme historike, si luftërat, migracionet, robëria, mund të përjetohet ose si superior ose si inferior” (Њиши, 2006: 227).

Pra, imazhi letrar të cilin e veneron imagologjia është i rrejshëm dhe ai, thotë imagologu i njohur Mura, është prodhim apo reflektim i *imaginariumit shoqëror* që mbretëron në një kohë të caktuar. Pothuajse të gjithë imagologët e ndajnë mendimin se të gjitha imazhet dedikuar popullit të vet ose popujve tjerë nuk konsiderohen si kategori esenciale, por kryesisht si kategori apo konstruktive diskurzive. Pa marr parasysh se për çfarë shkolle bëhet fjalë, qoftë frënge ose gjermane, emërues i tyre i përbashkët është se imazhet letrare janë kontruktive të llojit të vet. Në të vërtetë, imazhet letrare, qofshin për veten ose të tjerët venerohen si diçka që nuk prodhohen domosdoshmërisht nga përvoja kolektive ose individuale, por nga diçka që ndërlihet apo është rezultat i intertekstualitetit. Këto imazhe trajtohen si

huazime nga tekste paraprake, fragmente nga ajo që kemi lexuar, nga ajo që kemi dëgjuar e stërdëgjuar gjatë jetës. Supozohet se këto konstrukte letrare mund të jenë shumë më larg apo më afër realiteteve që synojnë t'i prezentojnë apo t'i paraqesin. Vallë konsiderohet një ngjarje e caktuar si kategori relevante në hulumtimet imagologjike? Gjithsesi se jo, pasi ajo deformohet dhe konstruktohet sipas skemave të imagjinatës shoqërore, e kjo vlen gjithsesi edhe për ligjërimet folklorike të cilat u nënshtrohen shijeve kolektive të cilat funksionojnë në bazë të klisheve, skemave dhe trajtave apo modeleve e kodeve të qëndrueshme dhe të pandryshueshme që barten prej një gjenerate në një gjeneratë tjetër.

Meqenëse ne vazhdim do të bëjmë fjalë për përmbajtje të caktuara të eposit heroik, atëherë dihet e dhëna se se ai është prodhim i kohës paramoderne, d.m.th., i kohës kur realiteti është konceptuar në përgjithësi sipas parametrave mitikë. Në këtë drejtim, historiani i njohur botëror, Antoni Smith duke iu referuar kujtesës apo memorjes kolektive, thekson me të drejtë, se ajo, veçmas te popujt paramodernë, sillet diku në kufirin midis mitit në njërën anë dhe historisë në anën tjetër (Smith, 1991: 89). Në të vërtetë, kufiri i tillë është i megjulluar apo ndonjëherë është tejet vështirë të tërhiqet në trajtë të prerë. Pra, folklori apo më konkretisht, eposi heroik është reflektim i *imaginariumit* mitik, andaj edhe Tjetri, apo Tjetërsia projektohet nga dioptria kryesisht e përmasave mitike.

Nga ana tjetër, një ndër imagologët më të njohur në botë, Pazho duke kërkuar qasje më precize të metodologjisë së hulumtimit të një imazhi letrar, kërkon apo pretendon që një tekst i kësaj natyre të interpretohet si një proces semiotik - struktural (mund të thuhet edhe analitiko-didaktik) i cili duhet të ndahet në disa faza të caktuara nëpërmjet të cilave do të mund të sqarohen materialet apo mënyrat, si dhe format e krijimit të një imazhi letrar. Faza e parë përbëhet nga analiza semiotike e tekstit: bëhet fjalë për identifikimin e disa fjalëve dhe shprehjeve kyçe që e përmbajnë materialin leksikor të *imazhit* (për imazhin e gjermanëve mund të veçohen termet si “precizitet”, “efikasitet”, “gjakfohtësi”, “të vendosur”, etj.). *Imazhi* që nxirret dhe krijohet në këtë mënyrë do të përkonte kryesisht me stereotipin. Me fazën e dytë kalohet në analizën semantike-strukturale, e cila duhet t'i vë në dukje mekanizmat nëpërmjet të cilave një autor bën përzgjedhjen gjuhësore. Materiali leksikor që shfrytëzohet me këtë rast do t'u përgjigjej dy parimeve: atij të “dallimit” nga “tjetri” dhe atij të “shkrirjes”, të cilat i përgjigjen në mënyrë adekuate procesit të “margjinalizimit” dhe “integritimit kulturor”. Gjithsesi se kjo fazë nuk mund të mbetet peng vetëm i analizës së tekstit letrar, por kompenzohet edhe me analizën historike, e dobishme për të realizuar lidhjen mes imazhit letrar dhe kontekstit kulturor. Sa i përket fazës së tretë, Pazho është i inspiruar nga metodat e antropologjisë kulturore, më saktësisht nga versioni struktural i Klod Levi - Strosit. Kjo qasje do të nënkuptonte analizën e “kundërvënieve të mëdha” që e përbëjnë tekstin dhe tërësitë themelore tematike; analizën e “kornizës kohore - hapësinore”, “riorganizimin” e hapësirës, “mitizimin” e kohës, prezentimin e protago-

nistëve letrarë dhe organizimin e marrëdhënieve të tyre sipas kategorive të caktuara, etj (sipas Њиши, 2006: 234-235). Gjithsesi se me një ecuri të tillë të këtij procesi metodologjik të hulumtimit të një imazhi letrar korrespondon padyshim edhe teksti folklorik. Andaj, në vazhdim do t'i mund t'i hetojmë vetëm disa elemente të këtyre fazave, por jo të elaboruara në mënyrë të detajuar pasi kjo do të dilte nga kornizat e synimit të kësaj trajtесе shkencore e cila pretendon t'i prezentoj disa vargje të këngëve epike ku mund të vërehet imazhi folklorik që ndërtohet mbi Tjetrin, nënkuptohet në bazë të një strukture semiotike që buron kryesisht nga logjika kuptimësore e mitit apo kozmogonisë si trajtë themelore e shpërfaqjes së tij.

## 2. Tjetri apo Tjetërsia nëpërmjet identifikimit me imazhin e Botës së Përtejme apo Botës së Poshtme

Struktura përmbajtësore e eposit heroik duke qenë produkt i mitit dhe historisë, si zakonisht është e tejmbushur me paragjykime, stereotipe, klishe të ndryshme që huazohen nga ligjërimi mitik, fetar, etj. Si rrjedhojë e një logjike të tillë, figura e Tjetrit apo Tjetërsisë, nënkuptohet në cilësinë e antagonistit është e ngarkuar me attribute negative të përmasave paragjykuese, denigruese, stigmatizuese, etj. Në një këngë të kësaj natyre, kryeprogonisti Muji i drejtohet Halilit si vijon: *At shkja jashta, i thot', m'e qitë, / se n'oborr vet' kur kam hy, / era shkja, Halil, m'ka ardhë* (EL, II, 1983: 26). Ndërkaq, eposi heroik sllav, në bazë të shembullit vijues, është edhe më i drejtpërdrejtë, pasi Tjetrin, përkatësisht *arbanasit* apo shqiptarët i projekton në këtë mënyrë: *Јанкул никој не пошчука / си вјавна својта коња, / си ја вјавна и отиде, / Арбанафска пушта земја; / и му рече: - Бог помагал, / долноземци, Арбенафци! / - Добро дојде, доб'р јунак, / доб'р јунак горноземец*<sup>25</sup> (Шап., 2, 1976: 206-207).

Pra, kemi dy stereotipe apo klishe të ndryshme, njëri e identifikon *shkaun*, pra Tjetrin si të papastër, pasi ai kundërmon nga larg, që ndërlihet me besimin tradicional dedikuar qenieve ktonike apo demoniake të botës së poshtme. Sipas këtij besimi popullor, këto qenie demoniake duke jetuar në botën nëntokësore kundërmojnë erën e dheut, andaj edhe konsiderohen si të papastra. Sipas besimit popullor që më vonë bartet edhe në fenë monoteiste krishtere, klerarkia e botës është e kategorizuar në tri pjesë: pjesa e poshtme e tokës është e papastër dhe e rezervuar për qeniet demoniake, pjesa e sipërme e saj është e rezervuar për njeriun, kurse pjesa qiellore e botës është e rezervuar për qeniet mbinatyrore. Qielli përbëhet kinse nga një substancë tejet e veçantë, andaj konsiderohet si tejet i pastër dhe specifik dhe si i tillë shërben si strehimore e qenieve hyjnore. Njeriu jeton mes dy botëve, asaj ktonike (e papastër) dhe asaj qiellore (e pastër).

<sup>25</sup> *Jankuli nuk e dëgjo askënd / kalëroi kalin e tij, / kalëroi kalin dhe shkoi, / në tokën e shkretët arbanase; / dhe u tha: - Zoti u ndihmoftë, / Arbanas të Botës së Poshtme! / - Mirë se erdhe, hero i mirë, / hero i mirë i Botës së Sipërme.*

Pra, edhe stereotipi apo sintagma *era shkja* në këngën shqiptare, por edhe stereotipi tjetër në këngën sllavojugore *arbanasët e botës së poshtme* janë disi të ngjashëm dhe operojnë me një logjikë kryesisht mitike dhe përbashkohen apo unifikohen në kuptimësinë e stigmatizimit të tjetrit duke e ndërlidhur atë me qenie demoniake apo qenie shkatërrimtare që pretenojnë ta çenojnë qetësinë, rendin dhe sigurinë e bashkësisë njerëzore që identifikohet me heroin apo mbrojtësin e saj. Në këngën e fundit, distinkcioni është shumë i qartë, përkatësisht kemi të bëjmë me heroin apo kryepersonazhin që identifikohet me botën njerëzore kundrejt të tjerëve që identifikohen me banorët e botës së poshtme apo të përtejme.

Në mitologjinë greke, bota e poshtme identifikohet me Hadin, ferrin, skëterrën, mbretërinë e të vdekurve. “Sipas përfytyrimeve të të vjetërve, Hadi ndodhej në nëntokë, ose në një ishull matanë Oqeanit, në perëndim, në një rajon që nuk ndriçohej nga rrezet e diellit. Ky ishte vendi ku shkonin dhe qëndronin shpirtrat pas vdekjes (FM, 1988: 102). Hyrjen për në mbretërinë e të vdekurve e ruante qeni me tri kokë Cerberi, i cili nuk lejonte që të gjallët të futeshin brenda dhe të vdekurit të dilnin që aty. Shpirtrat e të vdekurve i sillte në ferrin Hermes, përcjellësi i shpirtrave. Shpirtrat e të vdekurve vinin në Had që të vuanin për krimet që kishin bërë në tokë. Midis atyre që torturoheshin ishin Tantali, Sizifi, Danaidat dhe të gjithë armiqtë e perëndive. Mbretëria e nëntokës qeverisej nga vëllai i Zeusit, Hadi. Ai rrinte në një fron të artë me gruan e tij Persefonin. Këta dy hyjni ishin të rrethuar me një numër shërbyesish, midis të cilëve duhet të përmendim, Erinitë, Gorgonat, Harpitë, Tanatosin (vdekja), etj. Grekët e Vjetër e përfytyronin mbretërinë e Hadit, mbretërinë e shpirtrave të të vdekurve, të errët dhe të tmerrshme, kurse “jetën e përtej varrit” një fatkeqësi. Jo më kot, hija e Akilit, të cilën e thirri Odiseu nga mbretëria e nëntokës, thotë se më mirë të jesh argati i fundit në tokë, sesa mbret në mbretërinë e Hadit” (FM, 1988: 103). Përfytyrimet e tilla më vonë pjesërisht u bartën edhe në fetë monoteiste. Pra, siç mund të vërehet, bota e poshtme, ishte e dedikuar për qenie të tmerrshme, por edhe të neveritshme që sipas botëkuptimit mitik, u atribuoheshin të tjerëve, përkatësisht grupeve të tjera shoqërore.

Figurave antipode apo kundërshtarë, gjithmonë sipas diskursit mitik që kryesisht ndërlidhen me botën tjetër, u atribuohen edhe veçori zoomorfe, përkatësisht ato posedojnë tri koka, madje shkohet edhe më larg, saqë atyre u atribuohet edhe nxjerrja e zjarrit nga goja duke i atakuar në këtë mënyrë edhe kundërshtarët e tyre. P. sh.: *flak' e shkni për dham' ki' pa' lshue* (EL, II, 1983: 56). Në të vërtetë, të gjitha këto veçori i posedon qenia mitike e kuçedrës e cila është e pranishme, veçmas në përrallat e llojit fantastik. Meqenëse eposi heroik apo këngët epike paraqesin zhanër të veçantë që gravitojnë kah paraqitja kinse më objektive të ndodhive të tyre, atëherë mund të themi se figurat antipode edhe pse janë të karakterit antropomorf, megjithatë posedojnë edhe cilësi zoomorfe, kryesisht të kuçedrës. P. sh.: *Eje, Zoti e vraft, ej, Harap Zullumçarin! / E, po, m'i ka, he, tri*

*krena n'mi krye* (ELR, V, 1997: 110), apo: *Çka kish ba Aga Hasan Agë? / A sa vrap gjogin si po e nget, / të tan' shkieve para si u ka dalë, / para e kish ni shka me dy krejna*, (EL, II, 1983: 108). E njëjta gjendje paraqitet edhe në këngët epike të sllavëve të jugut. Në këtë kontekst vlen të përmendet kënga që përshkruan duelin midis Musa Kesexhisë dhe Krali Markos. Ky i fundit kur e mposht Musa Kesexhinë, çohet në këmbë, merr shpatën dhe ia çan gjoksin antagonistit, por mbetet i shtangur në vend, pasi Musa Arbanasi kishte pasur tri palë brinjë, nën të cilët flinin tri zemra burrërore, apo: *А кад стаде Марко преметати, / ал' у Муси три срца јуначка, / троја ребра једна по другијем; / једно му се срцо уморило, / а друго се јако разиграло, / на трећему љута гуја спава; / када се је гуја пробудила, / мртав Муса по ледини скаче*<sup>26</sup> (СНП, II, 1953: 397). Vargjet e këngës në fjalë hasen edhe në një këngë të kësaj natyre në gjuhën shqipe. Bëhet fjalë për vargje që i referohen duelit fizik në fjalë. Struktura dhe kuptimësia e vargjeve të mëposhtme në gjuhën shqipe është e ngjashme me vargjet e mësipërme që flet për një mendësi të ngjashme në krijimin dhe organizimin e vargjeve, nënkuptohet sipas parametrave mitikë. P. sh.: *Kqyr, shka bani Kraleviqe Marku: / N'bark pe e çil at Musen Qesexhi, / se çfar' forcet Musa si ka pasë, / kqyr, kur n'bark Musen e ka kqyrë, / tre gjarpinj n'bark Muses ia ka gjetë, / një e gjet çuet e dy i gjet fjetë* (EL, 2, 1983: 279). Edhe vargjet në vazhdim janë po në këtë frymë. P. sh.: *Kur e çeli at Gjurin, po, n'llubinë, / tre gjarpij, po, medet, ja ki gjetë - / nja ish çua e dy ishin tuj fjetë* (AKKSH, 2008: 115). Pra, gjithsesi se janë të qarta aludimet mitike me këtë rast, por që marrin edhe konotacione të etnizimit të figurës së Tjetrit.

Nga shembujt e mësipërm vërehet tendenca e zoomorfizimit mitik të figurës së Tjetrit, pasi kundërshtarët e heronjve janë të dyzuar apo posedojnë elemente kryesisht antropomorfe, por njëkohësisht edhe elemente të botës zoomorfe. Sipas logjikës mitike, hapësira e botës, sipas parametrave të përgjithshëm semantiko – leksikorë, është e ndarë në *të huajën* dhe *tonën*. Hapësira që është e banuar me njerëz identifikohet si *e jona* dhe është e ndarë nga *e huaja*, përkatësisht hapësira e të tjerëve në të cilën ka vend vetëm për qenie të natyrës demoniake. Duke u fokusuar në problematikën në fjalë, autori Meletinski me të drejtë konstaton se “tullat e para” të klasifikimeve simbolike mitologjike nuk janë motivet, por marrëdhëniet në trajtë të kundërvënieve themelore kuptimësore të cilat para së gjithash përkrijnë me orientimin më të zakonshëm hapësinor dhe shqisor të njeriut (*poshtë / lartë, majtas / djathtas, afër / larg, brenda / jashtë, i madh / i vogël, i thatë / i lagësht, i qetë / i zhurmshëm, dritë / errësirë, i zi / i bardhë* etj), kurse më vonë “objektivizohen” dhe plotësohen me marrëdhënie më të zakonshme të ndërsjella në vazhdimësinë kozmike

<sup>26</sup> *Dhe kur filloi Markoja t'ia kontrolloj trupin, / ia pa Musës tri zemra guximtare, / tri brinjë njëri pas tjetrit; / njëra zemër i ishte lodhur, / kurse tjetra fuqishëm ishte zgjuar, / në të tretën flente nëpërka; / kur u zgjua nëpërka, / i vdekur Musa kërcente nëpër djerrinë*

hapësinoro – kohore (*qiell / tokë, tokë / botë nëntokësore, tokë / det, veri / jug, përëndim / lindje, natë / ditë, verë / dimër, hënë / diell*), pastaj në baza shoqërore (*im / huaj, femërore / mashkullore, më të rinj / më të moshuar, më të ulët / më të lartë*), ose në kufirin e *sociumit* dhe *kozmosit*, në *natyrë* dhe në *kulturë* (*ujë / zjarr, zjarri diellor, zjarri i vatrës, e pazier / e zier, shtëpi / pyll, vendbanim / shkretëtirë* etj), si dhe në kundërvëniet apo antonimet rrënjësore si: *jetë / vdekje, fat / fatkeqësi* dhe të ngjashme, si dhe në kundërvënien kryesore mitologjike *sakrale / profane* (Мелетински, 2002: 280). Në kontekst të kësaj që u theksua më sipër, autori Lotman operon me njësi kuptimësore, të cilësuara si semiosfera. Ai thekson si vijon: “semiosferën, përkatësisht hapësirën e semiosferës e përcaktojmë me kategoritë: “e jona”, “imja”, “kulturore”, “e sigurtë”, “harmonikisht e organizuar”, etj. Kësaj i kundërvihet “hapësira e atyre”, “e huaja”, “armiçësorja”, “e rrezikshmja”, “kaotikja”, etj (Lotman, 2004: 141). Ndërkaq, studiuesi Cvetan Todorov i vendos këto marrëdhënie në një rrafsh tjetër apo në rrafshin kundërvënës midis superioritetit dhe inferioritetit, përkatësisht në fushën e disa kategorive tjera, siç janë: estetika, intelekti dhe etika: Ai vë në dukje si vijon: “në planin e cilësive fizike, vlerësimi në shumicën e rasteve përfiton trajtën e gjykimit estetik: raca ime është e bukur, të tjerët janë më pak të bukur ose më shumë të neveritshëm. Në planin shpirtëror bëhet vlerësimi sa në cilësitë intelektuale (njërët janë budallenj, kurse të tjerët të mençur) po aq edhe në cilësitë morale (njërët fisnikë apo bujarë, kurse të tjerët – të egër apo kafshë)” (Todorov, 1994: 102). Pra, siç mund të vërehet nga të gjitha këto marrëdhënie apo kundërvënie binare apo dyshe, njëri pol është i çmuar apo i privilegjuar, kurse poli tjetër i degraduar dhe i nënçmuar apo anasjelltas. Nëse figurën folklorike të antagonistit e vendosim në kontekst të këtyre marrëdhënieve të cekura më sipër atëherë me siguri se ai do ta gjejë vendin e duhur pothuajse në të gjitha këto kundërvënie dyshe, nënkuptohet gjithsesi në polin negativ apo në atë të degraduar. Në të vërtetë, sendërtimi letrar i figurës së antagonistit ka për bazë një logjikë mitike e cila operon me kundërvënie apo çifte semiotike që afirmojnë njërin pol, në rastin konkret - kryeprotagonistin dhe që degradojnë polin tjetër, përkatësisht antagonistin.

### 3. Tjetri apo Tjetërsia nëpërmjet identifikimit me imazhin e ngjyrës së zezë

Përmbajtja e eposit heroik shqiptar, por edhe e sllavëve të jugut, posedon shembuj të shumtë në të cilët figura e Tjetrit karakterizohet me ngjyrë të zezë. Ndoshta këngët më tipike të kësaj natyre janë ato që ndërliken me figurën antagoniste të Arapit të Zi apo Bajlozit të Zi. Një figurë e tillë rezulton të jetë edhe tejet tipike, veçmas në kulturën e popujve të Ballkanit. Tanimë është i njohur fakti se një veçori e eposit heroik popullor është shumështresia e tij. Në të vërtetë, eposi heroik apo çdo vepër tjetër e karakterit letrar, siç thotë teoricieni i nohur, Zherar Zhenet (1997), paraqet një palimpsest të llojit të vet. Me siguri se shembujt e

mëposhtëm paraqesin një mbishtresim të mëvonshëm që i referohen një nënshtresimi edhe të mëhershëm i cili figurën e Tjetrit e projekton kryesisht mbi baza mitike, por të natyrës racore. Figurat e tilla të cilat e identifikojnë Tjetrin me atë të Bajlozit të Zi apo Arapit të Zi, apo variacione tjera të ngjashme me to, paraqesin variante partikulare, por njëherit edhe arketipe universale që janë shtresuar jo vetëm në eposin heroik, por edhe në sfera tjera të veprimtarisë artistike.

Nënkuptohet se kjo figurë ndërtohet mbi bazë të elementeve mitike që u është atribuar qenieve demoniake. P. sh. *Eje, Zoti e vraft, ej, Harap Zullumçarin!* / *E, po, m'i ka, he, tri krena n'mi krye* (ELR, V, 1997: 110). Kjo figurë antipode e heroit të këngës popullore, posedon gjithsesi edhe përmasa kolosale të natyrës fizike. Në të vërtetë, në çastin kur Gjergj Elez Alija e mposht atë fizikisht vëren përmasat e tij fizike si vijon: *ani-o, rrxua, bre, o Gjergji qaty po ma ka, / ani-o, ja ka pre qata krye të zi; / ani-o, hukubet, more, zoti ja k'i falë, / ani-o, tri pllamë buzën trashë ma ki' pasë, / ani, shum', bre, vesh-t-e t'mdhej m'i ki' pasë, / ani, sa tre vet-e me ta, he, me mlu!* (KK, II, 1991: 187). Në eposin heroik, kjo qenie demoniake me ngjyrë të zezë vjen apo e ka zanafillën nga deti që në rastin konkret nuk i referohet konceptit gjeografik, por atij mitik. P. sh. *O, lum e lum, o zot, i lumi zot!* / *E koka kanë ky bajlozi i zi, / e kalon, more, krejt Detin e Zi, / o, qi po del, po, n'hudut t'Jutbinës* (KK, II 1991: 3). Edhe në këngët epike sllave, ai posedon përmasa fizike të një figure vigane, nënkuptohet me përmasa të një qenieje demoniake. P. sh.: *Глава му е петнаесет ока, / Горна рилка до чело му била, / Долна рилка, богме, до појаса*<sup>27</sup>. Po ashtu në këngët e njëjta epike, Arapi i Zi ndërlihet me detin apo më konkretisht, kryeprotagonisti epik i drejtohet me vargjet si vijon: *добро утро, наши господине, / господине, Арап од преку – море!*<sup>28</sup> (МКЛС, 1983: 446). Pra, atributi i tij, përkatësisht ngjyra e zezë që i jepet detit përmban funksionin konotativ, gjithsesi i ngarkuar me ligjërimin mitik, pasi shënon arealin, apo botën ktonike nga e cila paraqitet antagonistin po ashtu me ngjyrë të zezë. Uji, madje edhe i detit, në shumë mitologji paraqitet në cilësinë e shenjuesit të kaosit. Në mitologjinë sumero-semitase, në fillim të krijimit të botës, ekzistonte Apsoti, përkatësisht ujërat primordialë me Tijamatin në cilësinë e ujit dhe kaosit (Kuper, 1986: 187).

Ngjyra e zezë paraqet simbol të errësirës primordiale dhe shënon zbrazëtirën, përkatësisht të ligën, errësisën e vdekjes, mallëngjimin, degjenerimin, brengën, degradimin, privimin e kështu me radhë. Me këto stereotipe mitike me të cilat karakterizohet ngjyra në fjalë, në shumicën e rasteve, janë karakterizuar edhe bashkësitë etnike që janë bartëse të kësaj ngjyre. Kështu antisemitizmi ndoshta nuk ka burim tjetër, përveç armiqtësisë së natyrshme kundrejt llojeve etnike me ngjyrë të zezë.

<sup>27</sup> *Kryet e kishte pesëmbëdhjetë okëshe, / Buza e sipërme deri në ballë i arrinte, / Buza e poshtme medet deri në bel.*

<sup>28</sup> *mirëmëngjes, zotëriu ynë, / zotëri Arap nga përtej-det!*

Studiuesi Fenichel thotë: “Zezakët në Amerikë, në botën e fikSIONIT, përfitojnë gjithashtu funksionin e popullit agresiv, ashtu siç edhe romët kanë qenë të stigmatizuar padrejtësisht për të gjitha llojet e krimeve”. Me konstatimet e tilla ndërlihet edhe doktrina dhe veprimet e Hitlerit i cili duke u nisur nga urrejtja dhe përbuzja e tij, kishte persekutuar hebrenjtë dhe popujt me ngjyrë të zezë (sipas Durand, 1981: 82). Pra, figura e armikut e mishëruar në figurën e Bajlozit të Zi dhe Arapit të Zi ndërlihet me të gjitha cilësimet e mësipërme apo me *botën tjetër, papastërtinë, vdekjen, rrezikun, të ligën etj.* Figura e Arapit të Zi paraqet një simbiozë të realitetit mitik dhe atij historik, por gjithsesi edhe të realitetit të projektuar nga ana e rapsodit popullor.

Ligjërimi apo diskursi folklorik edhe më tej ndjek logjikën e formësimit mitik. Këto qenie antropomorfe me prapavijë demoniake, sipas përmbajtjes së eposit heroik, ndërmarrin veprime vetëm gjatë natës, pasi ato këtë periudhë kohore e konsiderojnë të volitshme, përkatësisht si kohë pasive kur bota njerëzore ndodhet si zakonisht në gjumë. Pra, kemi një kundërvënie semiotike midis ditës gjatë së cilës qeniet njerëzore janë aktive, kurse qeniet demoniake - pasive dhe anasjelltas. Ja një shembull i kësaj natyre. *Kur ka ken' Muji e Halili, / Në bjeshk' trimat kan dalë, / Tri net n'bjeshk' trimat kin ndejë, / Ça kish ba krajli i Selnisë? / Për mesnat' n'Jutbin' ka ra,* (EL, II, 1983: 18), apo: *Njiket natë ka zgjedhun Paji i Harambashit / Bjeshkve Mujin kund me e ndeshë, / N'mejdan t'natës kryet me ia pre* (AKKSH, 2008: 100). Kundërshtari i Mujit, Bani i Zatforit shkon pas mesnate: *Masajnena m'ish kan' çue n'kamë, / i hip vraçit rrugën e ka marrë / e n'tre t'natës n'Jutbin' ka ra, / E n'der' t'Mujit vojte ç'i po ka, / rrin mas dere, shkon tu nigjue,* (EL, II, 1983: 53). Pra, antagonistët në mesnatë, apo pas saj kur kryeheronjtë ndodhen në gjumë të thellë duan t'u shkaktojnë dëm atyre. Dihet se në besimin popullor, mesnata apo koha pas saj konsiderohet si interval i rrezikshëm pasi kemi lëvizje të frekuentuar të qenieve demoniake, andaj ka qenë e ndaluar lëvizja e njerëzve me arsyetimin se mund të pësojnë nga qeniet në fjalë.

Ngjyrës së zezë me të cilën karakterizohen këto figura - antiheronj, i kundërvihet si zakonisht ngjyra e bardhë që mishërohet me figurën e heroit. Kjo ngjyrë personifikon *këtë botë, pastërtinë, jetën, të mirën etj.* Ajo “paraqet të përkryerën transcendentë, të zakonshmen, dritën, diellin, ajrin, dliresinë, të shenjtën, autoritetin shpirtëror e kështu me radhë. E bardha është e ndërlihur si me jetën, po ashtu edhe me dashurinë, por njëkohësisht edhe me vdekjen dhe varrimin. Gjatë kurorëzimit të çifteve bashkëshortore, ajo simbolizon vdekjen e jetës së vjetër dhe lindjen e jetës së re, kurse në vdekje paraqet lindje të re në jetën e pëртеjvarrit (sipas Kuper, 1986: 16).

Si rrjedhojë, heronjtë apo kryeheronjtë e eposit heroik posedojnë ngjyrë të bardhë, madje edhe kuajt i kanë të bardhë. P. sh.: *Edhe gjoku i Lule Frangut është i bardhë: Un e kam njat gjogun e bardhë, / kurrkund shoqin, Ago, nuk ja dij, / as ne turk, bre trima, as në kaurr, / veç n'e pastë aj Gjeto*

*Basho Muji*, (AKKSH, 2008: 195). Edhe në një shembull tjetër, kali i kryeprogonistit të eposit tonë heroik, Mujit, është me ngjyrë të bardhë. Ja si përshkruhet një duel i tij me antagonistin: *E ki' adet gjithë Muji i parë me ikë. / E përmas mërkovin Gjura ja ka çitë. / Ku m'e xanë, po, at gjokun e bardhë! - / Shkojke gjoku si t'ish pllum i bardhë, / larg prej veti mërkovin n'ledinë p'e dan* (AKKSH, 2008: 112). Madje, Muji edhe mëzin e ka me ngjyrë të bardhë. P. sh.: *Muji 'i anderr e ki andrrue: / Andërr paka hargelen tuj pjellë, / Ki' ba mazin bardh si bora / Hyllin n'ball Zoti i ki' falë*, (AKKSH, 2008: 79). Si zakonisht, kali i antagonistit është me ngjyrë të zezë. P. sh.: *Heret çohej Gjure Harambashi, / (i) ki ra dallkë bjeshkën me çetë m'e msy. / Bajke gati at mërkovin të zi / edhe veshej për luftë e për mejdan;* (AKKSH, 2008: 109).

Po ashtu në logjikën e një fryme të tillë, edhe protagonistet e seksit femëror të eposit heroik kanë ngjyrën e bardhë, madje kjo theksohet në mënyrë të veçantë me qëllim që të krijojë një antipod me figurën e Tjetrit që kërkon t'i degradoj e përdhunoj ato. Në të vërtetë, në këngët heroike të sllavëve të jugut, figura antagoniste, përkatësisht Arapi i Zi kërkon të flejë me vajza të reja, kurse i kishte ardhur radha të flejë edhe me të motrën e heroit të sëmurë, Bolen Doççinit që i përgjigjet Gjergj Elez Alisë në folkorin shqiptar. Një motër e tillë njihet si Bela Angelina (Angjellina e bardhë). Vihet në dukje se Angjellina kur përkthehet në gjuhën shqipe rezulton të jetë *Engjullëshë*. Pra, siç mund të vërehet bie në sy kontrasti mes ngjyrës së bardhë dhe të zezë. Jo vetëm kjo, por tani antagonisti identifikohet me djallin, kurse protagonistja e seksit femëror identifikohet me engjullin. Kemi të bëjmë me qenie dhe karakterizime që burojnë kryesisht nga ligjërimi fetar në të cilin dualizmi apo konflikti zhvillohet midis atyre që përfaqësojnë antipodin e djallit i cili kinse atakon qeniet njerëzore që identifikohen me engjullin. Edhe në eposin tonë heroik, figura e femrës që tentohet të përdhuhet nga antagonisti është me ngjyrë të bardhë. E tillë është Tanusha që i kundërvihet bajlozit të zi. P. sh.: *Çaj kish thanun Tanushja e bardh' - e pra?* (EL, II, 1983: 127). Duke iu referuar ngjyrës së bardhë në raport me të zezën, përkatësisht duke e marr si bazë këtë kundërvënie dyshe, semiologu i njohur, Jurij Lotman, e cilëson atë si kundërvënien kryesore "Unë - Tjetri", përkatësisht marrëdhënien "Ne - të Tjerët" (Lotman, 2004: 191). Nëse figurën e Tjetrit e zbresim në rrafshin psikanalitik, atëherë poqese i referohemi Jungut duhet theksuar se projektimi i Tjetrit paraqet vetëm një alter – ego që buron prej nesh apo unit tonë. Në të vërtetë, po sipas Jungut, çdo individ fillon të formohet herët në fazën e fëmijërisë kur përshtatet me dëshirat dhe pretendimet e prindërve, mocanikëve dhe arsimitarëve. Fëmijët mësojnë në mënyrë të shpejtë se disa qëndrime dhe veprime janë të pranueshme dhe mund të shpërblehen, kurse disa të tjera edhe të ndëshkohen. Tendenca është që të formësohen veti të pranueshme brenda personalitetit, kurse aspektet e papranueshme të ruhen në fshehtësi, ose të ndrydhen. Këto veti të ndrydhura, ose të shtypura, si zakonisht ruhen në pjesën e nënvetëdijes së personalitetit ku

ato bashkohen për të formësuar një kompleks tjetër, ose një pjesë të personalitetit të cilin Jungu e cilëson si hije. Jungu më tej thekson se hija kur paraqitet në ëndërr duket si figurë lemeritëse dhe e ligë dhe ndonjëherë i përket ndonjë etnie, ngjyre, ose race tjetër. Në të ka diçka të huaj ose armiqësore dhe kështu krijohet një ndjenjë e frikës, mosbesimit dhe pezmit. Në figurën e hijes, thotë Jungu, fshihet figura e armikut, ose të huajit të lig. Nga të gjitha arketipet, shton Jungu, armiku është kryesori. Ndikimi i tij ndihet në vitin e parë të jetës. Ashtu siç fëmija tregon kënaqësi kur i afrohet nëna e tij, ai do të jetë i kujdesshëm dhe i tërhequr kur do t'i afrohet ndonjë tjetër, apo i huaj. Në vitin e dytë të jetës, kjo tendencë ksenofobe do të piqet në frikë dhe armiqësi të hapur. Domethënë, ksenofobia është produkt i paradispozitave të lindura, sepse ato vërehen në mënyrë të qartë te të gjithë fëmijët, çdokund ku ata kanë lindur dhe në të gjitha llojet e rrethanave ku janë zhvilluar. Sipas Jungut, arketipi i armikut ose hijes është prodhim i dy burimeve: indoktrinimit kulturor dhe ndrydhjes familjare (sipas Stevens, 2007: 80).

Në vend të përfundimit apo imazhe mirëkuptimi të Tjetrit apo Tjetërsisë

Përmbajtja e eposit heroik edhe pse kryekëput bazohet në konfliktin që heroi i saj ka me antagonistët e tij, madje brumi i tij përbëhet nga të bëmat e heroit kundruall problemeve që i krijojnë të tjerët, megjithatë ka edhe ndonjë episod apo fragment i cili afirmon paqen, pajtimin dhe bashkëjetesën midis protagonistëve në baza antagonistë. Në këtë drejtim, në një këngë të kësaj natyre në gjuhën shqipe, në kohën që kundërshtarët bëhen gati të ndajnë mejdanin, Orët e Malit ndërhyjnë duke u thënë: *Ju mejdan sot mos me da, / t'dy kuvetin çift e kini, / Të dy me orë çift po ini, / Gur e dru n'gjynah i shtini, / Se nuk muni shoqin me e pre. / Na rixhae ju domë me ju ba, / Probatima sot me u xanë* (KPL, 1955: 175). Kundërshtarët që duhet të ndajnë mejdanin midis tyre, sipas vargjeve popullore, janë Muji dhe Krajleviçe Marku. Ky i fundit kur e dëgjon propozimin e qenies mitike në fjalë fillon të qeshë dhe pastaj i thotë Mujit se ia fal plagët e rënda të dyluftimit të mëparshëm dhe vuajtjet që i ka shkaktuar duke e mbajtur dymbëdhjetë vjet në burg: *"T'tana ty të kofshin falë! / Pobratim ty t'pata xanë*. Pasi vëllamërohen Muji dhe Krajleviçe Marku, shkojnë në Jutbinë ku bëjnë një gosti të madhe për të festuar pajtimin e tyre. Më vonë gostia shtrohet edhe në Kraji, përkatësisht në vendin e antagonistit, si p. sh.: *Qaty ngrykë konkan marrë / E n'Jutbinë bashkë konkan ra, / Zjafet të mirë paskan ba. / Athere janë votë te Kraveviçe Marki, / Kanë ba zjafet e donamë...*

Studiuesi shqiptar, Anton Pappleka, vargjeve të mësipërme, u bën një lexim transtekstual apo metaforik duhet theksuar se prapa figurës mitologjike të Orëve të malit janë fshehur forca të caktuara historike, të cilat në periudha të ndryshme kanë qenë dalzotëse të shqiptarëve, apo të sllavëve (Pappleka, 2008: 94-95). Pra, kënga transmeton një alternativë tjetër, përkatësisht mesazhin e pajtimit dhe të vetëdijësimit, pasi edhe njëri

protagonist, por edhe tjetri, kanë të përbashkët jetën e tyre që duhet ta jetojnë në kushte të paqes dhe harmonisë ndërfqinjësore. Nga ana tjetër, ata i përkasin gjinisë njerëzore, andaj posedojnë edhe një varg gjërash tjera të përbashkëta. Një kthesë e tillë e kësaj kënge, ndoshta në frymën e poststrukturalizmit apo postmodernizmit, apo më mirë thënë, Zhak Derridasë, bën thirrje, në zbutjen e kontradiktave historike (armiqësore) dhe afirmimin e dallimeve që lidhin. Në të vërtetë, të dyja palët e konfrontuara mund ta gëzojnë lirinë sipas bindjeve të tyre, vetëm nëse nuk e cunojnë atë me masa të ndryshme të trysnisë.

Ndërkaq, filozofi Hegel duke gjakuar pas lirisë në veprat e tij thotë se ajo arrihet vetëm atëherë kur njeriu i robëruar dhe njeriu që e sundon atë shndërrohen në subjekte të barabarta dhe ushtrojnë lirinë e tyre në mënyrë të pavarur, pa mos ushtruar trysni ndaj njëri-tjetrit. Studiuesi Blerim Latifi duke iu referuar Frederick Beiserit - njohës i veprimtarisë filozofike të Hegelit thekson si vijon: “Në të vërtetë, Hegeli në dialektin e tij afirmon konceptin e lirisë. Dialektika e tij nënkupton luftën e pandërprerë midis robit dhe sundimtarit apo padronit. Kjo dialektikë merr fund vetëm kur sundimtari pranon lirinë e robit, përkatësisht të dy edhe njëri edhe tjetri shndërrohen në subjekte të pavarura, secili me gëzimin e lirisë së vet. Hegeli thotë se zotëria apo sundimtari e afirmon lirinë e tij jo përmes dominimit të robit, por përmes trajtimit të tij të barabartë të tij. Kështu Hegeli argumenton urtësinë e që fshihet prapa sentencës së famshme të Rusoit: “Ai që beson se është zot i të tjerëve ai është më skllav se ata”. Ky pranim reciprok mes qenieve të lira racionale përbën thelbin e vetëdijes universale për veten, që realisht është një emër tjetër për imperativin kategorik kantian. Ideja themelore e kësaj vetëdije është se afirmimi i lirisë së unit tonë në dëm të tjetrit e ka të pamundur të funksionoj. Që kjo të mundësohet është e domosdoshme që liria jonë të jetë njëkohësisht edhe liri e tjetrit” (Latifi, 2015: 120-121). Në këtë kontekst vetëm dy subjekte të barabarta që gëzojnë lirinë mund të lidhin marrëveshje reciproke dhe ta respektojnë njëri - tjetrin në mënyrë të barabartë.

Nga e gjithë kjo, përkatësisht nga shembujt e prezentuar në tekstin e mësipërm, mund të konstatohet se imagologjia pretendon ta studioj imazhin që përçon një figurë letrare, një vend me banorët e tij e kështu me radhë. Imalogjia në vija të përgjithshme pohon se teksti letrar nuk flet asgjë për realitetin e kombeve apo popujve tjerë si dhe bartësve të tyre, pasi ai realitet është i pakapshëm ose i deformuar. Me një element të tillë, imagologjia ndodhet në frekuencën e njëjtë epistemologjike me postkolonializmin i cili pohon se diskursi apo ligjërimi për Orientin “nuk flet thajse asgjë asgjë për vetë realitetin, por ndërton kornizën e vlerave diskurzive që plasohen si një realitet i shtrembëruar. Si rrjedhojë, imazhi i të huajit në letërsi duhet të studiohet si pjesë e një tërësie të gjerë dhe komplekse: si pjesë e „imaginariumit shoqëror“, që është një termin i huazuar nga historianët. Me këtë term shënohet tërësia e përfytyrimeve të imagjinuara: miteve, besimeve religjioze, përfytyrimeve për botën dhe utopive që

prodhojnë domethënie, rregullojnë jetën e përbashkët dhe praktikat shoqërore.

Në epiqendër të vëmendjes imagologjike janë narracionet për Tjetrin apo Tjetërsinë, të pranuar në një kohë dhe hapësirë të caktuar. Narracionet që ia rrëfejmë vetes për të tjerët janë të ndryshme, të kushtëzuara me realitetin empirik, konditat kulturore, ideologjitë, andaj detyra qendrore e imagologjisë është hulumtimi i këtyre imazheve, konditat e krijimit të tyre, konditat në të cilat ato bëhen të mundshme, recepcioni dhe ndikimi i tyre. Në bazën e studimeve të tilla qëndron koncepti bartian se letërsia varet nga kultura.

Pra, imagologjia në përgjithësi apo studimet imagologjike nuk mund të shmangin apo anashkalojnë *imaginariumin* shoqëror apo kontekstin në të cilin krijohet një vepër diskurzive. Imagologu francez Mura duke u nisur nga hermeneutika e Pol Rikerit dallon dy pole të *imaginariumit shoqëror*. Këto dy pole janë ideologjia dhe utopia, të kuptuara në aspektin përshkrimor e jo polemizues. Sipas tij, edhe ideologjia (ka funksionin integruar, interpretimin idealizues nëpërmjet të cilit grupi përfaqësohet dhe sforcon identitetin e vet dhe kohezionin e vet) dhe utopia (funksioni i saj është sjellja në pikëpyetje e rendit që e vendos ideologjia, sjellja në pikëpyetje e kohezionit ideologjik në bazë të përfaqësimit të Tjetrit). Të dyja paraqesin pikënisje nga të cilat sendërtohet një tipologji e imazhit të Tjetrit: imazhi ideologjik, qoftë pozitiv ose negativ, mbështetet në skemat e përfaqësimit dominant dhe është i afërt me stereotipin, kurse imazhi utopik e bart të huajën në “alteritetin e vet, ose madje duke u munduar t’i shmang përfytyrimet konvencionale dhe duke hyrë në një mit personal”. E para paraqet kohezionin njëgrupor e dyta e thyen këtë kohezion dhe ndërton narracion qytetar apo mbinacional. Pra, ideologjia e sforcon, kurse utopia e dekonstruktin imazhin e Tjetrit. Me siguri se miti apo veprat që e shfrytëzojnë arsenalin e tij krijojnë narracione që e sforcojnë kohezionin shoqëror, pasi përballë tij janë të tjerët të cilët i kanosen këtij kohezioni apo jetese në kushte të një lirie që e gëzojnë pjesëtarët e një bashkësie të caktuar njerëzore. Ndarja në “Ne” dhe “Ata (Ato)” - të përkufizuar qoftë në aspektin gjeografik, qoftë historik, hapësinor apo kohor, madje qoftë trupor apo shpirtëror, racor, klasor, gjinor ose ideologjik - çdoherë është në kontekst të ndërtimit të identitetit vetanak pozitiv, nënkuptohet gjithmonë në raport me Tjetrin i cili është i ndryshëm nga ne, ka veçori dalluese gjuhësore dhe kulturore. Në një ambient ku mirëbesimi dhe siguria reciproke ndërmjet bashkësive të ndryshme njerëzore nuk janë në nivelin e duhur, atëherë këto marrëdhënie karakterizohen nga frika apo fobia e cila edhe më tepër ndikon në përfaqësimin e Tjetrit me attribute apo klishe që deformat dukshëm realitetin referencial.

Nga e gjithë kjo rezulton se imagologjia nuk e studion imazhin letrar nga pikëpamja se vallë ai korrespondon me realitetin e vërtetë, apo vallë është reflektim i realitetit ontologjik, por përkundrazi - ajo nisat nga premisa se ky realitet është më pak ose më shumë i shtrembëruar andaj

duhet gjetur apo analizuar arsyet apo kontekstin i cili ndikon në prodhimin e imazheve të tilla. Në këtë drejtim imagologët bashkëkohorë theksojnë njëzërit se imagologjia nuk hulumton shkallën e vërtetësisë së imazhit (imazhet janë domosdoshmërisht të pavërteta) dhe mënyrat e transfigurimit letrar të së vërtetës apo reales, por qëllimi i saj është hulumtimi i rendit të fuqisë që sundon apo drejton një shoqëri, sistemin e saj letrar dhe imagjinatën e saj shoqërore.

Poqese i referohemi shoqërisë paramoderne atëherë duhet thënë se imagjinata e saj ushqehet me mitin si një trajtë dominuese e saj, por nënkuptohet se vetëm pjesë të caktuara të tij u atribuohen figurave letrare që karakterizojnë eposin heroik, pasi ky i fundit pretendon që të pasqyrojë edhe realitete historike, por të mbështjellura me pëlhurën e narracionit mitik. Sido që të jetë studimet imagologjike paraqesin një element të rëndësishëm të studimit të imazheve të ndryshme letrare duke u nisur nga e dhëna se ato janë konstrukte që kushtëzohen nga rrethanat kulturore, ideologjitet dominuese, fuqia që përcakton rrjedhat shoqërore, etj.

#### Abstrakt:

Në punimin shkencor trajtohen disa çështje që kanë të bëjnë me imagologjinë si disiplinë e letërsisë krahasimtare e cila merret me imazhet e përfaqësimit të Tjetrit dhe Tjetërsisë, kryesisht në narracionet me prapavijë letrare. Në rastin tonë konkret, figura e Tjetrit dhe Tjetërsisë shqyrtohet në kuadër të folklorit, përkatësisht në përmbajtjen e këngëve të eposit heroik shqiptar dhe atij të sllavëve të jugut. Figura e Tjetrit apo antagonistit në këto krijime letrare përfaqësohet me attribute të qenieve demoniake që ndërlidhen me botën e poshtme, pasi kemi të bëjmë me një mendësi mitike që është karakteristike apo tipike për shoqëritë paramoderne.

Fjalë kyçe: *imagologji, mit, këngë, demon, tjetri, antagonist, protagonist, mirazh, etj.*

#### Abstract:

This paper elaborates on some issues related to imagology as a discipline of comparative literature which deals with the images of the representation of the Other and Otherness mainly in narratives with a literary background. In our concrete case, the figure of the Other and Otherness is examined in the context of folklore, namely in the content of the songs of the Albanian heroic epic and that of the South Slavs. The figure of the Other or the antagonist in these literary creations is formed with features of demonic beings that are connected with the Underworld, since we are dealing with a mythical mindset that is characteristic of pre-modern societies.

Keywords: *imagology, myth, song, demon, other, antagonist, protagonist, mirage, etc.*

## Bibliografia dhe shkurtesat:

- AKKSH (2008): *Antologji e këngëve kreshnike shqiptare*. Parathënia dhe përgatiti: Anton Nikë Berisha. "Faik Konica". Prishtinë.
- Durand, Gilbert (1991): *Antropološke strukture imaginarnog. Uvod u opću arhetipologiju*. Biblioteka "August Cesarec". Zagreb.
- EL, II (1983): *Epika legjendare. Vëllimi i dytë*. Përgatitur nga Qemal Haxhihasani. Akademia e Shkencave e RPSSH. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë.
- ELR, V, (1997): *Epika legjendare e Rugovës. V. Këngë kreshnike dhe balada. Lahutari Haxhi Meta-Nilaj*. Përgatitur nga Zymer Ujkan Neziri. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.
- FM (1988): *Fjalor i mitologjisë*. "Rilindja". Prishtinë.
- Genette, Gérard (1997): *Palimpsests: Literature in the Second Degree*. Transl. Channa Newman and Claude Doubinsky. Lincoln: University of Nebraska Press.
- KK, II (1991): *Këngë kreshnike, II*. Instituti Albanologjik. Prishtinë.
- KPL (1995): *Këngë popullore legjendare*. Qemal Haxhihasani. Instituti i Shkencave. Tiranë.
- Kuper, Dž. K (1986): *Ilustrovana enciklopedija tradicionalnih simbola*. Prosveta: Nolit. Beograd.
- Latifi, Blerim (2015): *Ideja e emancipimit në historinë e mendimit përrëndimor*. Disertacion i mbrojtur në Universitetin e Tiranës. Fakulteti i Shkencave Sociale. Departamenti i Filozofisë). (në linkun: <https://unitir.edu.al/doktoratura-blerim-latifi-fakulteti-i-shkencave-sociale-departamenti-i-filozofise-2/>)
- Лотман, Јуриј (2004): *Семиосфера. У свету мишлења. Човек – текст – семиосфера – историја*. „Светови“. Нови Сад. 2004.
- Мелетински, М. Е. (2002): *Поетика на митот*. „Табернакул“. Скопје.
- МКЛС (1983): *Марко Крале. Легенда и стварност*. Приредил и предговор: Кирил Пенушлиски. „Мисла“. Скопје.
- Њиши, Армандо (2006): *Компаративна книжевност*. „Магор“. Скопје.
- Рарлека, Антон (2008): Marrëdhëniet ndëretnike në epikën tonë legjendare. *Kultura popullore*, 1,2 (2008), Viti XXVII (57, 58). Botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike. Tiranë.
- Smith, Anthony (1991): *National Identity*. "Penguin". London.
- СНП, II (1953): *Српске народне пјесме*. Вук Стеф. Караџић. „Просвета“. Београд.
- Stevens, Anthony (2007): *Jung. Një hyrje e shkurtër*. "Ideart". Tiranë.
- Шап., 2, (1976): Шапкарев, А. Кузман. *Избрани дела. Песни*. Том втори. Приредил Д-р Томе Саздов. „Мисла“. Скопје.
- Todorov, Svetan (1994): *Mi i drugi: francuska misao o ljudskoj raznolikosti*. Biblioteka XX vek. Beograd.
- Velek, R, Voren, O.: (1982): *Teoria e letërsisë*. "Rilindja". Prishtinë.

ISSN 2671-3004

UDC 323.1(18):316.722-027.6

Punim studimor

**Teuta ARIFI**

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe,  
Fakulteti Filologjik, Shkup  
e-mail:teutarifi@gmail.com

## **INTERKULTURA, NJË KONCEPT PROGRESIV I RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE**

**Interculture, a progressive concept of the Albanian National Movement**

**Интеркултурата, прогресивен концепт на албанскиот национален препород**

Shënime hyrëse

Në një kohë me kaq shumë sfida globale si që është kjo periudhë e ditëve tona, kur konflikti i dhunshmëm mes identiteteve të ndryshme është pjesë e jonë falë komunikimit viral, në një kohë kur është më se aktual rishikimi i parimeve të zgjerimit të Bashkimit Europian dhe kur migrimi bëhet një sfidë jo vetëm ekonomike për Perëndimin, por mbi të gjitha një sfidë kulturore, të flasësh, shkruash apo kontekstualozosh interkulturën, si qasje, mendim apo veprim, më e thjeshta gjë që mund të themi, është vërtet sfiduese. Nëse nisemi fillimisht nga koncepti që paradigma e interkulturës zëvendëson konceptin e multikulturalizmit si një kuptim i cili paraqitet si i tejkaluar, dhe duke e definuar si një formë e menaxhimit të diversitetit kulturor në kushte të shoqërive liberalo-demokratike (Joppke, 2018:1), atëherë gjithësesi që debati mbi diversitetin i cili mbetet si më aktual i shoqërive tona bazohet pikërisht në këto teori më të reja mbi interkulturën të cilat mëtojnë të vendosin në rrafshin analizues dhe shpjegimor këto relacione dhe marrëdhënie në mes kulturave. Duke ndjekur këto teori të cilat u japin përparësi lidhjeve mes kulturave të ndryshme në rrethana komplekse globale dhe lokale të cilat analizën e tyre e vendosin në një periudhë të post-multikulturës, duke quajtur qasjen e mëparshme multikulturore si ngushtuese veçanërisht në çështjet lidhur me dhënien përparësi obligimeve para të drejtave, është gjithnjë e më i

shprehur debati mes paradigmës multikulturore e cila trajtohet si konservatore dhe kufizuese dhe një koncepti më pak grupor, i identifikuar si paradigma interkulturore (Meer&Modood, 2011:3). Në këtë mënyrë koncepti interkulturore konsiderohet si më i dedikuar ndaj konceptit të tërësisë karshi fragmentimit dhe i dedikuar ndaj kohezionit social karshi ndasive shoqërore. Duke ndjekur këtë linjë mendimi i cili udhëhiqet nga realiteti që zhvillimet e sotme ndodhin në një botë dhe ambient super-divers, përfundimi i paradigmës multikulturore mes tjerash sikur i bën vend narrativit të interkulturës që paraqitet si një ndërmejtësues mes diversës dhe unitares, duke krijuar një mundësi të bashkëjetesës mes këtyre dy diskurseve. (Zapata-Barrero, 2017:7). Sipas kësaj, në këtë diskutim të brendshëm intensiv mes këtyre paradigmave lidhur me relacionet mes kulturave, koncepti interkulturore i ndërtimit të raporteve dëshmon se qasja ndaj diversitetit mbetet sduese teorikisht dhe historikisht, dhe asnjëherë nuk mjafton vetëm njohja dhe konstatimi i një realiteti divers (kulturor, etnik apo gjuhësor), por thelbore është se cili është ai koncept teorik i cili do të ndiqet edhe nga praktika institucionale për të akomoduar këtë diversitet në jetën e një shoqërie kohezive dhe tolerante.

Sfidë e këtij punimi është se si të vendoset parametri kohë dhe a është e mundur që një periudhë historike e shekullit XIX, të shqyrtohet dhe analizohet duke përdorur teoritë aktuale mbi interkulturën dhe diversitetin. Sa teoritë aktuale lidhur me çështjet etno-kulturore dhe identitare kanë mundësi të shtrihen në kohën historike për të gjetur zgjidhje për të tanishmen dhe për të projektuar të ardhmen? Gjithësesi se ky koncept analitik i trekohëshmërisë ishte sfidë e mendimit filosofiko-politik të para një shekulli, dhe mbetet koncept i shtrirjes së mendimit analitik edhe sot.

### Shekulli XIX-të dhe interkultura

Shikuar nga perspektiva e sotme globalizuese, post-postmoderne dhe të shpejtësisë së jashtëzakonshme të komunikimit virtual, një shekull i mbetur pas si ai i XIX, duket i tejkaluar dhe i paanalizueshëm me këto teori dinamike të kohës mbi interkulturën. Megjithatë duke pasur parasysh faktin që shekulli XIX është determinanta e ndërtimit të identiteteve etnike në truallin europian ashtu siç i njohim ne sot, dhe gjithnjë duke mos harruar që këto identitete nuk mbetën vetëm identitete etnike, por u rritën në përmasa etno-politike dhe gjeo-strategjike dhe në këto përmasa zhvilluan relacionet komplekse në mes tyre. Identitetet e popujve të Ballkanit në shekullin e XIX-të zhvillohen si rezultat i dobësimit dhe rënies së Perandorisë Osmane, kur edhe fillon rikonfigurimi i Ballkanit për të marrë konturat politike dhe kulturore të cilat i ka dhe sot, edhe pse ende e ka të papërfunduar procesin e relacioneve etno-politike shtetërore në truallin e vet. Por ajo e cila duhet shikuar me interes të veçantë është të kuptuarit e Ballkanit si një nocion sa gjeo-politik po aqë edhe identitar, si një nocion i trajtuar si periferia ekzotike e Europës dhe në të shumtën e

rasteve si *tjetra* në kuptimin identitar dhe kulturor. Po qe se kemi parasysh faktin që ndërtimi identitar i popujve të Ballkanit gjatë këtij shekulli kaloi nëpër procesin e lëvizjeve çlirimtare të popujve të pushtuar nga Perandoria Otomane dhe që u pasua menjëherë nga luftërat mes shteteve të reja dhe parimeve hegjemoniste të një pjese të këtyre shteteve, luftërat dhe konfliktet e natyrës etnike sikur shkruajnë letërnjoftimin e Ballkanit për dy shekuj me rradhë. Ky proces identitar i zhvilluar mes konflikteve, mohimit kulturor të tjetrit, tendencës për të krijuar kultura dhe popuj të dorës së parë e dorës së dytë, do të shtresohet në një formë të evolucionit shekullor të këtij identiteti ballkanik (Todorova, 1997:7). Ky evolucion i cili në vete përmban revolucionet kombëtare apo klasore në kufijtë e tij kohor shtrihet që nga Revolucioni demokratik-borgjez francez dhe mbaron me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945. Këta kufinj kohorë definojnë konceptin e *Shekullit të Gjatë XIX*, i cili përkufizohet me këto dy ngjarje historike të cilat edhe vulosin fatin politik të Europës, pra Revolucionit Francez si fillim i ndërtimit të ideve republikane në Europën monarkike dhe mundjen e nazi-fashizmit si ide ekstreme dhe totalitare e lindur në truallin europian (Meadwell, 2001:27). Vlerësoj që ky koncept i shekullit të gjatë XIX-të vazhdon edhe pas vitit 1945, duke qenë se vërtet fitorja mbi nazifashizmin përbën ndërprerjen e një totalitarizmi institucional në truallin europian, por fatkeqësisht ndarja e Europës në sferën e Perëndimit dhe Lindjes nënkupton edhe një gjysmë shekulli betejë kundër totalitarizmit tani komunist dhe një hibernim të çështjeve të pazgjidhura apo të patrajtuara etnike në Europën Lindore dhe atë Juglindore. Rënia e komunizmit dhe bashkë me të edhe shpërbërja e federatave socialiste shumëetnike në fund të shekullit XX, shënojnë realisht atë përfundim të shekullit të XIX në kuptimin etno-politik. Megjithatë, rënia e komunizmit dhe rrjedhimisht edhe shpërbërja e federatave multietnike riktheu temat etnike në Ballkan, sërish në një formë të përgjakshme që përkujtonte periudhat e luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, por tani me një vizualizim global mediatik. Duke qenë që dekadën e fundit të shekullit XX në Ballkanin e përflakur dhe të përgjakur ishte me rëndësi të rivendosej paqja, shumë më pak diskutohej apo mendohej për koncepte kulturore në raportet ndër-etnike dhe ndër-kulturore që pritej të ndërtoheshin pas përfundimit të konflikteve të armatosura. Rivendosja e paqës dhe marrëveshjet ndërkombëtare të paqës të cilat adresuan çështjet etnike me zgjidhje territoriale (Marrëveshja e Dejtonit, 1995), apo me zgjidhje jo-territoriale (Marrëveshja e Ohrit, 2001), domosdoshmërisht do të riaktualizonin temën e komunikimit etno-kulturor si parakusht i funksionimit të këtyre shoqërive të fragmentuara brenda shteteve rishtazi të pavarësuar dhe me stabilitet dhe demokraci fragjile. Duke mos e konsideruar si tërësisht të përfunduar shekullin e gjatë XIX, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që temat etno-politike vazhdojnë të jenë aktuale në konfiguracionet shtetërore dhe rajonale, atëherë koncepti interkulturor i cili dëshiron të evitohet thjeshtëzimin e debatit vetëm në një marrëdhënie

mes shumicës dhe pakicës etnike dhe duke mos lënë anash analizën kulturore të kësaj bote super-diverse, gjithësesi që përbën një sfidë më vehte për të shpjeguar këtë fenomenologji komplekse (Zapata-Barrero, 2017:15).

### Identiteti shqiptar

Identiteti etnik shqiptar ndërtohet në rrethana komplekse kulturore dhe gjeostrategjike, si një identitet i cili ndahet etno-politikisht nga Perandoria Osmane, ndahet nga një bashkëjetesë e detyruar shekullore e ngjitur edhe me konvertimin fetar, për tu përcaktuar për një areal kulturor oksidental-europian, si një vendim, zgjedhje apo orientim i vetëpërcaktuar kulturor, shoqëror dhe gjeostrategjik. Por ky identitet i cili ndërtohet si një identitet i veçantë etnik, nuk krijon filosofinë e eksklusivitetit apo jotolerancës ndaj identiteteve të tjera, përkundrazi Rilindja jonë Kombëtare duke krijuar idenë e mëvetësisë kombëtare, nuk e sheh këtë mëvetësi si të ndarë dhe të izoluar nga kulturat e tjera respektive dhe gjuhët e tjera në kontakt me gjuhën shqipe. Fillimisht ky koncept i aleancës ndërkulturore shprehet në konceptet politike të Lëvizjes Kombëtare e cila kërkon aleatë Perëndimorë në realizimin e synimeve kombëtare dhe shtetërore, kurse aspekti tjetër është shumëgjuhësia e veprave të shkruara të Rilindjes Kombëtare. Veprat e këtyre autorëve janë të botuara në pjesën më të madhe të rasteve edhe në një gjuhë tjetër përskaq shqipes dhe ky fakt është shpjeguar si një nevojë për të adresuar idetë kombëtare të Rilindjes Kombëtare drejt opinioneve publike të fqinjëve apo qendrave kulturore europiane (Qosja, 1984:67). Megjithë këtë aspekt praktik, shumëgjuhësia e bën këtë Lëvizje kombëtare një revolucion kombëtar me një dimension të gjerë kulturor dhe njëkohësisht kosmopolit. Aqë më tepër që kjo shumëgjuhësi përfshin dy botët e ndara të asaj dhe kësaj kohe, të Lindjes dhe Perëndimit, duke filluar nga veprat në gjuhën persiane, turke dhe greke e deri tek veprat në gjuhën italiane dhe frenge.

Për të shpjeguar konceptin kulturor të Rilindjes si baza intelektuale dhe teorike e ndërtimit të identitetit kombëtar është e rëndësishme këtë proces ta vendosim në të kuptuarit kulturor të Ballkanit në përgjithësi. Pjesa më e madhe e përshkrimeve për Ballkanin janë ato të cilat e tregojnë si tranzicional, si një kalim mes Perëndimit dhe Lindjes, që të dyja këto të përshkruara si entitete jokompatibile dhe si antibiotë kulturore me urën simbolike ballkanike në mes si kalimi nga njëra anë në tjetrën (Todorova, 1997:16). Në këtë kuptim të botës ballkanike, Rilindja shqiptare lëviz kulturalisht në një hapësirë të gjerë mes dy kontinentesh duke siguruar kështu jo vetëm shtrirje të gjerë të kulturës shqiptare, por një ndërkomunikim të thellë kulturor me kulturat e tjera. Kjo kulturë ndërton një botë të thellë inspirative që nga sufizmi shpirtëror shprehur në poezinë *Fyelli* të Naimit dhe idetë panteiste të kësaj filosofie lindore mbi gjithëpraninë e perëndisë në Tokë e Gjithësi, për të vazhduar me veprimta-

rinë aktive të mbledhjes dhe botimit të folklorit shqiptar në koloninë shqiptare të Kairos, një qendër kulturore shqiptare që nga koha e pavarësisimit të Egjiptit nën udhëheqjen e Mehmet Ali Pashës. Kuptimi i urës ballkanike shprehet në këtë kuptimësi kulturore dhe filosofike të Rilindjes e cila lëviz natyrshëm nga këto kuptime spirituale lindore drejt antikës ballkanase iliro-pellazge-greke për të vendosur kështu trashëgiminë antike si boshtin kryesor ekzistencial të kulturës dhe identitetit shqiptar.

Antikiteti, përkatësia në këtë botë antike dhe njëkohësisht kultura antike, është koncept dhe identitet i Rilindjes, e cila duke qenë lëvizje aktive romantike në thelb aktivizon historicizmin nga i cili e derivon të drejtën për të qenë i pranishëm dhe i respektuar edhe në të tanishmen. Antikiteti si koncept i Rilindjes ka kryesisht qëllimin e diferencimit kulturor të identitetit shqiptar nga ai otoman, duke u vendosur si një kulturë identitare paraotomane, paramesjetare dhe europiane në thelb (Vasa, 1989:271). Koncepti europocentrik i Rilindjes bazohet në trashëgiminë antike e definuar si paragreke, e vjetër, heroike, intelektuale dhe ballkanase njëkohësisht. Duke qenë një identitet antik, por ndryshe nga identiteti antik grek, i definuar si ilir, thesprot dhe molos (Frashëri, 2000:53), Rilindja definon përkatësinë europiane të identitetit shqiptar, identitet ky i cili pavarësisht transformimeve të cilat i pëson pas ndryshimeve të mëdha të periudhës mesjetare dhe asaj otomane, mbetet në thellësitë e veta si një nga identitetet më të moçme të Ballkanit dhe Europës. Mbi këtë identitet antik ndërtohet dhe rrefehet historia e mesjetës arbërore si një vazhdimësi e antikitetit dhe figura e Skënderbeut si vazhdimësi e Lekës së Madh, që të dy të lidhur me të njëjtin emër: *nomen est homin*. Megjithatë, shkrimet shqipe të kësaj kohe vendosin theksin dhe interesimin e tyre të mëtejshëm mbi figurën e Skënderbeut, duke nënvizuar karakterin çlirimtar të luftës së udhëhequr nga ky personalitet, karshi luftërave pushtuese sado legjendare dhe antike qofshin ato.

Ndërtimi i identitetit shqiptar përgjatë periudhës së shekullit XIX ndodh në një gjeografi të gjerë jo vetëm ideore dhe imagjinare, por edhe reale. Dhe në këtë gjerësi gjeografike mes Lindjes dhe Perëndimit është bota shpirtërore dhe intelektuale e arbëreshëve të Italisë ajo e cila bëhet pjesë aktive e këtij identiteti kolektiv. Shikuar nga perspektiva e sotme mbase ndikimi i arbëreshëve në proceset kulturore, shoqërore dhe etnopolitike të shqiptarëve në Ballkan është simbolik, por para më se një shekulli, në fazën e ndërtimit të kombit dhe më vonë idesë së shtetndërtimit shqiptar, ndikimi i mendimit intelektual në qendrat arbëreshe të Italisë ishte esencial. Në kuptimin kohor arbëreshët janë mesjeta shqiptare, janë memorja e kohës së lavdishme të Skënderbeut, përfaqësojnë emigrimin nga vatrat e tyre, një fenomen aq shumë i studiuar dhe trejtuar në studimet e aktualitetit të sotëm. Arbëreshët janë natyrshëm europianë, jetojnë për pesë shekuj në tokë europiane dhe jo në tokën e “diskutueshme” ballkanike, dhe duke qenë pjesë e asaj bote, mbajnë gjallë gjuhën dhe idenë për çlirim kombëtar, duke i bërë këto vlera si themeltare në konceptin e

ndërtimit të idesë shqiptare të shtetit-komb. Në kuptimin kulturor të fjalës kjo pjesë e trungut shqiptar ndërton një poli-identitet, si inspiruese intelektuale e kryengritjeve për çlirim në atdheun e dikurshëm dhe si pjesëmarrëse aktive në lëvizjen për çlirim dhe bashkim të Italisë. Duke qenë se lëvizja italiane për bashkim kombëtar udhëhiqej nga Garibaldi dhe përveç një lëvizje çlirimtare ishte edhe lëvizje republikane për ndryshim shoqëror, atëherë është lehtë e kuptueshme se si Rilindja Kombëtare e krijuar në më shumë vende, në Lindje dhe Perëndim, nga intelektualë me formim të ndryshëm shoqëror e kulturor, e ndërtuar në një kohë kur komunikimi mes këtyre distancave gjeografike ishte shumë i vështirë dhe në raste edhe i pamundur, kishte për fuqi bashkuese idetë çlirimtare dhe ato republikane. (Fracchia, 2010:182).

Nëse është e qartë që Rilindja Kombëtare krijohet dhe zhvillohet në një hapësirë të gjerë kulturore, në një gjeografi mes Lindjes e Perëndimit dhe brenda një koncepti romantiko-historik ndaj të kaluarës antiko-mesjatarë iliro-arbërore, atëherë do theksuar që koncepti ideor i Rilindjes është iluminizmi së bashku me idetë e Revolucionit Demokratiko-Borgjez francez (Stavileci, 2000:112). Theksuam më lart që Rilindja në thelbin e saj është një lëvizje eurocentriste, por ajo që duhet saktësuar është çështja se çka nënkuptohet me termin Europë në shekullin XIX. Në shprehjet e tyre lidhur me ndryshimet shoqërore që duhen bërë, rilindasit tanë si Europë i referohen një koncepti më të ngushtë nga ajo që definojmë sot si Europë në kuptimin gjeo-politik të fjalës. Europa e shekullit XIX-të nuk përbën një entitet të përbashkët duke qenë se një pjesë e saj (Gjermania, Italia dhe Europa Qendrore), kalojnë nëpër procesin e shtet-formimit dhe ndërtimit të identitetit komb-shtet, ndërkohë që Franca dhe Anglia kanë rrumbullaksuar më herët këtë proces. Dhe nëse i përmbahemi teorisë që shekulli i gjatë XIX fillon me vitin 1789, pra me Revolucionin Francez (Meadwell, 2001:32), atëherë janë idetë libertine të këtij revolucioni që jo vetëm krijojnë idetë republikane në Europë, por që njëkohësisht bëhen inspirim dhe angazhim intelektual i lëvizjeve kombëtare të popujve të Europës Lindore dhe Ballkanit. Prandaj, Rilindja shqiptare kur i referohet Europës, nënkupton revolucionin dhe ndryshimin dhe kur i referohet *dritës*, nënkupton dritën në kuptimin iluminist, ndriçimin mendor, dijen shkencore dhe filosofinë shoqërore të barazisë, lirisë dhe vëllazërisë. Në kuptimin kulturor dhe veçanërisht atë intelektual Rilindja bën dallimin e thellë mes Lindjes dhe Perëndimit. D.m.th, Rilindja njeh si kulturë filosofinë dhe mendimin e Lindjes, dhe këtë njohje e bën edhe pjesë të veprimtarisë artistike, mirëpo bën diferencën në kuptimin shoqëror dhe politik mes këtyre dy botëve. Si Lindje-Azi, në kuptimin politik Rilindja definon Perandorinë Osmane në rrënim e sipër, arkaizmin në mënyrën e jetës larg zhvillimit shkencor e teknologjik. Në këtë kuptim forma e sulltanatit trajtohet si një relik i tejkaluar dhe pa kapacitete reformuese për dallim nga një pjesë e monarkive europiane. Dhe kësaj i shtohet edhe mosgatishmëria për të kuptuar ndryshimet e kohës të cilat kërkojnë

organizim të popujve brenda kësaj perandorie për sa i përket vetvendosjes së këtyre popujve për fatin e vet kolektiv. Dhe kjo mungesë sensi nga ana e Perandorisë Otomane kishte për pasojë luftëra të përgjakshme ballkanike (Vlora, 1999). Perëndimi – nga ana tjetër, përbën një oponencë të plotë kulturore, ideore, politike dhe filosofike ndaj Lindjes-Otomane. Perëndimi identifikohet si përparimi shkencor dhe teknologjik, si kuptim i arsimit të bazuar në njohjen racionale dhe dijen iluministe, dhe mbi të gjitha politikisht si organizim shtetëror republikan i bazuar në institucione të zgjedhura nga vetë populli-qytetari. Lindja-Otomane në këtë mënyrë personifikon robërinë dhe nënshtrimin kurse Perëndimi personifikon lirinë dhe revolucionin.

Në këtë vorbull intensive shumëkulturore në procesin e ndërtimit të identitetit kombëtar shqiptar, me rëndësi të veçantë është ky formim identitar jo vetëm në dritën e më shumë kulturave dhe jo vetëm në oponencën intelektuale Lindje-Perëndim, por veçanërisht formimi identitar në një realitet shumë-religjioz, siç ishte dhe vazhdon të jetë realiteti shqiptar edhe sot. Të qëniti një popull me shumë religjione ishte një fat historik i shqiptarëve ashtu siç edhe filloi shtrirja e monoteizmit nga Lindja drejt Perëndimit. Fillimisht duke pranuar krishterimin si edhe popujt e tjerë të Europës, dhe mandej për të qenë pjesë e skizmës mes orthodoxsisë dhe katolicizmit dhe për të pranuar edhe islamin pas shtrirjes së Perandorisë Otomane në Ballkan. Ky realitet trereligjioz para fillimit të shekullit XIX-të rezultoi me shkrime në tri alfabetë të ndryshme të letërsisë shqipe edhe atë latin të shkrimtarëve katolikë të veriut, grek të akademisë së Voskopojës dhe arab të alamiadës shqiptare. Duke qenë se para shekullit XIX-të akoma nuk është ndërtuar koncepti i kombit si formim kolektiv identitar dhe politik, elementi përbashkues i këtyre tre shkrimeve letrare është gjuha shqipe si shtylla kryesore identitare, por e pamjaftueshme për të bërë ndërlidhjen dhe komunikimin mes këtyre qarqeve intelektuale. Këto qarqe intelektuale janë si ishuj brenda një liqeni të madh pa mundësinë për tu kaluar nga njëri tek tjetri, gjë që shpjegon procesin kompleks dhe të ndjeshëm të ndërtimit të kombit, pa të cilin proces nuk mund të ndodhë amalgamimi edhe kur pjesë të caktuara të një kulture kanë të njëjtën gjuhë apo i përkasin të njejtit popull, në një hapsirë gjeografike shumë të ngushtë territoriale. Duhet theksuar gjithësesi që gjatë shekujve të pranisë në Ballkan, Perandoria Otomane kishte lejuar lirinë e besimeve fetare duke mundësuar kështu edhe shkollat fetare, dhe si përfundim, këto qarqe mësimin dhe edukimin e tyre fillestar e marrin në shkollat fetare, në gjuhët e predikimit religjioz dhe kësaj i shtojnë gjuhën shqipe në shkrimet e tyre. Që dëshmon se religjioni nuk do të mundej të luante rolin e strumbullarit identitar tek procesi i ndërtimit të kombit tek shqiptarët, për dallim nga procesi i ndërtimit të kombit nëpër të cilin kaluan fqinjët ballkanikë të shqiptarëve. Në këtë mënyrë gjatë procesit të ndërtimit të konceptit një shtet-një komb-një gjuhë, intelektualët e Rilindjes do të duhej të akomodonin shumësinë e religjioneve si një realitet objektiv, por

njëkohësisht si një vlerë e cila mbetet si pjesë e pandarë e identitetit kombëtar, por që në rradhitjen aksiologjike qëndron nën vlerën e etnikes si baza përbashkuese e identitetit kombëtar. Në këtë drejtim intelektualët rilindas gjetën partneritetet ideo-filosofik tek konceptet deiste të iluminizmit dhe racionalizmit francez, duke njohur besimin fetar si pjesë e rëndësishme e ndërtimit individual të qenies njerëzore, por duke e diferencuar besimin e individit nga institucionet klerikale të cilat sipas kësaj dijeje shërbejnë interesave konjunkturale dhe jo forcimit të besimit religjioz të individit (Horkheimer&Adorno, 1989:29). Në këtë mendim ka bazën e vet edhe laicizmi i Rilindjes Kombëtare i cili është parim themelor në ndërtimin e identitetit kombëtar gjatë shekullit XIX. Sipas kësaj, ndërtimi i identitetit kombëtar shqiptar në shekullin e XIX-të përbën një proces kompleks kulturo-historik dhe të ngjashëm me ndërtimin identitar të popujve të Europës dhe Ballkanit. Ky proces në kuptimin e memorjes historike ndërlihd të kaluarën antiko-ilire dhe mesjetën arbërore gatisë të harruara për pesë shekuj me rradhë dhe rrikthimi i tyre gjatë procesit të ndërtimit të kombit vërteton parimin romantik të këtij procesi gjithëeuropian. Shtylla vertebrale e këtij identiteti është gjuha shqipe e cila është vlera e përbashkët pavarësisht dallimeve gjeografike, fisnore, fetare apo klasore dhe botimi i veprave në gjuhën shqipe në një kohë të mungesës të institucioneve ku kjo gjuhë do të përdorej dhe lëvrohej, përbën rëndësinë kyçe të botimeve të Rilindjes. Dhe ajo që përfundimisht rrumbullakson këtë proces të ndërtimit të kombit është koncepti politik i territorialitetit, me vendosjen e kufijve brenda të cilëve Lidhja e Prizrenit flet për autonomi shqiptare, përcaktohet territori kombëtar mbi të cilin ndërtohen idetë politiko-shtetërore dhe që në kuptimin ideor vendos perspektivën kombëtare. (Shpuza, 2013)

### Koncepti interkulturore i Rilindjes

Shikuar nga perspektiva e sotme shekulli XIX-të përveç që duket si një periudhë e largët dhe romantike, duket edhe si periudhë e ndërtimit të koncepteve etnocentrike dhe të nacionalizmave përjashtues ndaj *tjetrit* si kulturë, komb, gjuhë apo religjion. Edhe pse, koncepti i Rilindjes është i orientuar drejt ndërtimit të identitetit vetanak, por megjithatë ndërton opinione dhe qëndrime konkrete ndaj kombeve tjerë dhe kulturave në kontakt. Pra, ajo e cila është me interes të veçantë për këtë studim, është mënyra e ndërtimit dhe parashikimit të konceptit të një shteti shqiptar të së ardhmes, në dritën e relacioneve mes kulturave të ndryshme të supozuara si pjesë e pandarë e një shteti të ri, një shteti-komb.

Mendimi intelektual i Rilindjes është i nduarnduarshëm sa i përket formave letrare të shprehjes, por i njëshëm sa i përket konceptit ideor të formimit të kombit. Këto ide gjenden brenda veprave poetiko-letrare, por programi intelektual-politik i Rilindjes sa i përket organizimit shoqëror dhe shtetëror është definuar tek veprat: *E vërteta për shqipërinë dhe*

*shqiptarët, nga Pashko Vasa dhe Shqipëria Çka qënë, çështë dhe çdo të bëhetë nga Sami Frashëri.*

Nëse vepra e Pshko Vasës konsiston kryesisht në informacione historike dhe aktuale lidhur me origjinën dhe kulturën shqiptare, vepra e Sami Frashërit duke shtruar çështjet në rrafshin trikohor të të kaluarës, të tanishmes dhe të ardhmes, krijon vizionin dhe kuptimësinë e një shteti të organizuar sipas modelit shtet-komb, por që njëkohësisht ka sensin edhe për dallimet etnike, kulturore dhe gjuhësore. Se sa revolucionar është mendimi i Rilindjes dëshmojnë pikëpamjet sa i përket organizimit të arsimit. Në qoftë se në shekullinXX, Edgar Moren do të projektojë *Europën në Mendje*, Sami Frashëri do të projektojë *Shqipërinë në mendje*, si një projekt iluminist, european dhe të bazuar në vlerat e barazisë dhe respektit të ndërsjellë. Sipas këtij vizioni shkollimi fillor duhet të jetë laik dhe obligativ si për djemtë ashtu dhe për vajzat dhe me detyrime ligjore ndaj familjeve për të dërguar detyrimisht fëmijët në shkollën fillore, pa dallim gjinie. Dhe ky dimension i barazisë gjinore duke paraparë edhe shkollimin e mëtejshëm deri në nivelet universitare, përbën aspektin e parë të rëndësishëm të këtij koncepti kulturor i cili pretendon dhe dëshiron të bëjë ndryshimin shoqëror duke siguruar qasjen deri tek procesi arsimor për të dy gjinitë pa dallim mes tyre.

Ky sistem shkollor përveç barazisë gjinore parasheh edhe barazinë etno-gjuhësore duke paraparë shumëgjuhësinë në sistemin shkollor, si dhe duke konsideruar nxënien e më shumë gjuhëve si një pasuri të gjerë kulturore. Në njohjen e gjuhëve nuk ka kufinj dhe ndarje mes kulturave dhe civilizimeve, secila gjuhë e mësuar është një dije më shumë, është një vlerë e shtuar, qofshin ato gjuhë Lindore apo Perendimore. Ky është njëri aspekt, por aspekti tjetër jashtëzakonisht i rëndësishëm kur flasim mbi konceptet interkulturore është përdorimi i gjuhëve të ndryshme nga ajo shqipe, si gjuhë të grupeve tjera etnike, të cilat gjuhë do të gëzonin përdorim zyrtar krahas gjuhës shqipe. Në këtë traktat politik dhe kombëtar Sami Frashëri parasheh që në ato vise shqiptare ku flitet një gjuhë tjetër nga gjuha shqipe, si bullgarisht, vllahisht dhe greqisht të ketë shkolla me mësim në këto gjuhë deri në arsimin e lartë, që dëshmon qasjen interkulturore dhe kosmopolite të koncepteve të rilindjes sonë Kombëtare.

*N'ata vende të Shqipërisë, që flitenë edhe të tjera gjuhë përveç shqipesë, si bullgarisht, greqisht, vllahisht, ata që flasinë këto gjuhë do të mësojnë në shkollat e para gjuhën' e tyre edhe shqipenë bashkë: shkollat e dyta të larta do të jenë në shqip; po në dashçinë, munt të bëjnë edhe shkolla të mbëdha në gjuhët e tyre për vehte; (Frashëri, 1978:92).*

Aspekti tjetër i jashtëzakonshëm në ndërtimin konceptual interkulturor është qasja ndaj funksionimit të lirive dhe të drejtave fetare. Në këtë drejtim Sami Frashëri parasheh ndarjen e institucioneve fetare nga ato shtetërore, parasheh krijimin e institucioneve zyrtare të bashkësive të ndryshme fetare, një ministri për relacionet ndërfitare si dhe të drejta të veçanta për pjesëtarët e religjioneve të vogla si ata hebreje dhe protestante.

Pra, një çështje është ndërtimi i identitetit etnik si supremaci ndaj nën-identitetve tjera që ka një komb, por është çështje krejtësisht tjetër akomodimi i këtij koncepti në platformë dhe veprim shoqëror dhe politik. Sekularizmi i Rilindjes është i definuar dhe i pakompromis dhe këtë sekularizëm e vendos në vizionin e të praktikuarit të jetës së organizuar shtetërore në një të ardhme.

*Të parët' e besëvet, do-me-thënë Myftiu i math, Eksarku e Kryepiskopi, do të jenë në nder të math, po nuk do të përzhënë përveç se në punërat e besësë, si dhe myftinjt' e tjerë, piskopëtë e gjithë njezërit' e besësë. Ulemaja, dervishëtë e priftërija do të mos përzhënë as në mësimt e në shkollat* (Frashëri, 1978:95).

Ky koncept kombëtar por njëkohësisht me një ndjeshmëri ndaj të ndryshmes në aspektin kulturor, fetar dhe gjuhësor, përbën mbasë njëren nga vlerat thelbore të Rilindjes, e cila ndërton idenë e shtetit-komb, por ama nuk e bën atë ide shtetërore si pronë ekskluzive të një kombi, në këtë rast atij shqiptar, por ndërton ide gjithpërfshirëse ku dallimet kulturore, gjuhësore dhe fetare sigurohen me të drejta konkrete që këto dallime të mbijetojnë, kultivohen dhe zhvillohen.

#### Kundërshtimi i interkulturalitetit

Fatkeqësisht, historia dëshmoi se mund të ndërtoni ide e koncepte pozitive, të drejta dhe të avansuara, por kjo nuk mjafton nëse nuk keni fuqinë dhe rrethanat gjeo-politike të favorshme për ti realizuar ato. Rrugëtimi nga ideali dhe vizioni për një shtet shqiptar modern, sekular dhe tolerant ndaj gjuhëve dhe kulturave të ndryshme, deri tek realiteti objektiv i shpalljes së pavarësisë, përveç që kaloi në një rrugë të vështirë, u përplas me realitetin e vështirë të luftërave mes shteteve të sapokrijuara ballkanike dhe me reformatimin e ndikimeve strategjike ndërkombëtare në Europë dhe Ballkan. Termini *Ballkani në flakë* mbasë edhe është përshkrimi më i saktë i fillimshkullit XX (Poincare, 2009:33). Spastrimet etnike, gjenocidi dhe etnocidi janë kuptimet reale të këtyre viteve, ndërkohë që vendbanimet shqiptare janë shënjestër e këtyre ngjarjeve në një kohë kur mungesa e informacionit publik u shkonte për shtat atyre shteteve dhe politikave të cilët zgjerimin e tyre e bazuan në këto veprime pushtuese dhe kriminogjene (Llape, 2013:370; Vickers, 2006:66; Veremis, 2014:23). Në mesin e pak dëshmimeve të asaj kohe janë raportimet e Lev Trockit i cili përveç që jep të dhëna të shumta rreth veprimeve të ushtrive serbe e malaziasë mbi vendbanimet shqiptare, proteston edhe ndaj opinionit publik dhe shtypit moskovit të kohës për siç shprehet ai publikimin e informacioneve selektive mbi këto krime apo aprovimin e këtyre krimeve (Todorova, 2013:13). Akoma më shumë të dhëna për këtë periudhë ofrojnë raportet e Komisionit Karnegi të cilët qëndrojnë disa herë në Ballkan për të informuar dhe propozuar zgjidhje të mundshme paqësore. Edhe në këtë raport përveç të dhënave të shumta që ofrohen sa i përket bazës etnoce-

ntrike dhe përjashtuese të këtyre konflikteve të përbashkëta, theksohet dhe një fakt tjetër me rëndësi, se ideatorët e një *federate Jugosllave* kanë doktrinë nacionaliste serbe të përkrahur nga pushteti gjithnjë e më i fuqishëm serb (Carnegie Endowment for International Peace, 1914:25). Sa i përket situatave lidhur me shtetin shqiptar dhe sfidat e njohjes ndërkom-bëtare të këtij shteti si dhe gjendjes së popullatës shqiptare jashta kufijve të Shqipërisë, akoma më shumë informacione gjejmë tek raporti i të njëjtit institucion nga viti 1921, i cili konstaton se Shqipëria e pavarësuar në vitin 1912, e okupuar dhe e coptuar gjatë luftërave, mezi se paraqitet si një e mbijetuar në kontekstin e pas-luftës (Akhund, 2012:13). Megjithatë ky raport i dytë kishte shumë më pak publicitet se sa raporti i vitit 1913 duke qenë se i dedikohej kryesisht situatës me Shqipërinë dhe shqiptarët dhe tanimë kishte qendra të organizuara politike në Ballkan për të ndaluar apo kufizuar informacionet lidhur me realitetin objektiv të spastrimeve etnike në Ballkan. Ky raport i inicuar nga d'Estournelles de Constant i cili Shqipërisë i referohet si *e Përhitura e Ballkanit* dhe i përpiluar nga Justine Godard, përveç që bën përshkrimin e situatës në terren kritikon qëndrimet dhe pretendimet e Beogradit dhe Athinës ndaj shtetit shqiptar dhe ndaj vendbanimeve shqiptare. (Akhund, 2012:25).

Luftërat Ballkanike dëshmuar se sa larg mund të shkojë dhuna dhe agresioni mbi popullatën civile, dëshmuar se të jesh një identitet tjetër gjuhësor dhe kombëtar është kualifikues i mjaftueshëm për zhdukje fizike, por mbi të gjitha dëshmuar se pastrimi etnik dhe urrejtja etnike mund të përdoren si mjet i ndërtimit të shtetit, po qe se të njëjtat legjitimohen nga institucionet ndërkombëtare. Dhe po aqë sa e tmerrshme është dhuna dhe spastrimi etnik, i tmerrshëm është parimi ideor që frymëzon këtë dhunë. Është kjo ide e cila arsyeton dhunën mbi një popull me argumente kulturore/anti-kulturore. Dhuna është mjet i pranueshëm për të çrrënjësuar nga vendbanimet e veta një popull i cili nuk e ka aty vendin meqë origjina e tij nuk është nga Ballkani. Mohimi i ekzistencës shqiptare bëhet program pseudo-shkencor dhe pseudo-kulturor i Akademisë të sapoformuar Serbe të Shkencës. Sipas këtij programi shqiptarët janë të ardhur në Ballkan bashkë me turqit, nuk kanë gjuhën e tyre, nuk kanë të kaluar historike, Skenderbeu nuk është arbër-shqiptar, nuk ka shqiptarë të krishterë, janë fise dhe jo popull, për të përfunduar dhe me insinuata fizike ofenduese kolektive (Georgevitch, 1913:35). Ky koncept është kontestuar nga qarqet progresive të cilët theksojnë se është e pajustificueshme hakmarrjen ndaj shqiptrëve që prredikon klika sunduese e Serbisë, dhe që ky koncept do të ketë pasoja aftgjate për Ballkanin (Tucoviq, 1968:9). Historia botërore ka dëshmuar se spastrimet etnike, holokausti apo zhvillimet e ngjashme kanë pasuar ide të shkruara e të parashtruara nga qarqe intelektuale të cilët kanë inspiruar aparatet shtetërore dhe ushtarake të dhunës me ide anti-kulturore të argumentuara se këta popuj të cilët janë më të ulët kulturalisht janë të determinuar të zhduken me dhunë nga më të kulturuarit. Janë këto koncepte të cilat me brutalitetin e tyre kanë dëshmuar se dinjiteti njerëzor

kërkon garanci të reja të cilat do të kufizonin fuqitë e pushtetit për të mos u përsëritur dhuna totalitare (Arend, 1994:21).

### Shënime përmbyllëse

Të rikthehemi përsëri tek paradigma e interkulturës në teoritë e sotme. Po qe se ndjekim këtë paradigëmë, atëherë gjithësesi që idetë e Rilindjes Kombëtare, edhe pse të një kohe tjetër, të një kohe kur përplasjet mes identiteteve të reja krijuan edhe konceptet e mohimit, përjashtimit, mënshtrimit apo abuzimit të vlerave identitare të tjetrit, dëshmon se konceptet dhe idetë progresive mund të zhvillohen në cilëndo qoftë periudhë historike dhe si të tilla i qëndrojnë dhëmbit të kohës. Konceptet kulturore të Rilindjes ndërtojnë identitetin kombëtar së bashku me idetë e shtetit-komb duke kërkuar zgjimin, rilindjen dhe reformimin e shpirtit kombëtar, dhe këtë ndërtim nacional nuk e bazojnë në urrejtjen ndaj *tjetrit*. Edhe thirrjet për luftë çlirimtare apo mbrojtëse nuk drejtohen kundër popujve, por kundër sistemeve shtetërore dhe pushtetve të cilat prodhojnë dhunën, padrejtësinë dhe pushtimin.

Bota e sotme e cila ka shkuar përtej shekullit XIX si në zhvillimin teknologjik ashtu edhe në idetë intelektuale, edhe në ditët e sotme përballet me problemin se si të gjejë modelin për të akomoduar realitetin super-divers, në dritën e lëvizjeve intensive të popullatës dhe kulturave dhe tejkalimin e konflikteve dhe paragjykimeve që sjellin të gjitha këto ndryshime. Si të gjindet forma e duhur e komunikimit në situata të hiper-segregacionit të grupeve të caktuara sociale apo etnike (Vertovec, 2007:1026). Dhe se të gjitha këto lëvizje dhe ndryshime nuk mund të analizohen nga një perspektivë statike pa pasur parasysh të kaluarën, të tanishmen dhe të ardhmen e një identiteti (Zapata-Barrero, 2017:3). Prandaj edhe idetë intelektuale dhe progresive nga një e kaluar jo vetëm që mbeten aktuale, por edhe janë ndihmesë për të gjetur modele funksionale në Ballkanin i cili jeton shekullin e papërfunduar XIX. Nëse teoritë e sotme mbi interkulturalitetin tentojnë të ndërtojnë paradigëmën e tyre duke vendosur parimet e interkulturalitetit si një përgjigje intelektuale dhe politike ndaj racizmit, homofobisë, eksklusivitetit religjioz dhe etnik, këto koncepte të ndërtuara një shekull më parë kur ne nuk kishim institucionet në të cilat diskutojmë sot për këto ide, flasin qartë për vizionin e një kohe e cila mbetet moderne dhe përtej modernes edhe në ditët tona.

## Abstrakt

Punimi në fjalë ka për qëllim trajtimin e ideve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare sa i përket kulturës, arsimit dhe komunikimit me kulturat e tjera në dritën e teorive dhe ideve aktuale për interkulturën dhe sfidat që kanë këto ide me realitetin objektiv të një bote super-diverse dhe e cila ndryshon me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Në këtë drejtim, Rilindja Kombëtare përveç që është e shtylla vertebrale intelektuale e ndërtimit të identitetit etno-kombëtar shqiptar në vazhden e proceseve identitare në Europë, i një rëndësie të veçantë është fakti që ky koncept nuk është përjashtues ndaj kulturave tjera. Rrjedhimisht në vizionin e një shteti shqiptar të së ardhmes parashihen mekanizma të përfshirjes së kulturave dhe gjuhëve të tjera në sistemin kulturor dhe arsimor, gjë që e bën Rilindjen një koncept inkluziv në konkurrencën e koncepteve përjashtuese etnike ballkanike. Megjithatë, identitetet etnike të sapokrijuara nuk mbetën vetëm në fushën e imagjinare, por u pasuan nga proceset e vështira të shtet-formimit të cilat në truallin e Ballkanit jo vetëm që ishin komplekse por njëkohësisht ishin edhe luftëra të përgjakshme. Rikonfigurimi i Ballkanit në fillimet e shekullit XX, ndryshimet gjeo-politike dhe formimi i shteteve të reja dhe zgjerimi i tyre me agresion dhe dhunë, krijoi çarje të thella në kuptimin etno-politik dhe atë kulturor, çarje të cilat edhe sot kërkojnë qasje teorike dhe praktike për të pasur një Rajon funksional dhe të orientuar drejt së ardhmes. Fatkeqësisht, idetë e përjashtimit, izolimit po edhe zhdukjes së *tjetrit* si identitet, kulturë apo gjuhë, sado qofshin ato të prapambetura në kohë, janë çështje që kërkojnë qasje dhe trajtim serioz, në një kohë të lëvizjeve intensive të popullatës në përmasa europiane dhe botërore. Prandaj, duke kuptuar paradigmen e interkulturalizmit e cila në debatin teorik kërkon të gjejë mënyrën jo vetëm për njohjen e kulturës së tjetrit, jo vetëm të qëndruarit e kulturave pranë njëra-tjetrës, por me njëra-tjetrën, duke kërkuar forma për një përbashkësi kulturore në një qytezë por që ka tërë botën brenda saj, idetë kosmopolite të Rilindjes, vijnë nga një kohë tjetër dhe duken aktuale. Nga një shekull i stërzgatur XIX i Ballkanit të trazuar gjithësesi që ia vlen të shikuarit e perspektivës interkulturore globale.

*Terma kyçe: interkultura, Rilindja Kombëtare, identiteti, gjuha, shteti-komb;*

## Interculture, a progressive concept of the Albanian National Movement

## Abstract

The paper aims to deal with the ideas of the Albanian National Movement in the context of intercultural communication with other cultures in the sphere of education, use of languages and human rights. This communication is analysed in the light of current theories and ideas about interculture and the challenges these ideas have with the objective reality of a super-diverse and super-dynamic world concerning the changes in the demographic and social reality. In this regard, the National Movement of 19th century, apart from being the intellectual backbone of the construction of the Albanian ethno-national identity in the wake of identity processes in Europe, has one particular characteristic, that this concept is not based on exclusivity in direction of other cultures in contact. Consequently, in the vision of an Albanian state of the future, mechanisms for the inclusion of other cultures and languages in the cultural and educational system are foreseen, which makes the Movement an inclusive concept in the concurrence of exclusionary Balkan ethnic concepts. However, the newly created ethnic identities did not remain only in the realm of the imaginary, but were followed by the difficult processes of state formation, which in the Balkans were not only complex, but also followed by ethnic conflicts and wars. The reconfiguration of the Balkans at the beginning of the 20th century, the geo-political changes and the formation of new states and their expansion with aggression and violence, created deep cracks in the ethno-political and cultural sense, cracks which even today require theoretical and practical explanation and understanding in order of building one functional and future-oriented Region. Unfortunately, the ideas of exclusion, isolation and even the disappearance of *the other* as identity, culture or language, no matter how backward in time, are issues that require a serious approach and treatment, at a time of intense population movements on a European and global scale. Therefore, understanding the paradigm of interculturalism which in the theoretical debate, seeks to find the way not only to know the culture of the other, not only to keep cultures next to each other, but with each other, looking for forms for a cultural commonality, the cosmopolitan ideas of the Albanian Movement of XIX century, no matter that they come from another time still seem current and actual. From a protracted 19th century turbulent Balkans it is nevertheless worth looking at the global intercultural perspective of today.

*Key words: interculture, National Movement, identity, language, nation-state*

## Literatura

- Akhund, N. (2012), *The Two Carnegie Reports: From the Balkan Expedition of 1913 to the Albanian Trip of 1921*; *Balkanologie, Vol.XIV, N.1-2*;
- Arendt, H. (1994), *The Origins of Totalitarianism*, San Diego, New York, London, A Harvest Book, Harcourt, Inc.;
- Dayton Peace Agreement, (1995)*, <https://www.osce.org>;
- Fracchia, J. (2010), "Hora": Social Conflicts and Collective Memories In Pianna Degli Albanesi, *Past&Present, N.209*, Oxford University Press;
- Frashëri, N. (2000), *Dëshira e vërtetë e shqipëtarëve*, Tiranë, Botimet Toena;
- Frashëri, S. (1978), *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?*, Prishtinë, Rilindja;
- Georgevitch, V. (1913), *Die Albanesen und die Grosmachte*, Leipzig, Verlag von S. Hirzel;
- Horkheimer, M.&Adorno, T. (1989), *Dijalektika Prosvetitelstva*, Sarajevo, Veselin Maslesa;
- Joppke, C. (2018), War of words: interculturalism v. multiculturalism, *Comparative Migration Studies, N.6*;
- Llape, L. (2013), *Raporte nga viti 1903, I konsujve, mitropolitëve dhe inspektorëve shkollorë serbë në Maqedoni*, Shkup, Logos-A;
- Malkolm, N. (2020), *Rebelët, Besimtarët, të Mbijetuarit, Studime mbi historinë e shqiptarëve*, Prishtinë, Botime Artini;
- Meadwell, H. (2001), The Long Nineteenth Century in Europe, *Review of International studies, N.27*, p. 165-189, London, British International Studies Association;
- Meer, N.&Modood,T. (2011), How does Interculturalism Contrast with Multiculturalism?, *Journal of Intercultural Studies*, Routledge;
- Morin, E. ( 2001), *Europa në Mendje*, Tiranë, Libra për shoqëri të hapur;
- Ohrid Framework Agreement, (2001)*, <https://www.osce.org>;
- Poincare, R. (2009), *Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913)*, Shkup, Logos-A;
- Qosja, R. (1984), *Historia e Letërsisë shqipe, Romantizmi I*, Prishtinë, Rilindja;
- Report of the International Commission to Inquire into the Causes and Conduct of the Balkan Wars, (1914), *Carnegie Endowment for International Peace, Publication No.4*, Washington D.C., Published by Endowment;
- Stavileci, M. (2000), *Iluminizmi shqiptar*, Tiranë, Botime Toena;
- Shpuza, G. (2013), Kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (15-17 Qershor 1787), *Gjurmime Albanologjike N.43*, Prishtinë, Instituti Albanologjik;
- Shpuza, G. (2020), *Bota iraniane në veprën e Sami Frashërit*, Tiranë, Shtëpia Botuese "Fan Noli";

- Todorova, M. (1997), *Imagining the Balkans*, New York, Oxford University Press;
- Todorova, M. (2013), War and Memory: Trotsky's War Correspondence from the Balkan Wars, *Perceptions, Vol.XVIII, N.2*;
- Tucoviq, D. (1968), *Sërbija e Shqipnija*, Prishtinë, Rilindja;
- Vasa, P. (1989), *E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Prishtinë, Rilindja;
- Veremis, Th. (2014), *The Modern Balkans: A concise guide to Nationalism and Politics, The rise and Decline of Nation State*, London, LSEE;
- Vertovec, S. (2007), Super-diversity and its implications, *Ethnic and Racial Studies, 30:6*;
- Vickers, M. (2006), *The Albanians*, London, I.B. Tauris;
- Vlora, E. (1999), *Kujtime (1885-1925)*, Tiranë, Botimet IDK;
- Zapata-Barrero, R. (2017), Interculturalism in the post-multicultural debate: a defence, *Comparative Migration Studies, No.5*;

ISSN 2671-3004

UDC 316.723-021.463(497-15)

Punim studimor

**Rubin ZEMON**

E-mail: zemon.rubin@gmail.com

**NDËRKULTURALIZËM PA KULTURË DHE KONTAKTE NË BALLKANIN  
PERËNDIMOR****Интеркултурализам без култура и контактите во западен балкан****Interculturalism without culture and contacts in the Western Balkans**

Pothuajse të gjitha vendet në tërësi janë kulturalisht, etnikisht dhe fetarisht pluralë dhe të ndryshëm ose heterogjenë. Këto pluralitete dhe diversitete përbëjnë realitetet e tyre multikulturore, multietnike dhe multifetare.

Debatet në teorinë liberale të rikonceptualizimit të kulturave dhe kufijve mes nesh tregojnë për një qasje që është e hapur dhe teorikisht e pakufizuar në paradigmen liberale. Ne jemi më të prirur të konkludojmë se në kushtet e rrjeteve sociale të zhvilluara mirë, dominimit të gjuhës angleze dhe zhvillimit të fuqishëm teknologjik, dallimet ndërmjet grupeve kulturore dhe etnike fshihen dhe shtypen me shpejtësi. Duke vepruar kështu, është e lehtë të mos harrojmë se zhvillimi teknologjik, format e avancuara të komunikimit dhe transporti modern kanë shkaktuar "zgjimin e etnisë" në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, si dhe se etnia si formë e organizimit shoqëror ka treguar vitalitet të madh, dhe shpesh aspekte zhvillimore dhe krijuese në natyrën e saj.

Në vitin 2007, Anne Philips publikoi studimin e saj me titullin "Multikulturalizmi pa kulturë", (Philips A. 2007) ku argumenton se kulturat janë koncepte thellësisht problematike. Së pari, nuk është e qartë se ka gjëra të tilla si kulturat - të paktën, jo nëse një kulturë kuptohet si diçka që është "njëjës, e unifikuar dhe e kufizuar". Së dyti, pjesa më e madhe e fuqisë shpjeguese që shpesh i atribuohet kulturave është kimerike: "kulturat prodhohen nga njerëzit, në vend që të jenë gjëra që shpjegojnë pse sillen ashtu siç sillen". Së treti, thirrjet ndaj kulturës përdoren shpesh për të justifikuar traditat që shtypin gratë. Së katërti, thirrjet ndaj kulturës

kontribuojnë në stereotipizimin negativ të anëtarëve të grupeve minoritare, dhe në veçanti përfaqësojnë anëtarët e grupeve pakicë të përcaktuar nga kultura dhe të paaftë për agjenturë. Megjithatë, Phillips nuk dëshiron të heqë dorë nga qasja normative e multikulturalizmit. Ajo argumenton se alternativa kozmopolitane është e papranueshme pasi, filozofikisht, ajo tenton të kthehet 'në një formë mjaft arrogante të imperializmit kulturor', dhe meqenëse, politikisht, refuzimi i multikulturalizmit nxit reagimin që shpesh është 'një kthim i koduar në nocione më të ngushta dhe më përjashtuese të identitetit kombëtar'.

Phillips nuk është simpatik ndaj asaj që mund të konsiderohet si pretendimi multikulturor se kulturat janë entitete domethënëse dhe homogjene me vlerë të brendshme, të tilla që grupet kulturore kanë nevojë për mbrojtje si të tilla. Përkundrazi, Phillips argumenton se kulturat janë të rëndësishme vetëm për atë që janë të rëndësishme për individët dhe duhet të konceptohen sitribute të individëve dhe jo të grupeve. Nga ana tjetër, Phillips kritikon atë që mund të konsiderohet si një pretendim kozmopolit ose ndoshta gjithëpërfshirës liberal që kulturat duhet të kuptohen si gjëra që kufizojnë autonominë e anëtarëve të tyre. Phillips argumenton se kjo qasje është e gabuar nga pikëpamja filozofike, sepse 'nuk ka shumë njerëz atë që zhveshur nga rrethanat sa që i kanë përvetësuar plotësisht normat e saj'.

Në të vërtetë, problemi nuk është se shtete-kombe të ndryshme me sistem social liberal-demokratik kanë qasje të ndryshme ndaj çështjes së menaxhimit të heterogjenitetit etno-kulturor, por në teoritë sociale, politike dhe të tjera shkencore, ku një sferë e marrëdhënieve etno-kulturore është lënë pas dore, deri në mesin e viteve të 80-ta të shekullit XX, kur pak filozofë politikë filluan të merren me çështjen e menaxhimit të diversitetit kulturor dhe etnik. Një nga arsyet e interesimit kaq të vonë të studiuesve dhe politikanëve për diversitetin etno-kulturor mund ta gjejmë në pushtimin e tyre me të ashtuquajturin mit të "neutralitetit etno-kulturor"! (Kymlicka W., 1999:3)

Në shumë diskurse në politikën bashkëkohore shprehet nevoja, ndonjëherë edhe kërkesa për njohje. Mund të themi se nevoja për njohje është një nga shtytësit e lëvizjeve nacionaliste në një politikë. Nga ana tjetër, kërkesa për njohje në politikën bashkëkohore po shfaqet në shumë mënyra, në emër të pakicave dhe grupeve "të pafavorizuara", si dhe në të ashtuquajturën politikë të "multikulturalizmit". Zakonisht, një kërkesë për njohje ka një shenjë të "rastit urgjent", për shkak të lidhjes së supozuar ndërmjet njohjes dhe identitetit. Kjo tezë pohon se identiteti ynë pjesërisht po formohet me njohje, ose me mungesën e tij, dhe shumë shpesh me njohje të rreme nga forma "të tjerët", e cila ndaj individëve apo grupeve të njerëzve mund të aplikojë një dëm dhe shtrembërim real, në rastet kur njerëzit apo shoqëritë po pasqyrojnë shifra të kufizuara, të poshtëruara dhe përçmuese. Mosnjohja dhe njohja e rreme mund të dëmtojnë aplikuar, të japë një formë nënshtrimi dhe të mbyllë një njeri në një formë të rreme, të shtrembëruar dhe të reduktuar ekzistuese. (Taylor Ch, 1995: 25)

Në një kontekst të politizimit të pafund të përkatësisë etnike, zhvillimit dhe afirmimit të identiteteve etniko-fetare dhe proceseve të shpërbërjes së brendshme politike në vendet e Ballkanit Perëndimor, personat që u përkasin pakicave kombëtare numerikisht më të vogla janë në një situatë më të keqe se qytetarët e tjerë në një kontekst të pjesëmarrjes efektive në jetën publike (jetën shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike). Duke marrë parasysh shtetet e Ballkanit Perëndimor, hendeku thelbësor ekzistues është midis dokumenteve dhe shpalljeve ligjore, politike dhe zyrtare nga njëra anë, dhe zbatimit të tyre aktual dhe realitetit social në praktikë. Megjithëse vendet shpallin dhe deklarojnë zyrtarisht se janë të shumëllojshme dhe multikulturore dhe se praktikojnë multikulturalizëm dhe/ose ndërkulturalizëm, realiteti është disi i ndryshëm, zakonisht më pak optimist. (Zemon R. 2023:30)

Në shtetet bashkëkohore liberale ekzistojnë çështje dhe pengesa serioze lidhur me integrimin e pakicave të ndryshme etnike, kulturore, gjuhësore, fetare dhe të tjera. Moskuptimi i dallimit ndërmjet diversitetit multi-etnik si realitet shoqëror dhe politikave të duhura të menaxhimit dhe qeverisjes së diversitetit shumë shpesh solli tensione ndëretnike dhe konflikte sociale. Proceset e rënies së komunizmit në Evropën Lindore dhe në ish-Jugosllavi, si dhe përpjekjet për krijimin e institucioneve liberal-demokratike u minuan nga konfliktet e dhunshme nacionaliste. Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Kosova janë vende që kanë përjetuar konflikte në historinë më të re dhe po përpiqen të ndërtojnë shoqëritë e tyre pas konfliktit sipas marrëveshjeve të paqes që u arritën me ndërmjetësimin dhe ndikimin e madh të bashkësisë ndërkombëtare.

### Interkulturalizmi në Maqedonin Veriore si mbas observimit të Këshillit të Europës

Me këtë rast, do të doja të fokusohesha në rastin të Maqedonisë së Veriut lidhur me çështjen e dialogut ndëretnik dhe tolerances, siç qe mund te shihet nga raportet dhe opinionet te Komitetit Këshillimor i Konventës Kornizë për Pakicat Kombëtare nga Këshilli i Evropës (KKPK). (Zemon R., 20023a)

Komiteti Këshillëdhënës i KKPK nga Opinioni i pare ne vitin 2004, konstaton se trashëgimia e konfliktit të armatosur ende ndihet brenda shoqërisë dhe e bën më të komplikuar rivendosjen e besimit dhe mirëkuptimit ndëretnik. Komiteti Këshillëdhënës konsideron se autoritetet qendrore dhe lokale duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të promovuar tolerancën dhe marrëdhëniet paqësore ndëretnike. Është konstatuar se ekziston një nivel i ulët i ndërveprimit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike, veçanërisht ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve. Për më tepër, konsiderohet se është thelbësore që autoritetet të marrin një sërë masash për t'iu kundërvënë dukurisë së polarizimit të shoqërisë në vija etnike, veçanërisht në fushën e arsimit. (CoE AD FCNM, 2005: 27).

Në Opinionin e dytë të vitit 2008, AC KKPK e konsideroi dialogun ndërretnik si çështjen e parë shqetësuese. Është sqaruar si “i pamjaftueshëm, dhe në disa raste praktikisht mungon, një çështje e cila është veçanërisht shqetësuese pasi prek” nxënësit dhe mësuesit maqedonas dhe shqiptarë. (CoE AC FCNM, 2008:39). Shqetësimet për dialogun ndërkulturor u vunë re edhe në sferën e mediave dhe mbulimit mediatik të minoriteteve.

Kjo çështje e (jo)tolerancës ndërretnike arriti kulmin e saj në dekadën e dytë të shekullit XXI, kur luftimet ndërretnike midis të rinjve u shfaqën në rrugë dhe në transportin publik dhe ky vend hyri në kategorinë të “shoqërive të ndarë” (Harel-Shalev A. 2013).

Përgjigja e parë sistematike e Qeverisë për adresimin dhe zbutjen e tensionit ndërretnik, (jo)tolerancës dhe “shoqërisë së ndarë” është bërë në vitin 2019, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Konceptit të “Një Shoqëri” dhe Ndërkulturalizmit. Kjo Strategji inicioi aktivitete për forcimin e proceseve të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve në drejtim të krijimit të një shoqërie në të cilën të gjithë do të ndjehen si anëtarë të “Një shoqërie”. Strategjia veprimi në shtatë fusha strategjike: kuadri ligjor, arsimit, kultura, media, rinia, vetëqeverisja lokale dhe kohezioni social dhe u zbatua në një periudhë 3-vjeçare nga viti 2020 deri në vitin 2022. (Zemon R. 2021).

KK e KKPK në Opinionin e saj të fundit nga 2022 vuri në dukje se “Qeveria miratoi në vitin 2019 “Strategjinë për zhvillimin e konceptit “Një shoqëri për të gjithë” dhe ndërkulturalizmit” dhe se dokumenti i referohet qartë rekomandimit të ciklit të katërt të Komitetit Këshillimor nën Neni 6 dhe bazohet në parimin e mosdiskriminimit dhe qasjen ndërkulturaliste. ...Sipas autoriteteve, zbatimi u ngadalësua nga pandemia COVID-19, por në përgjithësi është në një rrugë të mirë; masa konkrete që rrjedhin nga Strategjia janë miratuar për shembull në fushën e kulturës (shih nenin 5) dhe arsimin (shih nenin 12). Sipas anketave, me të vërtetë mund të vërehet një përmirësim i caktuar në marrëdhëniet ndërretnike në krahasim me ciklin e mëparshëm të monitorimit. Sondazhet e opinionit tregojnë rritje të besimit ndërmjet personave që identifikohen si maqedonas dhe atyre që identifikohen si shqiptarë. Shqiptarët dhe pjesëtarët e grupeve të tjera etnike priren t'i perceptojnë vitet e fundit më pozitivisht sesa personat që identifikohen si maqedonas.... Megjithatë, ndarjet etnike ende dalin në sipërfaqe në situata të tilla si zgjedhjet, krizat politike, apo çështjet gjyqësore të profilit të lartë me një komponent etnik.... (CoE AC FCNM 2022: 13).

Komiteti Këshillëdhënës e vërejti këtë situatë në realitet dhe për këtë arsye “i kërkon autoriteteve të ndërmarrin hapa të mëtejshëm drejt promovimit të një shoqërie të integruar që bazohet në respektin dhe besimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Për të garantuar qëndrueshmërinë e Strategjisë “Një Shoqëri për të Gjithë”, autoritetet duhet të ofrojnë mbështetje politike të nivelit të lartë, financim solid dhe kontakt me

praktikuesit në arsim, media dhe shoqërinë civile, si dhe publikun e gjerë”. (CoE AC FCNM, 2022: 14).

Komiteti Këshillëdhënës në Opinionin e tij të parë konstatoi se ka qëndrime të intolerancës në mesin e nxënësve maqedonas dhe shqiptarë ndaj çështjes së shkollave të përziera dhe konsideroi se autoritetet duhet të synojnë lehtësimin e kontaktit ndërmjet nxënësve gjatë hartimit të masave në fushën e arsimit, duke përfshirë edhe promovimin. njohurive të individëve për gjuhët që fliten në rajonin e tyre. I njëjti opinion konstatoi gjithashtu se departamenti përkatës i Ministrisë së Arsimit që merret me arsimin e pakicave nuk ka kapacitet institucional për të kryer detyrat e veta në mënyrë adekuate dhe konsideron se autoritetet duhet të rishikojnë situatën. Tekstet shkollore në gjuhët e pakicave dhe disponueshmëria e mësuesve të kualifikuar kishin mangësi të ndryshme që janë sfida të mëdha sot. Ndjekja e ulët e shkollës dhe shkalla e lartë e braktisjes pas shkollës filllore në mesin e nxënësve romë është një çështje që autoritetet duhet ta trajtojnë dhe ta zgjidhin, por situata mbetet pa përparim të rëndësishëm (CoE AC FCNM 2005: 29).

Për sa i përket mësimin në gjuhët e pakicave, në Opinionin e tij të parë, Komiteti Këshillëdhënës konstatoi se ka kërkesa nga komuniteti turk dhe shqiptar për hapjen e klasave shtesë që ofrojnë mësim në gjuhën e tyre. Për më tepër, Komiteti Këshillëdhënës konstatoi se ka mangësi në mësimdhënien në dhe në gjuhët vllahe, rome dhe serbe dhe konsideroi se autoritetet duhet të ofrojnë mbështetje adekuate në këtë fushë. (CoE AC FCNM 2005: 29) Në vazhdim në Opinionin e tij të dytë, KK vuri në dukje se përpjekjet e autoriteteve për të mbështetur arsimin e pakicave, megjithëse të dukshme, nuk plotësonin në mënyrë adekuate nevojat e komuniteteve më të vogla dhe ende raportoheshin vështirësi në lidhje me shqiptarët. qasje në mësimdhënie në gjuhën e tyre dhe të kësaj gjuhe. (CoE AC FCNM 2008: 40).

Në Opinionin të fundit të vitit 2022, Komiteti Këshillimor “i kërkon autoriteteve të zbatojnë një qasje ndërkulturore ndaj arsimit nëpërmjet shpërndarjes së burimeve adekuate, vazhdimin të rishikimit të materialeve mësimore dhe trajnimit të mësuesve dhe personelit tjetër arsimor mbi kulturat, historinë dhe situatën aktuale të pakicave të ndryshme. Duhet të sigurohen kontakte më të rregullta mes nxënësve me prejardhje të ndryshme etnike, duke përfshirë edhe krijimin e mjediseve të përziera në shkollë dhe në klasë”. (CoE AC FCNM 2022: 20-21). Për më tepër, Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të përmirësojnë mjedisin për mësimin dhe mësimin e gjuhëve të pakicave. Kërkesa për fillimin e një klase të gjuhës së pakicave duhet të reduktohet dhe anketat mbi kërkesat duhet të ndërmerren shpesh dhe shumë përpara çdo viti shkollor. Autoritetet duhet të hetojnë mënyra për të inkurajuar fëmijët nga shumica për të mësuar gjuhët e pakicave, veçanërisht shqipen. (CoE AC FCNM 2022: 31).

### Në vend të përfundimit

Zbatimi i rekomandimeve të Komitetit Këshillëdhënës të Konventës kornizë për pakicat kombëtare për Republikën e Maqedonisë së Veriut është një pikë referimi e rëndësishme për proceset integruese në BE. Strategjia kombëtare “Një shoqëri dhe ndërkulturalizëm” madje është autentike dhe pioniere, zbatohet pjesërisht nga autoritetet për të promovuar një shoqëri multikulturore. Megjithatë, autoritetet pranuan nevojën për të miratuar në kohë Strategjinë e re për zhvillimin e konceptit të “një shoqërie dhe ndërkulturalizmi”, për periudhën 2024-2026, e cila tani do të titullohet me emrin “Strategjion për nderkulturalism dhe kohesion shoqëror”. Komisioni Evropian në draft raportin e tij të shqyrtimit rekomandoi përpjekje të mëtejshme për të siguruar mbështetje të mjaftueshme politike, financim adekuat, me qëllim promovimin e mundësive të barabarta dhe përmirësimin e kohezionit social në vend.

“Tani jemi të gjithë multikulturalistë”, deklaroi Nathan Glazer në bestsellerin e tij prej 1998 libër. Ajo ishte një kritikë provokuese, mjaft konservatore të ndryshimeve bashkëkohore në kurrikulën e shkollave publike të SHBA-së, të cilat ai e pa si një simptomë të braktisja e idealeve më të vlefshme, të para viteve 1960 në shoqërinë amerikane. Një nga arsytet pse kjo ishte një ndërhyrje provokuese është se, në kontekstin amerikan, nocioni i multikulturalizmit, të paktën në mjediset publike, është një nga ato “ideologjiaa të zakonshme” që zakonisht nuk vihet në dyshim.

Njerëzit në Ballkan flasin shumë për njëri-tjetrin ose kundër njëri-tjetrit, por dinë pak për njëri-tjetrin. Sa më pak ta njohin njëri-tjetrin, aq më lehtë është të mobilizohen kundër njëri-tjetrit. Mitbërësit nacionalistë nga të gjitha anët bënë dhe po bëjnë gjithçka që munden për ta mbajtur atë qeshje. Ajo që shihet me dixhitalizimin e fortë dhe zhvillimin e rrjeteve sociale, tregon për prodhimin sistematik të injorancës, injorancës, si dhe shtimit të gjuhës së urrejtjes, që e bën më të lehtë manipulimin e emocioneve, dhe në politikë emocionet janë të rëndësishme dhe nuk duhet të përjashtohen, as të injorohen. Dy gjëra janë thelbësore: ne duhet të njohim më mirë popujt, komunitetet dhe kulturat ballkanike dhe duhet të luftojmë pandërprerë kundër paragjyqimeve, stereotipave dhe miteve për të tjerët.

Ne te kunderten te gjitha do jemi interkluturaliste, por pa kulture dhe pa kontakte!!!

### Abstrackt

Almost all countries as a whole are culturally, ethnically, and religiously plural and diverse or heterogeneous. These pluralities and diversities constitute their multicultural, multi-ethnic, and multi-religious realities. The debates in liberal theories of the reconceptualization of cultures and the boundaries between us point to an approach that is open and theoretically unlimited in the liberal paradigm. We are more inclined to conclude that in conditions of well-developed social networks, the dominance of the English language, and strong technological development, the differences between cultural and ethnic groups are rapidly erased and suppressed. In doing so, it is easy to overlook that technological development, advanced forms of communication and modern transportation have caused the "awakening of ethnicity" in the second half of the 20th century, as well as that ethnicity as a form of social organization, has ever been threatened, has shown great vitality, and often developmental and creative aspects in its nature.

The current political map of Europe and the Balkans is a triumph of the project of a "Nation -State" and involvement in fragmentation processes, in parallel with the processes of globalization and Europeanization. It seems that cultural pluralism is not one of the winning categories in this political-historical competition. The winner is the political (and cultural) unity of small and medium-sized states whose interests in the past and today have sacrificed the interests of more or less well-known and diverse ethnic and cultural groups. In contemporary liberal states exist serious issues and obstacles related to the integration of different ethnic, cultural, linguistic, religious, and other minorities. Non-understanding of the difference between multi-ethnic diversity as a social reality and proper politics of diversity management and governance very often brought inter-ethnic tensions and social conflicts. The processes of the fall of communism in Eastern Europe and in former Yugoslavia as well as efforts for the creation of liberal- democratic institutions were undermined by violent nationalistic conflicts. Bosnia and Herzegovina, North Macedonia, and Kosovo are countries that experienced conflicts in the newest history, and they are trying to build their post-conflict societies according to the peace agreements that were achieved with mediation and the great influence of the international community. In a context of endless politicization of ethnicity, developing, and affirming of ethno-religious identities and internal political disintegration processes in the Western Balkan countries, persons that belong to the numerically smaller national minorities are in a worse situation than other citizens in a context of effective participation in public life (social, economic, cultural and political life). Considering the Western Balkan states the existing substantial gap is between the legal, political, and official documents and proclamations on the one side, and their actual implementation and social reality in a practice. Although countries proclaim and officially declare that they are

diverse and multicultural and that they practice multiculturalism and/or inter-culturalism, the reality is rather different, usually less optimistic.

Keywords: Multiculturalism, Interculturalism, Divided societies, Western Balkans

#### Bibliografija:

Bašić, G. Žagar, M.. & Tatalović S. (ed.) 2018, Multiculturalism in Public Policies, Academic Network for Cooperation in South- East Europe, Institute for Social Sciences, Beograd, Institute for Ethnic Studies, Ljubljana and Centre for International and Security Studies, Faculty of Political Studies, Zagreb

Kymlicka W., 1999, Ethnic relations and Western Political Theory, in: *Habitus*, Novi Sad

Phillips, A. (2007). *Multiculturalism without culture*. Princeton University Press.

Taylor Ch., 1995, *Multiculturalism: Examining the Politics of Recognition*, Princeton University Press; translated in Macedonian by Чемерски О., 2004, *Мултикултурализам: Огледи за политика на празновање*, Евро-Балкан Пресс, Скопје

Harel- Shalev A. (2013). *Implementing democracy and minority rights in deeply divided societies: a comparison of Macedonia and Israel*, *New Balkan Politics* Issue 13,

<http://www.newbalkanpolitics.org.mk/item/Implementing-democracy-and-minority-rights-in-deeply-divided-societies:a-comparison-of-Macedonia-and-Israel> (approached on 08.09.2023)

Zemon R. (2021). *Republika Severna Makedonija izmegju etničke demokratije I koncepta "Jedno Društvo"*, *Kulturna autonomija nacionalnih manjina u svetlu činjenica* (str. 168- 187), Beograd, Institut društvenih nauka

Zemon R. (2023) *Contemporary Challenges of Identities, Multicultural Societies and Interculturalism*, in: *Global Trends and Threats related with Identities cultural Heritage, Environment, Creative Communities, Tourism and Sustainable local/regional development*, Center for Advanced Researches, Skopje

Zemon R. (2023a) *The position of National Minorities in North Macedonia According to the Framework Convention*, in: Basic G. (ed.) *Monitorig Minority Rights- Twenty Five Years of Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities*, Institute for Social Sciences, Belgrade & Institute for Ethnic Studies, Ljubljana

CoE, FCNM, (2003). Report Submitted by the "The former Yugoslav Republic of Macedonia" pursuant to Article 25, paragraph 1, of the Framework Convention for the Protection of National minorities

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008aecd> (approached on 08.09.2023)

CoE AC FCNM, (2005), Opinion on the "the former Yugoslav Republic of Macedonia" adopted on 27 May 2004,

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008bd41> )approached on 08.09.2023)

CoE AC FCNM, (2008), Second Opinion on the "the former Yugoslav Republic of Macedonia" adopted on 23 February 2007,

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008c189> (approached on 08.09.2023)

ISSN 2671-3004

UDC 811.111'243:37.091.3

Punim studimor

**Qatip ARIFI**

Universiteti "Nënë Tereza", Shkup

**[Qatip.arifi@unt.edu.mk](mailto:Qatip.arifi@unt.edu.mk)****ANGLISHTJA SI LINGUA FRANCA (ALF) DHE APLIKIMI I SAJ NË  
PROCESIN E MËSIMDHËNIES SË KËSAJ GJUHE****English as a Lingua Franca (elf) and its application in the teaching  
process****Англискиот како лингва франка (alf) и неговата примена во  
процесот на наставата на овој јазик**

Hyrje

Nevoja e përhershme për zhvillim dhe për përparim, shkëmbim njo-  
hurish, njohje me popujt dhe kulturat e ndryshme, shkuarjet jashtë vendit  
për arsimim të mëtejshëm ose puna imponojnë nevojën për të njohur të  
paktën një gjuhë të huaj. Nevoja për të gjetur një mjet global të komuni-  
kimit për përmirësimin e mëtejshëm ose arritja e një qëllimi, si dhe  
paraqitja e Internetit që ka lidhë njerëzit në botë, çoi në faktin se për herë  
të parë në histori, një gjuhë e vetme - anglishtja - u shfaq si zhargon global i  
sinqertë, i përdorur nga njerëzit anembanë globit për të komunikuar dhe  
për të bërë përparim në një shkallë personale apo globale. Shpërndarja e  
madhe e anglishtes, apo një numër në rritje i folësve të kësaj gjuhe, ndikon  
në krijimin e politikave gjuhësore kudo, ku anglishtja dominon si gjuhë e  
huaj. Epoka e globalizimit karakterizohet, ndër të tjera me rritjen e gjuhës  
angleze, kështu që "fillimi i mijëvjeçarit të tretë do të mbahet mend si fillimi  
i imperializmit gjuhësor dhe kulturorë i gjuhës angleze, i cili është përhapur  
me shpejtësi nëpër të gjithë botën, dhe hyn në të gjitha sferat, si në  
hapësirën e punës ashtu edhe në atë të jetesës së çdo banori individual të  
planetit tonë. Ky imperializëm linguistik bart me vete pyetje dhe probleme  
të ndryshme që duhet të zgjidhen brenda kuadrit të politikës arsimore. Dhe  
imponon nevojën për ndryshime në fushën e organizimit të mësimdhënies,  
si anglishtja si gjuhë jo-amtare ashtu edhe gjuhë të tjera të huaja.

## Anglishtja si Lingua Franca

Termi *Lingua Franca* origjinën e ka nga shprehja *lisan-al-farang* nga arabishtja<sup>29</sup> dhe nënkupton gjuhën ndërmjetësuese që e kanë përdorur folësit arabë në komunikimin me udhëtarët nga Evropa Perëndimore dhe më vonë kuptimin e saj e ka zgjeruar dhe e kanë shënuar si gjuhë e tregtisë. Si nocion (ALF) i referohet mësimi dhe përdorimi të gjuhës angleze si mjet i përbashkët i komunikimit për folësit e gjuhëve të ndryshme amtare. Apo ndryshe, bëhet fjalë për një gjuhë që është adoptuar si një gjuhë e përbashkët midis folësve me gjuhët e tyre amtare të ndryshme. Anglishtja si Lingua Franca mund të përkufizohet si "një gjuhë e përdorur si mjet komunikimi mes pjesëtarëve të grupeve gjuhësore të ndryshme e që gjuha e të cilëve nuk është gjuha e parë". Është për të theksuar faktin se për herë të parë në histori një gjuhë përdoret globalisht, dhe struktura dhe përmbajtja e saj ndikohen në të njëjtën kohë edhe nga folësit burimorë edhe ata të cilëve kjo është një gjuhë tjetër. Gjuhëtari i famshëm David Crystal<sup>30</sup> në shumë nga artikujt e tij merret me këtë fenomen, apo me anglishten si një gjuhë planetare dhe si folësit e kësaj gjuhe ndikojnë në ndryshimin e saj. Ai kritikon përdorimin e metaforës së "kalit të trojës", të cilën disa autorë e përdorin, që i referohet përhapjes së gjuhës angleze dhe imponimit të kulturës së saj në mbarë botën. Crystal thotë se tre të katërtat e fjalorit anglez janë fjalë të huazuara që kanë hyrë në anglisht për më shumë se një mijë vjet nga më shumë se njëqind e njëzet gjuhë të ndryshme. Nëse i përmbahemi metaforës së përmendur, atëherë ka një numër të madh (njëqind e njëzet) "kuaj trojanë" brenda anglishtes. Gjithashtu, ky autor shpjegon se lidhja midis kulturës dhe gjuhës është komplekse, duke theksuar se ne duhet të jemi gjithmonë të kujdesshëm në lidhje me rreziqet potenciale të "imperializmit gjuhësor", por edhe nuk duhet të ekzagjerohet. Ai nuk pajtohet me pretendimet e autorëve të caktuar që përmes mësimi të anglishtes, gjithmonë imponohen edhe vlerat kulturore dhe sociale të anglosaksonishtes.

Anglishtja në realitet mund të shërbejë si një ndërmjetës në mësimin e kulturave të tjera, në zhvillimin e tolerancës dhe krijimin e vetëdijes për diversitetin kulturor. Crystal <sup>31</sup> në artikullin e tij "The future of English as a World Language" bën një paralele midis anglishtes dhe latinishtes, duke theksuar ngjashmëritë dhe dallimet e këtyre dy gjuhëve, dominimi i të cilëve ndodh në periudha të ndryshme. Përhapja e gjuhës latine rezultoi me copëzimin, krijimin e gjuhëve të reja që ende jetojnë për shkak të zhdukjes së saj. Kur gjuha shtrihet, ndryshon kultura, flora dhe fauna që në pjesë të ndryshme të botës janë të ndryshme, kështu që imponohet nevoja për zgjerimin e fjalorit të gjuhës angleze, folësit e rinj e ndryshojnë atë dhe e

---

<sup>29</sup> House, Julian, *English as a lingua franca: A threat to multilingualism* 2003, (557)

<sup>30</sup> David Crystal, *English as a Global Language*, 1997

<sup>4</sup> David Crystal,, *Language Death*, 1997

përshtatin me mjedisin dhe nevojat e tyre. Bumfrit<sup>32</sup> thotë se shpërndarja e madhe e anglishtes ka çuar në faktin se kjo gjuhë nuk i përket vetëm folësve amë ose e kanë si gjuhë të parë. "Gjuha është në pronësi të të gjithë atyre që e përdorin atë, dhe kjo nënkupton edhe fuqinë për të rregulluar dhe ndryshuar atë."<sup>33</sup> Megjithatë, edhe pse elementet e fragmentimit njihen në zgjerimin e anglishtes, Crystal dyshon se anglishtja do të përjetojë të njëjtin fat si latinishtja, apo që në të ardhmen të formohet familja e gjuhëve angleze në llogari të anglishtes standarde. Ai shpjegon se në mesjetë ishte e lehtë për t'u izoluar nga pjesa tjetër e botës, dhe sot, me ekzistencën e internetit, është pothuajse e pamundur dhe se kjo lidhje e njerëzve mundëson mbajtjen e gjuhës angleze si një gjuhë globale. Crystal<sup>34</sup> thekson se, përveç që interneti mundëson gjuhën angleze të jetë si një Lingua Franca, ajo gjithashtu mundëson shumëgjuhësinë. Nëpërmjet shembujve të gjuhës japoneze, afrikano-jugore, amerikane dhe britanike, ky autor ilustron pohimin se jo vetëm dimensionin gjuhësor është i mjaftueshëm, por është e nevojshme edhe njohja e kulturave të ndryshme së folësve. Ai thekson se shfaqja e internetit dhe zhvillimi i teknologjive të informacionit kanë bërë të mundshëm që e gjitha gjuhët e botës të gjejnë shpejt dhe lehtë vendin e tyre në internet dhe ta përdorin atë për promovim dhe zgjerim. Promovimi i gjuhëve dhe kulturave të pakicave përmes internetit është i lehtë dhe i arritshëm kudo që ka energji elektrike, kompjutorë dhe internet; dhe përfitimet e ofruara nga interneti mund të përdoren për të forcuar gjuhët me pak folës në krahasim me gjuhët dominuese, kryesisht me anglishten. Ky autor<sup>35</sup> duke folur për gjuhët e rrezikuara dhe për atë që është e nevojshme për rigjallërimin e gjuhës, thotë se problemi më i madh është vetëdija e pazhvilluar publike se disa gjuhë janë të kërcënuara me zhdukje dhe se është e nevojshme të miren hapa të caktuar për të parandaluar këtë të ndodhë. Ai ofron një model për zgjidhjen e këtij problemi duke përshkruar katër mënyra për të informuar publikun në lidhje me këtë çështje - përmes mediave, artit, internetin dhe kurrikulës në shkollë. Ky paragraf i fundit tregon se politikat e mësimdhënies së ALF mund të kontribuojnë shumë në fillimin e zgjidhjes së këtij problemi. Është theksuar gjithashtu se përveç zhvillimit të vetëdijes, edhe entuziazmi është i domosdoshëm për të zgjidhur problemin.

Roli i gjuhës angleze në formimin e politikave të mësimdhënies së gjuhës

<sup>5</sup> Christopher Bumfrit, *English for International Communication*, 2001

<sup>6</sup> Barbara Seidlhofer, *English as Lingua Franca*, 2003:7

<sup>7</sup> David Crystal, *Crossing the Great Divide: Language Endangerment and Public Awareness*, 2003

<sup>35</sup> Crystal, David, *Crossing the Great Divide: Language Endangerment and Public Awareness*. (2003).

Politikat dhe planifikimi i gjuhëve arsimore merren me "zgjedhjen e gjuhëve që do të përdoren si gjuhë arsimit, ose gjuhë të tjera / të huaja / në një sistem arsimor të caktuar". Kur është fjala për Evropën, autori Breidbach<sup>36</sup> merret me çështjen e gjuhës angleze në Evropë, ku shumëgjuhësia përcaktohet si parim dhe qëllim i politikave arsimore. Sipas tij duhet t'i mundësohet çdo individ që të bëhet plurilingual në mënyrë që të përfshihet në jetën sociale dhe politike dhe në formimin e një identiteti evropian, duke ruajtur dhe promovuar shumëllojshmërinë kulturore. Ai pohon se Udhërrëfytesa për Zhvillimin e Politikave Arsimore Gjuhësore në Evropë (The Guide for the Development of Language Education Policies in Europe), thotë se "politika gjuhësore arsimore duhet të promovojë të mësuarit e disa gjuhëve gjatë jetës së çdo individ në mënyrë që evropianët të bëhen qytetarë të karakterizuar nga plurilinguizmi dhe interkultura, të aftë për të bashkëvepruar në të gjitha sferat e jetës". E drejta <sup>37</sup>që çdo individ të përdor, mëson dhe kultivon gjuhën e tij konsiderohet të jetë "ligj kulturor" si një specifikim i së drejtës njerëzore, sepse "mësimi i një gjuhe gjithashtu nënkupton të mësuarit për një kulturë, një mënyrë tjetër për të kategorizuar dhe kualifikuar botën, duke shprehur dhe ndërtuar mendimet dhe emocionet e një individ".<sup>38</sup>

Breidbach konsideron se Këshilli i Evropës është i vetëdijshëm se me anë të mësimin të një gjuhe të huaj, i cili dominohet nga gjuha angleze si gjuhë e huaj, është vështirë për të promovuar diversitetin gjuhësor. Shkencëtarë paralajmërojnë se nuk është e mjaftueshme për të përpjekur për shumëgjuhësi, por kjo kërkon vullnet politik dhe fuqi ekonomike për të thyer paragjykimet në lidhje me domosdoshmërinë e vlerës absolute të gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Megjithatë, disa autorë konsiderojnë se kufizimi i të mësuarit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj mund të ketë më shumë dëm sesa dobi, sepse pikërisht "përdorimi kompetent i anglishtes siguron dominimin e folësit në çdo lloj komunikimi në mes folësve të vendeve evropiane.<sup>39</sup> Njohja e anglishtes sot është e krahaseshme me artin e leximit dhe të shkrimit në epokën e industrializimit. Anglishtja si një Lingua Franca konsiderohet si pjesë e arsimit të përgjithshëm, dhe disa dyshojnë se shumë probleme globale nuk mund të zgjidhen pa njohuri të gjuhës angleze.

<sup>36</sup> Breidbach, Stephan. (2003). *Plurilingualism, democratic citizenship in Europe and the role of English* (1-24

<sup>37</sup> Konferenca mbi Gjuhët, Diversiteti, Shtetësia: politikat për plurilingualizmin në Evropë, Strazbur, 13-15

Nentor, 2002. Strasbourg: Council of Europe, 2003: 7

<sup>38</sup> François Audigier, *Basic Concepts and core competencies for education for democratic citizenship* (1999).

<sup>39</sup> Cathie Carmichael, *Conclusions: Language and National Identity in Europe..* 2000. In Barbour, S ...

House,<sup>40</sup> duke eksploruar gjuhën angleze dhe rolin e saj si Lingua Franca në Evropë, thekson se kjo nuk përbën një kërcënim për gjuhën e parë dhe shumëgjuhësinë, pasi është e nevojshme të bëhet dallimi midis gjuhëve të komunikimit (si sot, për shembull, ALF) dhe gjuhës së e identifikimit (gjuha amtare). Në punën e tij, ai përmend një trend të ri të sotëm - futjen e ALF si gjuhë të instruksioneve në fakultete. Si model, paraqet modelin e ALF në arsimin e lartë të Gjermanisë dhe futja e një risie të tillë shpjegohet nga autori si një përpjekje e universiteteve gjermane për të fituar një epitete ndërkombëtare dhe për të tërhequr sa më shumë studentë të huaj, dhe përmes kësaj edhe një infuzion të burimeve financiare sepse studimet paguhen. Doli se kjo praktikë në Gjermani nuk e rrezikoi gjuhën nacionale të atij vendi, por ALF shërbeu si ndërmjetës në përhapjen e gjuhës dhe kulturës gjermane. Në të vërtetë, sipas politikës së tyre arsimore, ALF përdoret vetëm në fillim dhe shërben si gjuhë ndihmëse (helping language), derisa studentët e huaj nuk e mësojnë gjuhën gjermane. Sipas këtij, ALF është vetëm një gjuhë hibride (gjuhë ndihmëse); Kjo na kujton se Fishman, A. Joshua<sup>41</sup> qysh para njëzet e pesë vjet, ALF-in e quajti një "gjuhë shtesë" që vepron së bashku me gjuhët lokale, dhe jo kundër tyre. House beson se nëse e shikojmë ALF-in në këtë mënyrë, nuk ka frikë se kjo do të rrezikojë gjuhën tonë amtare, por mund të ndërmjetësojë në promovimin dhe zgjerimin e saj.

Neuner<sup>42</sup> gjithashtu merret me konceptin e gjuhës angleze si një gjuhë planetare (Lingua Franca) dhe rolin e saj në politika të ndryshme arsimore, duke u mbështetur në Udhëzuesin për Zhvillimin e Politikave të Arsimit të Gjuhës në Evropë. Ai thekson tre aspekte që kanë kontribuar në popullaritetin dhe motivimin për të mësuar gjuhën angleze anembanë botës: *vlera e tregut* (ja vlen të studiohet), *struktura të thjeshta gramatikore* që mësohen me lehtësi (të paktën në fillim) dhe *statusin e dhënë nga njerëzit* si diçka që ka të bëjë me pasurimin dhe përparimin. Megjithatë, Neuner tërheq vëmendjen për disa aspekte të rëndësishme të mësimin të një gjuhe të huaj, duke theksuar se njeriu duke e mësuar këtë gjuhë zgjeron horizonte dhe fiton nga përvoja, si për botën e jashtme ashtu edhe për botën e tij të brendshme; mësimi i një gjuhe të huaj kontribuon në formimin e qëndrimeve ndaj njerëzve të tjerë dhe kulturës së tyre, gjë që çon drejt hapjes dhe tolerancës, apo paragjykimit dhe urrejtjes. Ai thekson se politikat arsimore të gjuhës të Evropës bazohen në ruajtjen dhe promovimin e diversitetit.

Veçoria kryesore e Evropës në tërësi, si dhe e shteteve anëtare individuale të Këshillit Evropian, është se ata janë multikulturor dhe shumë

<sup>40</sup> Julian House, *English as a lingua franca: A threat to multilingualism*, 2003

<sup>41</sup> Joshua. A Fishman, *English in the context of international societal bilingualism*, 1997

<sup>42</sup> Frank Neuner, *Policy approaches to English. Strasbourg: Language Policy Division*, 2002.

gjuhësore. Objektivi i trefishtë i politikës evropiane të gjuhës, kur është fjala për mësimin e gjuhëve të huaja, do të thotë: *qëllim pragmatik* (mësimi i gjuhëve të huaja për lëvizje më të lehtë të qytetarëve dhe shpërndarje të ideve), *qëllimi ndërkulturorë* (tejkalimi i paragjytimeve dhe zhvillimi i tolerancës midis qytetarëve evropianë) dhe *qëllimi socio-politik* (sigurimi i mbrojtjes dhe mbështetja për trashëgiminë e pasur gjuhësore dhe kulturore për pasurimin reciprok). Bazuar në këtë, autori bën disa përfundime lidhur me parimet e mësimin të gjuhëve të huaja në politikën evropiane të mësimin të gjuhëve: mësimi i një gjuhe të huaj duhet të zhvillojë interes për kulturat e të tjerëve, të zhvilloj qasje të hapur te të tjerët dhe të zhvilloj tolerancë ndaj të ndryshmes, aftësitë pragmatike; mësimi i më shumë gjuhëve të huaja duhet të vendoset si element qendror i arsimit formal; çdo evropian duhet t'i jepet mundësia për të mësuar më shumë se një gjuhë të huaj gjatë shkollimit; t'i ofrohen gjuhë të ndryshme (të folura brenda dhe jashtë Europës); qëllimet, motivimi, intensiteti, metodat dhe kontekstet e mësimin të gjuhëve të ndryshme mund të ndryshojnë, dhe në këtë mënyrë edhe arritjet e ndryshme në gjuhët e ndryshme të të mësuarit janë gjithashtu të ndryshme. Ky autor pastaj thekson se anglishtja kundrejt gjuhëve të tjera ka një rol të dyfishtë në kontekstin evropian. Ka një nevojë të dukshme për një gjuhë që mund të përdoret në komunikimin e përditshëm të evropianëve dhe anglishtja si Lingua Franca e përmbush këtë funksion. Anglishtja gjithashtu zën vendin e parë si një gjuhë e huaj në kurrikula në të gjithë Evropën, me përjashtim të vendeve ku është gjuhë amtare. Ky autor thotë se dominimi i anglishtes mund të rrezikojë konceptin e një politike të gjuhës evropiane të bazuar në diversitetin gjuhësor dhe sugjeron dy mënyra për të zgjidhur këtë problem. Nëse bëhet fjalë për faktin se ka një motivim të fortë për të mësuar gjuhën angleze dhe se mësohet me lehtësi, atëherë brenda kurrikulës shkollore është e nevojshme të kufizohet koha e mësimin të gjuhës angleze dhe të rezervohet mësimi i gjuhëve të tjera të huaja.

Anglishtja si gjuha e parë e huaj duhet të përdoret si bazë për të mësuar gjuhë të tjera të huaja në bazë të ngjashmërisë. Ai gjithashtu thekson se gjatë mësimin të një gjuhe e huaj, përveç elementeve gjuhësore, gjithashtu mësohet si të mësosh një gjuhë të huaj, e cila mund të zbatohet në të mësuarit e çdo gjuhe tjetër të huaj për tejkalimin më të lehtë dhe më të shpejtë.

### Përfundimi

Globalizimi, zhvillimi i teknologjive të informacionit dhe nevoja për arsimim gjatë gjithë jetës kanë kontribuar në rëndësinë e kompetencës gjuhësore si një kualifikim kyç profesional. Edhe pse politikat e edukimit gjuhësor aspirojnë për të krijuar një shoqëri shumë gjuhësore të karakterizuar nga toleranca dhe respekti për ndryshueshmëri, zgjedhja e një gjuhe të dytë apo të huaj shpesh ndikohet nga konteksti më i gjerë

socio-politik dhe kryesisht brenda arsimimit formal si lëndë të detyrueshme mësohet një gjuhë dominuese i bazuar në pushtetin politik dhe ekonomik. Autori House<sup>43</sup> thekson se ALF për shkak të vlerës së tij të madhe komunikuese ka fituar një status të veçantë në BE dhe ka lënë mënjatë gjuhët e tjera evropiane. Njohja e ALF-së u mundëson banorëve të botës dhe banorëve të Evropës lëvizshmëri më të madhe dhe njohje me kultura dhe gjuhë të ndryshme.

Udhëzuesi për zhvillimin e politikave të gjuhës arsimore në Evropë kërkon që politikatat e gjuhës arsimore të Evropës t'i japin çdo qytetari mundësinë për të mësuar shumë gjuhë, duke e kultivuar gjuhën dhe kulturën e vet, duke respektuar kulturat e evropianëve të tjerë dhe duke përdorur disa gjuhë të tjera evropiane, sidomos anglishten, për integrimin më të mirë dhe pjesëmarrje në sferën publike, në një mjedis shumë gjuhësorë siç është Evropa vë në dukje se politikatat e arsimimit gjuhësor duhet të jenë të hapur dhe fleksibël dhe duhet të njohin mënyrat më të mira për të caktuar objektivat dhe duke i zbatuar me sukses në praktikë, duke u mbështetur në modele që kanë dhënë rezultate të mira. Gjermania është një shembull i mirë se si të tërheqin studentët e huaj për të studiuar dhe për t'u njohur me një kulturë dhe gjuhë të ndryshme, duke u shërbyer me ALF si gjuhë mësimore në fazën fillestare të studimit.

Përveç kësaj ju duhet të jenë të kujdesshëm për shkak të rrezikut të mundshëm të imperializmit gjuhësor, shumë studiues argumentojnë se nuk ka arsye për frikë nga përdorimi i ALF në nivel planetar, sepse gjuhët e pakicave mund të përfitojnë nga njohuritë e ALF-së për promovimin dhe zgjerimin e tyre. Megjithatë, pavarësisht dominimit të gjuhës angleze në botë kjo nuk do të thotë gjithmonë vendosjen e modelit kulturor anglosakson, që tregojnë llojet e ndryshme të gjuhës botërore (World Englishes), folësit e të cilit ndikojnë në ndryshimin e saj dhe jepen shembuj për përshtatjen e kulturës së gjuhës angleze me kultura të ndryshme, Këshilli i Evropës dhe disa studiues janë të vetëdijshëm se dominimi aq i madh mund të kërcënojë zhvillimin e shumëgjuhësisë. Ata theksojnë se është i nevojshëm entuziazmi, por edhe vullneti politik dhe burimet financiare në mënyrë që të mësohen më shumë gjuhë të ndryshme të huaja si mënyrë për të larguar paragjykimet në lidhje me mësimin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj, ku ajo shihet si gjuhë e mjaftueshëm dhe më e vlefshme se gjuha me më pak folës.

---

<sup>43</sup> Julian House, *English as a lingua franca: A threat to multilingualism*, 2003

## Rezyme:

Nocioni *Anglishtja si Lingua Franca* (ALF) njihet si një gjuhë urë dhe gjuhë e përbashkët që përdoret për të bërë të mundur komunikimin midis njerëzve që nuk ndajnë një gjuhë amtare, veçanërisht kur ajo është një gjuhë e tretë, e dallueshme nga të dyja gjuhët amtare. Ky shkrim do të trajtoj një temë që ndërlidhet me këtë, apo si diçka që gjithmonë ka qenë e diskutueshme te linguistët; nëse termi ALF si një modalitet i veçantë i gjuhës angleze mund të përdoret në mësimdhënie të gjuhës angleze krahas gjuhës standarde angleze që përdoret në shkollë. Ndërsa shumica e gjuhëtarëve bashkëkohorë e konsiderojnë anglishten si *Lingua Franca* (ALF) si një mjet të vlefshëm për komunikimin ndërkombëtar dhe një objekt të vlefshëm studimi, disa kanë sfiduar idenë se ALF është një varietet i veçantë i gjuhës angleze. Në pjesën hyrëse të këtij shkrimi do të tregohet se sa është e përhapur kjo gjuhë angleze në nivel global si rezultat i globalizimit, zhvillimit të teknologjive të informacionit dhe nevojës për mësim dhe avancim gjatë gjithë jetës. Ideja e këtij shkrimi është të prezantojë, në bazë të një sondazhi të burimeve përkatëse, anglishten si *Lingua Franca* në formimin e politikave arsimore gjuhësore. Disa autorë besojnë se njohuritë e ALF mundësojnë lëvizjen më të madhe të qytetarëve dhe pjesëmarrjen në të gjitha sferat publike, dhe se ALF mund të shërbejë për të promovuar gjuhë dhe kultura tjera. Megjithatë, në Këshillin e Evropës mendohet se ka shumë dominim gjuhësor. Gjuha angleze mund të rrezikojë dëshirën e politikave të gjuhës evropiane për të krijuar një shoqëri shumëgjuhësore, ku të gjitha gjuhët janë të barabarta dhe të vlefshme në mënyrë të barabartë.

Fjalët kyçe: *Gjuha angleze si Lingua Franca (ALF), politika arsimore, diversiteti.*

**ENGLISH AS A LINGUA FRANCA (ELF) AND ITS APPLICATION IN THE TEACHING PROCESS**

## Abstract:

The notion of English as a *Lingua Franca* (ELF) is recognized as a bridge language and common language used to enable communication between people who do not share a mother tongue, especially when it is a third language, distinct from both mother tongues. This article will deal with a topic related to this, or as something that has always been controversial among linguists; whether the term ELF as a special modality of the English language can be used in English language teaching alongside the Standard English language used in school. While most contemporary linguists consider English as a *Lingua Franca* (ELF) like a valuable tool for international communication and a valuable object of study, some have challenged the idea that ELF is a distinct variety of English. In the

introductory part of this article, it will be shown how widespread this English language is at the global level as a result of globalization, the development of information technologies and the need for lifelong learning and advancement. The idea of this paper is to present, based on a survey of relevant sources, English as a Lingua Franca in the formation of language education policies. Some authors believe that ELF knowledge enables greater citizen movement and participation in all public spheres, and that ELF can serve to promote other languages and cultures. However, there is thought to be too much linguistic dominance in the Council of Europe. The English language may jeopardize the desire of European language policies to create a multilingual society, where all languages are equal and equally valuable.

Key words: English as a Lingua Franca (ELF), education policy, diversity

#### LITERATURA

- Audigier, Frank. *Basic Concepts and core competencies for education for democratic citizenship*. DGIV/EDU/CIT. 2000 23. Document CDCC /Delphes (99) 4. Online <http://www.coe.int> (Education).
- Breidbach, Stephen. *Plurilingualism, democratic citizenship in Europe and the role of English* 2003 (1-24). Conference on Languages, diversity, citizenship: policies for plurilingualism in Europe, Strasbourg, 13-15 November, 2002. Strasbourg: Council of Europe.
- Brumfit, Christopher. (Ed.) *English for International Communication*. Oxford: Pergamon, 1998
- Carmichael, Cathie. *Conclusions: Language and National Identity in Europe.2000*.
- Barbour, S. & Carmichael, C. (Eds.) *Language and Nationalism in Europe*, 2000. (280-289). Oxford: Oxford University Press.
- Council of Europe. *Guide for the Development of Language Education Policies in Europe: 2003*. From Linguistic Diversity to Plurilingual Education. Executive version. [www.coe.int/lang](http://www.coe.int/lang) (Language Policies).
- Crystal, David.. *Language: medium, barrier, or Trojan horse?* (Contribution to: Cultural Diplomacy at the Crossroads: Cultural Relations in Europe and the Wider World, Wilton House, 26 November, 1997). Retrieved December 12, 2014. from: <http://www.davidcrystal.community.librios.com>
- Crystal, David. *The future of English as a World Language*. 2000. Retrieved December 12, 2014. from: <http://www.davidcrystal.community.librios.com>.
- Crystal, David. *Languages on the Internet*. Retrieved December 12, 2014. from: <http://www.davidcrystal.community.librios.com>.

- Crystal, David. *Crossing the Great Divide: Language Endangerment and Public Awareness*. 2003. (Keynote Speech to the International Expert Meeting on Endangered Languages, UNESCO, Paris, 10 March, 2003). Retrieved December 12, 2014. from: <http://www.davidcrystal.community.librios.com>.
- Crystal, David. *Towards a philosophy of language management*. 2006. (Keynote paper at the conference Integrating Content and Language in Higher education, Maastricht, 28 June, 2006). Retrieved December 12, 2014. from: <http://www.davidcrystal.community.librios.com>.
- Fishman, A. Joshua. *English in the context of international societal bilingualism*. (1997). *The Spread of English* (329-336). Rowley, Massachusetts: Newsbury House. In: House, J. (2003). *English as a Lingua Franca: A threat to multilingualism?*. *Journal of sociolinguistics*. 7 (4), 556-578.
- House, Julian. *English as a Lingua Franca: A threat to multilingualism?*. 2003. *Journal of sociolinguistics*. 7 (4), 556-578.
- Huber, Evelyne. *Lingua Franca und Gemeinsprache. Gehort zur Allgemeinen Bildung eine gemeinsame Sprache?* 1998.
- Janssen, Henrike. *Linguistic dominance or acculturation - problems of teaching English as a global language*. In: Gnutzmann, 1999. C. (Ed.) *Teaching and Learning English as a Global Language, Native and Non-Native Perspectives* (41-55). Tübingen: Stauffenburg.
- Neuner, Frank, G. *Policy approaches to English*. Strasbourg: 2002. Language Policy Division.
- Raasch, Albert. *Breaking down borders - through languages*. 1999. In: Krumm, H.-J. (Ed.). *The Languages of our Neighbours - our Languages* (78-91). Proceedings of the Symposium, Vienna 29. 10-31. 10. 1998. Vienna: Eviva.

ISSN 2671-3004

UDC 81'27:316.723-021.463(497.782)

Punim studimor

**Ajten HAJDARI-QAMILI**Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare  
Fakulteti i Filologjisë "Bllazhe Koneski" - Shkup**LESIKU NDËRKULTUROR DHE NDËRGJUHËSOR NË TË FOLMEN  
URBANE TË STRUGËS****Intercultural and interlinguistic lexicon of the  
urban speakers of Struga  
Интеркултурната и меѓујазичната лексика во  
урбаниот говор во струга**

Hyrje

Interkulturalizmi nënkupton bashkëveprimin e disa kulturave me raport të barabartë, pra, mundëson gërshetimin, bashkëpunimin dhe bashkekzistencën aktive, duke pasur parasysh se në proceset e tilla kulturat dhe identitetet e veçanta zhvillohen dhe ndryshojnë vazhdimisht, si dhe mund të krijojnë kultura dhe identitete të reja. Gjegjësisht, interkulturalizmi paraqet promovimin ideologjik, politik, shoqëror të respektit, tolerancës dhe ndërveprimit kulturor e shoqëror midis individëve, pavarësisht nga raca, feja ose përkatësia etnike brenda një shteti.

Në masë shumë të madhe interkulturalizmi është qasje nga e cila pritet të tejkalohen disa nga mungesat e multikulturalizmit. Multikulturalizmi më shumë iu kushtohet parimeve, rregulloreve dhe politikave në një shoqëri shumëkulturëshe me ç'rast pranohet dhe afirmohet ekzistimi i diferencave dhe bashkësive të veçanta, etablohet dhe garantohen të drejtat e tyre (të veçanta), statusi i barabartë dhe mbrojtja përkatëse. Qëllimi i tij qendror është krijimi i kushteve për bashkekzistencën dhe bashkëpunimin e të gjitha bashkësive të veçanta dhe individëve që u takojnë po atyre, si dhe të stimulimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të kulturave të tyre të veçanta.<sup>44</sup>

Përveç përfshirjes së postulateve për multikulturalizmin të cekura më parë, interkulturalizmi një vëmendje të veçantë i kushton ekzistimit të

<sup>44</sup> Kymlicka W, 1955, Multicultural citizenship a liberal theory of minority rights, (Oxford)

mpleksur të bashkësive të veçanta, interesave të tyre të përbashkëta dhe aktiviteteve që sjellin praktika dhe kultura të reja në kontekstin e evoluimit të vazhdueshëm të kulturës dhe ekzistencës së përbashkët të të gjitha sferave të shoqërive bashkëkohore të ndryshme.<sup>45</sup> Sipas Booth-it, *interkulturalizmi është qasje, detyra e së cilës është të krijojë shoqëri civile kohezive përmes shndërrimit të identiteteve njëdimensionale në ato shumëdimensionale dhe përmes zhvillimit të sistemit të përbashkët të vlerave dhe kulturës publike*.<sup>46</sup> Përparësitë që karakterizojnë këtë qasje janë ndërveprimi dhe dialogu, aspiratat drejt bashkimit dhe kohezioni social i fortë.<sup>47</sup>

Që të flasësh për dygjuhësinë dhe shumëgjuhësinë ka nevojë të bësh një analizë komplekse sintetike nga përpjekjet e përbashkëta të degëve përkatëse të shkencës. Studimet e aspekteve të ndryshme janë pjesë e tërësisë, plotësojnë dhe thellojnë zhvillimin e problemit të dygjuhësisë. Aspekti sociolinguistik është i lidhur me studimin e ndikimit të faktorëve shoqërorë në formimin dhe ndërveprimin e përbërësve kryesorë të dygjuhësisë, në formimin dhe zhvillimin e këtij fenomeni, si dhe me përcaktimin e rolit të dygjuhësisë në jetën sociale të bartësit të saj. Aspekti sociolinguistik është i lidhur ngushtë me aspektin aktual gjuhësor ose ndër-gjuhësor, i cili është krijuar për të karakterizuar proceset ndërstrukturore në kontekstin e zhvillimit të dygjuhësisë. Psikolinguistika e përqendron vëmendjen e saj në aktet e prodhimit të të folurit, në të cilat manifestohet cilësia dhe niveli i zotërimit të një gjuhe të caktuar në tërësinë e saj: kompetenca gjuhësore, e të folurit dhe sociokulturore.

Në analizën tonë, konkretisht trajtojmë ndërndikimet gjuhësore në Strugë, e cila është mjaft e vështirë, jo për shkak të asaj se ato gjuhë gjatë bashkëjetesës shekullore kanë ndikuar shumë njëra te tjetra, por për shkak të vështirësisë që të përcaktohet se cila gjuhë dhe në çfarë mase ka ndikuar mbi tjetrën. Në Strugë sot fliten katër gjuhë: shqipja, maqedonishtja, turqishtja dhe vllahishtja, por pjesërisht përdoret edhe gjuha rome. Megjithatë, në rrjedhë të kohës kanë pasur ndikim edhe nga latinishtja, greqishtja, turqishtja, gjuhët neolatine e së fundi nga anglishtja.

Zakonisht, gjuha e cila ndikon më shumë mbi të tjerat është gjuha e folësve me kulturë mbisunduese apo që është në pushtet dhe që i ka forcat ushtarake-politike më të fuqishme. Elementet e huaja gjuhësore janë më evidente në të folmen popullore sesa në gjuhën standarde, për këtë arsye është e domosdoshme të studiohet e folmja dhe krijimtaria popullore (epika, lirika, balada, përrallat, kashelashet, frazeologjizmat, legjendat,

<sup>45</sup> Basic, Zagar, Tatalovic (2018), Multiculturalism in Public Policies, Institute for Social Sciences, Beograd, p. 18-22

<sup>46</sup>Booth, T (200) Book review of: Interculturalism, Education and Inclusion, British Journal of Educational Studies, 51 (4) pp: 432–433.

<sup>47</sup> Nasar Meer & Tariq Modood (2012) How does Interculturalism Contrast with Multiculturalism?, Journal of Intercultural Studies, 33:2, 175-196, DOI:10.1080/07256868.2011.618266

fjalët e urta etj.). Për ta ilustruar këtë do japim disa shembuj që përdor populli i të gjitha kombeve në Strugë.

Si, p.sh. frazeologjitë: (shqip) *ma mori bukën me atë zanat* = (maqedonisht) *ми го зеде лебот со тој занает* = (turqisht) *ekmegimi aldi o zanatlen*; (shqip) *bukë e kripë* = (maqedonisht) *леб и сол* = (turqisht) *ekmekle tuz*. (shqip); *do t'ia gjej çaren* = (maqedonisht) *ky му најдам чапе* = (turqisht) *çaresini bulacim*.

Apo formulimet sintaksore: (shqip) *tash për tash jam mirë* = (maqedonisht) *cega за cega сум добро*.

Po ashtu, fjalët e përbashkëta të ligjërimit bisedor të të gjitha nacionaliteteve në Strugë dhe frazat përshëndetëse, si p.sh.: *A be ?* (me kuptimin: Si je? ose Çka bën?) *Ja be*. (me kutimin: Ja siç më sheh. = mirë jam); *tel, çupe, buza, krug* (= xhiro), *smole, maler, zhglë-dur, najdo* (i humbur, tunç, kokëbosh), *ajnasës* (i dobët, i ngratë, i mjerë), *qakat* (nga turqishtja: letër "kâgjit", me kuptim: para, të holla), *fegi* (nga ang., por me kuptim: i pasinqertë, tradhëtar, jolojal), *teshki* (shkurtim nga shprehja serbe: тешки сељак, pra njeri shumë i thjeshtë, i paqytetëruar), *gllupi* (nga sllav. глуп = i thjeshtë skajshmërisht), *grebator* (servil), *ama smeshno!* (nga maq., por me kuptim të kundërt e thënë me ironi, për: aspak nuk është për të qeshur), *zllaten xhoker* (nga maq. златен цокер), *semka* (nga sllav.: vetëm për farat e lulediellit) etj.

I. Ndërndikime me maqedonishten - Maqedonishtja si gjuhë shoqërore-politike e mjedisit dhe me prestigjin që ka patur në kohën e qeverisë së ish RSFJ-së, e më vonë si gjuha e vetme zyrtare e Republikës së Maqedonisë (së Veriut), pa dyshim se ka ndikuar më tepër mbi gjuhët që përdoren në këtë mjedis, veçmas në gjuhën e popullatës së paarsimuar. Pjesa më e madhe e barbarizmave maqedonase që përdor popullata jomaqedonase strugane, qysh moti ekzistojnë në thesarin e gjuhës së tyre amtare, por popullata e paarsimuar nuk e njuh mirë leksikon e administratës dhe të jetës shoqërore. Kjo mund të përlligjet me faktin se e tërë administrata dhe shërbimet zyrtare deri para pak vitesh, si në tërë Maqedoninë e Veriut ashtu edhe në Strugë, zhvilloheshin vetëm në maqedonisht dhe popullata e haste vetëm atë terminologji. Andaj, jo rastësisht, te popullata e paarsimuar dhe e moshës së shtyrë i hasim amalgamet e tipit: *Shkova në sud ta podnesi mollbën që ta tuzhis komshiën. Ay plaku punon në opshtin, ama tashti dë dale në penzi. Sestra ma dha knishkën, ama në shallter kishte shumë guzhvë. Dje e pagova smetkën e strujës*.

Ndërkaq, ka raste kur të rijntë e arsimuar vetëm për t'u treguar se janë "kullera" përdorin huazime të panevojshme (barbarizma), si p.sh.: *Mos u bo shum smeshno. Darka ishte bogato. Puna është zhestoko*:

Ndikimi i shqipes mbi maqedonishten vërehet jo vetëm në përdorimin e leksemave, por edhe në aspekt fonetik e morfologjik p.sh.: *чупе, биро, тель, пус, босилек, кумбар, кукувајка, буза, гуша, шара, нипрка, го шитнав, карпа, талас, рофја, угуч, шкјмба, сојој, сугар, гурмаз* etj. Bashkëtingëlloret /ќ/ dhe /ѓ/ nën ndikim të gegërishtes qendrore të

Strugës nyjëtohen si afrikate të përparme (*че ода, че прам, цеврек, цердан*); tek emrat e përveçëm ruhet dhanorja; përdoret forma foljore me foljen ndihmëse kam+ mbiemër prejfoljor, e cila tash ka hyrë edhe gjuhën standarde (*имам одено = kam shkuar*); ndajfolja *после* (pastaj) kryen funksionin e parafjalës sikurse në turqisht p.sh. *после неколку месеци* (kaç ay sonra);

II. Ndërndikime me turqishten - E folmja turke e Strugës më shumë ka dhënë leksema, kurse ka marrë forma. Në fakt ndryshimet që ka pësuar turqishtja e Strugës nuk janë bërë nga vetë turqit, por janë rezultat i gabimeve të joturqve kur e flasin turqishten ose nga shqiptarët që deklarohen turq, si dhe nga martesat e përziera të shqiptarëve me turqit.

Turqizmat janë shumë të pranishme te të gjitha gjuhët e Strugës, sidomos te gjeneratat e moshuara. Nëse bëjmë krahasim se cila gjuhë ka pranuar më shumë turqizma, del se shqipja ka pranuar pak më shumë sesa maqedonishtja, për shkak të fesë së njëjtë dhe kulturës orientale, p.sh.: *qebe, çarshaf, këllëf, tenxhere, kapak, xhezve, tepsi, çajnik / çajdanllëk, byrjan, tyrlitavë, jagmazllëk, kadëngjybek, imam bajëlldi, sytliash, ashure, musaka, yrnek, açik, aksham, azër, buasllëk, gafil, gjezdis, gjyase, javash, jeshilkë, llafe, llauskë, lyrek, maviçkë, sebep, vakët, avale, ajr, ajmali., ak, aber, gajre:t, kimet, fukara, ashiqare, bitevi, erhap, tamam, gjyna, zor, yzmet, isharet, yrnek, kusur* etj.

E folmja turke e Strugës nga shqipja dhe maqedonishtja e ka marrë fonemën /c/ dhe /q/, si p.sh.: *cigara, cirtalerim, centarda, qojli, Qemal*. Gjithashtu, varianti i butë i fonemës /g/, gjegjësisht /ğ/ nuk përdoret fare, po në vend të saj përdoret varianti i fortë /g/ (p.sh.: *sogan, agaç, dag* etj.); Në aspekt morfologjik dhe sintaksor tërësisht është ndikuar nga shqipja dhe maqedonishtja, kështu që në vend që koha dhe mënyra foljore të ndërtohet me mbaresa, siç e ka natyrën turqishtja si gjuhë aglutivative, ajo ndërtohet me ndajfolje (apo mbiemër prejfoljor)+ folja ndihmëse “jam” me formë sikurse në shqip dhe maqedonisht *iyim* (gjegjësisht, ey iyım) *isın, idir, iyis, isınıs, idiler*; forma mohore e foljes kopulative me *değil* nën ndikim të shqipes ka radhitje të kundërt, gjegjësisht *iyi değil > deldir ey* (s’është mirë); mënyra se si përdoret lidhëza *açan* (në vend të formës *gidecek (gideyen) zaman...*, përdoret forma *açan gidecim...*) etj.

Meqenëse në shqipe dhe në maqedonishte nuk ka zanore /ö/ edhe në të folmen turke të Strugës kjo zanore është zëvendësuar me zanoren /ü/ = /y/ ose /o/, si p.sh.: *öldüm* (për: öldüm), *dünder* (për: döndü), *ümrüm* (për: ömrüm), *ünder* (për: önder), *ole* (për: öyle), *bole* (për: böyle), *dort* (për: dört), *üğretmiştir* (për: öğretmiştir), *üdeyecim* (për: ödeyeceim), *durum* (për: dürüm), *burek / bürek* (për: börek), *qojli* (për: köylü).

Një ndikim shumë karakteristik nga turqishtja në shqip dhe në maqedonisht janë strukturat.: *Kush ka aty?* (Orda kim var?) në vend të: *Kush është aty? Има некој тука? Erdha me saba* (Geldim sabaylen) në vend të: *Erdha që në mëngjes.*

III. Ndërndikime me gjuhën rome - Elemente rome hasen vetëm në varietetet sociale të muzikantëve struganë, për shkak se secili grup muzikor ka anëtar që është egjiptian ose rom. Ja disa shembuj: *as* (hesht), *aspir* (pushim, mjaft, pauzë), *ajnali* (nikoqir i mirë, bujar, i pasur), *najdo* (i humbur, i hutuar, i thjeshtë), *love* (të holla, para), *çavo* (djalo), çavi ja (vajzë), *Te puçavte?* (A të thashë?) etj.

Egjiptianët e Strugës si gjuhë amtare e përdorin shqipen, kurse ata që e quajnë veten romë më shumë e përdorin maqedonishten, prandaj gjuha rome përdoret shumë pak dhe është si një gërshtetim: gjuhë rome + shqip + maqedonisht + turqisht, p.sh. *Çavo, idi gore nëna të kërkonte t'ia apish klyçat, allashkën!*

IV. Ndërndikime me vllahishten – Shqipja dhe vllahishtja e Strugës kanë disa afri më tepër nga gjuhët e tjera që fliten në këtë mjedis, p.sh. kanë: 7 tipare të përbashkëta fonetike-fonologjike, 8-9 tipare të përbashkëta morfologjike dhe 90-100 leksema të përbashkëta, të cilat janë trashëguar nga lidhja e shqipes me rumanishten. Ja disa leksema të përbashkëta: *avull* ~ *abur*, *bajgë* ~ *baligă*, *baltë* ~ *baltă*, *bardh* ~ *bardă*, *buzë* ~ *buză*, *çjap* ~ *tap*, *çukë* ~ *çiuică*, *droe* ~ *droaie*, *dhallë* ~ *zară*, *dhuratë* ~ *dar*, *fyell* ~ *fluiera*, *gardh* ~ *gard*, *gati* ~ *gat*, *gjemb* ~ *glimp*, *hamës* ~ *hames*, *kokë* ~ *coacaza*, *mal* ~ *mal*, *moshë* ~ *mos*, *nepërkë* ~ *năpărkă*, *përrua* ~ *paran*, *qafë* ~ *ceafă*, *rrufe* ~ *rimf*, *sorrë* ~ *cioara*, *shkrep* ~ *scăpară*, *thërrime* ~ *fărima*, *urdha* ~ *urda*, *vatër* ~ *vatră*;

Edhe në aspekt morfologjik vllahishtja ka pësuar ndikime nga shqipja, sidomos më karakteristike është mënyra habitore, p.sh.: *phero* – *phurka* (njëjtë sikur: mësoj – mësuaka ose mësoka) etj.

V. Ndikime nga anglishtja - Kohëve të fundit ndikimi i anglishtes mbi të gjitha gjuhët në botë po thellohet dukshëm. Elementet angleze kryesisht kanë hyrë përmes personave publikë, gjegjësisht përmes politikanëve, gazetarëve ose njerëzve të tjerë eminentë, kurse hovin më të madh e mori përmes rrjeteve sociale. Edhe në Strugë përdoren shumë fjalë apo shprehje nga anglishtja, si p.sh.: *Kjo është nonsens; Barnatorja punon non-stop; Këndonte llajv; Je shumë fani; Çarxhe baterinë; Hidhe në garbiç; Tejkere këtë beben; Unë jam fri; Barkun e kam full; Unë dë asistoj; Sot ishte shou në klasë; A ma pëlqen lukun tim? Nuk jam në mud sot. Ky hamburgeri ta jep atë vajbin si te "Burgerhausi"; E downllaudoj foton; E bora seiv foton; Kam akaunt të ri; Boe çek in; Çile follderin; Kam shumë folloversa; Atë nuk e kam follow; Kjo paska shumë frendsja në fb; E bora llajk postin; E pashë në story te ty; Tash ta boj share videon; Të bora tag edhe tye; Ku je sisi?; Si të kam bro?; Ky çuni qënka shumë kull; Jam shumë najs; Isha në shopping* etj.

Të gjitha këto anglizma përdoren në secilën gjuhë në Strugë, p.sh.: *Bu idir nonsens; Apoteka işler non-stop; Ова е нонсенс. Аптекама работи нон-смон* etj.

## Përfundim

Nga ky hulumtim erdhëm në përfundim se në Strugë vërehet një ndërndikim ndërkulturor dhe ndërgjuhësor mes shqipes, maqedonishtes, turqishtes, vllahishtes dhe gjuhës rome; e kohëve të fundit të gjitha së bashku po ndikohen nga anglishtja. Secila gjuhë ka ndikuar mbi njëra-tjetrën, por ndonjëra më shumë ka dhënë e më pak ka marrë ose më shumë ka dhënë fjalë e më shumë ka marrë forma gramatikore ose fonetike dhe të gjitha këto kanë qenë të ndryshme gjatë periudhave historike. Elementet e përbashkëta më dominante janë orientalizmat (turqizmat) dhe anglizmat. Numri i anglizmave nga dita në ditë shkon gjithmonë duke u rritur, kurse i turqizmave dhe i maqedonizmave duke u zvogëluar.

Së fundi mund të themi se, edhe përkrah ndërndikimeve të shumta gjuhësore që kanë përjetuar në periudha të ndryshme historike dhe politike-shoqërore të folmet e Strugës, përsëri secila gjuhë ka arritur që ta ruajë formën dhe veçantinë e vet, sidomos e folmja shqipe i është afruar edhe më shumë strukturave dhe shprehjeve të gjuhës standarde shqipe.

### Abstrakti:

Shpeshherë duke vjelë materiale gjuhësore në terren ballafaqohemi me dukuri të llojllojshme gjuhësore dhe jashtëgjuhësore, të cilat ndonjëherë edhe nuk mund t'i zbërthejmë. Por duke i hulumtuar më thellësisht shkaqet dhe pasojat e atyre dukurive, zbulojmë se sa tinëzisht janë pleksur njëra me tjetrën, kurse fuqia e tyre ndikuese përcakton fatin dhe evoluimin e mëtutjeshëm të gjuhës.

Studimi i interferencës ndërgjuhësore dhe ndërkulturore është mjaft i ndërlikuar. Ndërthurja gjuhësore dhe kulturore në territore ku bashkëjetojnë për shumë kohë disa gjuhë dhe kultura është e pashmangshme dhe varet nga shumë faktorë politikë, shoqërorë, ekonomikë, ideologjikë etj., dhe vështirë mund të përcaktohet cila gjuhë, në çfarë mase, kur dhe pse ka ndikuar mbi gjuhën tjetër.

Të flasësh për ndërndikimet gjuhësore në vendbanime ku përdoren më shumë se dy gjuhë, do të thotë të bëhet një vështrim më i thelluar mbi të gjitha fushat e jetës dhe bashkëjetesës së popujve të cilët përfaqësojnë një tërësi. Një rast të këtillë kemi në Strugë ku bashkëjetojnë shqipja, maqedonishtja, turqishtja, arumanishtja dhe gjuha rome. Megjithatë, në rrjedhë të kohës kanë pasur ndikim edhe nga latinishtja, greqishtja, turqishtja, gjuhët neolatine e së fundi nga anglishtja. Në këtë kumtesë do t'i ftillojmë pikërisht këto ndikime ndërgjuhësore dhe ndërkulturore në të folmen urbane të Strugës, të cilat kanë rëndësi për sociolinguistikën, psikolinguistikën, etnografinë e të folurit, dialektologjinë etj.

Kjo analizë është bërë në Strugë te: 1. folësit njëgjuhësh (me shqipen gjuhë amtare); 2. folësit dygjuhësh, që dinë: a) shqip e maqedonisht, b) shqip – anglisht, c) shqip – turqisht. 3. folësit shumëgjuhësh, që

flasin: a) shqip – turqisht – maqedonisht, b) shqip – maqedonisht – anglisht, c) shqip – turqisht – maqedonisht – anglisht.

Fjalët çelës: bashkëjetesë, leksiku, ndërndikim, gjuhë, kulturë, faktorë.

**Abstract:**

Often, while collecting linguistic materials in the field, we are faced with various linguistic and extra-linguistic phenomena, which sometimes we cannot even analyze. But by researching more deeply the causes and consequences of those phenomena, we discover how secretly they are intertwined with each other, whereas their influencing power determines the fate and further evolution of the language.

The study of cross-linguistic and cross-cultural interference is quite complicated. Linguistic and cultural intermingling in territories where several languages and cultures coexist for a long time is inevitable and depends on many political, social, economic, ideological factors, etc., and it is difficult to determine which language, to what extent, when and why it has influenced over the other language.

Talking about linguistic interferences in settlements where more than two languages are used means taking a deeper look at all areas of life and coexistence of peoples who represent a whole. There is such a case in Struga, where Albanian, Macedonian, Turkish, Vlach and Romani languages coexist. However, in the course of time they were also influenced by Latin, Greek, Turkish, Neo-Latin languages and finally by English. In this paper, we will focus on exactly these interlinguistic and intercultural influences in the urban speech of Struga, which are important to sociolinguistics, psycholinguistics, ethnography of speech, dialectology, etc.

This analysis was conducted in Struga for: 1. monolingual speakers (with Albanian as their mother tongue); 2. bilingual speakers, who speak: a) Albanian and Macedonian, b) Albanian - English, c) Albanian - Turkish. 3. multilingual speakers, who speak: a) Albanian – Turkish – Macedonian, b) Albanian – Macedonian – English, c) Albanian – Turkish – Macedonian – English.

Key words: coexistence, lexicon, interaction, language, culture, factors.

## Bibliografia

- Ajeti, I., *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare-sllave*, SF, 4, Tiranë, 1974.
- Basic, Zagar, Tatalovic (2018), *Multiculturalism in Public Policies*, Institute for Social Sciences, Beograd.
- Booth, T (200) *Book review of: Interculturalism, Education and Inclusion*, British Journal of Educational Studies, 51 (4) pp: 432–433.
- Jashar - Nasteva, O., *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, Logos-A, 1998.
- Johanson, Lars, *Discoveries on the Turkish Linguistic Map*, Swedish Research Institute in Istanbul, Publications 5, Stockholm, 2001.
- Kymlicka W, 1955, *Multicultural citizenship a liberal theory of minority rights*, Oxford.
- Nasar Meer & Tariq Modood (2012) *How does Interculturalism. Contrast with Multiculturalism*, Journal of Intercultural Studies, 33:2, 175-196.
- Qamili, A *Psikologjia gjuhësore te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh*, Aktet, Reviste shkencore e Institutit Alb-Shkenca, vëll. III, Nr.4, 2009, Tiranë – Prishtinë – Shkup, 2010.
- Qamili, A., *Variantet shoqërore në të folmet e Strugës dhe ndikimi ndërgjuhësor te folësit njëgjuhësh, dugjuhësh dhe shumëgjuhësh*, (punim magistrature), Shkup, 2008.
- Атанасов, П. *Романско-албански јазични врски*, Годишен зборник на Филолошкиот факултет "Блаже Конески" во Скопје (одделен отпешаток), Скопје, 1997.
- Ахмед, О., *Морфосинтакса на турските говори од охридско-препанскиот регион*, (disertacion doktrate), Скопје, 2004.
- Видоески, Б., *Охридско-струшките говори*, Прилози, IX, 1, МАНУ, Скопје, 1984.
- Тошев, К., *Струшкиот говор (според некои материјали од XIX век)*, кн.12, Скопје, 1979.
- Ќамили, А. *Албанско-македонско-турските јазични врски според Оливера Јашар-Настева и денес*, Меѓународна научна конференција „100 години од раѓањето на акад. Оливера Јашар-Настева“ (лингвистика-балканистика-македонистика), Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Филолошки факултет „Блаже Конески“, Скопје, 25-26.11.2022, (објавено во декември 2023).
- Ќамили, А. *Јазични контакти на балканските простори*, Годишен зборник на универзитетот "Св. Кирил и Методиј" во Скопје, Филолошки факултет "Блаже Конески", Книга 33, Скопје, 2007.
- Фридман, В., *Адмиративот во балканските јазици*, МЈ, XXX, Скопје, 1980.

Sejdi M. GASHI

Instituti Albanologjik-Prishtinë

e-mail: [sgashi.iap@gmail.com](mailto:sgashi.iap@gmail.com)

**ROLI I MEDIEVE NË (MOS) NGRITJEN E PRESTIGJIT TË SHQIPES  
(GJUHA SI IDENTITET PERSONAL E NACIONAL)**

Улогата на медиумите во (не) подигнувањето на престижот на албанскиот јазик (јазикот како личен и национален идентитет)  
The role of the media on (not) increasing the prestige of the Albanian language (language as personal and national identity)

Hyrje

Gjuha si identitet personal e nacional

Gjuha shqipe është përbërësi kryesor i identitetit tonë kombëtar shqiptar. Nëpërmjet gjuhës pasqyrohet urtësia e një populli dhe roli i saj është i pazëvendësueshëm në komunikimin shoqëror. Por gjatë ardhjes së saj nga mijëvjeçari në mijëvjeçar, nga shekulli në shekull, ajo ka njohur procese dhe zhvillime të panumërta, herë duke u pasuruar e herë duke u kërcënuar për t'u asimiluar nga gjuhët pushtuese që, po kështu, kanë qenë të panumërta. Vështruar nga ky fillim-shekulli jemi dëshmitarë që gjuha shqipe u qëndroi rrebesheve dhe sot ajo është një gjuhë e gjallë, me disa variante diatopike dhe me një variant standard që është i përpunuar në të gjitha nënsistemet; është e hapur si të gjitha gjuhët standarde të popujve të tjerë për prurje të gjithanshme, sidomos nga të folmet dialektore dhe nga gjuhët e tjera, sidomos nga ato ndërkombëtare që kanë status të ngritur dhe trysnues, si fjala vjen anglishtja, frëngjishtja, italishtja etj. Së këndejmi, Prof. J. Thomai thekson se "burimet e plotësimit e të pasurimit të shqipes standarde sot mbeten po ato që njihen në historinë e zhvillimit të saj, si edhe për gjuhët e tjera. Nga burimi i fundit (huazimi) po i vjen shqipes standarde sot një valë e madhe fjalësh, forca e së cilave shumëfishohet nëpërmjet ndërthurjes së huazimit me neologjinë; kështu, me të hyrë fjala *amendment*, krijohen në shqipe (edhe sipas modeleve të gjuhës së huaj)

rrjedhojat *amendamentoj*, *amandamentim*, *i amandamentuar* etj. Madje ka krijime analogjike si: nga *opozitë* është krijuar me prapavajtje në shqipe një fjalë e përçudnuar me kuptim të kundërt *pozitë*, që s'e gjen në asnjë gjuhë, as në gjuhën huazuese të fjalës *opozitë*; nga *dakord* krijohet *dakordohem* e *dakordim* etj. Kjo do të thotë që është e nevojshme "të mbahet nën kontrollin shkencor" formimi i fjalëve në gjuhën shqipe. Mund të thuhet gjithashtu se fjalët e këtij burimi (huazimet) janë edhe më të paqëndrueshmet, për shkak të mënjanimet të vetëvetishëm a të vetëdijshëm (f.v. kredibilitet e besueshmëri, fushata elektorale e fushata zgjedhore, organet lokale e organet vendore, komisione parlamentare e komisione kuvendore etj.)"<sup>48</sup>.

Shqipja sot realizohet në të gjitha ligjërimet e stilet, sepse ajo ka një pasuri të madhe leksiko-semantike. Megjithatë, jo të gjithë e përdorim njëllor gjuhën, sipas parimeve e pa ngarkesa të panevojshme dhe kjo natyrisht, së pari, bëhet për arsye subjektive, që vijnë prej formimit të pamjaftueshëm gjuhësor, sidomos njohjes së pamjaftueshme të leksikut të shqipes nga njëra anë dhe mungesës së kulturës gjuhësore në anën tjetër. "Prandaj, sot gjejmë në ligjërimet të ndryshme, sidomos në medie etj., një mori fjalësh të huaja të përdorura vend e pa vend, struktura të prishura sintaksore, fjalë e fjali pa kuptim, duke i shtuar kësaj edhe një qëndrim, sipas të cilit ai që përdor fjalë të huaja, sidomos nga anglishtja, frëngjishtja, italishtja etj., di të flasë bukur. Por paragjykohe ata që, fjala vjen, përdorin fjalën *saba* në vend të *mëngjes*, *penxhere* në vend të *dritare* etj."<sup>49</sup>

Shembuj të shtrembërimit të gjuhës dhe të përdorimit të pavend të fjalëve të huaja gjenden pa shumë mundim si në mediat e Kosovës, ashtu edhe në ato të Shqipërisë. Nga kjo pakujdesi e gazetarëve, lexuesi, shikuesi, apo dëgjuesi has çdo ditë fjalë të tilla si: *agravoj*, *neutralizoj*, *konfuz*, *implementim*, *sensitiv*, *involvoj*, *adaptim*, *adoptoj*, *disponibël*, *top listë*, *interferoj*, *akomodohem*, *frustrim*, *lançoj*, *startoj*, *impakt*, *suport* etj., të gjitha të panevojshme, po të kihet parasysh se i kemi barasvlerëset në shqipe për secilën prej fjalëve të mësipërme: për *agravoj* kemi *rëndoj*, për *konfuz* kemi *i pështjelluar*, (*i ngatërruar*), për *sensibël* kemi *i ndjeshëm*, për *involvoj* kemi *përfshij* e kështu me radhë.

### Huazimet terminologjike

Përdorimi i huazimeve terminologjike e vendos problemin e terminologjisë gjuhësore si një marrëdhënie midis traditës së ngulitur kombëtare dhe teorive të reja gjuhësore. Kjo marrëdhënie shfaqet dyfish: si një

<sup>48</sup> Shih më gjerë J. Thomai. *Probleme të leksikut në shqipen standarde*, në aktet e "Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 3-4 tetor 2011.

<sup>49</sup> M. Zaçellari, *Vështrim rreth disa çështjeve mbi pastërtinë e gjuhës shqipe*, Gjuha shqipe I, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 2021.

mësymje e gjuhës së huaj në sistemin e gjuhës pritëse, në rastin tonë të shqipes, dhe si mësymje kulturore e një teorie të re, koncepteve të reja<sup>50</sup>.

Terminologjia e huaj ka vërshuar, sidomos në fushat e dijes, ku kuptimet leksikore janë prurje të reja bashkë me elementet që ato emërtojnë. Sot, edhe gjuha e administratës, e medias, janë bërë vatra kryesore e lindjes dhe e përdorimit të këtyre termave. Ato janë bërë pjesë e fondit aktiv të shqipes, aq shumë sa, siç shprehet edhe studiuesi Qemal Murati “*me fjalët e me shprehjet e përdorura gabim vlojnë... gjuha e administratës dhe e veprimtarive të tjera shoqërore e publike, saqë me një lëndë të tillë mund të hartohet dhe një“fjalor i gabimeve gjuhësore*<sup>51</sup>”.

Në këtë pjesë të studimit do të hedhim një vështrim mbi një çështje me rëndësi, siç është ajo e cilësisë së gjuhës shqipe të përdorur në medie dhe rolit të jashtëzakonshëm të medias për ngritjen e prestigjit të shqipes.

Si rregull, pasurimi i çdo sistemi terminologjik më së shpeshti kryhet me qëllim të plotësimit të boshllëqeve, pra kur sistemi ka nevojë për një term të ri. Në rastin e mungesës në sistemin leksikor të gjuhës marrëse të fjalëve që ekzistojnë në një terminologji të huaj, ndodh që të lindë nevoja për të krijuar një term të ri.

Ekzistojnë dy mënyra që huazimet të depërtojnë në gjuhën marrëse. Së pari, përmes gjuhës së folur, që është kryesisht specifike për fazat e hershme të kontaktit gjuhësor. Kjo mënyrë është dëshmuar shumë rrallë në kohën e tanishme në shoqërinë me një sistem të zhvilluar socio-ekonomik. Së dyti, nëpërmjet teksteve të shkruara. Kur huazimet leksikore ndodhin përmes burimeve të shkruara, depërtimi bëhet me anë të:

- 1) terminologjisë speciale
- 2) shtypit
- 3) komunikimit intensiv në formë të shkruar në botën e biznesit
- 4) përkthimit të literaturës së huaj të specializuar.

Më poshtë po japim disa shembuj të huazimeve terminologjike që i kemi vjelë në medie e që i përkasin fushës së ekonomisë:

Asetet - të drejtat pronësore të një subjekti ekonomik për lloje të ndryshme pronash, duke përfshirë fondet në qarkullim.

Aktivete afatgjata- aktivitet e kompanisë që transferojnë vlerën e tyre në produkte për një periudhë që tejkalon një vit, dhe (ose) disa cikle operimi dhe (ose) të formuara për të marrë përfitime afatgjata.

Aktivitet likuide – para të gatshme dhe aktive të tjera që kompania mund t'i konvertojë në para pa humbje të konsiderueshme të vlerës dhe në një kohë të shkurtër, para të gatshme për të përmbushur detyrimet e tyre urgjente.

<sup>50</sup> A. Spiro, *Terminologjia gjuhësore: nga traditat kombëtare te komunikimi i njehsuar ndërkombëtar*, Terminologjia në shkencat e ligjërimit, Elbasan 2014, f. 221-229.

<sup>51</sup> Q. Murati, *Fjalor i gabimeve gjuhësore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 9.

Bilanci (i jashtëm)- bilancin e shoqërive të përpiluara për publikim të jashtëm, pra për aksionerët, kreditorët, publikun dhe organet tatimore.

Vlera kontabël e aksionit- vlera e aksionit, e llogaritur në bazë të vlerës kontabël të kapitalit.

Overdraft bankar- një kredi e dhënë një huamarrësi në një llogari rrjedhëse, e shlyer sipas kërkesës.

Këta dhe shembuj të tjerë në medie dëshmojnë se sa proces dinamik është procesi i huazimit të termave. Analiza e kryer dëshmon se sot futja e termave të rinj në sistemin terminologjik është një proces i pakthyeshem. Pavarësisht fanatizmit të disa studiuesve për "pastërtinë" e gjuhës, duhet pranuar se proceset e vazhdueshme që ndodhin në pasurimin e sistemeve terminologjike janë procese që ndodhin në të gjitha gjuhët e botës, me një trysni të jashtëzakonshme nga gjuhët e mëdha, si anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja etj.

### *Abstrakt*

Zhvillimi i shpejtë i masmedias dhe teknologjive të reja të komunikimit gjatë viteve të fundit, ka ndikuar fuqishëm në gjuhë. Rritja e numrit të mediave tradicionale, si shtypi i shkruar, radio dhe veçanërisht televizioni, solli ndryshime rrënjësore në gjuhë. Pikërisht, kjo rritje e jashtëzakonshme e prodhimit gjuhësor dhe tekstit në sferën e komunikimit masiv në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI u shoqërua me një numër të konsiderueshëm studimesh shkencore që trajtonin aspekte të ndryshme të funksionimit të gjuhës në medie. Këto studime kryesisht fokusohen në karakteristikat e veçanta të teksteve të lajmeve dhe te veçoritë e përdorimit të gjuhës në blogjet e internetit dhe rrjetet sociale. Kjo fushë e re kërkimore me këtë zhvillim kaq dinamik tërhoqi vëmendjen e praktikisht të gjitha degëve të gjuhësisë: sociolinguistikës, psikolinguistikës, gjuhësisë konjitive, studiuesve të analizës së diskursit, gjuhësisë së tekstit, semantikës etj. Kjo krijoi parakushtet për lindjen e një nëndisipline të re të gjuhësisë, asaj të gjuhësisë mediatike, që sot në botë është një fushë në hov të madh zhvillimi. Në fokus të studimit tonë, është pikërisht gjuha e teksteve mediatike. Megjithatë, ne nuk jemi përqendruar te gjuha në tërësi, por kryesisht te terminologjia që përdoret në medie dhe te disa veçori të tyre gjatë përdorimit. Pra, thënë shkurt, me anë të kësaj trajtese kemi bërë përpjekje ta kundrojmë rolin e mediave në (mos) ngritjen e prestigjit të shqipes.

*Fjalët çelësa:* medie, internet, sociolinguistikë, psikolinguistikë, gjuhësi konjitive, analizë e diskursit, gjuhësi e tekstit, semantikë.

*Abstract*

The language has been strongly influenced by the rapid growth of mass media and new communication technologies in recent years. The expansion of traditional media, such as print media, radio, and especially television, has brought about radical changes to the language. Specifically, the remarkable increase in language and text production in the realm of mass communication during the second half of the 20th century and the beginning of the 21st century has been accompanied by numerous scientific studies that investigate various aspects of language functioning in the media. These studies primarily focus on the specific characteristics of news texts, as well as on the peculiarities of language usage in internet blogs and social networks. This new field of study, with such a dynamic development, has captured in reality the attention of all branches of linguistics: sociolinguistics, psycholinguistics, cognitive linguistics, discourse analysis researchers, text linguistics, semantics, etc. This was a prerequisite for a new sub-discipline of linguistics to emerge, known as media linguistics, which is currently experiencing significant growth and development. Our study was specifically focused on the language utilized in media texts. However, our primary focus lies not on the language itself, but rather on the terminology employed in the media, and on the certain aspects of its usage. In summary, this research paper aims to examine the role of the media on (not) increasing the prestige of the Albanian language.

*Key words:* media, Internet, sociolinguistics, psycholinguistics, cognitive linguistics, discourse analysis, text linguistics, semantics.

## Literatura

Aristotel Spiro, *Terminologjia gjuhësore: nga traditat kombëtare te komunikimi i njehsuar ndërkombëtar*, Terminologjia në shkencat e ligjërimit, Elbasan 2014, f. 221-229.

Grup autorësh, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

Jani Thomai, *Probleme të leksikut në shqipen standarde*, në aktet e "Seminarit V Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, 3-4 tetor 2011.

Manjola Zaçellari, *Vështrim rreth disa çështjeve mbi pastërtinë e gjuhës shqipe*, në "Gjuha shqipe", 1/2021, Instituti Albanologjik-Prishtinë.

Qemal Murati, *Fjalor i gabimeve gjuhësore*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 2004.



**Agron VRANGALLA**  
Universiteti "Nënë Tereza", Shkup  
[agron.vrangalla@unt.edu.mk](mailto:agron.vrangalla@unt.edu.mk)

**ANALIZË KRITIKE E DISKURSI:**  
**GJUHA E ALBIN KURTIT NË INTERVISTËN E DHËNË PËR CNN (31 MAJ)**

Анализа на критичкиот дискурс: Јазикот на Албин Курти во интервјуто за CNN (31 Мај)  
Critical discourse analysis: The language of Albin Kurti in the interview given to CNN (May 31)

Hyrje

Bindja si koncept funksionon përmes njerëzve të tjerë, të cilët mund të çojnë përpara ose të pengojnë interesat dhe objektivat e caktuara. Kur dikush flet diçka, përpiket të ndikojë në atë se si të tjerët i shohin gjërat, si ndihen, si besojnë dhe si veprojnë në përgjigje të asaj që mësojnë. Folësi mund të mos ketë gjithmonë sukses, as nuk duhet të ketë gjithmonë sukses. Pikëpamjet e tjera mund të jenë më bindëse, në varësi të dëgjuesit, situatës dhe meritave të rastit. Por të paktën folësit e mirë, mund t'u japin ideve të tyre një mundësi për t'u dëgjuar nga të tjerët.

Bindja mund të jetë etike ose jo etike, vetëmohuese ose egoiste, frymëzuese ose degraduese. Bindësit mund të na ndriçojnë mendjen ose të prekin dobësinë tonë. Megjithatë, bindja etike bazohet në arsyetim të shëndoshë dhe është e ndjeshme ndaj nevojave dhe interesave të dëgjuesve. E për të qenë një bindës i mirë, duhet poseduar aftësi të jashtëzakonshme të të folurit dhe paraqitjes në publik, pra gjuhën e gojës, gjuhën e fytyrës dhe gjuhën e trupit.

Liderët politik zakonisht presupozohet të jenë folës të mirë. Ata janë personat që duhet të elektrizojnë masën me fjalimet e tyre por edhe me paraqitjet apo "aurën" e tyre. Vetë publiku, pra qytetari, është mësuar të ketë një lloj pritshmërie të madhe karshi një politikani kur ai i drejtohet atij publiku. "Kjo njohje e marrëdhënies themelore midis gjuhës dhe politikës mund të gjurmohet në traktatet klasike greke dhe romake mbi retorikën.

Për shkak të rolit jetik të oratorisë politike që luante në punët e shtetit, Aristoteli e shihte artin e retorikës si çelës për qytetarinë gjatë ngritjes së qytet-shtete në Greqinë e lashtë. Ciceroni, po ashtu, e kuptoi retorikën si një armë të fuqishme politike për formimin e besimit dhe veprimtimit politik. Në të vërtetë, ishte arti i retorikës ai që u mundësoi njerëzve të jetonin dhe të angazhoheshin në jetën e qytetëruar.” (Dunmire, 2012, pp. 735–751).

Analiza Kritike e Diskursit është një lloj analize e ligjërimit. Midis studimeve të ndryshme të Analizës Kritike të Diskursit, fokusi i studiuësve u vendos jo vetëm mbi atë që quhet gjuhë, por edhe mbi rrethanat që gjuha paraqitet si një gjendje e tillë. “Me fjalë të tjera, Analiza Kritike e Diskursit përpiqet të eksplorojë kuptimin e ligjërimit dhe se si një lloj i tillë kuptimi prodhohet nga ligjërimi. Nëpërmjet nivelit sipërfaqësor të formës gjuhësore, Analiza Kritike e Diskursit synon të zbulojë ndikimin e ideologjisë në ligjërimit, ndikimin kundërveprues të ligjërimit mbi ideologjinë dhe se si këto dy elemente rrjedhin dhe shërbejnë për strukturën shoqërore dhe marrëdhëniet me pushtetin. Me një fjalë, synon të zbulojë marrëdhëniet midis gjuhës, ideologjisë dhe pushtetit”. (Ke Liu, Fang Guo, 2016, pp. 1076-1084).

Duke u nisur nga disa përvoja shkencore të përmendura më sipër, do të bëhet një analizë diskursive e një interviste të kryeministrit aktual të Kosovës, Albin Kurti, dhënë për televizionin ndërkombëtar CNN International. Ideja e kësaj analize nuk ka të bëjë me rrethanat politike apo me raportin Kosovë-Serbi. Ajo çka është në interes të analizës, lidhet me gjuhën dhe retorikën e përdorur të Albin Kurtit në këtë intervistë.

### Bindja dhe gjuha e politikës

Për të ndërtuar argumente të forta, bindësit duhet të zhvillohen prova të fuqishme. Provat mund të prekin reagimet emocionale të dëgjuesve, mund të bazohen në trashëgiminë e tyre shoqërore e shpirtërore ose mund të bazohen në cilësitë e lidershit personal të folësve në përpjekje për të ndikuar tek njerëzit. Natyra e provës është studiuar që nga Epoka e Artë e Greqisë.

Në *Retorikën* e tij, Aristoteli identifikoi tre forma të provës. E para, logos, pranon se ne i përgjigjemi arsyes. Të paktën na pëlqen të mendojmë se jemi krijesa të arsyeshme. E dyta, patosi, pohon se ne mund të prekemi nga thirrjet ndaj ndjenjave personale si frika, keqardhja dhe zemërimi. Forma e tretë, etosi, pranon se ne i përgjigjemi perceptimeve tona për kompetencën, karakterin, vullnetin e mirë dhe dinamizmin e folësit. Kur këto cilësi duken pozitive, ne duam të pajtohemi me folësit. Kur këto cilësi duken negative ose mungojnë, folësit do ta kenë të vështirë të na fitojnë. (Michael Osborn, Suzanne Osborn, Randall Osborn, 2009, p. 373).




Figura 1. Modeli i komunikimit publik sipas Aristotelit

Fjala *etikë* rrjedh nga fjala greke *ethos*. Në fakt, kjo fjalë përdoret për të nënkuptuar diçka si besueshmëri ose reputacion. Megjithatë, ajo kishte një kuptim më të madh në Greqinë e Lashtë. Folësi ishte i lidhur pazgjidhshmërisht me komunitetin. Për Aristotelin, një folës tregon moralin duke ndarë një lidhje me të tjerët në komunitet - domethënë, dikush që ka sens të mirë, vullnet të mirë dhe moral të mirë. (German, 2017, p. 33)

Udhëheqësit mund të përshkruhen nga llojet e sjelljes, ose stilet e udhëheqjes, që ata shfaqin ndërsa ndikojnë në grup për të ndihmuar në arritjen e qëllimit të tyre. Kur liderët thirren për të udhëhequr, apo japin urdhra dhe presin që të tjerët t'i ndjekin; apo kur lideri i kërkon grupit të votojë për rrjedhën e veprimit që duhet ndjekur; ose ndoshta kur lideri nuk përpiqet fare të ndikojë në grup. Ndoshta ky lloj lideri preferon të rri dhe ta lej grupin të zgjidhë problemet e veta. Këto strategji përshkruajnë tre stilet e përgjithshme të liderit: autoritar, demokratik dhe liderit neutral. (Steven A. Beebe, Susan J. Beebe, 2015, p. 443). Liderët autoritarë marrin pozita epërsie, duke dhënë urdhra dhe duke marrë kontrollin e veprimtarisë së grupit. Liderët demokratik kanë më shumë besim në grupet e tyre sesa udhëheqësit autoritarë, ata përfshijnë anëtarët e grupit në procesin e vendimmarrjes në vend që të diktojnë se çfarë duhet bërë. Ndërsa liderët e neutral u lejojnë anëtarëve të grupit liri të plotë në të gjitha aspektet e procesit të vendimmarrjes. Ata bëjnë pak për të ndihmuar grupin të arrijë qëllimin e tij. Ky stil udhëheqjeje (ose jo-udhëheqjeje) shpesh e lë një grup të frustruar sepse i mungon udhëzimi dhe duhet të luftojë me organizimin e punës. (Steven A. Beebe, Susan J. Beebe, 2015, pp. 443-444).

### Gjuha e politikës

Politika ndryshon sipas situatës dhe qëllimeve të dikujt. Kjo në vetvete është një përgjigje politike. Por nëse merren parasysh përkufizimet, të nënkuptuara dhe të qarta, të gjetura si në studimin tradicional të politikës

ashtu edhe në studimet e ligjërimit të politikës, ka dy fije të gjera. Nga njëra anë, politika shihet si një luftë për pushtet, midis atyre që kërkojnë të pohojnë dhe ruajnë pushtetin e tyre dhe atyre që kërkojnë t'i rezistojnë. Disa shtete bazohen në mënyrë të dukshme në betejat për pushtet; nëse demokracitë në thelb janë të konstituara kjo është e diskutueshme. Nga ana tjetër, politika shihet si bashkëpunim, si praktikë që ka një shoqëri për zgjidhjen e përplasjeve të interesit për paratë, ndikimin, lirinë e të ngjashme.

“Fjalimi, nga ana tjetër, shërben për të treguar se çfarë është e dobishme dhe çfarë është e dëmshme, si dhe çfarë është e drejtë dhe çfarë është e padrejtë. Sepse ndryshimi i vërtetë midis njeriut dhe kafshëve të tjera është se vetëm njerëzit kanë perceptim të së mirës dhe të keqes, të drejtës dhe të padrejtës, etj.” (Aristotle, 1992)

Natyrisht, aftësia e individëve për të pasur një ndjenjë të së drejtës dhe të padrejtës mund të nënkuptojë se mund të ketë po aq opinione sa ka individë. Një gjendje e tillë ndoshta nuk do të korrespondonte me atë që dikush e kupton si politikë. Prandaj, nuk është për t'u habitur, pika e fundit e Aristotelit në këtë pjesë domethënëse, është se kemi të bëjmë me një pikëpamje të përbashkët në këto çështje, pra çfarë është e dobishme dhe e dëmshme, e drejtë dhe e padrejtë, etj. që bën një familje dhe një shtet.

Është e qartë se veprimtaria politike nuk ekziston pa përdorimin e gjuhës. Është e vërtetë, siç u përmend më herët, që përfshihen sjellje të tjera dhe, në veçanti, detyrimi fizik. “Por bërja e politikës konstituohet kryesisht në gjuhë. Në të kundërt, është gjithashtu e diskutueshme rasti që nevoja për gjuhë (ose për përpunimin kulturor të instinktit gjuhësor) lindi nga socializimi i njerëzve që përfshin formimin e koalicioneve, sinjalizimin e kufijve të grupeve dhe gjithçka që nënkuptojnë këto zhvillime, duke përfshirë shfaqjen e asaj që quhet altruizëm reciprok. Sigurisht, kjo nuk do të thotë se gjuha lind ekskluzivisht nga këto motive ose funksione.” (Chilton, 2004, p. 7)

Qëllimi kryesor i politikanëve është të bindin audiencën e tyre për vlefshmërinë e pretendimeve të tyre politike. Ndikimi politik rrjedh nga përdorimi i burimeve që formësojnë besimet dhe sjelljet e të tjerëve. Burimet e zakonshme përfshijnë aftësitë e ekspertëve, kufizimin e informacionit, aftësinë për t'u dhënë favore të tjerëve ose për t'i lënduar ata të pamundurit. Edelman (1977) shprehet se politikani i ditur bëhet i suksesshëm duke “përdorur njohuritë e tij/saj për ndikimin informal” (Edelman, 1977, p.123).

Presupozimet janë supozime të sfondit të ngulitura brenda një fjalie ose fraze. Këto supozime merren si të mirëqena, si të vërteta, pavarësisht nëse e gjithë fjalia është e vërtetë. Një teknikë e tillë është veçanërisht e dobishme në diskursin politik, sepse mund ta bëjë më të vështirë për audiencën të identifikojë ose refuzojë pikëpamjet e komunikuara në këtë mënyrë, duke i bindur njerëzit të marrin si të mirëqenë diçka që në fakt është e hapur për debat. Ashtu si supozimet, nënkuptimet e shtyjnë

dëgjuesin të konkludojë diçka që nuk është pohuar në mënyrë eksplicite nga folësi. Megjithatë, ndryshe nga presupozimet, këto funksionojnë mbi më shumë se një frazë ose fjali dhe varen shumë më tepër nga njohuritë e përbashkëta ndërmjet folësit dhe dëgjuesit dhe nga konteksti i diskursit (Jones dhe Peccei, 2004, p.44).

### Qasje teorike mbi Analizën Kritike të Diskursit

Analiza kritike e diskursit (Critical Discourse Analysis) është një hulumtim analitik i diskursit që studion kryesisht mënyrën se si abuzimi dhe pabarazia e pushtetit social zbatohen, riprodhohen, legjitimohen dhe rezistohen nga teksti dhe biseda në kontekstin social dhe politik. Me një hulumtim të tillë disident, analistët kritikë të diskursit marrin një pozicion të qartë dhe kështu duan të kuptojnë, ekspozojnë dhe përfundimisht sfidojnë pabarazinë sociale. Kjo është edhe arsyeja pse CDA mund të karakterizohet si një lëvizje shoqërore e analistëve të diskursit të angazhuar politikisht. (Dijk, 2015, pp. 466-485)

Si një praktikë analitike, CDA nuk është një drejtim i kërkimit midis shumë të tjerave në studimin e ligjërimit. Përkundrazi, është një perspektivë kritike që mund të gjendet në të gjitha fushat e studimeve të ligjërimit, si gramatika e ligjërimit, analiza e bashkëbisedimit, pragmatika e ligjërimit, retorika, stilistika, analiza narrative, analiza e argumentimit, analiza e diskursit multimodal dhe semiotika sociale, sociolinguistika, dhe etnografia e komunikimit ose psikologjia e përpunimit të ligjërimit, ndër të tjera. Me fjalë të tjera, CDA është studim diskursi me një qëndrim.

Përveç këtyre ndikimeve kontekstuale në interpretim, Analiza Kritike e Diskursit fokusohet veçanërisht në mënyrat se si strukturat e ligjërimit mund të ndikojnë në modele specifike mendore dhe përfaqësime gjenerike të marrësve, dhe veçanërisht në mënyrën se si besimet mund të manipulohen në këtë mënyrë (van Dijk 1984, 1991, 1993).

Teun A. van Dijk (2006) vëren se "situatat politike nuk i bëjnë thjesht aktorët politikë të flasin në mënyra të caktuara, përkundrazi "ka nevojë për një bashkëpunim kognitiv midis situatave dhe bisedës ose tekstit, që është një kontekst" (Van Dijk, 2006, p. 733). Kontekste të tilla përcaktojnë se si pjesëmarrësit përjetojnë, interpretojnë dhe përfaqësojnë për ta aspektet përkatëse të situatës politike. Diskursi politik nuk përkufizohet vetëm me strukturat e ligjërimit politik, por edhe me kontekstet politike. Kështu, të vepruarit si deputet, kryeministër, lider partie ose demonstrues zakonisht do të perceptohet nga folësit ose marrësit si një kategori e kontekstit përkatës në diskursin politik.

Një analizë gjuhësore e ligjërimit politik në përgjithësi, dhe e fjalimeve politike në veçanti, mund të jetë më e suksesshme kur lidh detajet e sjelljes gjuhësore me sjelljen politike. Kjo mund të bëhet nga dy këndvështrime: mund të fillojmë nga niveli mikro gjuhësor dhe të pyesim se cilat funksione strategjike shërbejnë për të përmbushur strukturat specifike (p.sh. zgjedhja

e fjalëve, një strukturë sintaksore specifike). Përndryshe, mund të nisemi nga niveli makro, pra situata komunikuese dhe funksioni i një teksti dhe të pyesim se cilat struktura gjuhësore janë zgjedhur për të përmbushur këtë funksion. Përdorimi i gjuhës, ligjërimi, ndërveprimi verbal dhe komunikimi i përkasin nivelit mikro të rendit shoqëror. Fuqia, dominimi dhe pabarazia ndërmjet grupeve shoqërore janë zakonisht terma që i përkasin një niveli makro të analizës.

Duke pasur parasysh fuqinë e ligjëritimit të shkruar dhe të folur, Analiza Kritike e Diskursit mund të përdoret për të përshkruar, interpretuar, analizuar dhe kritikuar jetën shoqërore të pasqyruar në tekst. CDA synon të eksplorojë sistematikisht marrëdhëniet midis praktikave, teksteve dhe ngjarjeve diskursive dhe strukturave, marrëdhënieve dhe proceseve më të gjera sociale dhe kulturore. Analizat e sakta dhe përshkrimet e materialitetit të gjuhës janë faktorë që janë gjithmonë karakteristikë për CDA (Critical Discourse Analysis). Ajo përpiket të eksplorojë se si këto marrëdhënie jo-transparente janë një faktor në sigurimin e pushtetit dhe hegemonisë, dhe tërheq vëmendjen ndaj pabarazive të pushtetit, pabarazive sociale, praktikave jodemokratike dhe padrejtësive të tjera me shpresën për të nxitur njerëzit drejt veprimeve korrigjuese (Fairclough, 1992). Kjo lloj analize përpiket të ndriçojë mënyrat në të cilat forcat dominuese në një shoqëri ndërtojnë versione të realitetit që favorizojnë interesat e tyre. Kjo do të thotë se CDA teorikisht mund të kapërcejë hendekun midis qasjeve mikro dhe makro, që është një dallim, një konstrukt sociologjik më vete (Van Dijk, 2003, p.354).

Natyrisht se një analizë e këtij lloji do të ishte tepër sfiduese për studuesit e rinj, pasi që ajo kërkon një përvojë dhe njohuri multidisiplinare që e kanë vetëm ata autorë të cilët janë marrë më gjatë me lëvrimin e kësaj fushe. Megjithatë, më poshtë do të merret një shembull modest me një përpjekje modeste për të parë diskursin politik të përdorur nga ana e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit në një paraqitje të tij për një publik ndërkombëtar.

Analizë Kritike e Diskursit mbi gjuhën e Albin Kurtit në intervistën e tij për CNN

Situata në veri të Kosovës ngjalli reagime të shumta në opinionin publik kombëtar e ndërkombëtar. Fërkimet atje janë pothuajse të përhershme, mirëpo ato u intensifikuan pas zgjedhjeve të parakohshme lokale. Pas tensioneve mes serbëve nga njëra anë dhe policisë së Kosovës dhe KFOR-it nga ana tjetër, situata mori përmasa ndërkombëtare. Përfaqësuesit e Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian e vlerësuan si tepër shqetësues këtë moment.

“Përplasjet mes serbëve në veri të Kosovës dhe policisë nisën më 26 maj, ditën që kryetarët shqiptarë të 3 komunave, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok do të merrnin zyrtarisht detyrën. Ndërsa kryetari i komunës së

Mitrovicës së Veriut ishte betuar më herët. Pas qetësisë që solli fundjava, tensionet u rikthyen të hënën e 29 majit, kur për të garantuar sigurinë në terren u stacionuan edhe forcat e KFOR-it. Tensionet kulmuan me plagosjen e 30 ushtarëve të KFOR-it, 19 nga kontingjenti hungarez dhe 11 nga ai italian. Serbët lokalë kërkojnë që të ndalohen kryetarët e rinj shqiptarë të hyjnë në ndërtesat e komunave dhe që njësitë speciale të Policisë së Kosovës të tërhiqen nga veriu i banuar me shumicë serbe”.(Shqiptarja.com)

Në vazhden e zhvillimeve në veri të Kosovës, kryeministri Kurti u gjend përballë një sfide jashtëzakonisht të madhe. Në pamje të parë dukej sikur të gjithë janë kundër tij, duke përfshirë këtu Serbinë në radhë të parë, më pas të gjithë partitë opozitare në Kosovë, mediat, opinionistët, Tirana zyrtare, dhe ajo që është më shqetësuesja, edhe përfaqësuesit ndërkombehtarë dukej se janë kundër tij. Kurti, i mbështetur për muri, nuk lëshonte pe për asnjë çmim, duke u përballur me një lumë kritikash. Artikulimi i tij në prononcimet publike dukej i fortë dhe i pakthyeshëm.

Në intervistën e dhënë për CNN International, me gazetaren Isa Soares më 31 maj, kryeministri Kurti i bëri të qarta qëndrimet e tij për të gjithë publikun ndërkombëtar. Gjëja e parë që bie në sy në këtë intervistë e cila zgjat tetë minuta, është postura e tij karshi kamerës. Vërehet një qëndrim prej një lideri të fortë i cili e ka shumë të qartë se çfarë dëshiron. Kjo është përshtypja e pamjes dhe nuk lidhet domosdoshmërisht me atë që mendon Kurti në të vërtetë si dhe me atë se si mund të jetë ai në jetën pa kamera. Duke qenë mirë i artikulueshëm në gjuhën angleze, Kurti gëzon avantazhin të justifikojë qartësisht veprimet e ndërmarra politike.

### *Marrëdhënia me pushtetin*

Kryeministri Kurti pasqyron një vetëbesim të madh gjatë paraqitjeve të tij publike. Një ndër arsytet për këtë vetëbesim mund të jetë fitorja plebishitare në zgjedhje dhe mbështetja e madhe që ka te elektorati. Ai di të shfaqet bindës karshi publikut, pavarësisht situatave të krijuara siç është ajo me përplasjet në veri të Kosovës. Fairclough (1995) thekson se si gjuha përdoret për të ushtruar dhe mbajtur pushtetin në diskursin politik, duke u fokusuar në mënyrën se si përdoren strategjitë gjuhësore për të legjitimuar autoritetin dhe për të kontrolluar opinionin publik.

van Dijk nënvizon shqyrtimin e marrëdhënieve të pushtetit përmes gjuhës, me fokus në mënyrën se si aktorët politikë manipulojnë ligjërimin për të rritur dominimin e tyre dhe për të marginalizuar grupe ose perspektiva të caktuara (van Dijk, 2001, pp. 352-371). Ja si duket pjesa e përgjigjes së parë të kryeministrit në këtë intervistë:

Isa Soares, gazetar e CNN: Donim të merrnim perspektivën e Kosovës për këtë situatë shumë të tensionuar që pat atje. Tashmë na bashkohet edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai sonte është në Prishtinë. Kryeministër, faleminderit shumë që gjetët kohën për të folur me ne këtë

mbrëmje. Prej disa kohësh tensionet po ziejnë në veri. Thjesht shpjegoni shikuesve tanë, Kryeministër, nëse mundeni, pse vendosët të dërgoni forcat e policisë dhe njësitë policore në veri të vendit. Pse menduat se ishte e nevojshme?

Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës: ...unë dua të kemi paqe dhe siguri, por besoj se demokracia dhe sundimi i ligjit janë rruga përpara. Nuk është e mundur që në ndërtesat komunale të mos ketë kryetar të zgjedhur. Pushteti në Kosovë nuk mund të fitohet me goditje-bomba, me krime dhe me dhunë, por se vetëm me zgjedhje. (CNN, 2023)

Në pjesën e kësaj përgjigjeje, Kurti tregon katër elemente: paqen dhe sigurinë, demokracinë dhe sundimin e ligjit, legjitimitetin e kryetarëve të zgjedhur në komunat përkatëse, dhe se pushteti në Kosovë nuk merret me dhunë por me zgjedhje të lira.

Thënë ndryshe, në çdo fjalë të tij, ai nuk jep thjeshtë përgjigje por shfaq koncepte. Koncepte politike që po të merreshin të analizohen si të ndara, me siguri që do të duhej një studim i gjerë e i thelluar.

### *Ideologjia*

Fairclough (1995) diskuton rolin e ideologjisë në diskursin politik, duke theksuar se si gjuha ndërton dhe përforcon botëkuptimet, vlerat dhe besimet specifike, shpesh duke promovuar ideologjitë dominuese duke marginalizuar pikëpamjet alternative. Ndërsa Wodak dhe Meyer (2009) theksojnë hetimin e dimensioneve ideologjike në diskursin politik, duke synuar të zbulojë ideologjitë e fshehura dhe të sfidojë diskurset dominuese.

Në të njëjtën pyetje të gazetares (pyetja e parë), Kurti nuk e humbet shansin për të bërë një diferencim të theksuar midis pikëpamjeve të tij të majta politike dhe siç e quan ai ekstremit të djathtë serb:

Albin Kurti: “Ne po përballemi me krahët e djathtë ultra nacionalistë që paguhen dhe urdhërohen nga Beogradi dhe që e admirojnë presidentin despotik Putin. Kjo është një milici fashiste që sulmoi policët tanë, ushtarët e NATO-s dhe gazetarët që ishin në terren.” (CNN, 2023)

Termtat e përdorur nga kryeministri Kurti, publikut ndërkombëtar i jep të kuptojë se dallimet midis dy palëve janë jashtëzakonisht të theksuara. Në panoramën e gjerë, Kurti shfaqet si një politikan populist.



Figura 2: Kryeministri i Kosovës Albin Kurti gjatë një interviste të dhënë për CNN International me gazetaren Isa Soares, më 31 Maj, 2023. Burimi: <https://edition.cnn.com/2023/05/31/europe/albin-kurti-kosovo-serbia-interview-intl/index.html>

### *Strukturat sociale dhe pabarazitë*

“Gjuha reflekton dhe riprodhon strukturat dhe pabarazitë shoqërore, dhe diskursi politik mund të ndërtojë dhe përjetësojë hierarkitë sociale bazuar në faktorë të tillë si gjinia, raca, klasa dhe kombësia”. (van Dijk, 2001, pp. 352-371)

Chouliarakis dhe Fairclough (1999) diskutojnë analizën e diskursit politik brenda kontekstit të modernitetit të vonë, duke u fokusuar në mënyrat në të cilat gjuha mund të përforcojë dhe sfidojë pabarazitë sociale. Në këtë pjesë të intervistës, Kurti vë në pah pabarazinë etnike në mes serbëve dhe pakicave të tjera kombëtare që jetojnë në Kosovë.

Isa Soares, CNN: Por përse atëherë serbët i bojkotuan zgjedhjet? Pse ndihen të nënpërfaqësuar?

Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës: Ne kemi komunitetin serb në Kosovë, që është 4% e popullsisë. 93% janë shqiptarë, dhe pjesa tjetër 3% janë minoritete të tjera, romë, boshnjakë, turq, egjiptianë, goranë. Dhe ne duam të jetojmë në një shoqëri multikulturore, por nuk mund të kemi një pakicë të privilegjuar sepse Beogradi po qan për humbjen e Kosovës në vitin 1999 kur NATO ndërhyri për të ndaluar gjenocidin e regjimit të Millosheviqit. Kosova është një histori suksesi e ndërhyrjes së NATO-s. Kjo është ajo që shqetëson Beogradin dhe Kremlinin. (CNN, 2023)

Kurti nënvizon faktin se serbët pretendojnë të jenë më të privilegjuar si pasojë e “humbjes” sipas tyre territorin e Kosovës. Madje, serbët sipas kryeministrit, duan të tregohen superiorë edhe ndaj vetë shqiptarëve shumicë në Kosovë. Me këtë lloj gjuhe, Kurti dëshiron të justifikojë veprimet e ndërmarra në veri të Kosovës.

### *Strategjitë diskursive*

Fairclough (2003) thekson analizën e strategjive gjuhësore të përdorura në diskursin politik, të tilla si mjetet retorike, inkuadrimi dhe ndërtimi narrativ. Këto strategji përdoren nga politikanët për të formuar opinionin publik, për të ndikuar në perceptimet dhe për të kontrolluar narrativën për çështje specifike. Ndërkaq Wodak dhe Krzyżanowski (2017) diskutojnë shqyrtimin e strategjive diskursive në diskursin politik, duke theksuar se si gjuha përdoret në mënyrë strategjike për të fituar pushtet, për të promovuar axhenda të caktuara dhe për të formësuar opinionin publik. Pyetja e radhës gazetares së CNN është e përqendruar në ndalimin e veprimeve të kryeministrit të Kosovës. Ajo ia sjell në vëmendje atij edhe një postim në Twitter të sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken ku e qorton Kurtin për veprimet e marra.

Isa Soares, CNN: Sekretari Blinken bëri një “tweet”, duke pasur parasysh atë që kemi parë, tensionet po përshkallëzohen. Ai ju ka bërë thirrje. Unë mendoj se ai ju përfshiu në këtë postim në Twitter për të ndaluar ato që ai i quajti masa të dhunshme. “Dënojmë fuqishëm veprimet e qeverisë së Kosovës që po përshkallëzojnë tensionet në veri dhe po rrisin jostabilitetin. I bëjmë thirrje kryeministrit që menjëherë t'i ndërpresë këto masa të dhunshme...” Çfarë po bëni ju zotëri për të ndaluar këto përshkallëzime? A do të vazhdoni të vendosni policinë në terren në këto komuna?

Albin Kurti, kryeministër i Kosovës: Të gjitha organet ndërkombëtare i njohën zgjedhjet që kemi. Pasi të njihni procesin e zgjedhjeve dhe rezultatet e tij, atëherë kryetarët duhet të shkojnë në komunë. Kush tjetër duhet të jetë në këto ndërtesa komunale nëse jo kryetarët? Dhe unë jam duke punuar ngushtë me faktorët ndërkombëtarë, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian. Ne i konsiderojmë të dy aleatë, miq dhe partnerë të domosdoshëm. Dhe ne do të bëjmë më të mirën. Por unë nuk po ia dorëzoj republikën demokratike milicisë fashiste. (CNN, 2023)

Mirëpo përgjigja e Kurtit është reverzive. Ai ia kujton gazetares se këto zgjedhje që janë mbajtur, kanë qenë të pranuar ndërkombëtarisht dhe se shprehja “unë nuk po ia dorëzoj republikën demokratike milicisë fashiste”, e bën gazetaren të mos insistojë më në pyetjen e saj. Kjo gjë vërehet edhe në mimikën e fytyrës së saj në video.

### *Paraqitja dhe ana vizuale*

Analizimi i diskursit politik brenda kontekstit të tij më të gjerë social shpjegohet nga van Leeuwen (2008) i cili thekson rëndësinë historike dhe kulturore, duke marrë parasysh jo vetëm aspektet tekstuale, por edhe elementet vizuale, dëgjimore dhe multimodale të komunikimit në politikë. Edhe Kress dhe van Leeuwen (2006) diskutojnë analizën e aspekteve multimodale të ligjërit, duke pranuar se komunikimi politik përfshin jo vetëm gjuhën, por edhe elementë të ndryshëm vizualë dhe audiovizualë që kontribuojnë në kuptimin dhe dinamikën e fuqisë.

Gjatë gjithë kohës sa është duke u prononcuar në këtë intervistë, Albin Kurti mban një qëndrim mjaft serioz. Shprehja e tij e fytyrës tregon për një brengë që ka por në asnjë moment nuk vërehet ndonjë dozë frike apo pasigurie. Ai flet qartë dhe në mënyrë deskriptive përtej aspektit politik apo asaj se në çfarë beson. Shfaq një vetëbesim të madh dhe i ngjan një lideri autoritativ. Nuk duket se dikush mund t'ia ndryshojë mendimet dhe veprimet, përkundrazi, është ai që tenton ta bindë botën se veprimet e tij janë të duhurat.

Albin Kurti u përball me një lumë kritikash nga të gjitha palët, por pas disa ditësh, më saktë më 11 qershor, i dërguari i SHBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka cilësuar kryeministrin e Kosovës, partner të SHBA-së, ani pse ka thënë se ai nganjëherë është partner i vështirë.

“Zotëri Albin Kurti është partneri ynë. Nganjëherë është partner i vështirë, por ai është partner. Kosova është partner.”(evropaelire.org)

Gabriel Escobar, i dërguar i posaçëm i SHBA-së për Ballkanin Perëndimor

Ky deklaram i Escobarit, ishte kthesa sinjifikative e ndryshimit të diskursit të Washingtonit zyrtar në raport me Albin Kurtin. Kur të gjithë prisnin të ndryshojë kahje Kurti, në fakt ndryshoi narrativin vetë SHBA. Sigurisht, kemi të bëjmë me një fuqi botërore e cila është e interesuar që të ketë paqe dhe stabilitet në Ballkan. Kosova është histori suksesi e NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për këtë arsye ata kërkojnë që palët të ulin tensionet dhe të arrijnë marrëveshjet që i presin. Megjithatë, sipas deklarimeve të zyrtarëve ndërkombëtarë, sanksionet që mund t'i vijnë Kosovës nga “kokëfortësia” e Kurtit mund të jenë me pasoja të rënda për Kosovën. Kjo është një analizë politike që mund të bëhet në një rast tjetër...

## Përfundim

Studimet e Analizës së Diskursit janë ende të reja dhe ka nevojë të jashtëzakonshme për t'u marrë akoma më shumë me to. Mirëpo për hir të së vërtetës, lëvrimi i kësaj fushe kërkon studiues të mirëfilltë që janë njohës të mirë të sociolinguistikës, semiotikës së tekstit, rrethanave kulturore, politike e sociale. Nevoja për posedim të njohurive të mirëfillta multidisiplinare e bën këtë metodë kërkimore tepër të vështirë, prandaj si e tillë u takon kolosëve të mëdhenj të fushave përkatëse. Kërkuesit e rinj, do të duhej të mjaftohen vetëm me leximin e drejtë dhe të saktë të tyre.

Analiza Kritike e Diskursit është një metodë mjaft e kërkuar në fushën e mediave dhe komunikimit pasi që çdo tekst apo përmbajtje mediatike do të mund të analizohet nëpërmjet kësaj metode, duke filluar nga studimi i gjuhës së reklamave, edicioneve të lajmeve, ligjërimeve politike, sociale, kulturore e kështu me radhë.

Njerëzit që jetojnë në zona të ndryshme shfaqin dallime në përdorimin e gjuhës, pra kontekstit të saj. Në këtë mënyrë, nëpërmjet të gjuhës së përdorur, ekziston mundësia të çimentohen bindje të caktuara nga të tjerët duke u bazuar vetëm në atë që është thënë me fjalë.

Ky punim analizoi sfondin gjuhësor të mishëruar në fjalimin e kryeministrit të Kosovës Albin Kurti, gjatë një interviste të dhënë për CNN. Sigurisht se një paraqitje e caktuar publike, nuk mund të jetë definicion i një përkufizimi të mundshëm rreth ligjërimit të përgjithshëm politik të Kurtit. Sipas koncepteve të lashta të Aristotelit, rezulton se Kurti posedon elementet bazë për tu konsideruar një folës i mirë publik. Nuk ndërlihet me atë që thotë, por me atë se si e thotë. Kurti ka *etos* (besueshmëri, ton dhe stil), *patos* (përcjellje emocionale dhe efekte emocionale), si dhe *logos* apo argumentim dhe ilustrim me fakte të asaj që dëshiron ta thotë. Bindjet politike nuk kanë fare rëndësi për analizën në fjalë. Nuk kanë rëndësi as vendimet e tij politike. Ato janë çështje që do t'i takonin një analize politike ku do të shqyrtoheshin ecejaket e Albin Kurtit për situatën në veri të Kosovës apo edhe të veprimeve të tij të përgjithshme si kryeministër i Kosovës. Këtu është bërë analizë e ligjërimit të tij politik.

E përmbledhur me dy fjalë, fjalimi (intervista) i Albin Kurtit nën dritën e Analizës Kritike të Diskursit, është një fjalim politik me doza të forta populiste. Ai beson fuqishëm në atë që thotë dhe nuk jep shenja se mund të zmbropset nga fjalën e thëna. Gjuha e tij është e qartë dhe bindëse. Nëpërmjet frazave si: ruajtja e sovranitetit dhe territorialitetit të Kosovës, zbatimi i Kushtetutës për të qëndruar kryetarët e komunave përkatëse në godinat e komunave, milicia fashiste serbe, protestuesit kriminelë serbë, e të tjera, lejnë përshtypjen se nga kjo intervistë për CNN, Kurti i ka nxitur ta urrejnë më shumë ata që e kanë urreyer dhe ta duan edhe më shumë ata që e kanë dashur.

---

## Abstract

Critical Discourse Analysis is analytical research that elaborates a critical perspective that can be found in all areas of discourse studies, including political and media studies. This paper summarizes the body of research known as Political Discourse Analysis. The theoretical approaches are placed within the linguistic and political curves (more linguistic than political) of an interview of the prime minister of Kosovo, Albin Kurti, given to CNN International television on May 31. The interview is related to the aggravation of the situation in the north of Kosovo since May 26 of this year. The research is carried out on the method of "content analysis" of a public presentation by Albin Kurti and aims to make a qualitative measurement of the linguistic rhetoric used in this interview, according to the theories of van Dijk (2001) and Fairclough (1995), according to the method of Critical Discourse Analysis. Based on the relevant theories, it appears that the current prime minister of Kosovo, in the interview given to CNN with the journalist Isa Soares, has used a strong political language, making a knife-like division between Kosovo and Serbia. Being in a difficult political situation, Kurti does not hesitate to use divisive terms between "us" and "them", not showing for a moment the willingness to withdraw from the decisions taken, until the conditions he has for the extension of the situation are met. In the north of Kosovo, despite the threat of sanctions from the United States of America and the European Union. His discourse is populist and through this interview, he wants to tell the international public opinion that it is not Kosovo but Serbia that is to blame for the situation created in the north.

Key words: Critical Discourse Analysis, Political Discourse, rhetoric, interview, public opinion, Kosovo, Serbia, tension.

## Abstrakt

Analiza kritike e diskursit është një hulumtim analitik i cili shtjellon një perspektivë kritike që mund të gjendet në të gjitha fushat e studimeve të ligjërimit, përfshirë edhe atë politik. Kjo ese përmbledh tërësinë e kërkimit të njohur si analiza e diskursit politik. Qasjet teorike janë vendosur brenda kthesave gjuhësore dhe politike (më shumë gjuhësore se sa politike) të një interviste të kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhënë për televizionin CNN International më 31 maj. Intervista lidhet me temën e agravimit të situatës në veri të Kosovës që nga 26 maji i këtij viti. Hulumtimi në fjalë realizohet mbi metodën e "analizës së përmbajtjes" të një paraqitjeje publike të Albin Kurtit dhe ka për qëllim të bëjë një matje cilësore të retorikës gjuhësore të përdorur në këtë intervistë, sipas teorive të van Dijk (2001) dhe Fairclough (1995) në dritën e Analizës Kritike të Diskursit. Duke u bazuar në teoritë përkatëse, del se kryeministri aktual i

Kosovës, në intervistën e dhënë për CNN me gazetaren Isa Soares, ka përdorur një gjuhë të fortë politike, duke bërë një ndarje si me thikë në mes Kosovës dhe Serbisë. I gjendur në një situatë të vështirë politike, Kurti nuk nguron të përdorë terma përçarëse midis “ne” dhe “ata”, duke mos shfaqur për asnjë moment gatishmërinë e tërheqjes nga vendimet ndërmarra, deri sa të plotësohen kushtet që ai ka për shtensionim të situatës në veri të Kosovës, pavarësisht kërcënimit me sanksione nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. Diskursi i tij është populist dhe nëpërmjet kësaj interviste, dëshiron t’i thotë opinionit publik ndërkombëtar se fajtor për situatën e krijuar në veri, nuk është Kosova por Serbia.

*Fjalët kyçe: Analizë kritike e diskursit, diskurs politik, retorikë, intervistë, opinion publik, Kosovë, Serbi, tension.*

### Aneks

Intervista e plotë e Albin Kurtit dhënë për CNN International  
31 Maj, 2023

*Ky tekst është transkriptuar fjalë për fjalë nga intervista në formatin video dhe e njëjta është përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Minutazhi i intervistës është 8:06 minuta.*

Isa Soares, gazetare e CNN [00:00:00.410] - Speaker 1

Donim të merrnim perspektivën e Kosovës për këtë situatë shumë të tensionuar që pat atje. Tashmë na bashkohet edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai sonte është në Prishtinë. Kryeministër, faleminderit shumë që gjetët kohën për të folur me ne këtë mbrëmje. Prej disa kohësh tensionet po ziejnë në veri. Thjesht shpjegoni shikuesve tanë, Kryeministër, nëse mundeni, pse vendosët të dërgoni forcat e policisë dhe njësitë policore në veri të vendit. Pse menduat se ishte e nevojshme?

Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës [00:00:25.130] - Speaker 2

Më 5 nëntor të vitit të kaluar, katër kryetarë komunash në veri që i përkisnin një partie politike serbe dhanë dorëheqjen kolektivisht. Dhe në dhjetor, për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë, vendosëm që zgjedhjet e parakohshme të shtyhen për katër muaj. Kështu që më në fund, më 23 prill, i patëm. Pjesëmarrja ishte mjaft e ulët për shkak të presionit, shantazhit dhe kërcënimeve nga Beogradi ndaj të gjithë qytetarëve serbë, dhe në veçanti atyre që planifikonin të kandidonin. Dhe tani kemi katër kryetarë komunash, legjitimiteti i të cilëve është i ulët, por megjithatë nuk ka më legjitim se ata. Duhet të kemi shtet ligjor. Ne jemi republikë demokratike dhe duhet të sigurojmë që në ndërtesat komunale që janë pronë e republikës, të jenë këta kryetarë komunash kosovarë që janë

zgjedhur. Nga ana tjetër po përballemi me protestues jo paqësorë. Jemi përballë një turme ekstremistësh. Ne po përballemi me krahët e djathtë ultra nacionalistë që paguhen dhe urdhërohen nga Beogradi dhe që e admirojnë presidentin despotik Putin. Kjo është një milici fashiste që sulmoi policët tanë, ushtarët e NATO-s dhe gazetarët që ishin në terren.

Albin Kurti [00:01:55.103] - Speaker 2

Raportimi atje sot është shumë më i qetë sepse ata nuk kanë bërë sulme ndaj policisë sonë dhe..., por megjithatë kanë sulmuar disa gazetarë.

Albin Kurti [00:02:07.370] - Speaker 2

Unë dua të kem paqe dhe siguri, por besoj se demokracia dhe sundimi i ligjit janë rruga përpara. Nuk është e mundur që në ndërtesat komunale të mos ketë kryetar të zgjedhur. Pushteti në Kosovë nuk mund të fitohet me goditje-bomba, me krime dhe me dhunë, por se vetëm me zgjedhje.

Isa Soares [00:02:30.670] - Speaker 1

Dhe zotëri, a keni ndonjë provë që ato që po dërgohen, se ato protesta që ne po shikonim, ka ndonjë vendim? Ne thjesht po u tregojmë shikuesve tanë që kanë ardhur nga Serbia, që janë dërguar nga Serbia, aleatët e Putinit. A keni ndonjë nga këto dëshmi për të na treguar?

Albin Kurti [00:02:47.910] - Speaker 2

Kemi dhjetëra video dhe foto që tregojnë se milicia serbe është në vijën e parë të një turme të dhunshme. Dhe këta janë personat që ne kemi identifikuar që vijnë nga Serbia. Disa prej tyre vijnë edhe nga veriu i Kosovës, por një pjesë e tyre vijnë nga Serbia. Dhe ne jemi një republikë demokratike, pro evropiane. Fqinji ynë verior Serbia është pro autokracisë ruse. Pra atje nuk ka shumë demokraci, edhe pse kanë zgjedhje, pasi kanë një parti, një shtet, një lider dhe e kanë urdhëruar këtë të ashtuquajtur xhandarmëri, të vijnë të bëjnë trazira në veri të Kosovës.

Isa Soares [00:03:34.710] - Speaker 1

Le të flasim për marrëveshjen tuaj të vitit 2013, sepse paraardhësi juaj, me sa kuptoj dhe më korrigjoj nëse gabohem këtu, kryeministri pranoi të themelojë një asociacion të komunës serbe ku serbët, natyrisht, janë shumicë. Epo, dhjetë vjet më vonë kjo nuk ka ndodhur. Pse nuk ndodhi kjo, zotëri?

Albin Kurti [00:03:56.730] - Speaker 2

Tani kemi një marrëveshje me Serbinë. Ne e quajmë atë traktat bazë. Presidenti i Serbisë dhe unë nën kujdesin e përfaqësuesit të lartë z. Borell dhe i dërguari i tij special për Ballkanin, Jajçak. Teksti ka njëmbëdhjetë nene, gjashtë pika në preambulë, kemi një marrëveshje. Pjesë e kësaj marrëveshjeje është edhe zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të dakorduara më parë. Nga paraardhësit e mi, janë 39 gjithsej. Dy prej tyre kanë të bëjnë me asociacionin e komunave me shumicë serbe, e cila megjithatë nuk e kaloi testin e Gjykatës sonë Kushtetuese sepse është e inkuadruar në

frymën e etnonacionalizmit territorial. Unë dua të kem vetëadministrim të komunitetit serb, siç thotë neni i shtatë i Traktatit tonë Themelor. Nuk neglizhoj dhe nuk i mohoj dokumentet e dakorduara më parë. Por kjo nuk është e vetmja. Ne kemi nevojë për një udhërrëfyes të sekuencës së zbatimit për të gjithë marrëveshjen që kemi bërë në shkurt të këtij viti.

Isa Soares [00:05:08.770] - Speaker 1

Por përse atëherë serbët i bojkotuan zgjedhjet? Pse ndihen të nënpërfaqësuar?

Albin Kurti [00:05:16.630] - Speaker 2

Ne kemi komunitetin serb në Kosovë, që është 4% e popullsisë. 93% janë shqiptarë, dhe pjesa tjetër 3% janë minoritete të tjera romë, boshnjakë, turq, egjiptianë, goranë. Dhe ne duam të jetojmë në një shoqëri multikulturore, por nuk mund të kemi një pakicë të privilegjuar sepse Beogradi po qan për humbjen e Kosovës në vitin 1999 kur NATO ndërhyri për të ndaluar gjenocidin e regjimit të Millosheviqit. Kosova është një histori suksesi e ndërhyrjes së NATO-s. Kjo është ajo që shqetëson Beogradin dhe Kremlinin.

Isa Soares [00:05:58.250] - Speaker 1

Joseph Borell, të cilin ju përmendët, kryeministri i tyre i bëri thirrje policisë që të tërhiqet nga komunat e tyre. A do të tërhiqni policinë nga këto komuna?

Albin Kurti [00:06:07.590] - Speaker 2

Policia duhet të jetë prezente si në çdo komunë në republikën tonë, janë 38 komuna gjithsej. Por nëse ka dhunë... (e ndërpret gazetarja)

Isa Soares [00:06:22.020] - Speaker 1

Duke folur për veriun. Këtu po flas veçanërisht për veriun, ku kemi parë tensione?

Albin Kurti [00:06:29.130] - Speaker 2

Për sa kohë që ka një turmë të dhunshme jashtë ndërtesës, unë nuk mund të kem vetëm pak policë. Më duhet të kem polici që do të mbrojë sundimin e ligjit, që do të mbajë rendin, qetësinë dhe sigurinë. Dhe komuna duhet të jetë për të gjithë, jo vetëm për strukturat paralele të Serbisë të kthyera në banda kriminale.

Isa Soares [00:06:51.340] - Speaker 1

Sekretari Blinken bëri një "tweet", duke pasur parasysh atë që kemi parë, tensionet po përshkallëzohen. Ai ju ka bërë thirrje. Unë mendoj se ai ju përfshiu në këtë postim në Twitter për të ndaluar ato që ai i quajti masa të dhunshme. "Dënojmë fuqishëm veprimet e qeverisë së Kosovës që po përshkallëzojnë tensionet në veri dhe po rrisin jostabilitetin. I bëjmë thirrje kryeministrit që menjëherë t'i ndërpresë këto masa të dhunshme..." Çfarë po bëni ju zotëri, për të ndaluar këto përshkallëzime? A do të vazhdoni të vendosni policinë në terren në këto komuna?

Albin Kurti [00:07:23.710] - Speaker 2

Të gjitha organet ndërkombëtare i njohën zgjedhjet që kemi. Pasi të njihni procesin e zgjedhjeve dhe rezultatet e tyre, atëherë kryetarët duhet të shkojnë në komunë. Kush tjetër duhet të jetë në këto ndërtesa komunale nëse jo kryetarët? Dhe unë jam duke punuar ngushtë me faktorët ndërkombëtarë, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian. Ne i konsiderojmë të dy aleatë, miq dhe partnerë të domosdoshëm. Dhe ne do të bëjmë më të mirën. Por unë nuk po ia dorëzoj republikën demokratike milicisë fashiste.

Isa Soares [00:08:02.410] - Speaker 1

Kryeministër Kurti, ishte kënaqësi që ju pata në emision. Shumë faleminderit zotëri.

## Referenca

Aristotle. (1992). *The Politics*. (T. J. Saunders, Ed., & T. A. Sinclair, Trans.) Harmondsworth: Penguin.

Chilton, P. (2004). *Analysing Political Discourse*. Routledge.

Chouliaraki, L., & Fairclough, N. (1999). *Discourse in Late Modernity: Rethinking Critical Discourse Analysis*. Edinburgh University Press.

Dunmire, P. L. (2012). *Political Discourse Analysis: Exploring the Language of Politics and the Politics of Language*. *Language and Linguistics Compass*, 6(11), 735–751.

Edelman, M. J. (1977) *Political language : words that succeed and policies that fail*. New York: Academic Press.

Fairclough, N. (1992) *Discourse and social change*, Cambridge: Polity Press.

Fairclough, N. (1995). *Critical Discourse Analysis: The Critical Study of Language*. Routledge.

Fairclough, N. (2003). *Analyzing Discourse: Textual Analysis for Social Research*. Routledge.

German, K. M. (2017). *Principles of Public Speaking*. Routledge.

Jones, J. and Peccei, J. S. (2004) 'Language and politics', in Thomas, L.(ed), *Language, society, and power*. New York: Routledge.

Ke Liu, Fang Guo. (2016, May). *A Review on Critical Discourse Analysis*. *Theory and Practice in Language Studies*, 6(5), 1076-1084. doi:http://dx.doi.org/10.17507/tpls.0605.23

Kress, G., & van Leeuwen, T. (2006). *Reading Images: The Grammar of Visual Design*. Routledge.

Michael Osborn, Suzanne Osborn, Randall Osborn. (2009). *Public Speaking*. Pearson Education.

Steven A. Beebe, Susan J. Beebe. (2015). *Public Speaking*. Pearson.

van Dijk, T. A. (2001). *Critical Discourse Analysis*. In D. Tannen, D. Schiffrin, & H. Hamilton (Eds.), *The Handbook of Discourse Analysis* (pp. 352-371). Blackwell Publishing.

van Dijk, T. A. (2003) '*Critical discourse analysis*', in Schiffrin, D., Tannen, D., Hamilton, H.E. (ed), *The handbook of discourse analysis*. Oxford: Blackwell, pp. 352-371.

van Dijk, T. A. (2006) '*Politics, ideology, and discourse*', in Brown, K.(ed), *The Encyclopedia of language and linguistics*. Vol. 9 Oxford ; New York: Pergamon Press, pp. 728-740.

van Dijk, T. A. (2015, 17 April). *Critical Discourse Analysis*. (H. E. Deborah Tannen, Ed.) *The Handbook of Discourse Analysis*, Volume I, pp. 466-485.

van Leeuwen, T. (2008). *Discourse and Practice: New Tools for Critical Discourse Analysis*. Oxford University Press.

Wodak, R., & Krzyżanowski, M. (Eds.). (2017). *The Routledge Handbook of Critical Discourse Studies*. Routledge.

Wodak, R., & Meyer, M. (Eds.). (2009). *Methods of Critical Discourse Analysis*. Sage Publications.

Burime nga Interneti

Shqiptarja.com (30 Maj, 11:52): Në Kosovë tensione dhe frikë për përshkallëzim, si nisi konflikti dhe cilat janë qëndrimet e të gjitha palëve (Pyetje dhe përgjigje) - Shqiptarja.com Data: 12.06.2023, Ora 12:31

CNN International (31 Maj, 2023, 12:00) Kosovo protests: Prime minister says he will not surrender country to Serbian 'fascist militia' | CNN Data:11.06.2023, Ora 14:15

Evropaelire.org (11 Qershor, 2023) Escobar për Kurtin: Nganjëherë është partner i vështirë, por ai është partner (evropaelire.org) Data: 12.06.2023, Ora 17:00

ISSN 2671-3004

UDC 821.18:811.163.2'255.4

Punim studimor

Kosovare KRASNIQI  
Instituti Albanologjik  
[Kosovare81@yahoo.com](mailto:Kosovare81@yahoo.com)

**IMAGOLOGJIA DHE PËRKTHIMI  
LIBRAT E PËRKTHYERA NGA GJUHA SHQIPE NË ATË BULLGARE**

Имагологијата и преводот  
Преведените книги од албански на бугарски јазик  
Imagology and translation  
Books translated from Albanian into Bulgarian

Hyrje

Lidhur me çështjen e marrëdhënies midis kulturave të ndryshme është edhe përkthimi i veprave. Për përkthimin, mendohet se është po aq i hershëm sa shkund pluhurin e shekujve të barabartë me vetë komunikimin njerëzor. Ç'është një vepër e huaj, ose ç'është një vepër e huaj, kjo është ajo që, historia e njerëzimit e njeh si fuqinë e zhvillimit kulturor të tyre apo edhe rëndësinë e përkthimit. Që të vendoset nën një kornizë të qartë pjesëmarrja e një letërsie të një shteti, në një shtet tjetër, si rezultat kryesor janë përkthimet. Përkthimi është mënyra e vetme sipas së cilës letërsia e një shteti mund ta plotësoj rolin e vet edhe në një shtet tjetër, andaj nëse duhet një përkufizim i tillë për përkthimin, e adresuara është studiuësja e letërsisë Majlinda Bregasi, e cila thotë, "Pra, gjuha dhe kultura, letërsia si mediumi më i lartë i shprehjes gjuhësore e cila pastaj transformohet në gjuhët e popujve të tjerë nëpërmjet përkthimit letrar duket të mbeten elementet themelore të identitetit kulturor të shqiptarëve". (Bregasi, 2020: 83). Përkthimi i një autori në gjuhë tjetër është njëri nga segmentet e cilësisë dhe vlerës së veprës së tij, mirëpo vlera e përkthyesit i përgjigjet edhe një rëndësie tjetër, në atë të promovimit dhe përafrimit e dy kulturave.

Takimi me të huajën gjithnjë na bën kureshtar, qoftë për libra të cilat mund të janë të panjohura për ne, qoftë për katër pamjet tjera, si, gjuha, kombësia, përkatësia etnike dhe përkatësia fetare, andaj, siç shprehet Chevrel, "Punimet imagologjike ndihmojnë për të përcaktuar tiparet e së huajës në një vepër". (Chevrel, 1997:38).

## Një përmbledhje e shkurtër-Disiplina e imagologjisë

Kontakti i parë i retinës së syrit me një kulturë tjetër, të krijon ndjesinë për mënyrën e të jetuarit të atij populli, mentalitetin dhe kulturën që e zotëron. Kjo mënyrë e të menduarit dhe këndvështrimet që zotëron rreth atij populli të bën ta kuptosh ndryshimin që ekziston mes teje dhe tjetrit. Andaj, për ti kuptuar më në detaje këto ndryshime që ekzistojnë në mes kulturave, e gjithashtu edhe perceptimin e të tjerëve për ty, është e domosdoshme që të jemi të njohur edhe me përfaqësimin kombëtar jashtë vendit. Ajo që përbën nyjën themelore të rëndësisë së imagologjisë është se nga këndvështrimi krahasues, “tjetri” na sheh me sy realë, jo siç kemi dëshirë të jemi, por siç jemi.

Shfaqja e imagologjisë si disiplinë e rëndësishme e studimeve krahasuese, na sjell dëshirën për të bë hulumtimin rreth saj, për të zbuluar ide dhe mendime të reja apo këndvështrime krahasuese të cilët i krijojnë të tjerët për ne ose e kundërta, ne për të tjerët.

Në historinë letrare, nevoja për elaborim të temës së imagologjisë nuk është e re, pasi që përshkrimet e kombeve kanë qenë gjithmonë një nga motivet më të zakonshme në letërsi, por termi “tjetër” është bërë një nga çështjet kryesore në studime kulturore, vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur krahasuesit francezë Marius-Francois Guyard dhe Jean-Marie Carré, kur fushës së tyre të hulumtimit, imagologjisë, brenda letërsisë krahasuese, i dhanë një profil të caktuar. Baza kryesore e fjalës Imagology ose imagologji ose në gjuhën shqipe edhe imazhologji vije nga fjala latine, imago - imazhi, mendimi, dhe kombinimi i saj me fjalën greke, logos - fjalimi, fjala, termi, mendimi, arsyeja.

Imagologë, kritikë e teoricienë ballkanas e botëror për të vendosur nën kornizën e duhur disiplinën që studion imazhe të kombeve dhe të popujve të ndryshëm, kanë formuluar qëndrime të qarta dhe shumë informuese për objektin e imagologjisë. Punime shkencore për të eksploruar thelbin e imagologjisë si drejtim modern, e vazhduan edhe studiues tjerë, veçuar edhe studiuesin kroat, Davor Dukiçi cili njihet edhe si njëri ndër përkrahësit e kësaj discipline, ai shton se, *“Hapi i parë në çdo analizë imagologjike është hartëzimi i hapësirave gjeokulturore. Në fillim ekziston caktimi i kufijve të vetvetes nga hapësira të panjohura, pra caktimi i kufijve të vetë prezantimit (autoimazhi) nga koncepti i huaj (heteroimazh)”*. (Dukić, 2014:166).

Letërsia shqipe ende është imagologjikisht e pa eksploruar, andaj, imagologjia si disiplinë mbetet ende një zonë e papunuar brenda kornizës së letërsisë shqipe dhe çështja për studimin e saj mbetet e hapur. Të njëjtin mendim ndan edhe profesoresha Mirlinda, *“Në të vërtetë, në letërsinë shqipe nuk kemi studime analitike që i referohen mënyrës se si është paraqitur tjetri, i huaji ose si është paraqitur shqiptari nga të huajt në letërsi, sado që studimet e tilla do të ishin të mirëpritura, sidomos në rrethana kur studimet imagologjike në botë ngjallin interes të duhur”*. (Krifca-Beqiri,198: 2019)

Në korpusin e këtij hulumtimi mbi këtë çështje, analiza aktuale do të përqendrohet kryesisht në marrëdhëniet ndërkulturore, në atë shqipe dhe bullgare, përkatësisht në përkthimin e autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare. Përkthimi i librave të autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare dhe anasjelltas, është njëra nga shtyllat kryesore për të bërë të njohur letërsinë, kulturën dhe autorët e saj.

### Letërsia shqipe në sytë e studiuesve bullgarë

Qasjes hulumtuese në rrjetëzimin e studimeve e përkthimeve shqipe në gjuhë tjera i dhanë jetë shumë studiues e përkthyes, me studime e përkthime shumë cilësore. Për ata studiues, shkrimtarë dhe kritikë të huaj që e ndjejnë kulturën e tjetrit, arrijnë që të jenë, jo vetëm promovues, por edhe përafrues të dy kulturave në të cilat marrin pjesë.

Letërsia shqipe krahas letërsisë ndërkombëtare konsiderohet si letërsi e vogël, pavarësisht asaj që letërsia shqipe i dha letërsisë ndërkombëtare një shkrimtarë të nivelit mjaftë të lartë, siç është shkrimtari, Ismail Kadare. Gjithashtu, e konsideroj të rëndësishme të shtoj se, letërsia shqipe edhe në nivel ballkanik, mbetet ende e pa trajtuar aq sa duhet, megjithëse në dy dekadat e fundit, duket se ka një zhvillim më të lartë dhe fazë ngritjeje. Vihet re një vëmendje më e shtuar e sidomos sa u përket përkthimeve.

Për arsye të shumë paragjykimeve dhe stereotipave që ka një kulturë për tjetrën, e që mbeten të pandryshuara përgjatë shekujve, marrëdhëniet ndërkufitare brendabalkanike nuk janë edhe aq të integruara në qytetërimin evropian. Rrjedhimisht, ndodhë që edhe shkrimet e një shkrimtari të ngjajnë me një muri të gurëzuar dhe në një kuptim më të përgjithshëm shtojmë se nuk kalojnë andej kufiri, kështu që nuk i ke shumë të njohur autorët e shteteve fqinje, andaj, për një qasje pasuruese dhe frytdhënëse mund të shtojmë citimin, edhe nga ajo çfarë thotë Monika për Ballkanin, *“Ballkani ku përkthehet edhe letërsia e bulevardeve, por shkrimtari i vendit fqinj mbetet i ndaluar”* (Stafa-Shoshori, 197:2012). Filluar nga ky aspekt, ndonëse shkrimet mund t'i takojnë pedestalit të letërsisë, koncepti i krijuar për kulturën e *‘tjetrit fqinjë’* nuk është i njohur aq sa duhet, dhe nga informatat e pakta që posedojmë për atë kulturë krijohen plot stereotipe të pabaza.

Ndër studiuesit ballkanas të pajisur me pasion për letërsinë shqipe, dhe të cilët e kanë pasuruar fondin e tyre librar me studime për letërsinë shqipe dhe përkthime të librave të gjuhës shqipe janë studiuesit bullgar. Në Bullgari studimet për gjuhën dhe letërsinë shqipe kanë qenë të gjera dhe të ndërlydhura prej kohësh, që nga rilindja dhe vazhdojnë ende të jenë të gjera dhe të shumta. Shikuar në kontekstin historik, letërsia shqipe ka qenë e njohur me letërsinë bullgare qysh gjatë shekullit të XIX.

Lidhja e letërsisë shqiptare me hapësirën letrare bullgare fillon të komunikoj më lirshëm, kur shkrimtarët e mërguar shqiptarë krijojnë kolonin e tyre në Sofje të quajtur Kolonia e Sofjes. Kryeqyteti i Bullgarisë,

Sofja, hapi dyert për kontributdhënsit shqiptarë të çështjes kombëtare. Kjo koloni fillon të ketë sukses në jetën e organizuar politike e kulturore dhe krijimtarinë letrare, por që arriti të kishte suksese edhe në pikëpamje të veprimtarisë së drejtpërdrejtë politike dhe në atë kulturore ishte më e forta. Rikujtojmë që sa i përket kësaj problematike, një studim me këtë temë bën edhe studiuesja bullgare Bojka Sokollova, emri i së cilës dha një kontribut shumë të rëndësishëm për letërsinë shqiptare. Studiuesja Sokollova përmbledh brenda studimit të saj një pasqyrë të qartë mbi arritjet e botimeve dhe përkthimeve të shtypshkronjës *“Mbrodhesia”* e cila vepronte në kuadër të kolonisë shqiptare e ashtuquajtur *“Kolonia e Sofjes”*. Megjithatë përveç studiueses Sokollova, studimet për gjuhën dhe historinë e shqipes kanë qenë gjithmonë në vëmendjen e mjaft studiuesve bullgarë, si: Rosica Cvetkova, Greta Dellceva, Rusana Beyleri, Ekaterina Tërpomanova, Anton Pançev, Ivalena Antonova Taneva, etj.

Albanologia Rusana Bejlari konsiderohet si njëra nga studiueset dhe albanologët më të rëndësishme të letërsisë shqipe, e cila letërsinë shqiptare e sheh si më të denjën ta përcjell tek lexuesi bullgar. Ajo arrin që përmes studimeve të shumta të saj, t'u ofrojë lexuesve bullgarë një qasje sa më të gjerë të mundshme të letërsisë shqipe të mbështetura kurdoherë në fakte, argumente dhe të vërteta shkencore.

Qasjen për studimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe të studiueses Rusana, po e filloj me vet fjalën e saj për studiuesin, se: *“Studiuesi i jashtëm i një kulture, në qoftë se do të jetë kompetent, i lipset të depërtojë thellë në të”*. (Bejlari, 2006; e-article). Tek studiuesja Bejlari, theksohet ndjenja e veçantë që ka për letërsinë shqipe, andaj ajo arrin që përmes studimeve të saj gjurmuese të shqipes, ti sjell lexuesit mënyrën e informimit sa më të saktë për letërsinë shqipe, duke studiuar dhe analizuar karakteristikat më kryesore të letërsisë shqipe në periudhat e saj. Ajo me përkushtim dhe mprehtësinë e një shkencëtareje ka dhënë dhe vazhdon ende të jap kontributin e saj shkencor në studimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, dhe ajo që është e rëndësishme nga këndvështrimi im, është citimi i studiueses Oana, që thotë: *“Nuk është e lehtë të lexosh veten përmes syve të tjetrit dhe kjo detyrë është dy herë më e ndërlikuar për përkthyesin, i cili duhet të mbajë anën e autorit për t'i dorëzuar botuesit një përkthim objektiv dhe jo një rishkrim”* (Gheorghiu-Celia, 67 :2018 e-article)

Në bashkërrjedhjen e shumë studimeve për letërsinë shqipe, albanologia Rusana Bejlari liston në studimet e saj studiues e shkrimtarë të cilët prodhojnë gjuhësi e letërsi të mirë dhe të një rëndësie të veçantë. Duke u nisur nga kjo mund të filloj me emrin e njërit nga gjuhëtarët më të shquar të kohës Idriz Ajeti. Në konferencën e organizuar nga Instituti albanologjik në vitin 2017, në 100 vjetorin e lindjes së Profesor Idriz Ajetit, studiuesja Bejlari merr pjesë me kumtesën *“Rreth hetimeve gjuhësore në fushën e studimeve shqiptare- sllave në vështrimin shkencor të prof. Idriz Ajetit”*. (Bejlari, 2017:205)

Studiues e shkrimtarë tjerë të cilët janë në qendër të vëmendjes së studimeve të saj, është studiuesi dhe profesori Agim Vinca, me studimin titulluar *“Agim Vinca dhe alternativa letrare shqiptare në Kosovë”*, dhe nga studimi mjaft i detajuar i krijimtarisë poetike të Agim Vincës, studiuesja Rusana vije me një përfundim si, *një nga shkrimtarët më origjinalë, të cilin e shquan mënyra e të menduarit dhe shprehja origjinale*. Vazhdon me shkrimtarin tjetër i cili jetoi në Bullgari por që është me origjinë shqiptare Thoma Kacorri, për të cilin shkroi edhe monografinë; *Shkrimtari shqiptar Thoma Kacori në Bullgari- Jeta dhe vepra-(1922-2008)*, Sofia, 2022), e gjithashtu edhe shkrimtaren e studiuesen Shefkije Islamaj, *“Mos më thuaj se më ke parë ëndërr”*, ku në një mënyrë origjinale, albanologia Rusana aktualizon tjetërsinë e në vështrimin e saj për romanin e shkrimtares shqiptare Islamaj. Pena mjeshtrorë dhe mendjehapur e autores së romanit, futet thellë në rrethanat dhe mentalitetin shqiptar. Gruaja, që në letërsinë shqipe të traditës herë del viktimë e kanunit e herë viktimë e rrethanave dhe kushteve të vështira të jetës si rrjedhojë e zakoneve patriarkale, në letërsinë më të re shqipe del edhe si viktimë e luftës. Kritika e vërtetë dhe me rëndësi që i kushton romanit, kur i thekson njohuritë e saj dhe formën e saj të botëkuptimit, andaj studiuesja vijon, *“Nga këndvështrimi i romanit të Shefkije Islamajt ky akt kulmor shërben edhe si pastrim të plagës shoqërore të shfaqur në rininë e thyer të Butës dhe në paradigmen e shtrembër të opinionit publik”*. (Rusana, 2018;522).

#### Dy popujt në fushën e përkthimit

Gjatë rrjedhës së studimit, do të theksohet qasja ndaj përkthimit në një kontekst imagologjik. Duke analizuar konceptin e objektivave të disiplinës së imagologjise, që brenda një letërsie të caktuar të kemi gjykime nga një letërsi tjetër e huaj, në këtë rast do kemi qasjen kërkimore në rrjetëzimin e librave të përkthyer nga gjuha shqipe në atë bullgare.

Studentët bullgarë gjithashtu kanë mundësi të lexojnë edhe përkthime nga gjuha shqipe në atë bullgare nga albanologia dhe përkthyesja Rusana Bejleri. Kemi pra të përkthyerat vëllimin titulluar *“Poezi”* të poetit Adem Gajtani, poemën *“Toka”* të shkrimtarit Nehas Sopaj, tregimin *“Robi”* të shkrimtarit Kim Mehmeti dhe tregimin e shkurtër *“Valltarja e Dukagjinit”* të shkrimtarit Ernest Koliqi, Eqrem Basha me pjesë të përkthyerat të romanit *“Alpinisti”*.

Duke zgjedhur librat e përkthyer që do të përfshiheshin në këtë studim, d.m.th, librat të cilat i ofrohen lexuesit bullgar, përmend disa nga shkrimtarët e shumtë shqiptarë, si: Flutura Aça- *“Vetmi gruaje”* (roman), Dritëro Agolli-*“Poezi”* (përmbledhje); Majlinda Bregasi *“ikje”* (roman), Mimoza Ahmeti-*“Pjalmimi i luleve”* (poezi), Lindita Arapi *“Melodi të heshtjes”* (poezi), Sali Bashota-*“Bukuri e nëmur”*(poezi), Osman Gashi *“Përtej harresës”* (poezi), Agim Vinca *“Sonet i vetmuar”*(poezi), Eqrem Basha *“As plagë, as këngë”* (poezi), Luan Starova *“Koha e dhive”*(roman),

Fatos Kongoli “Jeta ne një kuti shkrepëse”(roman) dhe “Ëndrra e Damokleut” (romani tjetër cili është mbartës i çmimit “Ballkanika” të vitit 2002.),Shefkije Islamaj “Mos më thuaj se më ke parë ëndërr” (Roman), Luan Starova “Koha e dhive” (roman), Rudina Xhunga“Poezi”, Visar Zhiti “Poezi”, Olimbi Velaj “Qenia Pasdite”(Poezi), Xhevahir Spahiu “Poezi”, Mehmet Kraja “Tregime”, Bardhyl Londo“ Poezi”, Ismail Kadare “Poezi”, “Në periferi pran aeroportit” (Tregim), “Nata e Sfinksit”(Tregim), “Muri kinez”(Tregim)Romanet e Kadaresë në Bullgari, Luljeta Lleshanaku “poezi”,Beqir Musliu “Gruaja në verandë” (Tregim), “Narcisja ose balada për Fatimen”(Tregim), “Mezarja”. (Tregim) “Kronikë e pagjuhë”(Tregim) “Arkivol për Sadek Hedajatin”(Tregim)

Zija Çela “Misteri i jetës” (tregim) “Nëna e Odetës”(tregim), Rexhep Hoti “Ndëshkimi i Kujtimeve” (poezi), Ali Podrimja “Kush do të vrasë ujkun” (Poezi), Lasgush Poradesi “Vallja e yjeve”(Poezi), Maks Velo “Kokëqethja” (Poezi), Naime Beqiraj, “Hijeshia e lumit”, etj.

Në përhapjen e gjuhës shqipe në hapësirën e gjuhës bullgare dhe anasjelltas kontribuuan dy nga profesorët e rëndësishëm si, Prof. Rusana Beleri dhe Prof. Agim Vinca. Studimi i Beylerit, “*Agim Vinca dhe alternativa letrare shqiptare në Kosovë*” arrin ti kap në përgjithësi të gjitha gjërat nga më të rëndësishmet nga jeta dhe puna e një intelektualit. Ndryshe prej studiueses Rusana, e cila arrin të ofrojë te lexuesi bullgarë një pasqyrë të qartë mbi arritjet letrare dhe shkencore të letërsinë shqipe, Prof. Vinca arrin të përkthej vëllimin poetik të poetes Blaga Dimitova “Ballkaniada” poezi&ese”, në vitin 2000. Kështu të dy autorët pasuruan ndjeshëm kulturën e dy popujve, Vinca me përkthimin librit të shkrimtares Blaga Dimitrova, ndërsa Rusana Beyleri duke i kushtuar një studim të veçantë krijimtarisë së tij dhe studime tjera të ndryshme për gjuhën dhe letërsinë shqipe. Elementet e ndryshme të kulturave dallohen me anë të komunikimit në mes tyre, dhe autorët e përmendur këtu Rusana Beyleri dhe Agim Vinca ofrojnë një pasqyrë të qartë të lidhjeve letrare dhe kulturore shqiptaro bullgare, në të cilën të dy autorët shfaqen si një zë i arsyes dhe i bashkëpunimit midis shkencëtarëve dhe intelektualëve.

## Përfundim

Jemi dëshmitarë të asaj që, bota dhe nevojat e botës në të cilën jetojmë po ndryshojnë, dhe njerëzimi ka nevojë për një mendje të hapur në gjithë këto lëvizje të kohës. Ndryshimi i koncepteve po shoqërohet edhe me ndryshimin e realiteteve të jetës. Për këtë arsye, lëvizja drejt qëllimeve të reja duhet në çdo shoqëri. Letërsia shqipe për tu integruar në letërsitë tjera dhe për të krijuar rreth më të gjerë lexuesish, do të realizohet nëse do fillonim të merreshim më shumë me studimin e imagologjisë si një orientim i ri modern në shkencën e letërsisë krahasuese. Megjithëse, për shqiptarët dhe kulturën shqiptare ka shumë studiues, historian, e gjuhëtarë të cilët shkruajnë, për të identifikuar praninë e shkrimtarëve edhe të studiuesve të

huaj në letërsi, duhej studiuar edhe përkthimet të cilat janë të duhura për letërsinë tonë.

Nga çfarë do të na gjykojë bota? Kjo është baza e rëndësisë së imagologjisë, dhe është pyetja më frymëzuese dhe integruese prej së cilës shpresojmë të nxjerrim bërthamën e së vërtetës se, rruga të cilën do e ndërtojë njeriu i ri ballkanas, është ajo e së vërtetës, pa paragjykime se rrezikojnë të konceptojnë një shkrimtar të shtetit të tyre fqinje si të privilegjuar. Do të ishte e dëshirueshme që shtetet e Ballkanit të zgjedhin rrugën më moderne të mundshme dhe të përktheheshin edhe shkrimtarë të tjerë të rinj, që të pasurohen ndjeshëm kulturat e popujve ballkanase për të mësuar mbi vlerat kulturore të letërsisë së vet dhe të letërsive të tjera.

Abstrakt

## IMAGOLOGJIA DHE PËRKTHIMI

### LIBRAT E PËRKTHYERA NGA GJUHA SHQIPE NË ATË BULLGARE

Kultura është toka e cila na bashkon të gjithëve- thotë gjatë një interviste, Janka Selimi përkthyes nga gjuha bullgare në atë shqipe. Katër kategoritë që shoqërohen më shpesh me termin kulturë janë, gjuha, kombësia, përkatësia etnike dhe përkatësia fetare. Është e kuptueshme se, në kontaktin e parë me një kulturë tjetër, krijohet ndjesia e imazhit për kategoritë e cekura më lartë, që do të thotë, me një fjalë mund të themi se në ato kategori përmbledhet e tërë mënyra e të jetuarit të atij populli. Këndvështrimet që zotëron rreth atij populli tjetër të bën ta kuptosh ndryshimin që ekziston mes teje dhe tjetrit. Andaj, për ti kuptuar më në detaje këto ndryshime që ekzistojnë në mes kulturave, e gjithashtu edhe perceptimin e të tjerëve për ty, është e domosdoshme që të jemi të njohur edhe me përfaqësimin letrar e kombëtar jashtë vendit.

Për të identifikuar praninë e shkrimtarëve dhe të studiuesve të huaj në letërsi, duhej studiuar përkthimet të cilat janë të pranishme. Përkthimi i një autori në gjuhë të huaj është njëri nga segmentet e cilësisë, vlerës së veprës dhe krijimtarisë së tij. Qasjes hulumtuese në zgjerimin e rrjetës së përkthimeve i dhanë jetë shumë studiues e përkthyes, dhe analiza aktuale do të përqendrohet kryesisht në marrëdhëniet ndërkulturore, në atë shqipe dhe bullgare, përkatësisht në përkthimin e autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare. Përfaqësimi i letërsisë shqipe në literaturën bullgare ka qasje me një numër të konsiderueshëm të veprave. Përkthimi i librave të autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare dhe anasjelltas, është njëra nga shtyllat kryesore për të rritur njohjen e kulturave ndërmjet dy popujve.

Pra, edhe përkthimet janë ajo pjesa e rëndësishme e letërsisë e cila ndërton idenë themelore, pikërisht idenë e tjetrit apo tjetërsisë.

Fjalët kyç: Letërsia shqipe, letërsia bullgare, shkrimtare, përkthimet etj.

## Abstract

IMAGOLOGY AND TRANSLATION  
BOOKS TRANSLATED FROM ALBANIAN INTO BULGARIAN

Culture is the land that unites us all – says during an interview, Janka Selimi, a translator from Bulgarian into Albanian. The four primary categories associated with the term culture are: language, nationality, ethnicity, and religion background. When encountering a new culture, one tends to get an initial impression about the categories mentioned above, categories which essentially encapsulate the entire way of life of those particular people. The perspectives we have about those other people, enable us to comprehend the differences between ourselves and others. Consequently, to gain a more comprehensive understanding of these cultural differences and how others perceive us, it is imperative to become familiar with the national representation abroad.

To identify the presence of foreign writers and researchers in the realm of literature, one should examine the existing translations. The translation of an author's work into a foreign language is one of aspects of the quality, value, and creativity of his/her literary contributions. Numerous researchers and translators have actively contributed to the research endeavor of expanding the network of translations, and this analysis will primarily concentrate on intercultural connections within Albanian and Bulgarian literature, or on the translation of Albanian authors into Bulgarian, respectively. The representation of Albanian literature within Bulgarian literary works involves a significant number of literary works. The translation of books written by Albanian authors into Bulgarian, and vice-versa, is one of the fundamental pillars in fostering familiarity with the cultures of these two nations.

Therefore, translations are too a crucial part of literature, which builds the fundamental idea, specifically the idea of the other or otherness.

Key words: Albanian literature, Bulgarian literature, writers, translations, etc.

## Literatura

- DIMITROVA, Bllaga. (2000). *“Ballkaniada poezi & ese”* Shqipëruar nga Agim Vinca, “Sfinga”, Prishtinë.
- DAVOR, Dukić (2014). “Vezirët dhe Konsujt - Një Analizë Imagologjike” Zagreb, (e-article).
- DAVOR, Dukić. (2009) (Si i shohim vendet e huaja. Hyrje në imagologji-Përgatitur nga Davor Dukić, Zrinka Blažević, Lahorka Plejić Poje, Ivana Brković, Zagreb: Srednja Europa, 203.
- Chevrel, Yves. (2016) “Letërsia e Krahasuar”, Përktheu Ali Xhiku, Naimi, Tiranë.
- BEYLERI, Rusana. (2018) - *“Mos me thuaj se më ke parë ëndërr”*. ISLAMAJ, Shefkije. Shkrime të saj dhe shkrime për krijimtarinë e saj. Prishtinë.
- KRIFCA, Mirlinda. (2019)-Ballkanologjia 2- Tjetri në ciklin romanor të Luan Starovës”,Ballkanologjia sot dhe komunikime ndërballkanike (2018 - 2019) (Komunikime historike, gjuhësore dhe etnokulturore). Seminari ndërkombëtar i Ballkanologjisë. Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve – Shkup.
- HRISTOVA-BEYLERI Russana (2006) *Letërsia shqiptare dhe çështja e homogjenitetit në krahasim*,(Association Internationale de Littérature Comparée – AILC/ International Comparative Literature Association – ICLA). Rrethi Akademik i Letërsisë Krahasuese,anëtar i organizatës ndërkombëtare.
- HRISTOVA- BEYLERI Russana (2017) *“Rreth hetimeve gjuhësore në fushën e studimeve shqiptare- sllave në vështrimin shkencor të prof. Idriz Ajetit”*. *Figurë qendrore e studimeve të shqipes (Konferencë shkencore “Profesor Idriz Ajeti- Në 100 vjetorin e lindjes”)*.Instituti Albanologjik. Prishtinë.
- GHEORGHIU, Oana Celia Imagologjia dhe Përkthimi. Paraqitje e perspektivës së tjetrit për Rumanine. E-article -Viti XI Vol.21 2018.
- HRISTOVA-BEYLERI Russana (2006) *Letërsia shqiptare dhe çështja e homogjenitetit në krahasim*,(Association Internationale de Littérature Comparée – AILC/ International Comparative Literature Association – ICLA). Rrethi Akademik i Letërsisë Krahasuese, anëtar i organizatës ndërkombëtare.
- STAFSA-SHOSHORI, Monika. (2012)- *“Gjuha e tjetrit” si kriter mendësie*”. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Studime Albanologjike -5 Shkup.
- (<https://bnr.bg/sq/post/100100144/libri-i-ri-i-doc-rusana-bejlери-letrsia-shqipe-si-pasqyr-e-shpirtit-t-popullit> )
- [http://www.albanianbg.com/scroll\\_off.htm](http://www.albanianbg.com/scroll_off.htm)
- <https://www.albinfo.ch/interesimi-per-gjuhen-shqipe-mbledh-studiu-es-nga-e-gjithe-bota/>
- Përkthime letrare në bullgarisht [www.albanian.dir.bg](http://www.albanian.dir.bg)



ISSN 2671-3004

UDC 811.111'243:37.091.212

Punim studimor

**Arta TIKA BEKTESHI**  
Mother Teresa University,  
[arta.bekteshi@unt.edu.mk](mailto:arta.bekteshi@unt.edu.mk)

### **CHOOSING THE CORRECT N-WORD OR NPI - A CASE STUDY WITH ALBANIAN STUDENTS**

Zgjedhja e N-fjalës së saktë ose NPI - rast studimi me studentët shqiptarë  
Избор на точниот Н-зборот или NPI - студија на случај со албанските  
студенти

#### Introduction

Forming negative sentences, as well as using the correct negative structures may be challenging when studying a foreign language, as it is the case with Albanian students who study English as a foreign language. The challenge arises from the fact that these two languages differ structurally, which leads to confusion and errors in the use of negation. Standard English only uses single negation, either verbal or non-verbal, as in the examples: a. I don't have *any* money. / b. I have no money., while Albanian is a NC language and uses more than one negative elements in a sentence: c. Ajo nuk erdhi. / d. Ajo nuk tha asgjë. / e. Askush nuk tha asgjë. All these sentences express one single logical negation. Sentence (a) has verbal negation and a NPI, sentence (b) has non-verbal negation, sentence (c) has verbal negation, sentence (d) has verbal negation and one negative indefinite while sentence (e) has verbal negation with two negative indefinites. There is yet another possible negative sentence in Albanian in which verbal negation is accompanied by positive indefinites, such as: f. Ajo nuk tha gjë. Since all these negative sentences in Albanian imply one single negation although they use more than one negators, the question is whether these n-words are negative or not. Giannakidou (2002) makes a distinction between strict and non-strict negative concord languages, claiming that in strict NC languages sentential negation is obligatory, as it is the case with Albanian language.

Giannakidou (2002) also makes a comparison between Greek and English NPIs and comes to the conclusion that “Greek n-words are universal quantifiers, which are additionally polarity sensitive-- since they need negation to be licensed. NPI-universals can only combine with negative (i.e. antiveridical) predicates.” (p.13) Analogous to Greek, Albanian n-words share the same properties and therefore could be considered as NPIs.

Considering the above-mentioned differences that English and Albanian have in terms of the use of n-words and NPIs, it is supposed that EFL Albanian students may make a lot of errors while using n-words and NPIs in English as a result of the influence of their mother tongue. Therefore the aim of this study is to analyze what kind of errors do they make while transforming affirmative sentences into negative ones; as well as the errors in choosing a n-word or a NPI.

#### Methodology

*This case study was conducted with EFL Albanian students from three universities in North Macedonia. Each student was given an exercise sheet with Negation exercises, which consists of two different exercises. In the first exercise the students were supposed to form negative sentences from the given affirmative ones. The sentences are either in present simple or past simple, with verbal negation, negative words and NPIs. On the other hand, the second exercise consists of seven English sentences and five Albanian sentences with double-choice answers. The students had to choose the correct NPI or n-word.*

*The research questions of this case study are:*

- 1. Does the insertion of auxiliaries in the negative form of English simple tenses create difficulties for Albanian students?*
- 2. Do the students know the difference between n-words and NPIs, and their correct use?*

#### Transforming English positive sentences into negative

The first exercise of the Negation exercises, consists of five English affirmative sentences to be transformed into negative sentences. Three of the sentences are in the present simple tense, with or without a positive polarity item, and two sentences are in the past simple, one with a positive polarity item and one without it.

The first example is ‘*Ben always wears trainers*’. This sentence can be negated either by verbal or non-verbal negation. As it is shown in the chart, 70% of the students have correctly transformed it with non-verbal negation using the absolute negator never ‘*Ben never wears trainers*’, while another 10% have correctly transformed it with verbal negation ‘*Ben does not always wear trainers*’, which means the total percentage of correct answers is 80%. The remaining 20% have either used the wrong tense or the wrong negative form.

The second example ‘*They bought a new car*’ has been correctly transformed into negative by 62% of the students ‘*They didn’t buy a new*

*car'*. 20% of the students have used the past simple form of the verb buy along with the auxiliary did as in '*didn't bought*'. 11% have not transformed the sentence at all, but rather they have translated into Albanian, probably confused by the previous exercises. 5% have transformed with the wrong tense '*haven't bought/ don't bought*', and 1% have not transformed the sentence into negative, but have given a positive sentence with an opposite proposition '*They bought an old car*'.

The third example '*There are some beautiful houses*' consists of the verb to be and the positive polarity item some, in the present simple. There was a purposely given PPI, in order to see if they would transform it into a NPI, and 37% of the students did not transform it, so they gave the incorrect answer '*There are not some beautiful houses*'; another 15% of the students have neither used some, nor any in their transformation and another 11% have used no along with a negative verb (aren't no) which is also incorrect. Similarly to the second example, in this one as well 7% of the students have given a positive transformation with an opposite proposition as '*There are some ugly/ old houses*'.

There are two correct transformations of this sentence; by verbal negation '*There aren't any beautiful houses*' which has been transformed by 21 % of the students; or by non-verbal negation '*There are no beautiful houses*' transformed by 6% of the students. The total percentage of correct transformations is 27%.

The fourth example '*Mary has a very big house*' consists of the verb have in present simple and it is a very simple sentence, however from previous experience with students, the verb have usually poses a difficulty for students, and this example confirms that. Less than half of the students (43%) have transformed it correctly '*Mary doesn't have a very big house*', while 38% have transformed it by only adding the negative marker not to the verb have '*Mary hasn't a very big house*', which is incorrect and it may be a negative transfer from Albanian verb kam (nuk kam). As with previous examples, with this one as well 9% of the students have not transformed it into a negative sentence, but rather into positive with opposite proposition '*Mary has a very small house*', and the remaining 10 % have not transformed it at all or have translated it instead.

The fifth example '*You had something in your hands*' consists of the verb have in past simple, as well as the PPI something. As such it has two different transformations into a negative sentence: by verbal negation '*You didn't have anything in your hands*' which has been done by 21% of the students; and by non-verbal negation '*You had nothing in your hands*' which has been done by only 4% of the students, so the total percentage of correct answers is 25%. The remaining 75% of the students have given negative transformations of this sentence, however there is a mix of tenses as well as a variation of the PPI something, NPI anything and the n-word nothing. Similarly with the fourth example, out of those 75%, 32% have used verbal negation without adding the auxiliary did (hadn't something/

anything/nothing), which is again a negative transfer from their mother tongue.

#### Discussion of negative transformations

